

RUZHDI PULAMA

**zjarret
e shkurtit**

(ROMAN)

891.983-31

S.

P 97

R U Z H D I
P U L A H A

Christo Aliaj

Z J A R R E T
E
S H K U R T I T

(Roman)

~~53031~~

SHËNJA E SHËNËS
SHËNËS

8647

SHËNJA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

NGJITJE ME NGARKESË TË RËNDË

Shoferi e kupton shumë mirë ç'do të thotë kjo. Ai kujton të përpjetën e rrugëve malore, ku maqina gulçon si një buall i lodhur nën peshën e rëndë, dhe motori nxehet së tepërmi nga sforcimi dhe e mbush kabinën me një vapë të padurueshme. Edhe fshatari e di mirë dhe e kujton kur ngjitet malit me kalin që mban kuintalin mbi kurriz. Kafshën e mbysin djersët, shkrofëtin nëpër dhëmbë e flegrat e hundës i zgjerohen sa të futësh grushtin. Është e lodhshme ngjitja me ngarkesë të rëndë! Natyrisht, kjo varet edhe nga ngarkesa, nga lloji i saj.

Ajo e bënte për herë të parë një rrugë të tillë, nën një peshë të tillë. Valixhja që mbante në dorë, ishte e vogël, po e rëndë. Aty kishte një bluzë leshi, një fustan e ca ndërresa. Kishte dhe disa libra e broshura... Po tamam ato rëndonin aq shumë, sikur të ishin prej hekuri. E keqja ishte se ajo ndjente të rëndë edhe kokën. Dhe, ndonëse natën e shkuar kishte fjetur mirë, asaj i rrihnin tëmthas dhe i digjte palca e kurrizit aty rrëzë qafës, ku fillojnë e bashkohen shpatullat. Kishte gati një orë që ecte nëpër atë udhëzë të përpjetë

e dredhake, të rrahur nga këmbësorë e kafshë të samarit. Xhadeja kish mbetur pas dhe tani as që i dukej shenja nëpër atë relief të thyer e të gjelbëruar. Dielli qe varur poshtë. Diku larg, në një grykë midis dy majave, po formoheshin ca si mjegulla të kaltëra, që ngjanin si vërshime ujërash. Po Vali as që i vinte re këto bukuri malore. Ajo çapitej ngadalë të përpjetës. Sytë kishin filluar t'i digjnin prej djersës. Kur ju vu kësaj rruge, e mori me të shpejtë e me gaz, po dalëngadalë filloi të ndjejë rëndësinë e peshës dhe tani i dukej sikur në vend të kokës kishte mbi supe një shkëmb, që duhej ta ngjiste në majë të malit.

Në komitetin e partisë së rrethit të saj, ashtu si shoqet e tjera, edhe atë e kishin përgëzuar, i kishin folur për rëndësinë e detyrës që po merrte përsipër, i kishin shtrenguar dorën dhe i kishin uruar rrugë e punë të mbarë. Edhe në komitetin e partisë së rrethit ku kishte ardhur, i kishin përsëritur rëndësinë e madhe të detyrës, i kishin dhënë një urim tjetër dhe i caktuan tshatin ku do të shkonte. Për fshatin ajo dinte vetëm se quhej Malas, se organizata e partisë e kooperativës ishte njoftuar për vajtjen e saj dhe se atje të çonte kjo udhëzë dredhake, plot të përpjeta. Vetëm kaq.

Si la pas dy kodra të taracuara, udhëza e nxori në një shpat të qethur nga shkurret e drizat. Gjethet e tyre, megjithëse të prera prej kohësh, ende s'e kishin humbur gjelbërimin. Pesha e mendimeve, herë të copëtuara e herë të mpleksura, që ajo s'ua gjente dot fillin, sa vinte e bëhej më e rëndë.

«Si do të jetë ky Malasi?!»

Nga përshtypjet që ruante nga fshatrat ku kishte qenë si eskursioniste apo si anëtare e brigadës kulturele të shkollës, mundahej të krijonte një Malas në mendjen e saj.

«Po njerëzit?! Si do të jenë njerëzit?!»

Dhe i parafytyroheshin ca fytyra të panjohura. I bëhej sikur gjithë kooperativistët ishin mbledhur në mes të fshatit dhe po e prisnin me padurim, siç presin delegatët. Pastaj i çfaqej një tablo krejt ndryshe... Sheshi para fshatit ishte bosh... Nëpër rrugë takonte ca burra të vrëjtur e të heshtur, që e shikonin shtrembër. Një grup djemsh diç pëshpërisnin e qeshnin me të madhe. Gratë dhe vajzat nxirnin kokën në dritare dhe e shikonin me habi...

Tani ecte nëpër një grykë të ngushtë e të thellë, përtej së cilës shpaloseshin copëza kaltërsish të kthjellta. Kësaj here s'mundi t'i shmangej bukurisë së natyrës. Ajo s'kishte parë kurrë qiell aq të pastër, aq të kthjellët dhe s'qe ndodhur kurrë aq pranë tij. I dukej sikur, me të dalë nga gryka, do t'i prekte me dorë ato copa qielli, që sa vinin dhe bëheshin më blu. Një çast i mbajti sytë mbi to dhe ecte pa parë ku shkelte. Dhe ja, papritur copa e qiellit u mbush me shkronja të pakuptueshme, të cilat, duke u dridhur si tufa e rrezeve të projektorit të kinemasë (kur operatori do të fiksojë figurën mbi ekran), nisën të rreshtohen në radhë e në kolona... «Dje u nisën nga qyteti... tridhjetë vullnetare për në zonat e thella malore. Entuziazmi, gatishmëria e tyre revolucionare s'kanë të përshkruar...»

Shkronjat u drodhën përsëri e rreshtat nisën

të shthuren. Vetëm germat e mëdha të titullit ajo
i shquante ende nëpër atë perde të turbullt:
«U NISEN LUFTËTARET E SË RESE».

«Luftëtare...» — tha me mend Vali dhe ngriti
e uli dy tri herë me radhë valixhen, siç bëjmë kur
duam të provojmë peshën e një sendi.

«Ju po niseni në një betejë», — i kish thënë
dikush Valit. «Do të luftoni me zakonet prapa-
nike, me kanunin, me paragjykimet...»

Ajo peshoi përsëri valixhen në dorë, si për të
matur peshën e municionit.

«Vërtet, vetëm këto shtatë a tetë libra e bro-
shura që kam nënvizuar me laps të kuq, janë gjithë
armët e mia!? Si do të luftoj unë!? Mos vallë do
të gozhdohem pas një tryeze që s'ja di as formën,
apo në një sallë të panjohur, si mitralieri në po-
zicionin e zjarrit rrethor e do të qëlloj pa reshtur?
Po armiqtë do t'i kem përballë, apo të fshehur
kushedi se ku?

E mbytën pyetjet. Ç'probleme do të kishte
fshati? Si do të luftonte ajo? Si do të ishin nje-
rëzit?... Dhe, mbi të gjithë këta zëra, ajo dëgjoi
përsëri zërin e sekretarit të komitetit të partisë:

«Puna e gjallë me njerëzit... Mos e harroni
këtë... Sidomos këtë... Eshtë kryesore...»

Këto fjalë ua kishte përsëritur vullnetareve
edhe kur po nisej autobuzi.

Vali puliti nja dy herë sytë dhe sikur u për-
mend. Mbushi mushkëritë me ajrin e freskët. Dielli
po futej pas një maje të mprehtë dhe i ngjante
një shalqini të madh, të cilit i kanë hequr një
thelë. Shpejtoi hapin. Tani udhëza e tërhiqte me
një forcë të pakuptueshme. Ndjenja e detyrës!?

Kureshja për të panjohurën që priste t'i çfaqej!? Apo frika se mos e zinte nata aty midis shpateve, ku hijet e shkëmbinjve e të drurëve ngjajnë si silueta fantastike!? S'dinte si të përgjigjej, veçse e ndjente se ajo forcë po e tërhiqte si një litar i fortë. Ndaj e shpejtonte hapin.

Me të dalë nga gryka, u ndodh përpara një lugine vezake. Përballë ju çfaq Malasi. Qëndroi një çast dhe krahasoi tablonë që kishte parasysh me atë që ishte munduar të krijonte me mend. Asnjë përgjasim. Shtëpitë i vinin luginës si një vetull e trashë, që hollohej në të dy skajet. Hijet e maleve po stërzgjatëshin me shpejtësi të çuditshme. Kur hyri ajo në fshat, kish filluar të binte napa e muzgut. Rrugët ishin shtruar me gurë të hirtë e të bardhë. Edhe shtëpitë kishin po këtë ngjyrë. Shumë prej tyre ishin të reja, pothuaj njëlloj, ndërtuar me një stil të thjeshtë e të bukur.

Ja dhe njerëzit. Dikush tërheq një lopë për kapistre, dikush rregullon hunjtë e gardhit, një tjetër ndjell pulat për në qymez... Pleqtë veshur me shajak të zi, të rinjtë me rroba të lehta... Gratë e vajzat hynin e dilnin nga shtëpia në oborr e merreshin me punët e shtëpisë.

Të gjithë ata që takonte rrugës e përshëndesnin me përzemërsi, pa pritur t'u fliste ajo e para. Sec kish diçka të vakët e të butë në ato shikime e zëra të panjohur, që Valin e mbështillnin si me një mbulesë të butë prej pushi dhe i shkakttonin një si ndjenjë të pakuptueshme. I vinte inat që s'i kishte përfytyruar kështu këta njerëz të thjeshtë e mikpritës. Pyeti një meso burrë se ku ishin zyrat e kooperativës dhe ai u nis ta shoqë-

ronte pa fjalë, pa treguar asnjë shenjë kureshtjeje.

— Dua të takoj sekretarin e partisë, — tha ajo si kishin bërë një copë rrugë.

— Epo kështu më thuaj, dua Fadilin, që të merremi vesh, — tha fshatari dhe ndërroi drejtim. Ai ishte i heshtur. Ecte dy tre hapa para Valit. Midis buzëve të plasaritura mbante një cigare të trashë. Duart i kishte lidhur pas shpine.

— Kanë një mbledhje, — tha pas pak. Vali deshi t'i thoshte se do ta priste sekretarin sa të mbaronte mbledhja, po fshatari vazhdoi rrugën pa e kthyer kokën, dhe ajo, ndonëse u mat disa herë, s'guxoi të hapte gojë.

Mbledhja bëhej në vatrën e kulturës. Ishte një ndërtesë e re, me dritare të mëdha, që me sa dukej s'e kishte mbushur vitin që qe ngritur. Fshatari trokiti me çok dhe, pa pritur përgjigje, hapi derën.

— Fadil, të kërkon një çupë e largët.

Vali përsëri seç deshi të thoshte, po s'pati kohë. Sekretari i buzëqeshi dhe i bëri me dorë që të futej brenda. Ajo ngurroi kur pa gjithë ato shikime. Fadili u ngrit dhe, duke ju afruar, i tha:

— Hyrë, moj, brenda... Hajde...

Dhe ajo e kaloi prakun e ndrojtur. Ai i shtrëngoi dorën dhe e tërhoqi drejt tryezës. Një burrë zeshkan u hoq pak mënjanë dhe i bëri vend pranë Fadilit. Në sallë mbinë pëshpëritje. Një djalë i ri qëndronte më këmbë në mes të sallës. Me sa dukej i kishin prerë fjalën e priste të vazhdonte.

— Mirse na erdhe... Mos u ndruaj... Rri rehat, — dhe Fadili ju drejtua atij që po priste më këmbë: — Hë, Demir, vazhdo.

Ai nisi të fliste, po salla s'kishte qetësi. Fadili tërhoqi nja dy herë vërejtjen, po ishte e kotë. Pastaj u kujtua dhe u ngrit:

— Kjo shoqja është nga B... Ka ardhur vullnetare në kooperativën tonë. Do të punojë e do të rrojë ca muaj tok me ne. Me një fjalë e kemi të shtëpisë e s'ka pse të ndruhi.

Kaluan ca dallgë të forta pëshpëritjesh, që i mblodhi e i platiti një plak aty në krye të sallës:

— Epo kështu, o Fadil, de... Mos e humb të shkretën...

Demiri e ngau fjalën më tej:

— Unë e kam thënë, e thashë edhe këtu e prapë po e them, Kasëmi s'është për brigadier. Le për punë që s'është e s'është, po ka edhe ato të tjerat. Ç'pret nga një njeri që rreh të bijën? E pse? Se i tha një të vërtetë. Po ajo bënte mu. E bija për të mirë i foli... Ç'ta zgjatim kot! Unë e thashë, ta heqim.

Demiri u ul.

— Kush e do fjalën?

Nuk u çua njeri. Pyetja u përsërit disa herë. Heshtje. Po heshtja i ngjante një kapaku, që avulli e ngre dhe e ul papushim. Diskutime kishte plot. Ato zienin në sallë.

— Mirë je, moj çupë? — e pyeti Valin burri zeshkan, që ishte ulur pranë saj.

— Mirë! — u përgjegj vullnetarja me gjysmë zëri dhe ju duk sikur tjetri ja bëri atë pyetje për ta lehtësuar nga ndrojtja e turbullt që e kish pushtuar. I dukej vetja si një dorë e fortë, që i rëndonte kapakut për të mos shpërthyer avulli. Vërtet prania e saj po pengonte diskutimet!?

— E po ç'është kjo, mor shokë? Pse s'flisni? Ju vetë e kërkuat mbledhjen. Kush e do fjalën?

Kësaj here Fadili s'kishte nevojë të përsëriste pyetjen. U ngrit një burrë i shkurtër e gjoksgjerë, me një palë mustaqe të dendura e të zverdhura në mes, si t'u kish rënë bryma.

— Kam dhe unë nja dy fjalë. — Nxori një kollë të thellë e të mbytur, dhuratë e duhanit të shumtë që pinte. — Të marrtë djalli, të marrtë! E mallkuar!.. E kisha fjalën te Kasëmi, de... Unë jam me Demirin. Ay s'është brigadier, po kumandar. S'na duhen kumandarët këtu... Oj, na është bërë më keq se Zencja qëmoti! Në fillim ishte ndryshe. Tani na rri tërë hundë e buzë e s'të thotë kurrë një fjalë të mirë, s'të thotë. I duket vetja kushe-di... Sa kemi parë ne..! Le pastaj me atë punën e çupës, që e qelbi fare. S'kishte faj e shkreta. Shpresa i ktheu fjalë... Me hak ja ktheu. Ai desh ta përzinte nga puna. Ne s'e lamë. Edhe e bija i tha një fjalë. Me të drejtë ja tha. Në darkë lojti huri pastaj. S'kish ç'ti bënte gomarit e ju fut samarit... Ta heqim!

— Ta heqim! — u dëgjua një zë gruaje. Disa nga burrat kthyen kokën.

Valit i dukeshin si të pabesueshme ato pyetje, që e kishin ndjekur në udhëzën dredhake. Nganjëherë i dukej e pabesueshme edhe që kishte arritur në fshat dhe që për të kishte filluar jeta e vullnetares. Kishte filluar në një mënyrë të çuditshme, që ajo s'e kishte marrë kurrë me mend.

A ju ka qëlluar ndonjëherë të bëni një vizitë jo të zakonshme te njerëz të panjohur, në një shtëpi të panjohur? Sigurisht, kini qenë të emocio-

nuar. Po, sidoqoftë, duke kaluar nëpër shkallë e pastaj nëpër koridor, vizitori ja merr erën shtëpisë, merr me mend diçka edhe për dhomën ku do të hyjë, edhe për njerëzit që do të takojë. Kështu emocionet sikur zënë e shtrohen. Po ç'do të ndodhte sikur, me të hapur portën, të ndodheshe drejt e në dhomë ku njerëzit bisedojnë për hallet e shtëpisë?! A nuk do të dhjetëfishoheshin emocionet?!

Kështu e ndjente veten edhe Vali, të cilën fshati bujar e kishte pritur drejt e në thela... Dhe, ndonëse ajo e nuhati ngrohtësinë e mikpritjes së Fadilit, nuk e mposhtte ndrojtjen.

— Dale një herë, dale... T'i marrim radhën... Me lejë!

— Hë, Qeram?

— Këtu u thanë plot gjëra... Ashtu. Po u përzien e u bënë ujëm, të bardha e të zeza, të thata e të njoma; të drejta e të shtrembëra...

Në sallë nisën pëshpëritjet. Tek-tuk e thumbonin atë që kishte marrë fjalën.

— E, siç e thashë, u bënë ujëm, — ngriti zërin mbi pëshpëritjet Qerami. — Po fundja njeriu një mendje ka dhe flet si ja pret e tija.

— More, bjeri drejt e mos e shko fjalën pas gardhit, — i tha një aty pranë dhe i tërhoqi cepin e xhaketës.

— S'them se jo, bre... Kasëmi mund të ketë edhe gabime. Rrëmbehët nganjëherë. Bërtet, thonë. Epo prej gjaku e prej mishi jemi fundja. Nerva janë këto të shkreta... Kasëmi për punën nxehej, se mos...

— Qeram... — deshi t'i tërhiqte vërejtjen dikush.

— E... e, ca më i matur duhet të jetë, s'them se jo... Sa për atë të çupës, unë them të mos e marrim kallëp. Fundja bëri ç'bëri me të bijën, në shtëpi të tij e bëri. Në s'do rrimë të fusim hundët poçe më poçe... Po t'i futnim kudo, do ndjenim nga një erë... Kështu them unë, punën e çupës ta lëmë mënjanë. Nja dy thanë «ta heqim»... Dale, bre...

Dikush s'u përmbajt dot:

— Bjeri shkurt, de, se na plase... Oj ky! Kur është puna për normat: «Të mos i ngremë, se s'ja dalim dot», kërcen përpjetë. Po këtë normën e llafeve s'e ule një herë. Bjeri or shkurt, se s'do gdhijemi këtu.

— Shkurt do ti? Të mos e heqim, ja shkurt, — dhe Qeram i u ul.

— Të vijmë të tharta këto kumbulla, prandaj...

— Mua kështu ma pret kungulli.

Sepse ke bërë fole nën hundën e Kasëmit, prandaj... Ta morëm erën vonë... «Të mos e heqim», thotë! — foli Demiri i nxehur, pa luajtur vendit.

— Ti kafsho gjuhën aty, atë bëj... S'jam nga ata burra unë. — Shumica qeshën. — Le që e di unë ku e ke hallin ti... Të heqësh Kasëmin e t'i zësh vendin... Më tregon mua ti! Ahu... Kur the ti rrush, unë kisha ngrënë një barrë.

Kaq u desh që mbledhja të merrte zjarr.

— Mos thuaj që s'ka frymë revolucionare... Kërcet edhe këtej nga ne kritika, — i tha sekretari Valit, pa e fshehur krenarinë. Asaj po i largohej ndrojtja e hutimi i fillimit dhe shqisat nisën të

depërtojnë më thellë në atë botë të panjohur. Atë e tërhiqte thjeshtësia me të cilën flisnin këta njerëz me fytyra të bronxëta, të rrahura nga erërat e grykave dhe të pjekura nga dielli. Shpirti i pastër fshatarak sikur e ngazëllente. Asaj i bëri përshtypje edhe diçka tjetër: në radhët e para ishin ulur vetëm burra, kurse gratë qenë reshtuar pas tyre. Ajo i ndjente shikimet e atyre që mbushnin sallën. Disa i buzëqeshnin, kurse burrat në përgjithësi i shihnin ftohët, po jo pa interes. Po kushedi, mbase në kujtesën e dikujt portreti i saj atë mbrëmje do të mbetej i paharruar: flokët gështenjë, të mpleksur nga flladet e rrugës, që ja tregonin edhe më të vogël fytyrën e saj të hequr, sytë e zinj me atë shikim pak të turbullt, vetullat e mbërthyera, duart e vogla me gishtat e hollë, trupin e kursyer në mish. Po asaj as që mund t'i shkonte ndërmend një gjë e tillë. Ajo mendonte për mbledhjen. Një plak ishte ulur këmbëkryq mbi një stol, kishte hapur kutinë e duhanit dhe thurte cigare. Dhe ashtu siç qe, lëshonte nga një fjalë. Dikush u ngrit e foli duke i prerë fjalën një tjetri, me opingë në duar, të cilën e kish hequr për t'i nxjerrë një kotkë spangoje, që i vriste këmbën. Askush s'bënte deklarata, askush s'fillonte me ato hyrjet e gjata të frazomanëve, që ta bëjnë kokën daulle. Valit ju kujtua se dikur kish menduar se, përveç ndonjë shakaje, në mbledhje s'mund të gjeje gjë tjetër të bukur, se mbledhjet janë të gjitha njëllor: njerëzit grumbullohen, shirojnë një problem, diskutojnë, marrin një vendim e pastaj dalin me kokën të rëndë. Kjo u përkiste viteve të shkuara, kur ajo ishte nxënëse e klasës

së dhjetë. Për këtë ishte kritikuar edhe në mbledhjen e organizatës së rinisë. Po ja, kjo mbledhje brigade ja kujtoi përsëri gabimin e hershëm.

Zjarri i diskutimeve s'kish të shuar. E merrte fjalën njëri, tjetri shtonte një frazë, dikush korrigjonte, një tjetër aprovonte, dikush ankohej...

— Shoqet sikur... — hapi gojën më në fund Vali.

— Këtej, ç'është e vërteta, çalojmë një çikë... Po dhe aq të turpshme sa duken, nuk janë. — Fadili, duke i folur Valit, hodhi sytë nga fundi i sallës dhe gratë e vajzat zunë të lëvizin.

— Vetëm burrat do të flasin? Po ju, shoqe, s'kini gjë për të thënë? S'ma ha mendja...

— Ku të lënë këta... — u dëgjua një zë i plotë gruaje.

— Po hë, moj e uruar, folë... — tha me të qeshur plaku që thurte cigare.

— Do të flas posi... — dhe ajo u ngrit. Ishte një grua bojallie, në mes të moshës. Vali u habit që s'e kishte vënë re gjer tani. Ju duk e matur në fillim, po pas pak zuri të fliste me ton të lartë dhe s'lidhte dot dy fjalë.

Dukej qartë që fjalët e saj ishin një shpërthim, një revoltë e çastit.

Pas Merushes u ngrit një vajzë e re, e shëndetshme. I skuqnin faqet tej e mbanë e s'merrej vesh në i kish vetiu, apo ju ndezën prej turpfit. Më shumë kish mundësi kjo e dyta, se, kur fliste, s'guxonte të shihte njeri në sy. Zëri i dridhej e fjalët hera herës i ngatërroheshin. Po dukej që ishte vajzë e pjekur. Dikush lëshoi një thumb (ato s'kishin munguar gjatë gjithë mbledhjes) e plaku

që thurte cigare ju përgjegj me një të kollitur, si për të kruar zërin.

— Është e bija, — i tha Fadili Valit.

Mbledhja vazhdoi edhe ndonjë orë. Foli edhe Kasëmi. Ai u mundua të çfajsohej, po shumica e anëtarëve të brigadës ishin të mendimit ta hiqnin nga detyra e brigadierit. Disa nuk flisnin, kurse Qerami mundohej t'i dilte krah. Më në fund u vendos. Ndonëse në diskutime gratë dhe vajzat u treguan të ndrojtura, kur u hodh në votë, e ngritën dorën të parat. Edhe shumica e burrave votuan për ta hequr Kasëmin.

— Mirë, mirë... Ju e dini, — buzëqeshi ai dhe ngriti supet. Sytë e tij ndeshën në të Qeramit. Prej tyre seç rridhte, diçka e hidhur. Burimet dukeshin të thella e kjo rrjedhë ndoshta do të vazhdonte gjatë.

— Epo kujt do t'ja varim këmborën? — u hodh Bequa, një plak gazmor e i çiltër, që dallonte nga moshatarët. Valit ju dukën fyese ato fjalë për detyrën e brigadierit. Hetoi sallën dhe priti dallgë të reja. Po, për habi të saj, fjalët e Beqos nuk bënë atë efekt që priste ajo. Të gjithë ishin të shqetësuar për zgjedhjen e brigadierit të ri... Edhe Vali mundohej të merrte me mend se kush mund të zgjidhej. Biseda vesh më vesh. Shikime të kryqëzuara. Pyetje në heshtje.

— Hë, bre, vini gisht, se na mbeti këmbora në duar... — nxiti xha Shahini duke mbyllur kutinë e duhanit.

— T'ja varim sat bije, — thumboi rëndë Qerami.

— Këput gjuhën ti mos leh shumë. More vesh?

U ngrit Demiri:

— Qerami e tha me thumb, po më duket se i ka rënë shenjës. Gonxhen të vëmë... Do ta ketë ca si zor në fillim, po do të mësohet... Do ta bëjë...

— Punë që s'bëhet, — desh t'u vinte kosën diskutimeve xha Shahini.

— Këmbora do dash e jo dele... — doli si nga pusi një zë i ngjirur.

— Na ndriti dashi që kishte këmborën, — ja preu një grua.

Dikush u ngrit e propozoi Demirin, po ai nguli këmbë për Gonxhen dhe diskutimet morën rrugë. I ati kundërshtoi disa herë. Edhe ajo kundërshtoi, po këmbora i mbeti që i mbeti. Pas mbledhjes, kur filluan ta uronin, Gonxhes ju bënë faqet edhe më të kuqe sëç ja pa Vali, kur ajo u ngrit për të diskutuar. Dukej e hutuar, e trembur.

— Ta mbash me shëndet! — e pickoi me fjalë Kasëmi dhe doli pa i thënë njeriu natën e mirë.

Salla u boshatis. Aty mbetën vetëm Gonxhja, Fadili, Vali dhe Demiri. Fadili e uroi dhe i ra shpatullave me një dashamirësi atërore. Edhe Vali i dha dorën dhe ndjeu se pëllëmba e saj ishte qullur nga djersët.

— Mos e merr me frikë, Gonxhe... Shoqet e shokët do të të ndihmojnë. Partinë do ta kesh pranë... E bën ti, për bukuri... i tha Fadili. Ajo s'fliste. Mbante sytë përtokë e ngrinte supet. Përshëndeti e bëri të dalë. Demiri u nis ta përejellë, po, pa kapërcyer prakun, xha Shahini u koll për të thënë që ishte aty. Pas tyre dolën edhe Vali

me Fadilin. Ishte një natë e kthjellët e freskët e plot tinguj të panjohur për banoren e re të fshatit. Ajo u mbush thellë me frymë. Ajri i pastër e pak si i lagësht sikur ja freskoi humorin.

— Po he një herë... Toke «zyrtarisht», — i shtriu dorën Fadili buzagaz, pasi provoi derën në ishte mbyllur mirë. — Si i le nga shtëpia?

Valin e preku toni i tij familjar. Ai e pyeti se ç'njerëz kishte në familje, në e kishte lodhur rruga e gjatë dhe si i qe dukur fshati. Ajo përgjigjej shkurt. Zëri i tij i ngrohtë e tulate. Si e mbyti në pyetje, ai filloi t'i tregonte për fshatin.

— S'do të kalosh keq këtu. Fshatin e kemi të mirë, njerëzit të mirë... Këta dy vjet që u ngrit kooperativa, janë bërë plot ndryshime, plot gjëra... Po të themi atë që është: akoma jemi prapa. Duhet punë e madhe, jo shaka! Ja, ke për të parë me Gonxhen ti... Kanë për t'i nxjerrë telashe sa të duash. Këtu do të jemi... Kasëmi e Qerami kanë për t'i lojtur gurët. Do ndihmuar Gonxhja, është e para... Edhe shumë e hedhur s'është. Po do të mësohet. Brigada ka plot shokë të mirë... Demirin, Aliun... Edhe të tjerë ka. Po ne jse një herë se, pa ardhur akoma mirë, të futa në hallet e fshatit. Këtu jemi e do të bisedojmë shtruar.

Një çast ecën në heshtje. Radio Tirana, në emisionin «Universiteti popullor i radios», transmetonte një bisedë për mikrobiologjinë. Zëri i spikerit dridhej nëpër natë dhe përhapej si jehonë.

— Çudi! — tha Vali. — Sa shumë e ngrenë volumin e radios fshatarët!

— Të vjen si çudi ty, se ma ke patur që

foshnjë në shtëpi. Ne e hapim shumë, se na duket sikur na mbush, sikur dëgjojmë edhe për ato vjetër që s'kemi dëgjuar. S'ka një muaj që bëmë festën e dritave. Atë natë të ishe! Ajo që festë! S'ka parë fshati të atillë gaz. Kërcitën dollitë, këngët, vallet gjer në mëngjez. Lëre, s'ta tregoj dot. . .

Ata ecnin me hap të ngadaltë. Vali shikonte si zbardhnin nëpër errësirë gurët e kalldrëmit.

— Ne, si për më mirë, menduam që të banosh në një shtëpi këtu në mes të fshatit, — e mori përsëri fjalën Fadili. — Me ndihmësmjeken dhe të jëmën e saj. Kanë një dhomë të madhe dhe një si biçim kuzhine. Ushqimin do ta hash në men-së. S'ka nja dy muaj që e kemi hapur. Në fillim s'vinte njeri, po tani çka, jo keq. . . E që thua ti, siç të thashë, e menduam si për më mirë. Po kemi dhe një hall tjetër. . . Do të bisedojmë gjatë e gjerë. Ti je e lodhur nga rruga. . . Kështu. . . u! Sonte do të vish te unë.

— Faleminderit! Një herë tjetër.

Fadili, duke menduar se ajo ishte e lodhur e kishte nevojë të pushonte, s'nguli këmbë. E shoqëroi deri te shtëpia ku do të banonte.

— Ja, këtu.

Vali i shtriu dorën.

— Prit. — Ai ngriti kokën dhe thirri:

— Kristina!

U hap një dritare në katin e dytë dhe u duk një vajzë.

— Të kam sjellë shoqen. Dil prite një çikë.

Dritarja u mbyll, po Vali vuri re se dikush ngriti cepin e perdes dhe po vëzhgonte.

— Epo, — shtriu dorën sekretari.

— Shoku Fadil, po... ku do të punoj?

— Dëgjo. Mos më thuaj më ashtu. Ç'është kjo «shoku Fadil!» Më mirë shkurt. «Fadil», si të gjithë. Ne tërë shokë jemi këtu.

— Po, të paktën për moshën.

— Në të dukem aq plak, më thuaj «xha Fadil». Sa për punën, kollaj është. Shko e çlodhu një herë, pa këtu jemi.

— Do të kisha shumë dëshirë të isha në brigadën e Gonxhes. Nuk e di, po së si...

— Kolloj, kollaj... Hajde natën e mirë!

— Natën e mirë!

— Ke për të bërë gjumë të lehtë këtu... Do të shikosh. — Fadili ktheu shpinën dhe u nis nëpër errësirë. Kristina kishte dalë në hyrje të shtëpisë dhe po priste. U përshëndetën, tokën duart, buzëqeshën dhe ngjitën shkallët pa këmbyer fjalë. Kur hynë në dhomë, Aspasia u ngrit nga karrigja, lëshoi mbi tryezë tantellën, që ishte duke punuar, dhe i buzëqeshi të porsaardhurës duke nderur buzët e saj të holla dhe duke picërruar sytë, që për moshën e saj rreth të pesëdhjetave dukeshin shumë të gjallë.

— Mirse na erdhe!

Kristina i mori valixhen nga duart dhe i afro një karrige. Vali i hodhi një sy dhomës. Nuk ishte aq e thjeshtë sa e pat menduar.

— Shtëpi fshati, e... Ç'pret më shumë! — deshi të justifikojë Aspasia.

— Pse!? Shumë mirë... Mua të më falni, se mbase do t'ju bezdis këto kohë, që do të qëndroj këtu, po kështu më thanë.

— U... u, ç'është ajo fjalë! — Aspasia dukej shumë e shtirur në bisedë dhe kjo filloi ta plogë-shtonte Valin.

— Për sa kohë të kanë dërguar këtu? — pyeti me një ton të pakuptueshëm Aspasia.

— Unë kam ardhur vetë, vullnetare. Do të rri nja katër muaj a pesë.

Tjetra rrudhi buzët e ngriti vetullat.

— Fshati qenka i bukur! — vazhdoi Vali.

Aspasia pa të bijën dhe lëshoi një buzëqeshje tallëse.

— S'ke ç'i thua sa i bukur është! — dhe i mbuloi fjalët me një psherëtimë.

Valit s'po i pëlqente Aspasia. Ndryshe nga ato orë që kishte kaluar në mbledhje e nga bisedat me Fadilin, në dhomë ndjeu një boshllëk, që s'dinte ta shpjegonte. Megjithatë mendoi se s'duhej të ngutej për të gjykuar njerëzit. Biseduan ndonjë orë. Ishte një bisedë e ftohtë, e copëtuar, me pyetje e përgjigje të shkurtëra. Kryesisht flisnin Aspasia dhe Vali. Kristina rrallë hidhte ndonjë fjalë. Edhe kur e pyeste Vali, më shpesh në vend të saj përgjigjej e ëma.

Para një viti, Kristina kishte mbaruar shkollën dhe ishte emëruar këtu, në Malas. E ëma s'kishte lënë gur pa luajtur e derë pa trokitur për ta rregulluar në qytet, po s'i kish ndritur. Dhe i shkoi pas së bijës. Dy vajzat e tjera i kishte të martuara, kurse burri kishte vite që i kish vdekur. Kristina kishte shumë punë në ambulancë, kurse e ëma bënte tantella gjithë ditën. Vetëm kaq mësoi Vali atë natë. Po, ndonëse Aspasia mundahej të tregohej sa më e natyrshme, mysafirja e kuptoi

se diçka kishte në këtë familje të vogël, diçka që ajo ende s'i kapte dot as formën e as ngjyrën, po e ndjente se ishte diçka e mërzitshme. Për një çast ju mbush mendja se kishte përpara një mamakë të pushtetshme dhe një bijë të bindur. Megjithatë, Kristina kishte diçka që e tërhiqte... Secë lëvrinte në sytë e saj të bukur, diçka e butë, e gëzueshme.

Kur ranë për të fjetur, këmbyen ca fjalë në për errësirë, uruan natën e mirë dhe heshtën. Vali as që mendonte se do ta zinte gjumi shpejt, prandaj u mundua t'u merrte radhën përshtypjeve të asaj dite. Po, natyrisht, e kishte të vështirë. Ajo s'kishte provuar kurrë një ditë kaq të ngarkuar me mbresa dhe përshtypje. I dukeshin dhe i zhdukeshin para sysh fytyrat që kishte parë gjatë atyre pak orëve në fshat. Veshët nisën t'i gëmëzhijnë... Diskutime, pëshpëritje, thumba, heshtje... Kushedi sa kohë kaloi kështu, derisa e pushtoi një gjumë i thellë dhe i ëmbël, si pas një ngjitjeje me ngarkesë të rëndë.

PRANË NJERËZVE

Me të hapur sytë, Vali u shtriq një herë me të gjithë trupin dhe kujtoi fjalët e Fadilit: «Ke për të bërë gjumë të lehtë këtu!» Dhe vërtet, ndonëse kishte qenë e lodhur dhe gjumi e kishte marrë vonë, e ndjente veten të çlodhur dhe me forca të përtërira. U ngrit me kujdes nga shtrati që të mos zgjonte të tjerat, dhe ashtu si që ju afrua dritares. Mëngjezi ishte i bukur. Hodhi sytë përtej. E tërhoqi peizazhi malor. Ndërsa të djeshmen, në prak të muzgut, i që dukur sikur grykat e largëta lëshonin vërshime ujërash, tani ato thithnin mjegullat e lehta, që zvarriteshin shpateve e brinjave. Dielli kishte një shkëlqim të veçantë. Fshati që zgjuar me kohë dhe dita e re kishte filluar plot jetë... Ditë e kthjellët, njerëz të qeshur e gazmorë. Njerëzit!!! Si do të jenë ata? E djeshmja ju duk e largët... Ajo kishte dëgjuar ca zëra, kishte parë ca fytyra, kishte këmbyer ca fjalë me Fadilin, me Aspasinë, me Kristinë... Kurse tani do të shkonte pranë njerëzve... Dhe ndjeu përsëri shqetësimin e takimit me të panjohurën. Filloi të vishej.

— Ku kaq shpejt? — ndjeu pas shpine zërin e Aspasisë.

— Në punë.

— Në punë!?

Vali vazhdoi të vishej në heshtje.

— E ku do të punosh?

— Në brigadë.

— Në brigadë!? E ç'do bësh ti atje?

— Punë.

Vali as vetë s'e kuptonte se ç'e shtynte t'i përgjigjej aq prerë Aspasisë. Ndoshta toni i çuditshëm i zërit të saj! Apo humori që i kishte dhënë ai mëngjez i bukur! Aspasia s'foli më. Vali uroi ditën e mirë dhe doli me të shpejtë. Po, me të dalë në rrugë, u kujtua që do të shkonte në mensë dhe ju pre hovi. I vinte turp. Fshati ishte i tëri në lëvizje. Përshëndetje gazmore, biseda, të thirrura me zë të lartë, hapa të shpejta. Kur kaloi para klubit, hodhi sytë brenda dhe ngadalësoi hapin. Tre katër pleq pinin kafe më nge, një grup të rinjsh qenë afruar pranë radios dhe po dëgjonin «Pasqyrën e shtypit të përditshëm».

«Njerëzit! — mendoi përsëri Vali dhe, pa e kuptuar as vetë, atij mëngjezi kishte hyrë në ritmin e jetës së tyre. E kishte menduar mensën si një dhomë të zakonshme, me një tryezë të gjatë e disa stola, ku hanin përditë të njëjtit njerëz. Po, me të hyrë, u zhgënjye. Salla ishte goxha e madhe. Njerëz pothuaj s'kishte fare, po tryezat ishin mbushur me pjata të boshatisura. Një grua, që po pastronte, si e përshëndeti dhe i tha se Fadili po e priste nga kryesia, i futi krahun dhe e tërhoqi drejt kuzhinës.

Gjatë kohës që Vali po hante, pastruesja s'ju nda nga tryeza. Kjo e bëri më me turp Valin dhe u ngrit pa mbaruar së ngrëni.

— A... a! Jo kështu! Shata do bukë, — i tha. Vali buzëqeshi dhe doli të takonte Fadilin. Ai e njohu me Reshatin, kryetarin e kooperativës, një burrë rreth të dyzetave, gazmor e babaxhan, dhe me punonjësit e tjerë të administratës. Si bëri ato pyetjet e zakonshme që bëjnë fshatarët në takimin e parë, kryetari i tha:

— Më tha Fadili se paske qejf të punosh në brigadën e tretë?

— Po.

— Ne kemi plot punë këtu... Je marrë ndonjëherë me bujqësi?

— Jo.

— Është punë e rëndë. Po të mos jesh mësuar, të lodhë shumë. Ne e biseduam me Fadilin dhe, ç'është e vërteta, na bëhet mirë të shkosh në brigadën e tretë, t'i jesh Gonxhes pranë, po...

— Me një kusht, — ja mori fjalën Fadili. — Në shatë s'e ha dot me këto çupat tona... Dua të them mos e merr rrëmbyer, sa të mësohesh.

Në brigadë ajo shkoi në kohën e drekës. E shoqëroi Fadili. Tërë mëngjezin ai e kishte njohur me fshatin, e kishte çuar në shkollë, në ambulancë, në dyqan, në klub, në centralin elektrik. Në vatrën e kulturës i kish shfletuar historikun e fshatit.

Si lanë pas luginën, morën një kurriz boke të taracuar, pastaj u varën shpatullës së një mali. Fadili hera herës qëndronte dhe i fliste për të mbjellat, për prodhimet, për tokat e reja... Ajo ishte përgatitur për ta filluar ndryshe këtë ditë dhe i dukej vetja si një vizitore, së cilës ciceroni po i shpjegonte me durim kuriozitetet. Ata u futën nëpër një shteg të ngushtë dhe ecnin njëri pas tjet-

rit. Në të përpjetat, Fadili pothuaj s'fliste fare dhe mezi mbushej me frymë.

— Më mundon shumë kjo e shkretë azmë, — ju qa Valit kur dolën në një rrugë më të sheshtë. — Që kur m'u çfaq kjo flamë sëmundje, më hoqën edhe nga fusha e më bënë magazinier.

Brigadën e gjetën nën hijen e një lisi, duke ngrënë drekën.

— Mirse rrini e ju bëftë mirë!

— Bujrum e mirse na erdhët! — dhe kooperative të vazhduan të hanin ashtu të ndarë në grupe, nga tre e nga katër. Edhe tre pendët e qeve përtyreshin më nge aty në mes të arës, ku i kishin lënë të pushonin pa i zhbrehur. Toka që punohej, ishte rrëzë kodre, jo shumë e pjerrët.

— Si duket kjo, do ta bëjë misrin, apo jo? — pyeti Fadili, pa ju drejtuar askujt dhe ndoqi me sy rripin e tokës të punuar në formë harku.

— E hollë është e uruara, e hollë... Do ujë e pleh me bollëk, — foli dikush duke u mbllaçitur.

— Edhe punën e do të shëndoshë, — plotësoi një tjetër.

Shahini i hodhi që larg kutinë e duhanit Fadilit. Vajzat s'ja ndanin sytë Valit. Edhe burrat e shikonin, po ndryshe. Shikimet e tyre më shumë ishin hetonjëse.

— Si po ju shkon puna sot? — pyeti përsëri Fadili dhe pa Gonxhen.

— Do të shkojë, o Fadil, do të shkojë, — se kush foli si me përtesë. Vali pa Qeramin t'i shkelte syrin Kasëmit. Ai qeshi me djallëzi.

Si mbaruan së ngrëni, të gjithë u grumbulluan pranë të porsaardhurve, duke u ndarë më dysh,

burrat nga ana e Fadilit, kurse vajzat e gratë nga Vali. Ajo ishte e shqetësuar. Ç'do t'u thoshte Fadili?

Dhe ai s'vonoi t'ja niste:

— Vali ka qejf të punojë në brigadën tuaj. Ç't'ju them më shumë! Kjo shoqja vjen nga B... Një ditë rrugë që këtej. Kurse ca nga ne, kur erdhi puna të nisinin çupat... Ju e dini vetë, ç't'i hapim lakrat tani! Vali besojmë se do të na ndihmojë shumë për ca gjëra. Veç mos harroni një gjë: ne s'mbetëm për shatën e kësaj. Kjo është në radhë të parë një agjitate partie.

Ndërkohë vajzat e kishin rrethuar Valin dhe, sa nxori njëra një fjalë, u ndez biseda.

— Çudi e madhe, si është kjo punë e grave! Në minutë e zënë shoqen. Çudi, për besë! — tha një burrë, që, me sa dukej, kishte kapërcyer të pesëdhjetat.

Fadili s'ndenji gjatë.

— Mos e mundoni shumë këtë shoqen, — tha buzagaz, kur u nis për t'u kthyer në fshat. Shikimet e shoqeve të brigadës dukeshin që e miratonin vullnetaren e re. Burrat vazhduan të heshtin edhe një çast, gjersa xha Shahini hapi bisedën:

— Ç'njerëz ke në shtëpi, moj bijë?

— Prindërit dhe një vëlla.

— A mbahen pleqtë, mbahen?

— Ashtu, çka.

— Në punë janë?

— Nëna punon, babai është pensionist.

— Po ç'zanat ka pasur yt atë?

— Marangoz.

— Punëtor, demek, dora jonë!

Vali qeshi me ndrojtje. Tani para saj po formohej një gjysmë rrethi i ngjeshur. Disa, kohë më kohë, këmbenin ndonjë fjalë vesh më vesh ose ndonjë shenjë të pakuptueshme.

— Po ti ç'zanat ke?

— Punëtore jam, në fabrikën e konservimit.

— Mirë, mirë... Bukuri! Po shkollë sa ke bërë?

— Kam mbaruar gjimnazin.

— Ashtu hə!? Dhe na erdhe vullnetare këtu! Na rrofsh e të lumshin këmbët... Si t'u duk fshati?

— Më pëlqen shumë!

— Për sy është i bukur, po për bereqet është i varfër virani, — hyri një tjetër në bisedë. Xha Shahini, i prekur në sedër, ju kthye:

— E... e, i varfër është, prandaj të ka bërë ty sa një kalë.

Vali kaloi një herë shikimin mbi njerëzit që kishte përpara. «Sytë e tyre sikur më peshojnë. Kur thashë se kam mbaruar gjimnazin, pëshpëritjet u shtuan shumë. Mos mendojnë se kushedi ç'kam bërë dhe më kanë dërguar këtu për dënim?..»

Xha Shahini ja preu mendimet:

— Je zënë gjëkundit?

Vali e keqkuptoi plakun dhe ju skuqën faqet. Dikush qeshi.

— Jo, unë erdha vetë, vullnetarisht. — Zëri i saj i ndrojtur sikur kërkonte çfajsim.

— S'u morëm vesh, — tha plaku.

— Ai të pyet a je fejuar, — i pëshpëriti një grua në vesh Valit.

— Jo, — tha ajo e turpëruar, ngaqë s'e kishte kuptuar plakun.

Tani s'ishte vetëm xha Shahini që pyeste. Të gjithë i drejtoheshin asaj. Vali vetëm përgjigjej. Dhe habitej sa shumë pyesnin fshatarët. Muhabeti kishte nisur shtruar e kushedi sa do të vazhdonte, sikur të mos qe ngritur Demiri:

— Si e kemi zënë ne, as nesër s'e mbarojmë së mbjelli këtë copë që na ka mbetur. — Dhe, duke u ngritur, i hodhi një shikim të ngrohtë Valit, si për t'i kërkuar ndjesë që po prishte bisedën. Kurse ajo e falënderoi në heshtje.

— Presim fjalën e brigadieres, — tha Qerami dhe, duke sjellë përçark shikimin e tij dhelçerak, u sheshua sikur s'kishte për t'u çuar kurrë. Po të tjerët filluan të ngriheshin. Kur morën për nga arat, vajzat e futën Valin në mes, duke e rrethuar me një dashuri të sinqertë e fare të zbuluar, që ajo s'dinte si t'i përgjigjej.

Pendët e qeve nisën të tërheqin ngadalë plugjet e rënda. Pas tyre, gratë dhe vajzat hidhnin misër nëpër brazda. Disa nga burrat mbillnin fshesa anëve të parcelës, kurse të tjerët punonin me bel një rrip të pjerrët toke, ku s'puthte dot plugu. Vali shkante pas vajzave. I shikonte se si mbushnin grushtin me misër dhe i lëshonin kokrrat në tokë si duke i numëruar. Njëra prej tyre i zgjati kovën e mbushur përgjysmë me misër dhe i bëri shenjë që të mbushte dorën. Vali u ndrojt si para një prove të papritur.

— S'është ndonjë gjë e madhe... Ja, lëshoi kështu, sikur i numëron.

Vali futi dorën në kovë, e mbushi me misër

dhe, duke zbratur frymën me të dridhura prej emocionit, nisi të lëvizë gishtat. Si lëshoi kokrrën e parë, e ndoqi me sy, gjersa ajo humbi midis dy plisave.

— Paç dorën e mbarë! — uroi pendari që vinte pas.

Ajo filloi të çapitej si e dehur nga afshi i tokës, nga fara dhe nga njerëzit.

UJËRAT E BURIMEVE TË HIDHURA

Xha Shahini e njihte mirë rrjedhjen e ujërave të dëmshme në të mbjellat. Ishte plakur me këto punë. I kishte qëlluar shumë herë që të këpotej vija e ujit dhe ai të ishte lëshuar me shatë në dorë për të ndaluar rrjedhën, që mos t'i kalbte bimët e ngopura me vlagë. Po pse kësaj here po vepronte ndryshe? Në vend që të priste rrjedhën, shpejtoi të shkulte bimën. Kësaj here ujërat rridhnin nga burimet e hidhura.

Ai doli i pakënaqur nga zyra e kryetarit të kooperativës. Në prak të ndërtesës qëndroi një çast në mendime, duke kruar mjekrën e ashpër si furçë e ngrënë, pastaj ngriti supet, diç mërmëriti me vete, lëshoi duart e mëdha mbi pantallonat e shajakta dhe u nis drejt shtëpisë. Fadili dhe Reshati, që po rrinin aty pas dritares, e përcollën me sy plakun gjer larg.

- Unë i prisja këto gjëra, — tha Reshati.
- Dale se kemi për të pritur të tjera akoma.
- Dhe të gjitha i bën Kasëmi... Edhe Qerami.
- Jo vetëm ata, Reshat.

Reshati fryu bulçitë dhe i zbrazi ngadalë si me të psherëtitur:

— Si zor t'ja dalë Gonxhja kësaj pune... E di? Ngranjëherë them se do të qe më mirë të kishim vënë Demirin brigadier... Atij po, s'ja ha qeni shkopin...

— Edhe Gonxhja do t'ja dalë...

— Mirë thua ti, po punën e mori lumi. Brigada është çoroditur... Ka mbetur shumë prapa... S'ka organizim, s'ka drejtim... — Reshati e këputi bisedën. Ngriti kokën dhe pa Fadilin. Mendimet i kishte të ngatërruara e s'dinte a po e kuptonte shoku drejt. U mundua të shpjegohej.

— Jo se s'kam besim te Gonxhja, brë Fadil, po...

Tjetri s'e la të vazhdonte.

— E di ku e ke hallin dhe mbase ke një farë të drejte. Po kështu e kanë këto punë... Edhe do humbasësh ca kohë, edhe mund të dëmtohesh në fillim... Po duhet të luftojmë, që të fitojmë...

— Veçse, kur vjen fundi i vitit, anëtarët duan bukë e para, jo llafe. Brigada e tretë, si e ka zënë, do të dalë me këpucë të kuqe.

— Kjo është e keqja, Reshat. Dhe na ka dëmtuar shumë. Bukën e prodhojnë njerëzit. Po s'punam me njerëzit, na rrofshin tokat e reja, na rrofshin plehrat, na rrofshin zotimet... Kollaj është... Që nesër e heqim Gonxhen e vëmë Demirin. Dhe puna do të shkojë sahat... Po ne s'duhet ta lëmë Gonxhen që të thyhet...

Reshati e admironte Fadilin për logjikën e tij, për gjakftohtësinë e qartësinë e të snprehurit.

Nganjëherë i dukej se ai jepej shumë pas problemeve të tjera, se sa pas bukës, që ishte kryesorja. Po, kur ndodheshin pranë e pranë e bisedonin shtruar, zhgënjehesh.

— T'ua mbledhim rripat Kasëmit e Qeremit, — tha me vendosmëri Reshati.

— Na duhen mbledhur rripat të gjithëve... Te të gjithë ka diçka që pengon. Edhe te unë, edhe te ti... te të gjithë. Këto gjëra janë të thurura e të mpleksura si kungulli në gardh. Dhe janë këtu... Fadili i ra kokës së tij me gishtin tregues.

— Edhe këtu, — vuri dorën në të majtë të gjoksit Reshati.

— Mirë malit se i vë kazmën dhe i del në majë, e bën fushë. Po këtu s'puth kazma... Do kujdes e do durim kjo punë.

Dhe kujdesi nuk mungonte. Po ja që brigada e tretë s'po vihej në udhë. Punët ziheshin e liheshin për gjysmë. Bimët po i mbulonte bari, kurse brigadën po e mbytnin pëshpëritjet, thasethemet, grindjet. Gonxhja s'ndjehej e gjallë. Organizata e partisë ishte mbledhur një ditë më parë posaçërisht për këtë punë. Ishin kritikuar rëndë sidomos dy komunistët e brigadës së tretë, që nuk e përkrahnin sa duhet brigadieren e re. ~~Ata~~ në fillim që munduar të bënte diçka, po, kur pa se s'po vihej gjë në vijë, sikur po e humbiste besimin. Kurse Demiri, që ishte ende kandidat për anëtar partie mjaftohej vetëm me ndihmën praktike që i jepte Gonxhes për matjet, llogaritjet, mbushjen e evidencave. Gratë që e donin Gonxhen e kishin besim te ajo, në atmosferën e rëndë që ishte krijuar në brigadë s'guxonin të flisnin në prani të burrave. Va-

li qe ngritur nja dy herë e revoltuar, po s'ja dëgjounin fjalën. Kasëmin dhe Qeramin i kishin thirrur në kryesi dhe u kishin hequr veshët mirë, po ata justifikoheshin se s'kishin thënë gjë.

— S'ke si i tund mirë e mirë, jo...o... S'llapin në sy të njerëzve, — vazhdonte biseda në zyrën e kryetarit.

— Uji që rrjedh nën rrogoz, është nga burimi i tyre. S'ka burrë nëne të ma ndërrojë mendjen. Dhe uji ka për të dalë sipër. Këtu do të jemi.

— Po ne s'do presim gjer të na vijë në brez... .

— Edhe ajo vullnetarja s'po na bën ndonjë gjë të madhe. U bë një javë që ka ardhur... . Mua nga njëherë më duket se më shumë na prish punë se sa na ndreq. Tre anëtarë të brigadës m'u ankuan sot... . Një dy e u tregon citate e parulla. Dje u kishte mbajtur një leksion të gjatë. Po vazhdoi këshutu, as që pres gjë prej saj. Parulla e citate kemi ne sa të duash. S'ka mbetur mur pa shkruar. Edhe për mbledhje e konferenca s'jemi keq. Ahu... u! Të punosh me fshatarin s'është shaka... S'do llafe shumë ai.

— E, mo, se e re është. Pastaj e pamësuar. Po është çupë e mirë, e pjekur. Këto që thua ti, ja thashë në sy. As i mbeti qejfi hiç. Edhe ne duhet ta ndihmojmë ca më shumë.

Fadili fërkoj një herë ballin e ngushtë dhe i dha kasketës pas, sikur t'i kishte zënë shikimin.

— S'është aty, o Reshat, jo... o! Ne po na ngatërrohet lëmshi e s'dimë kujt t'ja hedhim fajin. Mos të presim vetëm prej Valit. S'ka ardhur të na nxjerrë nga balta.

Biseda vazhdoi gjatë. Por s'ishin vetëm ata që

tirnin këtë fill atë natë. Sheshuar mbi minderin e gjerë, Shahini i thoshte së bijës, pa e parë në sy.

— Kur s'të mban kurrizi, ç'm'i vë samar vetes?! Apo të erdhi mirë sefte...

— Unë s'desha.

— Epo pushkën ballit s'të vunë, de...

— ...

— Ec e dil nga vallja tani... S'e merr vesh qeni të zonë në brigadë, s'e merr.

— Mbase do të mësohem.

— Epo ç'më hyn në lumë, pa mësuar not, de, se më plase... Thuaju që s'e bën dot e të vënë një tjetër... Kur s'je e zonja të mbash nderë që të bëjnë, mos merr turpin. Shko u thuaj me gojën tënde...

— Më vjen rëndë.

Xha Shahini u nxeh e u mat të shfrynte, po u përmbajt...

— Dreqi e marrtë... Si punë e atij që tregojnë: jep një grosh për të hyrë në valle, pastaj jep një qese plot e s'del dot... Isha vetë sot në kryesi... U thashë të të heqin.

Gonxhja ngriti kokën. Ai nuk i dha përgjigje. Kujtonte bisedën që kishte patur me Fadilin e me Reshatin.

«Si, ore, ta heqim! Ti e di ç'thotë partia për gratë. Kur u bë kuvendi, u ngrite i pari që prishe fejesën e çupës... E dërgove në aksion.

«Mirë, bre, mirë, unë i vij fjalës së partisë, po pse ja vutë bajrakun derës sime?»

— Baba, ç'të thanë? — prishi heshtjen Gonxhja.

— Më thanë ta mbash me shëndet bajrakun... E më kujtuan ato të luftës, të reformës, të ngritjes.

së kooperativës, — dhe plaku humbi përsëri në mendime.

«Ndryshe ato e ndryshe kjo e sotmja... Le ta hapë rrugën një tjetër, pastaj, po u desh, le t'i hyjë valles edhe kjo imja... Ajo është kalama fare... S'i peshon fjala në burra».

— Pastaj ç'të thanë, baba? — pyeti përsëri Gonxhja.

— Pastaj!? Ta mbash me shëndet atë që more, ja, këtë më thanë... Ma mbyllnë gojën me një fjalë, që e kam thënë unë kaq herë... «Ç'tha partia e s'u bë?» Këtë më thanë.

* * *

Në klubin e fshatit, në një tryezë të qoshes, Kasëmi e Qerami çikën gotat e rakisë dhe këmbyen vështrimet. Dikush që ulur në tryezën pranë dhe ata e kishin prerë bisedën. Heshtja ishte e shkurtër. Ata e gjetën shpejt gjuhën. Ja nisi Qerami:

— Kot thonë, dita e bukur duket që në mëngjez. Dita e bukur duket kur perëndon dielli e jo kur lind.

Kasëmi buzëqeshi dhe, si u mundua të gjente një përgjigje të goditur, mori gotën e rakisë, po thua të boshatisur, dhe e vërtiti nëpër duar.

— Mirë e ke ti. Ka ca fjalë që nuk shkojnë hiç. Thonë «U mbush kupa e po derdhet», — dhe tregoi me dorë vatrën e kulturës. Qerami luajti kokën për të thënë se e kuptonte ku e kishte fjalën — Epo, më mirë ta kesh gotën plot, apo... — në vend të fjalës bosh, ai shkundi në gojë ato dy pika

raki që kishin mbetur, dhe e ktheu gotën përmbys, duke shtrembëruar turinjtë.

Tjetrit i pëlqeu përgjigja dhe thuri aty për aty një «përrallëz»:

— Më tregonte gjyshi, ndjesë pastë... S'i shkonte mirë tufa e dhive, që thua ti. Dha e mori e s'dinte nga t'ja mbante. Më në fund ja hodhi fajin përçorit. Dhe ja vuri këmborën një dhie. Priste plaku t'i shkonte tufa mbarë. Dhisë filluan t'i rriten veshët... Ca ditë tufa shkoi mirë, se ja kishte mësuar rrugën përçori, po, kur filloi dhia t'i fuste ferrave, s'e mernte vesh i pari të dytin. Posi, ore. Vinte tufa në darkë... Blegërinte e s'gjente derman. «Ç'kanë këto të uruara», — vriste mendjen plaku, po s'e kuptonte që i ankoheshin. Cepinjtë e tufës u tërbuan, po s'e bënë veten. Tufa po shthurej, qumështi po shteronte, leshi mbetej ferrave. Dha sa dha dhia, që thua ti, e një ditë futi këmbët e para në qafore dhe e hoqi këmborë... ën. Ja, kështu: «E, dhia po dhi» — i ra mendjes gjyshi — «s'është për këmborë, e mallëkuara». Dhe ja vari prapë...

— Përçorit, — ja rrëmbeu fjalën Kasëmi dhe e pa drejt e në sy.

— Përçorit, po kujt?! E ka bekuar perëndia. — Kasëmin e mbuloi kënaqësia, sikur ajo përrallëz ta kish zgjidhur vërtet atë që mendonte.

— Na mbush edhe dy, o Neim, — i thirri banakierit. Qeramit sikur i erdhi keq që po harxhohej miku i tij.

— E lëmë me kaq, Kasëm. Mjaft i kemi nga dy. Lëre tani, mjaft... — Po fliste me gjysmë zëri e sytë i mbante nga banaku.

— A derëzi e ti... Gjalpi në lakror është pra-
pëseprapë.

— Kush i porositi dy dopiot? — thirri banakie-
ri. Kasëmi u kthye me fodullëk, po s'e nxori dot
fjalën, se Guraliu, që ishte në tryezën përbri ja
pat me gojën plot:

— Përçori, — dhe tregoi me dorë ish briga-
dierin.

Banakieri qeshi me zë, pa e kuptuar nofkën,
dhe serviri gotat. Kasëmit i mbetën buzët hapur
dhe aty për aty s'diti si ta shkulte atë thumb që
i përvëlonte. U panë me Qeramin dhe ju trembën
shikimit të njëri tjetrit.

Kasëmi u gëlltit disa herë, mori gotën sikur
do të mbështetej te ajo, mblodhi forcat si ndonjë
që e kanë shembur në dru, dhe u mundua të bu-
zëqeshte:

— Është bërë shakaxhi i biri i Zeqos... I ka
ngjarë gjyshit qerratai, — dhe pa sa andej këtej.
Nëpër tryezat njerëzit kishin muhabetet e tyre dhe
as që ja kish vënë kush veshin.

— Pyet Qeramin, se ai i di përrallat e baba-
gjyshëve, — ja pat Guraliu.

Kasëmi po mundohej të gjente forca për një
buzëqeshje tjetër, po Qerami i shkeli majën e opin-
gës për t'i thënë «mos e zgjat më». Hoqi një herë
raki dhe as ai s'e kuptoi pse i dogji aq shumë gur-
mazi i argasur.

* * *

Si dolën nga vatra e kulturës, ata ja morën
shtruar rrugës për në qendër të fshatit. Dikush që
kaloi pranë, ktheu kokën dhe i pa me vërejtje dy

të rinjtë që çapiteshin ngadalë dhe bisedonin më nge nëpër errësirë. Edhe Vali e pa me vërejtje kalimtarin. Demirit i erdhi rëndë, duke menduar se do të fyhej Vali, po ajo s'e la të shqetësohej gjatë dhe vazhdoi bisedën.

— Gjithë puna është te Gonxhja. Është hutuar fare dhe ka rrezik të thyhet.

— S'do ta lëmë të arrijë gjer aty.

— Megjithatë s'po ja dalim dot.

— Dje Kasëmi sikur nisi të ndryshonte... Sikur filloi ta ndihmonte Gonxhen demek. Po sot e kuptova se ai do ta ngatërrojë më keq.

— Nejse, me këto do t'ja dalim... Po më duket se filluan të tjerat... Ato kanë telashe të mëdha.

— Kush?

— Thashethemet, shpifjet...

— Jo! Kasëmin e Qeramin i njohin të gjithë.

— Po ka ca pika të dobëta... delikate.

Demiri ktheu kokën. Ai e kuptoi se Vali diçka i fshihte. Megjithatë, i erdhi rëndë ta pyeste. Ajo u lëkund një çast, po mendoi se ishte më mirë t'ja thoshte atë që mendonte:

— S'besoj të ma marrësh për të keq?

— S'të marr vesh?!

— Dikush ka folur keq për ty.

— Për mua? Vetëm për mua?

— Kështu do të ishte më ndryshe... Për ty dhe për Gonxhen.

Ai qëndroi. U habit dhe pati turp të ngrinte kokën.

Vali u shpjegua:

— Ata e shikojnë që ti e ndihmon... Rri shu-

më me të... I shkon ndonjëherë edhe në shtëpi...
Mendojnë se ju të dy... E kupton ti?

— Ta marrë dreqi... Si s'kanë turp!..

Vali e kuptoi se ai u nxeh dhe kushedi sa do të ishte prishur në fytyrë.

— Ti mos u nxeh... Dhe...

— Dhe të mos tërhiqem, do të thuash, — plotësoi Demiri mendimin e saj.

Valit i erdhi mirë që ai e kuptoi. Kjo sikur ja shpengoi gjuhën:

— Sidoqoftë, ti mos e merr kështu, të mbaruar... Deri tani, me sa di unë, kjo fjalë vetëm nga një gojë ka dalë... Mbase, kushedi...

Demiri ngadalësoi hapin dhe priti që ajo të vazhdonte.

— Një Nedie a Nemie, s'më kujtohet mirë emri... E brigadës së dytë është më duket...

— Ajo është, Nedija... Tellallja e fshatit... Njëqind herë e kanë bërë qepaze nëpër mbledhje, po pse, vë mend?

— Se si ua kishte sjellë fjalën nja dy vajzave të brigadës sonë. Po ato ja kishin prerë shkurt.

— Është kunata e Kasëmit. Brazda e ujit pra-pëseprapë në burim të shpie. Ke parë ti?

Si ecën pak pa këmbyer fjalë, Demiri tha:

— E panë që Gonxhja sikur filloi të shkundej e... S'e pe si u bë Kasëmi sot në mëngjez, kur ajo u ndau detyrat skuadrave?

— Unë u gëzova në mëngjez... «Epo më në fund ju mbush mendja Gonxhes», thashë... Kurse në drekë ajo u pre fare. Kishte marrë vesh atë që të thashë...

— Ç'ngatërresa!

— Sidoqoftë, s'ma ha mendja të ntrashet kjo punë.

— Ti the një gjë me mend, — foli mendueshëm Demiri. — Janë ca pika të dobëta... Kjo që ke dëgjuar sot, do të na sjellë telashe sa të duash...

— T'i vëmë gjoksin, — qeshi Vali. Ajo deshi të ngacmonte humorin e djaloshit, që ju duk se u mërziit shumë, ndaj ju përgjegj me ato fjalë, që ai i përdorte shpesh. Po nuk ndodhi ashtu.

— E duan gjoksin të fortë këto gjëra, jo shaka, — tha ai, pa u tundur nga e tija.

Kishin arritur para shtëpisë ku banonte Vali. Qëndruan.

— Si ta ha mendja ty? — pyeti ai.

— Për se?

— Për Gonxhen.

Valit ju zgjuan përsëri dyshimet se mos vërtet kishte diçka midis brigadieres e Demirit dhe sapo matej ta pyeste. Po ai si duket e nuhati heshtjen e saj.

— Mos mendon edhe ti keq për mua?

— Unë keq?! Pse? Fundja, dhe në qoftë e vërtetë, s'ka asgjë të keqe!

— Janë shpifje.

— Po atëhere pse trembesh?

— Më shumë kam hallin e Gonxhes. S'i ke parë ti si ngatërrohen këto gjëra në fshat. Si ta ha mendja ty për Gonxhen?

— Do t'ja dalë...

— Po edhe kaq lehtë mos e merr, — dhe papritur i shtriu dorën. — Ë the bukur ti, ka ca pika të dobëta... Natën e mirë.

— Natën e mirë.

Ajo ngriti kokën. Cepi i kortinkës me dragua, që kishte thurur Aspasia, u ul vetëtimthi. Vali i mbajti një çast sytë lart dhe pa siluetën e gruas që u tërhoq nëpër dhomë. Ajo e kishte përgjuar. Ktheu kokën nga iku Demiri, po ai kishte humbur në errësirë. I ngjiti shkallët duke menduar për të, po, me të hapur derën, i dolën përballë sytë e picërruar të Aspasisë dhe ju kujtuan përsëri ujërat e burimeve të hidhura, që kishin nisur të rridhnin nëpër fshat. Në ç'brazda do të derdreshin të nesërmen?!

PRITA

Vali dëgjoi edhe nga të tjerët se sa të këqija ishin ato, që dikush i kishte quajtur vërshime të burimeve të hidhura. Dhe ato tregonin për gjendjen e nderë që ishte krijuar ato ditë në fshat, për grindjet që ishin mbjellë, për pasojat e rënda të atyre që prisnin vërshimet. Po këto ishin vetëm të dëgjua dhe shpesh ngjarjet që i tregonin, Vali i dukeshin të largëta, të papërsëritshme. Kjo ishte një gjendje e përkohshme, që s'do të mbante shumë. Mjaftuan vetëm dy ditë që ajo t'i shihte me sytë e saj ujërat e atyre burimeve, ta ndjente në qenjen e saj lagështinë dhe hidhtësinë e tyre. Fshati sillej si ai vorbulli, që sa vjen e zgjerohet. Për Demirin e Gonxhen flitej në brigada, nëpër familje, në klub, në rrugë, në shkollë... në dhomën e Aspasisë. Brigada e tretë ishte në pikë të hallit... Aty flitej më pak se kudo, po heshtja rëndonte më shumë se thashethemet që shkonin e vinin pareshtur nëpër fshat. Kooperativistët i ruheshin shikimit të njëri tjetrit. Veç sytë e Kasëmit e të Qeramit seç kishin një shkëlqim të çelur. Vali i përgjonte këta sy në heshtje. (Vërtet këta të jenë

burimet e gjithë kësaj vorbulle?! Nuk mund të jetë kështu... Ato nuk janë thjesht thashetheme... E pamundur! Këto burime sikur vijnë nga thellësi të nëndheshme... Ato vetëm sa kalojnë nëpër këta sy dhelparakë... Nuk janë thjesht thashetheme këto, jo. Ky është tërbimi i zakoneve, i kanunit... Sa keq kur i bëjmë qejfin vetes?! I dogjëm zakonet prapanike, i këputëm litarët e kanunit... Nganjëherë na rrëmbejnë deklaratat... Dhe kjo dëmton shumë... Kanuni është ende i gjallë, ende i fortë... Ja, tani mua më duket si një qenje fantastike... me sy të kuq, me një gojë të tmerrshme, si shpellë e pafund, me brirë të llahtarshëm... Kurse nga trupi më ngjan si një shumëkëmbësh. Jo, si një mijërakëmbësh... E këto këmbë janë si rrënjë, si dej të padukshëm, që zgjaten e hyjnë te njerëzit. Dhe nganjëherë gjaku i njerëzve i flet nëpërmjet këtyre fijëzave «Hej... Nuk sheh ç'po bëhet? Çohu! Si duron të të poshtërojnë kështu...» Atëhere ai çmendet, tërbohët... Lëviz këmbët e tij të padukshme e të panumërta për t'u kujtuar atyre se s'ka vdekur. Se, në i lidhën kokën, ai do të rrojë me rrënjët... Dhe nga sytë e tij të kuq nisin të derdhen...)

— Vali!

Ajo u tremb, sikur u përmend nga një ëndërr e frikshme.

— Of, — dhe u mbush me frymë, duke ngritur kapakët e syve të rënduar, si të mos kish fjetur një javë.

— Po të jesh lodhur, lëre, se e nxjerr unë rreshtin tënd, — i tha Shpresa, duke pritur me shatë në dorë që ajo t'i hapte rrugën për të vazhduar punën.

— Jo... Ashtu kot... Mendoja diçka, — dhe Vali vazhdoi të prashitte, duke i dhënë shatës shpejt për të arritur Demirin, që ishte larguar tre-katër metra më tej.

Që kur kishin filluar rreshtat e misrit nga kreu i parcelës e gjer tani që po i dilnin në fund, skuadra punonte pothuaj në heshtje. Edhe dy skuadrat e tjera po kështu. Rrallë e tek hidhej ndonjë fjalë... Po këto shkëndija shuheshin shpejt e nuk arrinin të ndiznin biseda. Kjo gjendje vazhdoi edhe kur brigada u ul për të pushuar. Njerëzit heshtnin. E, tek mundoheshin ta thyenin këtë heshtje, dilnin ca biseda të shplara e të ftohta, që i mundonin më shumë se heshtja. Gonxhen e kishin pushuar ethet. Demiri ziente përbrenda. Xha Shahinin ta zije në majë të hundës, i dilte shpirti. Vajzat e gratë gati sa s'po e nxirrnin dufin. Në këtë tablo të zymtë dallonin vetëm fytyrat e Kasëmit dhe të Qeramit, që rrezatonin kënaqësi e shpresë. Kasëmit ja kishin thënë copë në kryesi, që, sido të vinte, ai s'e puthte më brigadierllëkun, po dhe që ta komandonte një feçkë (siç e quante ai Gonxhen), këtë s'e gëlltiste dot. Vali po shikonte si dridheshin mbi lëndinë hijet e gjetheve të gorricës së egër, nën të cilën po pushonte brigada. Burrat thithnin cigaret në heshtje dhe i ruheshin shikimit të Shahinit. Ai u kishte kthyer shpinën. Jepte e mernte me thikën e tij të xhepit duke gdhendur një copë degë gorrice.

— Do të kemi shi, — tha Beluli, një ezmer nja tridhjetë e pesë vjeç, me fytyrë të skalitur e trup të ngjeshur si një copë shkëmb. Ai dyshoi nëse fjalët e tij do të ndiznin një bisedë, çfarëdo bisede

të qe... Mjafton që të mos tendosej ashtu ajo heshtje, që ai s'e duronte dot. S'e pasoi njeri.

— Si thua ti, Çeço? — i ra me brryl burrit më të moshuar, që ishte ulur përbri. Çeçua u mbush me frymë:

— S'ma ha mendja... Jo... o. — Lëshoi një zë të zvarritur dhe i ra me çok gjurit të djathtë. — S'më thotë gjë ky... Ma jep shenjën një ditë përpara reumatizma mua.

— Do kemi, o Belul, shi, do kemi, po kam frikë mos na bëjë dëme... se, kur vonon, të shkatërron, i mallëkuari, — tha Kasëmi duke u munduar mos linte shteg për keqkuptim dhe fshehtas e toku shikimin me Qeramin. Demiri e kuptoi ku deshte të qëllonte Kasëmi dhe përgjigja i erdhi në majë të gjuhës, po s'e lëshoi. Edhe të tjerët e kuptuan ish brigadierin. Shahini i mëshoi thikës dhe shtrëngoi dhëmbët. Demirit ju duk sikur nëpër artere i kaloi një urith, që ju suall nëpër gjithë trupin dhe i qëndroi në cep të vetullës së majtë, e cila ju drodh disa herë. Vali psherëtiu padashur. Gjatë atij pushimi, që po i lodhte kooperativistët më shumë se puna, ishte matur më shumë se një herë t'i binte drejt e drejt. Duheshin vetëm dy fjalë që ta shpërndanin atë mjegull mbytëse dhe shqetësimi i madh do të zbulohet lakuriq. Mendimet dhe frazat i kishte të qarta, po s'guxonte t'ja hiqte petën lakrorit. Kujtonte mbledhjen e natës së parë në vatrën e kulturës: (Ishin po këta njerëz! Ja, këta që kam këtu... Po ishin krejt ndryshe. Flisnin aq thjesht, aq hapur dhe aq ashpër. Kurse këtu sikur kanë frikë nga njëri tjetri... Po ajo ishte mbledhje për punën, për moskryerjen e detyrës.

Kurse kjo... E ç'lëmsh i ngatërruar është kjo ndër-gjegja. Kurse ne nganjëherë e marrim fare thjesht dhe i ndajmë ndërgegjet, si të them unë?! Si mund të ndajmë stofat... Këto janë të kuqe, këto të zeza, këto të pambukta, këto të leshta. Ja, këta njerëz, që për një gabim në punë të shtrydhin në djersë, tani heshtin... Në thellësi të tyre zakonet luajtën bishtrat helmatuese dhe ndërgegjet u bënë sheshe lufte dallgësh). Këto mendime ja nxorën Valit atë psherëtimë të pavullnetshme.

— Ato patatet e parcelës së poshtme s'më duken të mbara. Veç në u bëftë derman ai miku... kimiku, — deshte të hapte një fill të ri bisede Bequa. (Valit i pëlqente xha Bequa. Ai me Shahinin ishin më të vjetrit e brigadës. Bequa mundohej ta ndihmonte Gonxhen, i jepte zemër, i nxiste sedrën, e këshillonte. Ishte nga burrat e paktë në brigadë që bënte ndonjë shaka me vajzat. Edhe e bija, Shpresa, ishte disi më e çelur se të tjerat, fliste më shumë e nganjëherë hynte në bisedë me burrat).

— Si ta pret ty? — e pyeti Beqon Qerami, megjithëse s'kishte vend për pyetje. Atij s'ja merrte mendja që fjalët e Beqos të mbanin thumb, ndaj e ngacmoi t'i nxirrte ndonjë taban më të shëndoshë. Bequa, në vend që t'i përgjigjej, i hodhi një vështrim të rreptë dhe i këputi një të sharë me mend. Shahini e flaku me nervozizëm degën që po gdhendte dhe u ngrit. Duke futur thikën në xhep, iëshoi ca tinguj të pakuptueshëm dhe u nis ledhit të parcelës me hap të shpejtë. Të tjerët panë një-ri tjetrin të habitur dhe si të lehtësuar. Qerami krojti zërin. Kasëmi lëpiu buzët dhe u shkoi të

prapmen e dorës sipër me kënaqësinë e një llupsi që fshin sherbetin e mbetur mbi buzë, pasi është velur së ngrëni ëmbëlsirë. Demiri pa Valin në sy, sikur deshi t'i thoshte: «E di unë ç'duan këta... Po ç'të bëj që jam zënë ngushtë... Mos më thonë «pse kruan kokën, kur s'ke morra». Kurse në sytë e saj ju duk se lexoi: «Këto punë duan gjoks». U lëkund e sa nuk u ngrit. Po, para se të vendoste, i hodhi edhe një shikim Shpëtimit. Edhe ai po ziente. «Në organizatë na bënë për dy para... ç'presim akoma. Mirë unë. Po ti ç'pret?!». Kështu e kuptoi Shpëtimi shikimin e Demirit dhe s'priti më.

— T'i japim fund.

Të gjithë luajtën vendit dhe u kthyen nga ai.

— Ç'janë këto budallallëqe?

Gratë dhe vajzat miratuan me një pëshpëritje të përbashkët. Fytyrat e tyre filluan të marrin jetë.

— Turp, — i mëshoi zërit Vali dhe i hodhi sytë Gonxhes, e cila ishte kërrusur e kishte filluar t'i dridhej mjekra. — I vini vulën tjetrit kot së koti.

— Ngadalë, moj ti çupë... Peshoje fjalën kur ta lëshosh, — ju kthye rëndë Bequa, i fyer nga fjalët e saj. — Ç'është kjo?! I vini vulën, thotë. Kush, de? Apo i fut të tërë në një kallëp ti?

— S'e kisha aty, xha Beqo...

— Epo prandaj të thashë, peshoje fjalën... Se fjala vret më shumë se plumbi...

«Vërtet, për ca gjëra fjala rëndoka sa një mall!» — mendoi Vali.

— I thonë fshat këtu, moj çupkë, — u ckërmit Qerami.

Vali u mat t'i përgjigjej, po Aliu ishte më i shpejtë:

— Ajo e tha mirë, more... T'u vijë turp!

— Kujt?

— Atyre që na i hedhin këto ferra nëpër këmbë e ne të gjithëve që rrimë gojëkyçur, si mumje, që s'ua përveshim turinjve. Hë, more, flisni... I besoni ato që thuhet? Ne i njohim më mirë se të gjithë, se i kemi këtu, në brigadë, të dy. U besoni fjalëve që ziejnë poshtë e lart? Hë, moj vajza? Hë, moj gra? Unë s'u besoj.

— Jo, — tha dikush!

— Duan ta bëjnë Gonxhen që ta lërë brigadën, prandaj dhe shpifin, — pasoi Shpresa. Të tjerat miratuan me një psherëtimë si në kor.

— Po ju, mor shokë, ç'thoni? — ju drejtua burrave Shpëtimi.

Heshtje.

— Ç'janë këto, bre?

— Llafe janë, llafe... — u hodh Beluli.

— Po kësaj t'i marrin të keqen, — u hodh Shpresa dhe i ra shpatullave Gonxhes. Nga sytë e saj, si të ishin dy qershi të pjekura gjer në pikë të fundit, u këputën dy lot. Kasëmi ja lëshoi shkaras përbuzjen.

— Tamam ajo që tha Shpresa është, — kumboi zëri i Valit. — Edhe ata që i hapën këto fjalë, e dinë se s'ka asgjë të vërtetë...

— Hë, more, flisni! Ç'thoni ju të tjerët? — ju drejtua edhe një herë burrave Shpëtimi.

— Edhe mua ashtu më thotë mendja, llafe do të jenë.

— S'është nga ato çupa Gonxhja.

— Derës së Shahinit, për punë nderi, s'i ka dalë gjysmë fjale... S'më besohet...

- Po fjala s'del kot... xheç do ketë ndonjë gjë.
- Kush tha?
- Ata që thonë, kush. Ka parë, pa ka folur...
- tha Çeçua. Nja dy i dhanë të drejtë.
- Demek... sipas teje... — e provokoi Qerami.
Çeçua u nxeh:
- Sipas meje, mos më çaj kokën shumë ti...
- Fundja s'thashë që është e vërtetë, de, — dhe ju kthye Qeramit përballë.
- Po ty si ta pret?
- Nuk e di.
- Asnjë nga ne nuk e di, po i ta ha mendja!?
- Janë të ngatërruara këto gjëra, — foli si me vete një tjetër.
- Hë? — Kishte vënë duart mbi gjunjë dhe priste përgjegje Çeçua.
- Gjersa doli tymi, janë ndezur urët — tha Qerami.
- Epo na e thuaj, ta marrim vesh të gjithë. Ç'di ti, — e mori fjalën përsëri Shpëtimi.
- Ashtu ma preu e ashtu thashë... Oj ky, — dhe, duke mbledhur shikimin, diç i mërmëriti pa zë Kasëmit.
- Se mos jua vunë brigadiere me zor. Vetë e zgjodhët. E tani... Kjo është punë armiqësore...
- Mbaj, moj, gojën.
- Kështu është... Me këto që po bëhen, pengohet ngritja e shoqeve në përgjegjësi... Pengohet emancipimi. Pengohet fjala e partisë... — Valit ju duk se e mori me shumë zjarr. Heshti një çast për t'u përmbajtur, pastaj vazhdoi më shtruar: — Thashetheme ka kudo... Edhe ne kishim atje, në ndërmarrje... Po jo kështu...

— Epo ne jemi ca si prapa... Fshatarë hesapi, gjë e trashë, — shtrembëroi fytyrën Qeram.

— Po je kooperativist, shoku Qeram. E m'i thua vetes njëzet herë në ditë revolucionar... Apo jo?

— Atë fjalë e ka në majë të gjuhës, — tha Shpëtimi.

— Sikur i mbeti revolucioni këtij në dorë, — foli një nga vajzat, e papërmbajtur.

— Epo ju këtej thoni «Fjala pa punë, si mulliri pa ujë», — e mori prapë fjalën Vali.

— Mos ta kam lënë normën zotrote të ma bësh, a? Oj, dy javë s'ka që ka ardhur e po na jep mend.

Shumicës nuk i erdhi mirë nga fjalët e fundit të Qeramit. Po Vali i kaloi si pa i ndjerë dhe vazhdoi shtruar:

— Epo revolucioni s'do vetëm norma, shoku Qeram.

— Jo, moj...

— Duhet shkukur edhe ata gjambat që na shpojnë rrugës...

— E na paske ardhur të na i shkulësh ti, demek! Pse s'thua që shpëtuam...

— Mos e tepro, Qeram, — qortoi Shpëtimi.

— Po s'e shikon ç'flet? Sikur jemi një tufë ballistësh.

— Epo mirë të thotë, ore de... Kur s'je i zoti të shkulësh, mos mbill... — shikimet e njerëzve u nderën. Qeramit ju zgurdulluan sytë.

— Dëgjo këtu, Shpëtim Osmani... Mos e lësho gjuhën kështu, se do përgjigjesh. Apo kujton se je komunist e mund të thuash ç'të duash.

Shpëtimi hodhi me nervozizëm bishtin e ci-

gares, që mbante në cep të buzëve. Njerëzit prisnin ndonjë breshëri të rëndë, kurse ai jepte e merrte me veten, që të përmbahej. Në qiell u dukën ca njolla resh.

— Belul, mirë e pate ti, do të kemi shi, do të kemi, — tha Kasëmi duke treguar qiellin.

— Po mund të kemi edhe rrufe, ama, — gati sa s'bërtiti Demiri, që ishte torturuar deri tani duke u përmbajtur. Kasëmi e mblodhi shpejt fillin që kishte lëshuar.

— Xha Shahini! — se kush tha. Shpëtimi gëlltiti fjalët që desh t'i hidhte Qeramit. Të gjithë kthyen kokën nga ledhi i parcelës. Bashkë me Shahinin po vinin edhe Fadili, Reshati e Bujari, sekretari i rinisë. Dukej që plaku ishte bërë spec dhe jepte e merrte me duar e me kokë.

Ishin afruar te gorrica. Shahini ndjeu shikimet e anëtarëve të brigadës dhe s'foli më. Brigada kishte formuar një gjysmë hëne. Shikonin njëri tjetrin, mendoheshin, pyesnin e përgjigjeshin me mend. Të gjithë e ndjenin se do të ishte një mbledhje e fortë. Mbi fytyrën e Kasëmit e të Qeramit filluan të duken hijet e frikës. Valit i erdhi mirë që mbledhja do të bëhej aty. Ju kujtua një fjalë e xha Beqos «Sa më afër rrënjës ta kapësh gjembin, aq më pak të shpon dhe aq më shpejt e shkul».

Zjarri kishte qenë ndezur. Duhej vetëm një e fryrë që të shpërthenin flakët. As gjakftohtësia e Fadilit e as ndërhyrjet e disa të tjerëve, që s'ua kish qejfi të ndizeshin gjakrat, s'mundën t'i vinin dot fre shpërthimit. Ardhja e Fadilit, e Reshatit dhe e Bujarit e kishte ngrohur shumicën, sidomos gratë dhe vajzat, të cilat e ndjenin se po u hollo-

hej gjuha. Nuk mbeti njeri pa folur. Reshati dhe Fadili gjithë atë ditë ishin marrë vetëm me kete punë. Kishin shkuar brigadë më brigadë e kishin biseduar me shumë njerëz... Kishin menduar që mbledhjen ta bënin në mbrëmje, me të gjithë anëtarët. Po ja që koha s'priti. Ata nuk folën të parët. E lanë ta pleqëronte një herë brigada këtë punë. Dhe doli më mirë seç e patën menduar ata.

Ja nisi Shpëtimi. Pas tij Vali, Shpresa e diskutimet u ndezën si benzinë, që s'do t'i frysh fare. Njerëzit s'linin njëri tjetrin të flisnin gjatë. Shumica i nxirrnin të larë Gonxhen dhe Demirin, nja tre a katër në fillim heshtën, duke menduar se, «ku del tym, ka zjarr», e s'thanë as kështu as ashtu... Kasëmi, kur ndjeu se po i afrohej fitili i ndezur, e ktheu pllakën e u ngrit mbi të tjerët. «Fjalë në erë janë, kot u bien në qafë...» Kurse Qerami e kishte thënë fjalën para se të vinte xha Shahini me të tjerët e s'kish si të tërhiqej. Po edhe më tej nuk shkonte.

— Mua kështu ma pret... Fjala s'është pa gjë... Kështu më thotë kjo imja mua, — dhe i ra kokës.

Reshati e dëgjonte Valin me shumë vëmendje. Kjo «çupkë qyteti», me trup të pakët e me atë fytyrën e njomë, që e tregonte më të vogël seç qe vërtet, nganjëherë s'ja mbushte syrin. E tek e dëgjonte, i thoshte vetes: «Të dukej kalama, po ajo paska një barrë mend se... T'u sulka dhëmb për dhëmb e s'ta paska për pesë hiç... Apo s'e paska gjuhën brisk! E... e, po plakemi për vete dhe fëmijët tanë na duken gjithmonë kalamaj...» Ai vinte re gjithashtu se, sa herë fliste ajo, e pasonin

pesë-gjashtë nga vajzat e tjera. Dhe e ngrinin zërin, jo shaka. «E më ta lumsha, moj Vali!»!

Si folën gjatë anëtarët e brigadës, Fadili i ra drejt.

— Bukuri! Ju s'i besoni këto llafe... Mirë. Po kush na i nxjerr këto gjëra? Vini dot gisht ju?

Filli i mbledhjes sikur u këput, po e lidhi shpejt Shpëtimi:

— Unë do t'i them sheshit ato që mendoj. Këto punë janë të Kasëmit e të Qeramit... Me të vënë Gonxhen brigadiere, ja, këtu jemi dhe i dimë të gjithë, ata janë përpjekur të pengojnë brigadën.

— Si flet ky kështu?!

— Ç'janë këto?!

— Unë jam komunist. Kështu mendoj e kështu flas. Pritëm që ta ndihmoje Gonxhen... Ti s'u tunde... Pastaj fillove ta ngatërrosh më keq. Po, kur pe që ajo po ja merrte dorën, zure nga këto të tjerat... Se ti e di ku vret samari më shumë... Qerami po, të mban bishtin...

— Ore, me gjithë mend e ke ti, — deshi të tregohej i matur Kasëmi.

— Ç'faj kemi ne se ajo s'e bën dot punën? — tha Qerami.

— Ajo e bën e ka për ta bërë më mirë se Kasëmi. Ju s'e vutë kot në krye. Jua mbushi syrin, pa e vutë. Edhe tashti doni ta pengoni... E pastaj t'i thoni partisë: «Ti mirë e ke, po në fshatin tonë s'janë femrat për brigadierllëk...» — Reshati fliste dhe s'ja shqiste sytë Qeramit. Ç'janë këto shpifje të ndyra?

— Unë?

— Po kush?

— As unë s'kam folur, — tha Kasëmi.

— Ju të dy i kini hapur fjalët, — foli Vali.

— Edhe unë kështu them, këta të dy, — i shkoi pas Shpresa. Dhe ju kthye Kasëmit:

— Ti mos më shiko ashtu si ujk, se s'të kam frikën.

Folën dhe të tjerë. Kasëmi e Qerami u munduan të mbroheshin, herë duke bërë be e rrufe e herë duke u justifikuar se «më mirë të të dalë syri se nami». Po ishte e kotë. Fadili e Reshati e çpështuall me kujdes në sy të të gjithëve tërë atë lëmsh thashethemesh që kishin mbledhur nëpër fshat e nëpër brigada, dhe kreu i fillit doli në gojën e atyre të dyve. Bujari tregoi përrallëzën e përçorit... Pastaj i tha së bijës së Kasëmit, Verës, që të ngrihej e të tregonte ç'kishte dëgjuar për Gonxhen nga goja e të jatit dhe e Qeramit në shtëpi. Kasëmi e pa të bijën sikur do ta përpinte. Ajo u zverdh, si të mos i kishte mbetur pikë gjaku.

— I dimë të gjitha, — i tha Fadili. — Partia e rinia nuk flenë... Po thuaji me gojën tënde më mirë, që t'i dëgjojnë të gjithë. Dhe mos ki frikë nga yt atë, se, në guxoftë, ja presim dorën mu këtu. Hajde, Vera...

Dhe ajo u çua sikur të ishte përpara ekzekutimit. Ato që dinte i tha shumë shkurt e gjysma-gjysma, po ato mjaftonin për t'i vënë kapakun çështjes.

Gjatë gjithë mbledhjes Shahini rrinte kërrusur e nuk i ngrinte sytë. Demiri e kishte braktisur atë mëdyshjen e fillimit e tok me Valin e Shpëtimin ish-in bërë vatra kryesore e diskutimit. Xha Shahini

nguli këmbë përsëri që ta hiqnin të bijën, po fjala e tij nuk zuri vend.

— U muarëm vesh, besoj? — tha Fadili kur po mbyllej mbledhja. — Për Qeramin dhe Kasëmin kjo që bënë të jetë e para dhe e fundit. Po që se do të përpiqeni të bëni prapë të këtilla, do të mbledhim fshatin e do të bëjmë gjyq.

— E do t'ju fusim në kallëp tjetër, — u hodh Çeçua.

Kur e lanë gorricën dhe u vargosën ledhit të parcelës, po errej. Bisedat vazhdonin. Reshati ecte pas Shahinit. Çeçua me Belulin kishin marrë Kasëmin në mes e bisedonin shtruar. Qerami jepte e merrte me Shpëtimin për ato thumbat e fillimit të mbledhjes. Fadili diç i thoshte Gonxhes. Kurse Vali... «Ishte mbledhje e fortë, jo shaka... Besoj se, pas kësaj, do të ndryshojë puna. Edhe Gonxhja nga fundi i mbledhjes filloi të ndryshojë. Me sa duket po e kupton se ka mbrojtje të fortë... Kjo me siguri do t'i shtojë besimin... Sa mirë foli Fadili! Pse Shpëtimi keq?! Po Demiri? Po Shpresa? Bujari... Po unë? Si?! E, mirë thashë: «Pc unë?!» Më vjen turp prej vetes kur kujtoj si i mendoja mbledhjet e këtushme... si e kuptoja rolin tim... Jo rolin, po «misionin tim të madh»... Ja ç'domethënë të mos e njohësh njerëzit, të mos e njohësh jetën... ^{Paradaj} ~~Pastaj~~ ndërtoam një pritë në Përroin e Kuq për të kthyer ujin në patatet. S'kisha parë kurrë si ndërtoheshin pritat... Premë hunj në korie. Premë dhe purteka. I ngulëm hunjtë në rresht. Pastaj thurëm purtekat nëpër to dhe bëmë një gardh të trashë. Pastaj hodhëm para tij gurë e plisa. Kjo

ishte e gjitha. Po mbledhja e sotme a nuk i ngjet një prite të tillë?!

Ne ishim hunjtë... Diskutimet tona purtekat që thurëm gardhin. Thashethemet ishin ujërat e turbullta që u premë rrugën. Kurse unë mendoja nganjëherë se po vija këtu që t'u prisja rrugën vetëm të gjitha dallgëve. Ç'budallallëqe!!! Si duket ngaqë s'e dija si ndërtohen pritat këtu, në fshat. Në priten e sotme unë s'jam veç një hu dhe ndoshta një nga hunjtë më të hollë, që vihen qosheve, ku forca e ujërave është më e dobët...»

Nga mendimet e zgjoi një e rënë dashmirësie mbi shpatulla. Ishte Reshati.

— E tunde sot... Të lumtë... Na bëre punë...

Ajo buzëqeshi dhe uli kokën si fajtoreshë. Kur ai ishte larguar disa hapa, Vali ngriti sytë dhe e pa sikur t'i thoshte: «Unë s'jam veç një hu në prite». I futi krahun njëres prej vajzave që ju ndodh pranë, dhe e shtrëngoi fort, sikur deshte të ndante me të një gëzim të madh, që s'e mbante dot vetëm. Në fshat ishin ndezur dritat.

REVOLTA

Vali i hodhi një vështrim ambulancës qoshe më qoshe. Kishte ardhur edhe herë të tjera këtu e gjithmonë i kishte bërë përshtypje pastërtia dhe rregulli. Edhe tani, ndonëse po afronte koha që Kristina të linte punën, gjithçka ishte në vendin e vet.

Duke mbajtur një çast shikimin mbi dollapin ku ishin vendosur barnat e mjete të tjera mjekimi, Vali u mundua të kujtonte njohuritë që kishte marrë në shkollë për sanitetin.

— Më jep pak fashë!

Zëri i Kristinës e nxori menjëherë nga kujtimet.

— Ja, ja... Mbi tryezë.

Kristina, si mbaroi së lidhuri plagën, ja futi pacientit dorën midis kopsave të jelekut dhe i ndihmoi të hidhte xhaketën krahëve. Kur po dilte, i dha disa këshilla, po ai s'e dëgjoi deri në fund. Bëri një lëvizje me dorën e shëndoshë dhe lëshoi një mërmëritje nëpër dhembë, fare i shkujdesur. Të gjitha këto për Kristinën donin të thoshin:

«Hë, moj, se do të shkoj, po hë!»

S'i erdhi mirë.

Vali pa orën.

— Edhe dhjetë minuta ka. Tani s'besoj të vijë njeri. Ikim?

— E dinë që jam këtu deri në gjashtë. Disa e lënë për minutën e fundit.

Megjithëse e kundërshtoi, Valit i erdhi mirë nga përgjigja e saj.

«Çudi! Në punë Kristina është kaq e rregullt, kurse...»

— Ç'u bë me Gonxhen?

— Po e merr veten. Edhe pak kohë e ke për të parë ti.

— Po i ati?

— Ai akoma sikur përtypet. Gjithë puna është te Gonxhja... Na prishën shumë punë ato fjalët që i dolën për Demirin. Këtu e pashë unë sa të tmerrshme janë thashethemet. Pleqtë thonë një fjalë të bukur: «Po të trembesh nga qeni e të vraposh, të ndjekë më shumë». Kështu janë edhe thashethemet, sidomos kur dalin për punë nderi.

— Po në mbledhjen e rinisë si kaluat sot?

— Ishte interesante. Edhe aty për thashethemet u diskutua. Edhe për grupin artistik. Çudi, Krista, larg prindërve, vajzat ishin krejt ndryshe, më të gjalla. Megjithëse prapë ndryheshin prej vëllezërve e kushurinjve. Ata sikur kishin marrë me vete hijen e baballarëve.

— Ti fole?

— Diskutova edhe unë, po disa shokë, sidomos Demiri, kur mbaroi mbledhja, më qortuan se fola shumë ashpër.

Kristina diç deshi të thoshte, po vetëm buzëqeshi. Megjithatë Vali e kuptoi.

— Jo, kishin të drejtë. Më duket se ta kam thënë edhe një herë. Në fillim m'u bë mani të zbuloja të metat e gabimet e të tjerëve. Sikur në fshat kishte rënë ndonjë epidemi dhe unë isha dërguar për të bërë ekzaminimin e sëmundjes... Këtë ma vuri në dukje edhe Fadili, edhe disa të tjerë. Prapë nganjëherë marr zjarr kot.

— Ikim tani? — dhe Kristina mori çelsin mbi tryezë.

Ato e nisën rrugën ngadalë dhe në heshtje. Kristinën e shqetësonte heshtja, ashtu si shqetëson një fajtor që i duket se gjithmonë do t'i kujtojnë fajin e hershëm.

— Domethënë e provove dhe ti kritikën e fshatit, — dhe nëntekstin e zbuloi buzëqeshja e saj.

— Ty mos të mbetet qejfi. — ja ktheu Vali me të qeshur. — Si shoqe e mirë që je, nuk më le vetëm.

— Si? — pyeti Kristina me gjysmë zëri.

— E ç'rëndësi ka? — dhe pas një pauze të shkurtër: — Krista, mua më duket se kanë të drejtë. Ti rri shumë larg tyre. Unë s'e kuptoj si nuk mërzi-tesh? Një vit këtu dhe asnjë shoqe!

Kristina dukej e vrarë, e mërzitur. Vali, që i kish futur krahun, e afroi pas vetes. Ajo edhe herë të tjera i kishte hedhur nga ndonjë fjalë, po këtë radhë **desh** t'i fliste gjatë, t'i hapte zemrën e t'ja thoshte të gjitha. Po ndërsa ajo mundohej të gjente radhën e fjalëve, erdhi Ganiu me një dy shokë të tjerë të brigadës së saj dhe biseda ndërroi udhë. Duke ju afruar shtëpisë, Kristinën e kapi shqetësimi. Ajo po

vonohej dhe Aspasia me siguri do të bëhej merak. Le pastaj sikur ta shikonte që shetiste me djem.

Kur arritën te dyqani, në bisedë e sipër, ashtu si pakuptuar, grupi i të rinjve qëndroi. Ajo hodhi një shikim të trembur nga shtëpia dhe diç i tha Valit në vesh.

— Ikë ti, Krista. Ònë do shkoj te Shpresa sonte. Mos më prisni.

Ajo lëshoi një përshëndetje të thatë dhe u nis thujt duke vrapuar. Po u përmbajt e nisi të çapitej ngadalë, kur dëgjoi pas shpine zërin dhe të qeshurat e Valit.

Ç'është e vërteta, Kristina, që kur kishte ardhur vullnetarja, kishte filluar të ndryshonte, po këto ndryshime ajo i ndjente pak, kurse Aspasia shumë më tepër nga ç'ishin në të vërtetë. Ajo gjallëri që po merrte fytyra e së bijës, ndonjë fjalë që i kthente, nja dy, tri shetitje që kishte bërë me vajzat e fshatit, pëshpëritjet vesh më vesh e të qeshurat fshehurazi me Valin, Aspasia s'i gëlltiste dot. Ishte bërë më e rreptë me të bijën, kurse Valin filloi ta përbuzte. I kishte hyrë frika për fatin e së bijës (natyrisht, edhe për të vetin), ndaj mendohej t'ja shtrëngonte rripat së bijës e t'i vinte sinor me atë «bishtpërdredhurën, që po tërbonte fshatin».

Si i foli gjatë e gjatë Kristinës e s'i la gjë pa i thënë (ajo e kishte parë kur u nda me Valin), ashtu, duke turfulluar, mori lapsin e fletoren dhe u ul pas tryezës. Kristina e dinte se ç'do të shkruante e ëma. Ajo këtë punë e bënte për javë dhe gjatë atij viti kishte dërguar më shumë letra se tërë jetën e saj. Kristinës i vinte ligisht kur lexonte ato letra, po ja që i lidhej gjuha e s'guxonte të fliste. Shpesh ziente

përbrenda dhe i vinte t'i griste ato shkaravina të neveritshme, po muajt pasuan njëri tjetrin dhe ajo sikur po mësohej me këtë punë të së jëmës. Tani përsëri i qe zgjuar neveria për letrat. Ndërsa ajo po shkruante, Kristina mundohej të kujtonte emrat e panumërt që merrnin letra prej Aspasisë. Shumë prej tyre për Kristinën ishin emra njerëzish të panjohur, megjithëse Aspasia i quante «E dashur kushërira ime Gjenkë!» apo «E shtrenjta motër Fotini».

Dhe, kur ulej Aspasia të shkruante, lëshonte rrënjë mbi karrige. I zgjidhte fjalët me kujdes, përdorte tërë mjeshtërinë e saj për t'u shprehur sa më qartë dhe për t'u treguar sa më e afërt me ato që do të merrnin letrat. Kurse kësaj here Aspasisë i rrëshqiste dora, pa u penguar gjëkund, dhe i rëndonte lapsit gjithë nerva, sikur po gërvishte me gozhdë mbi një dërrasë. Nganjëherë luante kokën e seç lllomotiste me vete. Kristina, ulur në krevat, e ndjente nervozizmin e së jëmës dhe po e ndiqte me një ndjenjë të turbullt shqetësimi. Nëpër këtë turbullirë ajo herë ndjente lodhje, këputje, që i ndillnin ngashërime të hidhura e herë i dukej sikur në organizmin e saj po hynte diçka e panjohur, që i zgjeronte damarët, i ndizte gjakun dhe i shtonte nevojën për të marrë frymë. Dhe ndjente një si dhembje. Ishte revolta që ish zgjuar dhe po çukiste nga brenda lëvozhgën e ndrojtjes, të përuljes para sentimentalizmit, nënshtrimit.

Aspasia u ngrit nga karrigja me një kënaqësi solemne. Hoqi syzat, puliti sytë duke buzëqeshur, dhe hodhi lapsin mbi tryezë. Kristinës ju duk e ëma tamam si një llogaritar burokrat që mbushet

brinjë më brinjë nga kënaqësia mbasi ka mbaruar së hartuari një koncept «ideal» të një shkrese të rëndomtë e tani s'i mbetej veçse ta shumëfishonte. (Dhe merreni me mend punën kolosale të Aspasisë, e cila e dhjetëfishonte letrën, duke e shkruar rresht për rresht me dorë, pa letër karboni). Aspasia, si u ngroh mirë e mirë me kënaqësinë e saj të çuditshme, i tha së bijës:

— Na... lexoje, — dhe në fund të fjalës i zbrazti mushkëritë gjer në fund.

Kristina u ngrit me përtesë dhe e ngrysur. Sidoqoftë, e parandjente se kjo letër do të kishte diçka të re. Kurrë e ëma s'kishte qenë kaq e frymëzuar. Me siguri ajo duhej të kishte dalë nga shtampa e saj e tmerrshme. Dhe ndryshimi u duk që në rreshtat e parë.

«E dashur Lefkë!» (në kopjen e parë të letrave të tjera, zakonisht vendi i emrit lihej bosh dhe plotësohej mbas shumëfishimit).

«Jemi mirë e mirë qofshi edhe ju... Le që mirë i thëncin kësaj tonës. Po ç'të zgjatem kot?! Të kam shkruar gjerë e gjatë, se ti i di mirë punët e ne hallemëdhave, që na hodhi fati këtu, në mes të maleve. Unë e di si e kam ngrysur këtë vit këtu, në vrimë të djallit... Jam bërë për të vvarë veten... Më duket se kam vdekur për së gjalli...»

Kristinës ju drodh letra në dorë. Aspasisë i erdhi mirë për shqetësimin e së bijës dhe i bëri shenjë me kokë, duke u krekosur, që të lexonte më poshtë.

«... Pa i ngrënë nja tri a katër vjet këtej as që kam shpresë për transferim. I kam varur shpresat te ajo puna që të kam shkruar e që besoj të

ma qash hallin. Do të ma gjesh një burrë të mirë për Kristinkën ti... e di unë. Jo se e kam vajzën time e dua ta lëvdoj, po lum kush do ta marrë. Do t'i ndritë shtëpinë. Unë e di që të kam për kokë ty, Lefkë, e do të ma bësh këtë... Ai baxhanaku i kunatit tënd sikur ka një djalë të pamartuar më duket. Pa shiko mos na e mbarosh këtë hall! Ose ndonjë tjetër po s'u bë aty. Ti i di vetë këto punë, më mirë se unë. Mendo për Kristinkën time si për çupën tënde... Po sa të do, moj Lefkë... S'të lëshon nga goja. Teto Lefka, thotë, e s'ka tjetër».

Kristina përsëri e ndërpreu leximin. Ajo as e dinte kush ishte kjo Lefkë, që i doli teto e as e kishin zënë në gojë gjatë atij viti. Ndjeu se po e humbiste durimin dhe ngriti sytë të shihte të jëmën, po ajo, krekosur më shumë se më parë, i bëri shenjë të vazhdonte leximin.

«E që të kisha fjalën, moj xhan i motrës, jemi në pikë të hallit. Sikur s'na mjaftonin ato që kishim, po na u shtua edhe një e keqe tjetër. Na kanë sjellë në fshat një vullnetare, një të krisur, një, si të të them... Një nga ato, që di ti. Dhe ma sollën në dhomën time, pa le. Më ka hyrë frika, Lefkë... Do më ikë çupa nga duart... Po s'më bëre derman, më iku Kristina... Si e ka zënë ajo proso-pulla, ju shoftë emri, ma prishi çupën. Ç'është ajo, ç'është ajo...!!! Pu, pu, pu, pu, pu... ç'të të them e shkreta... Pa vënë këmbën këtu, e bëri fshatin si shtëpinë e saj... S'mblidhet gjëkundi. Tri katër herë në javë s'vjen as për të fjetur, sallhanet gjer në mes të natës me fshatarët... Ç'të të them... Një

zuskë, një... lëre, lëre ç'më ka gjetur. Po ç'e duan çupat e fshatit se? Shushkat! I gënjen ajo e do t'i bëjë si vetja... Unë bëj çudi, moj motër. Po ka prindër apo s'ka kjo e mallkuar! Me sa mend e lënë kështu?! Le ta presin tani kur t'u kthehet me kopilin me vete...»

Kristina as vetë s'e kuptoi se si i erdhi. E mblodhi letrën shuk dhe e përplasi mbi tryezë. Aspasia çapleu sytë, sikur të mos u besonte. Edhe Kristina një çast u habit me atë që bëri, po nuk u pendua.

— O... O... O... — hapi gojën Aspasia, ashtu siç qe me sy të çakaritur, dhe u këput njëheresh. Trupin ja mbuloi një avull përvëlues. Sytë po i visheshin. U ul në karrige dhe shkopsiti bluzën, se po i merrej fryma.

— Mama!... Është... Po mua më vjen turp, mama... Unë s'jam e vogël! — Dhe Kristinës ju mbushën sytë me lot.

E mori ferra uratën... E mori, moj të martë mortja, të martë... Mbeta pa çupë... Aspasia fliste me një zë të këputur e të dredhur, duke luajtur këren sa majtas djathtas.

Edhe Kristinën e kishin kapur ethet. Ndjenja e re që ishte zgjuar te ajo, qe ende e papërkëmbur. S'e kishte parë kurrë të jëmën në atë gjendje. Ju dhimbs sa s'i kërkoi të falur, po në thellësi diçka lëvrinte, diçka luftonte me këtë dhembje, i shtrëngonte lotët, i lidhte gjuhën. Vali s'i ndahej nga sytë e mendjes. Asnjëherë s'e kishte ndjerë atë aq të afërt.

Pse s'ma dhe dënimin me kohë, o perëndi, po ma le për tani në pleqëri, — fliste me vete Aspasia.

— Pse s'ma more këtë të çmendur, po ma le të më nxijë jetën.

— Po, ç'kam bërë unë, mama?! Unë...

— A, moj kuçkë, moj kuçkë, që ma prishe çupën...

— Edhe Vali s'ka ndonjë faj... Nuk është ashtu si mendon ti! Kristinës i erdhi mirë që po i kthjellohej zëri.

— Si, moj korbë, ta mori mendjen prosopulla... Si arrite në këtë ditë, moj mos arrifsh të nesërmen, si?

— Mama?!

— Dreq më thuaj!

Vajza i vuri dorën mbi supe.

— Ikë... Hiqmu, — u çuar Aspasia. E kishin zënë të dridhurat. Në skajet e ballit, damarët i qenë fryrë. Midis vetullave ju formua një njollë e kuqe, kurse faqet po i zverdheshin. Kristina u tremb. Ishin shenjat e krizës së nervave. Aspasia kishte kohë që vuante nga kjo sëmundje. Me këtë Kristina justifikonte veten që i nënshtrohej pushetit të së jëmës dhe s'i kundërshtonte kurrë.

Aspasia u ngrit e dërmuar dhe u nis drejt shtratit. Kristina e kapi për krahu, po ajo i shtyu dorën. Vajza u ngashërye thellë e sa s'ju hodh në qafë, ta puthte, ta përkëdhelte, t'i kërkonte të falur. Po s'mundej. Nëpër atë mori ndjenjash, ajo diçka e padukshme, ende e pakuptueshme, humbiste e dilte përsëri në sipërfaqe.

Aspasia u shtri në shtrat me fytyrë nga tavani, mbylli sytë, shtrëngoi tëmthat e ballin me pëllëmbë e nisi të nxjerrë ca «oh-e» të mbytura e të zgjatura, që më shumë ishin ankime se rënkime.

Kristina qëndronte më këmbë si e hutuar te kreu i shtratit. Lagu një leckë me ujë të ftohtë dhe ja vuri së jëmës mbi ballë me kujdes, po ajo e flaku tej.

— Mama! Po unë...

— Lipsu!

Pa ditur ç'të bënte, Kristina mblodhi buzët, ngriti supet dhe filloi të lëvizë këmbët, sikur të kish një ditë të tërë ngulur aty pranë së jëmës. U ul në shtratin e saj dhe humbi në mendime.

— Vali! — thirri dikush nga rruga. Ajo njohu zërin e Bujarit.

— Vali!

— Kristina i mbërtheu sytë së jëmës, e cila u prish më keq në fytyrë.

— O Vali...i!

— A, moj kuçkë, moj kuçkë... Ah, moj ti që... oh...

Kristina s'dinte ç'të bënte. Qe ngritur më këmbë, po s'guxonte t'i afrohej dritares. Kur e thirrura u përsërit disa herë, u nis me majë të gishtave. Ngriti perden dhe i bëri shenjë me dorë Bujarit për t'i thënë që Vali nuk ishte aty.

Aspasia u dergj gjatë në kllapi, pastaj e zuri gjumi. Kristina i rregulloi jorganin me kujdes. U shtri dhe vetë në rroba, po dritën nuk e fiku. E dinte që s'kishte për të fjetur shpejt. Kokën e kishte të rëndë, në tëmthat sikur i ishin mbledhur grumbuj shushunjash, buzët i qenë tharë, sytë i digjnin, kurse trupin e ndjente të lodhur. Filluan t'i çfaqen arabeska fantastike si në një marrjemendsh. Ajo po voziste në dallgë të turbullta, në një lëmsh rrymash të ngatërruara. U mundua të përqëndrohej. Aspasisë po i normalizohej frymëma-

rrja e fytyra po i merrte ngjyrën e saj të zakonshme. Kjo sikur e qetësoi Kristinën. Po mendimet shkuan te e nesërmja dhe filluan të krijohen vorbulla të reja. U ngrit, mori letrën e shukosur dhe filloi ta lexonte prej fillimit, sikur desh të peshonte atë që kish bërë. Rreshtat e fundit i rilexoi disa herë. E ndjeu veten të fyer. Mendoi se ç'gjë e tmerrshme do të ishte sikur letra të binte në dorë të Valit; po, duke u munduar të përfytyronte atë çast, ju duk sikur Vali e lexoi letrën e qetë, mbeti një çast në mendime, pastaj qeshi dhe e kapi për supesh Kristinën e turpëruar. «Ç'bëhesh budallaqe»!

Diçka kërciti. Kristina mbeti pa frymë nga frika dhe rراسi letrën në gjoks. Vjedhurazi ktheu kokën nga e ëma. Ajo ishte kthyer në krah e vazhdonte të flinte. Tani Kristinës nuk i ndahej Vali. Sa mirë do të qe ta kishte pranë!!! Sa e ndjente nevojën e saj në këtë prak mesnate, e sulmuar nga vetmia, nga mendimet dhe pagjumësia. Sa të vështirë e kishte të çante vetëm ato ujëra të panjohura. Vali, që e kishte ndjellë kësaj rruge, me siguri do ta mësonte të voziste, po ajo ishte larg. Mbi tryezë rrinte letra e zhubrosur, që s'kishte guxuar ta griste.

ÇORBA E XHA BEQOS

Shpresa ishte një nga vajzat më të gjalla të fshatit. Në brigadë fliste e qeshte më shumë se të tjerat, në mbledhje s'ja përtonte të kritikonte, ndërsa në bisedat intime ishte mjaft e çelur. Veç të tjerash ishte dhe këngëtare e mirë. Kurse në grupin artistik nuk kishte asnjë vajzë këngëtare. Edhe ato dy vajza të tjera që merrnin pjesë, njëra ishte e bija e kryetarit, që sapo i kishte mbushur të pesëmbëdhjetat, kurse tjetra një pioniere e klasës së shtatë, nuk kishin zë të mirë.

Vali ua hidhte fajin shokëve të partisë dhe organizatës së rinisë që e kishin lënë pasdore punën e grupit, se tërheqja e vajzave në të s'duhej të ishte aq e vështirë sa e bënin ata. Dhe ajo kishte parasysh Shpresën.

— S'ka burrë nëne t'i mbushë mendjen Beqos,
— thoshte Fadili. — Njëqind herë i kam thënë. S'është punë që bëhet.

— Edhe ne jemi munduar, po s'kemi nxjerrë gjë, — thoshin Bujari dhe Demiri.

Po Valit sikur s'i besohej. Vërtet të ishte kaq i tmerrshëm xha Bequa! Ai ishte nga të pakët që

bënin shakara me Valin. Shpresa nuk ndruej, si të tjerat, të fliste para tij... Bile një herë ai tha se i vinte keq që s'e kishte dërguar të bijën të vazhdonte shkollën në qytet. Si ishte e mundur që e bënin kaq të ashpër, kaq prapanik!? Kaq hipokrit të ishte ky burrë me një barrë thinja, që e nderonin aq shumë dhe i kërkonin mendim për çdo gjë!? Ai i pat thënë Shahinit që të mos kërkonte ta hiqte të bijën nga detyra e brigadieres dhe se, po të kishin vënë Shpresën në vend të saj, ai s'do të kish kundërshtuar. Pse të mos e lejonte atëhere të bijën në grupin artistik? Ja kishte bërë këtë pyetje edhe Shpresës.

— Ashtu është.

— Apo nuk do vetë ti?

— Unë dua, po babai s'ka për të më lënë kurrë.

— Pse s'i thua vetë?

— Unë!?

— Ke frikë, apo të vjen turp?

— Nuk i them dot.

—

— Ai do xhindoset, po t'i them.

Vali çuditej. Më në fund vendosi ta provonte një herë vetë.

— Kot që lodheh, — i thanë disa. Ndërsa Shpresa sikur u tremb. Po puna e grupit artistik nuk priste. Festivali po afrohej dhe më mirë se me Shpresën me kë do të fillonte ajo për tërheqjen e vajzave? Dhe vendosi.

— Xha Beqo! Ta zura derën sonte, — i tha kur po ktheheshin nga puna. Atij ju bë qejfi.

— Bujrum e mirse të vish! Po ç'të përmbysim? Mua më shkoi goja prapa duke të lutur...

— Desha të vija pa ftuar.

— Epo ti e di se kush vjen pa ftuar, e gjen pa shtruar. — Dhe qeshi me gjithë shpirt. — Do na zemërohet plaka që s'e lajmëruam.

— Unë do të vij për muhabet, se...

— E moj se bëj shaka unë.

Bequa hodhi ca hapa në heshtje. Pastaj tha:

— Shiko, mos ke kurdisur gjë, se je dhëlpër ti.

— Dhe buzagaz u mundua mos lexonte gjë në sytë e Valit e të së bijës. Shpresa uli kokën. Vali i shtrëngoi dorën.

— Të kemi bërë një komplot. — Bequa u bë serioz. — Do të vij t'i mbush mendjen plakës ta bëjmë kryetare të kooperativës.

— O të marrtë e mira, të marrtë... Shejtankë që je...

Zenepes ju bë qejfi për mysafiren. E puthi në të dy faqet, e pyeti kokë më kokë për gjithë të dashurit, me rrënjë e me degë dhe u ngrit t'i futej punës për të përgatitur darkën. Vali e zuri për dore:

— Unë s'kam ardhur për gosti. Ulu këtu e bëjmë muhabet. Tani jam e shtëpisë, apo jo, xha Beqo?

— Do të na vijë ligsht kur të na ikësh, — tha plaku.

Zenepja bëri si bëri dhe u shkëput nga dora e Valit.

— S'do bëj gjë, moj bijë... Atë që kemi për vete.

— Po bëre gjë për mua, do të zemërohem... Ta dish.

— Epo ne lopën do të therim, s'e sheh! — u hodh xha Bequa.

Po Vali tashmë ishte mësuar. Gratë e fshatit, sado që të premtinin, ato do ta bënin që do ta bënin të tyren. Dhe sa shpejt! Hyrë e dil e këmbë nga një fjalë me mysafirin, veç kur shtrohej sofrë. Ç'të shikojë! Hiq një gjellë e vërë një tjetër, ngri një tas e lësho një tepsi. Kështu i ndodhte kudo që shkonte dhe kudo gjysma e kohës i shkonte duke biseduar për zakonet prapanike, për shpenzimet e tepërta e probleme të tjera. Për të mos ja prishur qejfin, fshatarët shpesh ja miratonin fjalën, po ajo e ndjente se s'u vinte mirë.

Megjithatë, ajo shikonte një bujari e fisnikëri të lashtë në mikpritjen e fshatarëve. Sido që është ndodhur fshatari, sado hollë, sado ngushtë e sado halle të ketë pasur, kurrë s'i ka munguar sofrë e shtruar, fjala e ëmbël e shakaja për mikun. Veç me këto gjellët e shumta e tepronin. Këtu zakoni i keq kishte dalë mbi bujarinë. Tamam për këtë ja nisi Vali bisedës me xha Beqon.

— Dalëngadalë do t'i heqim edhe këto gjëra, — i thoshte ai, ndërsa nga ana tjetër seç i bënte ca shenja së shoqes dhe e ngutte në punët e kuzhinës.

Llaf muhabet e xha Bequa e nxori fjalën te Aspasia.

— Si, moj, e lanë motnë këtu e s'na e panë një herë derën. Çudi e madhe! Ja ti, sa mirë erdhe! Po njeriu për njerzillëk rron të shkretën. Nxire atë, ... Spasinë, natën e lëshojë në fund të fshatit, po nuk humbi, kokën të më preç... Po njerëz jemi edhe ne të shkretën, de... S'ka rënë nga qielli bazureti i saj. Oj, xheç i duket vetja... Ajo e bija dorën e ka të lehtë për gjilpërat, po gjuhën e ka

të rëndë për fjalë. Janë bërë si pula furiku atje në dhomë... Po edhe pula rri njëzet ditë e të nxjerr zogjtë. Po ato lanë motnë. Bëj çudi si s'mërziten, xhanëm!? Unë një ditë të mos dal e bëhem derr.

Vali i jepte të drejtë nganjëherë si për të ushqyer fjalën, po mendjen e kish gjetiu. S'dinte si t'ja niste. Shpresën e kishte kapur ankthi e ruante Valin në gojë.

— Njeriu s'rron vetëm për punë, de...

— Ashtu është.

— Po mirë them, — u mëshoi fjalëve Bequa. Valit ju duk se i erdhi fjala në shteg. Po përsëri s'ju duk me vend t'ja niste asaj që mendonte. S'i vinte mirë t'ja priste fjalën të zotit të shtëpisë. Po, kur pa se ai s'e ngau më tej punën e Aspasisë, i erdhi inat me veten. Tani i duhej të priste një rast tjetër. U shtrua sofrë.

— A... a... punë e bukur dhe kjo... Një mik më shumë, një pulë më pak, — tha Vali e mërzitur kur u lëshua pula me lëng. — Ma prishe qejfin, teze Zenepe...

— U, moj bijë, po ç'është ajo... Ne e kishim bërë niet për vete... Në mos sot, nesër do ta themnim... Po, meqë erdhe ti... se mos kushedi ç'bëmë.

Pulën e pasoi pilafi e atë ëmbëlsira, një lloj revanie me kos, që Vali në këtë fshat e provoi për herë të parë.

— E paske tepruar, teze Zenepe... Ma bëre borxh që të lë lugën e të ngrihem...

— Për kokën e Bashkimit po...

— Grua... thuaj peqe e mos u kap me këtë, se s'ja del dot... Kjo lidh burrat në fjalë e jo ty, pastaj, ç'të ka... — i tha Bequa së shoqes dhe,

si mbushi plot me revani lugën e Valit dhe të tijën, i tha mysafires:

— Epo të kam gjetur, moj kapedane. S'i përpoqëm dot gotat me raki, t'i përpkjim lugët me revani. Mirse na erdhe! Të lumshin këmbët e të hëngshim dasmën, në mos harrofsh të na ftosh.

Vali pa ç'pa mori lugën dhe i ktheu urimin Beqos:

— Mirëse të gjeta. Të të vijë Bashkimi shëndoshë nga ushtria e në dasmë të Shpresës.

— E moj, të thashë? — ju krekos së shoqes Bequa. — As çupat tona s'janë për davet e për muhabet si kjo. Djall, o Vali, jo...

— Mos e thuaj atë fjalë, xha Beqo, — ja mori fjalën Vali. Ajo e dinte se s'kishte asgjë për të kundërshtuar, po kërkonte shkak për t'i hapur rrugë bisedës, për të cilën kishte ardhur. — Çupat i kini të mira, po s'ua dini kimetin.

— Po litarin ua hoqëm nga kurrizi, me para s'i shet njeri, në punë i nxuarëm. Ç't'u bëjmë tjetër? Njëpër mbledhje venë... Epo tani vetëm të lidh përparësen unë e t'u lëshoj qoshenë... T'u japim edhe qesen e shtëpisë, se veç ajo ka mbetur. — Xha Bequa foli shtruar dhe pa e parë Valin në sy.

— Qesen e parave mbajeni dhe ca kohë ju, po atë qesen tjetër si kur s'po e zgjidhni dot... Ju ardhsha për të mirë. — Vali u ngrit nga sofa. Shpresa menjëherë pas saj. Bequa i peshoi një herë fjalët e Valit, këmbëu një shikim me të shoqen, që rrudhi buzët dhe vazhdoi të përtypej. Valit ju duk se ja gjeti shtegun bisedës, po nuk i pëlqeu që Bequa s'ju përgjegj. Kur mbaroi së ngrëni, ai i

shkoi një fshesë buzëve me shpinën e pëllëmbës, u sheshua mbi minder, e, duke dredhur cigaren, i tha Valit:

— Ke nisur të marrç huqet tona e ta shkosh fjalën pas gardhit më duket. S'e mora vesh atë punën e qeses tjetër.

Ajo u ndruajt dhe e vonoi përgjigjen.

— Ku ma kishe?

Vali pa Zenepen dhe Shpresën që po ngrinin sofrën. Ato dukeshin të trembura. Vendosi t'i bjerë drejt e drejt.

— Te çupat e fshatit, xha Beqo.

— E mora vesh që me çupat e kishe, po atë të qeses ma shkoqit një çikë, se sikur s'e kuptova.

Vali u tërhoq rrëshqanthi mbi minder e ju afrua.

— Janë pak ato që kini bërë, xha Beqo! I nxirrni në punë, nuk i shisni me para, nuk i ngarkoni si mushkat... Bukuri! Goxha është bërë, po ato janë akoma në qese, — dhe i vuri dorën mbi xhaketë, aty ku mbante portofolin.

— Nxirre kollën, de, nxirre... — e ndonëse mundahej të përmbahej, zëri i tij po e humbiste atë ngrohtësinë që kishte më parë.

— Edhe unë po i bie drejt... Te Shpresa e kam fjalën.

— Hë? — bëri ai me hundë dhe i hodhi një sy dhomës mos qe e bija brenda.

— Pse nuk e lë të vijë në grupin artistik?

Bequa hungëroi. Muskujt e nofullave i kërcyen mbi rrudha. Valit ju kujtuan fjalët e Fadilit e të Demirit për xha Beqon dhe po u jepte të drejtë. Po nuk do të tërhiqej.

— Sa të forta janë këto drej zakonesh!
— Këto zakone na e kanë mbajtur nderin gjallë, po ti je e vogël e s'i di gjërat. — Beqiri ndezi një cigare tjetër. — Lëre atë muhabet... s'përtypem dot andej unë.

— Unë për atë kam ardhur.

Beqiri u ligshtua e shfryu me duf tymin e duhanit:

— Ke ardhur mysafire... Bëjmë një muhabet tjetër e mos na ngatërro, hë, bijë! Ata që të kanë mësuar të vish me këto mend, kanë ardhur vetë kushedi sa herë, po unë ua kam thënë copë ç'kisha për të thënë.

— Mua as më ka mësuar e as më ka dërguar njeri, xha Beqo. Erdha vetë.

— Mirë, mirë... lëre atë muhabet tani...

Vali po njihte një tjetër xha Beqo, ndryshe nga ai që kishte njohur në brigadë. Dhe kushedi si do të bëhej po të vazhdonte kështu si e kishte zënë. Ajo e ndjente shtrëngatën nga fytyra e trembur e Shpresës.

— Po s'ka asgjë të keqe, xha Beqo... Pse të është mbushur mendja që...

— Lëre, de... vëri kapak...

— S'është mirë...

— Këtu ka mbetur e mira jonë, s'e sheh?

— Çudi, pra! Për në mbledhje ti s'thua gjë...

Për këtu...

— Në mbledhje s'ka tërc-vërce...

— Po pse në grupin artistik si mendon ti?

— Ahu... u...

— Po mirë them.

— Lemë për kokën tënde... Rri aman... Apo

ti ka futur spicat kjo? — dhe pa vrerët të bijën.
— Ngrije, moj, kokën ti?

— Unë të thashë, xha Beqo, kam ardhur vetë.
Ai as që e dëgjoi.

— Ty, moj, të pyes? — ju çuar së bijës.

— Jo! — belbëzoi Shpresa.

— Jongla të preftë... Trushkukur...

Vali atë çast e ndjeu veten të çarmatosur.
Bequa turfullonte.

— Dëgjo edhe ti, — ju drejtua ai. — Kjo punë
ka mbaruar. Këtë fjalë mos ma thuaj më.

— Po dale, ta bisedojmë një herë.

— S'ka ç'të bisedojmë...

— Ç'të keqe ka, mor xha Beqo! E ç'u bë se
Shpresa do dalë të këndojë para fshatit... Ka
ndonjë turp këtu?

— Vëri kapak, të thashë... Lëre tani.

— Po ne që shkojmë ç'jemi?

—

— Atje do vijnë edhe vajza të tjera. Pastaj
djemtë e fshatit janë.

— Djemtë janë djem.

— Po brirë s'kanë fundja.

— Ku di ti ç'është turpi... Turpin e di unë,
që ka tridhjetë vjet që e mbaj në kurriz. — Ai
u ra shpatullave me sa i hante krahu. — Tridhjetë
vjet kam. Që kur më iku ime motër në mes të
natës... E mori një zagarhane... Më ranë këmbët
duke e kërkuar, po s'e gjeta... Më shpëtoi gjallë...
S'ja kam parë sytë e s'dua s'ja shoh sa të kem
frymë... Tridhjetë vjet më parë kjo punë, bëj
hesap, që e mbanin mbyllur në shtëpi e ti më thua
ta lëshoj time bijë pa kapistall.

— Po pati për ta bërë atë punë, as kapistalli e as zinxhiri s'të shpëton dot.

— Ja këpus kokën... Ja, kështu... si pulës...

— Ai fliste me zë të lartë. Zenepja e Shpresa hyenin e dilnin si hije. Zëri dhe shikimi i tij kishin një forcë të çuditshme mbi to. Vali kurrë s'mund ta kishte marrë me mend se xha Bequa mund të ishte kaq i rreptë e Shpresa kaq e nënshtruar.

— Shpresa këndon bukur!

— I këndoftë qyqja mbi kokë, i këndoftë! Kur të shkojë në hale të saj (ai kishte parasysht martesën e së bijës), sytë le të nxjerrë... Sa është këtu, flas unë.

— E ke gabim.

— Epo erdhe ti të na shpëtosh tani, s'e sheh! Vali u prek nga këto fjalë. Kishte filluar ta humbiste gjakftohësinë e mezi po mbahej.

— Shpresa do vijë në grupin artistik.

— Kur të kafshoj dhë unë, në djall s'ka vajtur!

— Ti të jesh gjallë e shëndoshë, po ajo do të vijë.

— Dëgjo. Më ke ardhur mik e rri si mik. Komandar jam vetë në shtëpinë time e s'e lë mikun të më përziejë çorbën. Dëgjove?

— Të dija ndryshe, xha Beqo!

— Si më dije? Bukë e djathë më dije?

— Ty të duan aq shumë në fshat... Shokët e partisë të respektojnë. Njeri që i ke dhënë luftës... Partisë i ke qëndruar pranë... Ti vetë thua «Triskë s'kam, po jam komunist unë!»

— Po ç'kujtove ti?

— S'je komunist.

— Si, moi?

— Komunistët s'janë kështu.

— Dëgjo këtu. Kur luftova unë për këtë parti e për këtë pushtet, ti s'e kishe parë akoma dritën e diellit. More vesh?! Prandaj mos e lësho gojën ashtu.

— Atë që ke bërë atëhere, ta dinë të gjithë, po në këtë luftën tjetër që po të thërret partia, e paske zor t'i marrke armët. — Zenepja dhe Shpresa kishin ngrirë te dera. Bequa gjëmoi:

— Mos më ngatërro me partinë mua, se, për besë, të bëj atë që s'ta pret mendja.

— S'guxojnë vajzat të bëjnë gjë, se u merrni shpirtin.

— Mjaft!

— Mos të vijë keq!

— Qenkemi qorra ne e ardhke ti të na vësh sy...

— Sytë jua jep partia, po s'ju pëlqejnë.

— Epo mjaft, se më plase... E mos e thuaj më atë fjalë, se, për perëndi...

— Baba! — u drithërua Shpresa. S'e kishte parë kurrë kaq të xhindosur të jatin. Kushedi ç'mund të bënte.

• — Mbylle ti. Apo ta ka qejfi ta dredhësh bish-tin si ato bushtrat...

— Pse e fyen? — edhe zëri i Valit ishte i ashpër.

Shpresa i bëri shenjë që të mos vazhdonte më tej. Sytë e Zenepes i luteshin të heshte.

— Oj... vjen e bijë e botës e më tregon parti-në mua... Ke parë ti? — turfullonte me vete Bequa. Ai ishte prekur keq në sedër. Vali ishte bërë e papërmbajtshme.

— Ta kuptova se s'ja dëgjon fjalën, prandaj.

Atij i hipi gjaku, ju zgurdulluan sytë e duart po i dridheshin.

— Të bëj atë që s'e kam bërë kurrë. More vesh, apo jo? S'i ke bërë ditët ti të më kujtosh partinë mua. Përse na ke ardhur këtu, apo të na tregosh nga lind dielli?

— Më ka dërguar partia të punoj.

— Po jo të na tërbosh çupat e të na i lëshosh pa kapistall.

— Fjala e partisë s'është kapistall.

— Mos më trego partinë mua, të thashë, se të... Këtu s'mbaj unë... Të tregoj derën...

— Baba!

— Pusho ti!

Vali u ngrit.

— Mirë më thanë, me ty s'merret vesh njeri... Dhe shiko se mos ja nxjerrësh inatin Shpresës.

— Lipsu, moj.

— Mos ki merak se po iki.

— Prapa diellit të vesh!

Vali doli në rrugë. I digjte gjithë trupi, sikur kishte dalë nga një furrë e nxehtë. Gjunjët i dridheshin. Nga pas dëgjoi zërin e çjerrë të Beqos «S'ka lindur burrë të më futë lugën në çorbë».

* * *

Kristina u drodh nga frika kur ndjeu të kërçiturën e bravës së derës. Me të parë Valin, zbrazti frymën dhe vuri dorën në të majtë të krahërorit, sikur do të qetësonte zemrën, e cila filloi papritmas ato rrahje aq të shpejta.

— Po ti sikur...

— Më përzuri xha Bequa. — Dhe Vali hodhi trikon mbi krevat.

Zëri i saj i pikëlluar e shushati më tepër Kristinën. S'e kishte parë kurrë fytyrën e Valit aq të lodhur, aq të vrarë. Ndjente se duhej të thoshte diçka, po s'dinte ç'fjalë të nxirrte. U përcuall disa herë. Vali u ul mbi shtratin e saj dhe mori kokën midis duarve.

— Këtë s'e kisha menduar kurrë, — tha Vali dhe sytë sikur ju ligështuan.

— Pleqtë e këtushëm janë njëqind vjet pra-pa... S'guxon të thuash një fjalë, — deshi ta ngushëllonte Kristina.

Aspasia flinte e qetë, duke lëshuar një gërhitje të lehtë, që ja ngacmonte keq nervat Valit, kur këputej biseda.

— Injoranti! — tha e pasigurtë Kristina.

— Ahu dhe ti! Nuk është punë injorance kjo. Ndoshta edhe jot ëmë do të më kishte nxjerrë nga shtëpia po t'i kisha folur ashtu. Dhe ti me siguri s'do kishe bërë më shumë se Shpresa për të më mbrojtur. — Aty për aty u përmbajt dhe i hodhi Kristinës një shikim, sikur do t'i kërkonte të falur. — Çudi! Këtu, në fshat, disa mendojnë se ideali i emancipimit të fshatares është gruaja qytetare. Dhe s'e kuptojnë se këtu ju ka ardhur një shembull i tmerrshëm i antiemancipimit.

Kristina u çorodit fare. Shtrati i Aspasisë kërciti dhe ajo vuri përsëri dorën mbi gjoks. I bëri shenjë Valit që të ulte zërin.

— Ahu! S'e ka fajin vetëm ajo. Ti s'je bebe... Apo... — Po Vali gjeti përsëri forca të përmbahej. Sillej nëpër dhomë.

«Unë u ndeza te xha Bequa e dua t'i shuhem Kristinës. Kurrë s'e kam ditur se, kur u nevrifikoskam, qenkam e papërmbajtur... Epo fundja Kristinës i thashë të vërtetën. Po nuk duhej thënë kështu, jo. Unë e fyeva». I hodhi një shikim Kristinës si për të vërtetuar mendimet e saj. Ajo uli kokën. Kjo ja tendosi nervat edhe më keq. Vazhdoi të sillej nëpër dhomë. Mori mbi tryezë letrën e zhubrosur dhe filloi ta lexojë. Mbi kindat e buzëve të Kristinës dha shenjë një buzëqeshje e lehtë. Vali i hodhi dhe një sy dhomës e sikur ndjeu erën e dramës, që kishte ndodhur aty atë mbrëmje. Sikur u lehtësua dhe ju përgjegj sytheve të buzëqeshjes së Kristinës, e cila po ngazëllehej dhe mjaftonte një fjalë e Valit që t'i tregonte fill e për pe ç'kishte ndodhur. Po ky ishte vetëm një çast. Dhomën e mbushi jehona e zërit të xha Beqos. Si ndenji një çast ashtu, pa lëvizur, duke e kujtuar atë skenë, Vali ja tregoi Kristinës të gjitha. Ajo s'i dha asnjë mendim. Kjo e zemëroi Valin e sa nuk shpërtheu përsëri. Fiku dritën, u shtri në shtrat dhe nisi të bluante me vete tërë atë shqetësim të madh.

Kristina përgjonte frymëmarrjen e saj.

E PAPRITURA

...Dhe ishte vërtet e papritur! Si të thuash. .!
Po, ja... Mund ta krahasosh me një rast të tillë (krahasimi mund të mos jetë shumë i goditur, po diçka të përbashkët ka midis tyre): një atlet që s'ta mbush syrin, madje që e kanë këshilluar të mos marrë pjesë në garë, thyen rekordin. Ajo që ndodhi, habiti shumë veta, po sidomos Valin, së cilës ju duk e pabesueshme. Po ishte e vërtetë, megjithëse e papritur. Atë natë ajo kishte shkruar në ditarin e saj:

«... S'kam qenë kurrë më e shqetësuar se son-te. Kam bërë një gabim të pafalshëm dhe jam sjellë shumë keq me xha Beqon. Kur dola nga shtëpia e tij, isha shumë e fyer, ndërsa tani më duket se ai pati të drejtë të sillej ashtu me mua. Unë e fyeva më tepër. Pse e bëra këtë?! Ndoshta s'u përmbajta dot nga ai ndryshim i pabesueshëm i xha Beqos... Sidoqoftë s'duhej të isha sjellë ashtu. Tani kjo më mundon shumë. Dunet t'i kërkoj të falur...»

Duke zbritur shkallët, këmbët dhe duart i ndjeu të këputura. Kokën e kishte të rëndë, sytë

i digjnin, veshët i zienin nga një buçimë e mër-zitshme. Kishte bërë a s'kishte bërë tri orë gjumë. Ecte dhe mendonte për të mbrëmshmen. Kur u afrua te zyrat e kooperativës, shtangu. Mbi një trung lisi ishin ulur përballë diellit Fadili me xha Beqon. Ky i fliste papushim sekretarit dhe ai luante kokën mendueshëm. Vali mendoi të ndërronte rrugë e të mos u binte në sy. Me Fadilin do të takohej më vonë. I vinte turp nga xha Bequa. Po s'pati kohë të mendohej gjatë. Fadili e kishte vënë re dhe i bënte shenjë me dorë që të afrohej. Dhe, duke hequr zvarrë këmbët e këputura, ajo mendohej të merrte me mend ç'po i thoshte xha Bequa Fadilit për të. Po puna qëndronte krejt ndryshe.

Bequa kishte ndonjë orë, në mos më tepër, me Fadilin. E kishte pritur para portës e, me të dalë nga shtëpia, sa i tha mirëmëngjezi, s'e la Fadilin as t'i përgjigjej përshëndetjes.

— Fadil. .! E djallosa.

Fadili s'kishte kuptuar gjë dhe e pa i habitur.

— Lëre. . . Kam bërë atë që s'e ka bërë njeri në fshat gjer më sot. . . U turpërova në pleqëri.

— Nxirre de, të shkretën.

— Përzura mikun nga shtëpia.

— Ç'mik, o derëzi?

— Vullnetaren.

— Ore. .?!

— Lëre, Fadil. . . Lëre. . . E di si më vjen, apo jo?! Iku tani, u bë.

— Po si qe?

— Sikur se di ti?!

— More s'di gjë fare, po folë.

— Si, ore! Me gjithë mend vetë paska ardhur

ajo!? — Këto fjalë më shumë ja drejtoi vetes. — Për kokë të djalit unë thashë se ma kishe dërguar ti. Kishte ardhur për punë të sime bije, për atë të shkretë istradë. që ju shoftë emri.

— E pastaj?

— Do vij për darkë, më tha. Epo bujrum! E, të them të drejtën, m'u bë qejfi, se e kisha lutur nja dy herë. Nejse, bëri ç'bëri plakë e shkretë e u mundua ta priste mirë. Kur ajo, pa mbaruar bukën, ma lëshoi një fjalë. E ndjeva unë, më dogji. Kur u ngritëm nga sofrë, ja nisëm shtruar, po fjalë pas fjale e muhabeti u ntrash.

— Hë?

— Pastaj... E mori lumi... E shava.

— Ore, me gjithë mend e ke ti, apo..?

— More e përzura nga shtëpia, të them.

— Hajde, Beqo, hajde! Nga pleqtë, ajo ty të ka patur krah në brigadë. Kur filluan ta tallnin nja dy aty, ti e mbrojte, kurse tani... Edhe gabim ta kish ajo, ti, burrë plak, s'duhej t'ja vije re ... Ç'janë këto gjëra, bre Beqo?!

— Ti e di këtë të shkretë kokën time. Ndofta dukem i urtë kështu, por, po që për punë ndëri, më kërcen damari e s'ka zot që më mban. Edhe ty ta kam thënë sa herë: «Flije mendjen, s'ta jap çupën në istradë».

— Po ajo ç'tha?

— Ajo donte të më mbushte mendjen se në istradë s'ka ndonjë turp.

— Po ti?

— Unë i thashë njëqind herë që ta mbyllte këtë muhabet, se e pashë që po nxehesha. Po edhe ajo kokë më keq se timen paskej kur i hipte gjaku.

Bamb unë e bamb ajo. Do t'nuash ti po pse s'i hapa rrugë si më i madh? Po ja që s'i hapa dot. Veç një herë, kur ma priti: «Ti s'je me partinë». Këtu s'u mbajta më.

— Dhe ti i tregove derën?

— Po.

Dhe Bequa i qëndroi përballë sekretarit. Fadili gërvishtte truallin me majën e opingës. Si bënë ca hapa në heshtje, Bequa filloi të tregonte me hollësi si e kishte kaluar atë natë të tmerrshme, duke i bërë gjyqin vetes. Pastaj ishin ulur aty, mbi trungun e lisit.

— Vaftë në djall, vaftë, ime bijë me gjithë istradë, se nxiva faqen tani në pleqëri, — shfryu plaku.

— Ajo vjen nga anë e anës për të na ndihmuar, kurse ti...

— Unë i them «paske ardhur të na vësh sy». Le që kjo s'është gjë hiç. I thashë ca më të mëdha akoma.

— Na ndrite, lëre ç'punë të bukur ke bërë.

— S'e gjen gjekundi më të bukur punë. Do t'ja tregoj natës së varrit.

Vali ishte afruar. Gjatë gjithë asaj copë rruge, ajo kishte luftuar me veten për të mposhtur ndrojtjen.

— Mirmëngjez!

— Mirëmëngjez! — buzëqeshi Fadili dhe i bëri vend të ulej.

— Mirëmëngjez! — ktheu përshëndetjen Bequa, pa e ngritur kokën.
Heshtja ishte e shkurtër.

— Shoku Fadil... Le që besoj jua tha edhe xha Bequa. Për atë kam ardhur.

— M'i tha të gjitha.

— Të gjitha jo, po ca gjëra, — psherëtiu Bequa.

— Epo të tjerat po i them unë, po më parë duhet t'i kërkoj të falur xha Beqos.

Bequa ngriti kokën e rëndë.

— Edhe një shpullë të më kishe dhënë mbrëmë, s'do më mbetej qejfi.

— Ç'flet, moj, kështu? Ti je çupë e mençme, mos folë budallallëqe.

Fadili ishte çoroditur e s'po kuptonte asgjë. Shikonte sa njërin tjetrin, ngrinte supet, mblidhte buzët. Thonë se faji u bë qyrk e s'e veshi njeri, kurse ata grindeshin kush ta rrëmbente këtë qyrk.

— Për kokë të fëmijëve e mos më vijë djali shëndoshë nga ushtria që ti s'ke faj. Mos e thuaj atë fjalë, se më rëndon shumë, — ngulte këmbë xha Bequa.

Po edhe Vali në të sajën:

— Me sa mend të them unë ty «S'je me parti-në»? Ti mirë më the, «Na ke ardhur këtu me kordhë». «Të na tregosh nga lind djelli». — Pastaj ju drejtua Fadilit: — Më duket se, në vend që të jap ndonjë ndihmë, po dëmtoj më shumë.

Plaku i hodhi dorën shpatullave.

— Ti më rrofsh e më qofsh që më nderon kaq shumë, po atë të mbrëmshmen ma bëj hallall, hë bijë. Shpresa u enjt së qari kur ike ti. Edhe ime shoqe, që s'ma kish kthyer kurrë, s'më la gjë pa thënë. Kishte hak.

— Xha Beqo!

— Lëre tani. Kur të bëjmë pushimin e drekës

në brigadë, e bisedojmë më nge. S'ma mbush dot mendjen. Ahu...u! Të kisha qenë unë në vend tënd, kisha marrë leckat e i thosha fshatit rri me shëndet. Po qenke e fortë.

Fadili ja mori fjalën:

— Me të vërtetë që qenka muhabet i gjatë. Po me Shpresën si do ja bëjmë? Se për atë u bë tërë kjo mesele.

Bequa u mbush me frymë. Vali priti në ankth.

— Ja kam falur kësaj bablokes.

Valin kjo e papritur e mbushi me një gaz, që s'e mbajti dot. Ju hodh xha Beqos në qafë dhe ai tha atë, që ndoshta s'do ta kish thënë:

— Në pastë mbetur nderi aty, në djall të vejë.

— More, more, — ja bëri Fadili, — po ne t'u bëmë rrodhe e s'ta mbushëm që s'ta mbushëm mendjen. Si më the mua? «I duhet partisë ime bijë të punojë pa para një vit, vullnetare? Ngushtë jam nga gjendja, po merreni. Sa për atje, në atë istradë, s'e dërgoj dot». Vali me një të ardhur e ta mori çupën. Ç'është kjo?!

— Është ajo që është. Kjo jua kaloi juve. E kemi trime, Fadil, po s'ja dimë kimetin. Sikur t'i kishim tërë çupat si kjo ne, ehu...u!

— Do t'i kemi dhe ne, — tha Fadili.

— Aha...

— Pse, si të duket Gonxhja tani?

Vali s'po merrte vesh ç'ju bë, ku i vajti gjithë ajo lodhje, gjithë ajo këputje nga shqetësimet dhe nga pagjumësia. Edhe xha Bequa qe çelur e qe drejtuar, i lehtësuar nga ajo brengë e rëndë.

Fadili pa diellin.

— Hajde çupë, të nisemi, se na zuri dreka e kush dëgjon brigadieren, — qeshi Bequa.

— Vërtet që u vonuam, — aprovoi ajo.

— Hajd me të mira, o Fadil.

— Punë të mbarë.

Si u larguan ca, Bequa u kthye:

— Të pres nga shtëpia sonte. Të bëjmë një herë muhabet vençe.

— Thuaji Valit.

— Këtë s'e lëshoj unë, se kam për të larë gjynahet e brëmshme, po hap sytë e mos harrosh ti.

Kjo, pra, ishte e papritura, që i habiti disa, e sidomos Valin, e cila faqen e ditarit të natës së kaluar e plotësoi me këtë shënim:

«Ajo që ndodhi më habiti pa masë. Ndryshimin e xha Beqos unë e kuptoj kështu. Ai nuk do ta kishte lënë Shpresën të vinte në grupin artistik (një ditë natyrisht do ta linte), sikur të mos kishte ndodhur ikja ime nga shtëpia e tij në atë mënyrë. Me sa dëgjova nga Agimja dhe Shpresa, ai atë natë ishte bërë si i çmendur. Dhe më në fund fanatizmi i tij për të ruajtur nderin u thye. Dhe kjo është meritë e gjaknxehëtisë së tij. Ai u detyrua të thyejë një zakon, për të mbrojtur një tjetër. S'kam menduar kurrë se mund të ketë dhe të tilla variante lufta për të renë. Ai bëri kurban fanatizmin për të mbrojtur mikpritjen. Kjo është një fitore. Sidoqoftë, unë vazhdoj ta ndjej veten fajtorë që s'dita të sillem.

Mbi faqen e një mali, atje afër majës, rinia ka shkruar me gurë të bardhë: «Partia i ka rrënjët në zemrën e popullit.» Këtë ne shpesh e marrim si diçka thjesht simbolike, po unë i pashë rrënjët e partisë në zemrën e xha Beqos.»

Atë ditë edhe Fadili shënoi diçka në bllokun

që mbante për problemet e organizatës së partisë:
...«Kjo që ndodhi me Beqirin e me Valin ka një rëndësi shumë të madhe për luftën e së resë me të vjetrën. Me sa duket, me Beqon s'kemi ditur të punojmë si duhet. Nuk do të ishte keq për këtë që ndodhi të bënim një mbledhje të posaçme të organizatës Do nxirrnim shumë mësimë».

VAJZAT

Nga vetë natyra e saj, Vali ishte e afruar me njerëzit. Ajo kishte plot shoqe të lagjes, të shkollës, të ndërmarrjes. Po këtu në fshat shoqëria kish ca ngjyra të tjera. Vajzat dhe nuset e kooperativës seç kishin një forcë, që e tërhiqnin aq shumë. Me vajzat e gratë e brigadës u miqësua që në fillim, kurse tani njihte gjithë gratë e fshatit dhe, megjithëse për dikë më pak e për dikë më shumë, po dinte diçka për gjithsecilën. Dhe s'kishte ditë që nuk mësonte nga një gjë të re.

Atë të dielë ju vardis keq Sanija.

— Ti mbete me shoqet e brigadës, — i tha.
— Po edhe ne të tjerat shoqe të kemi. Hajde nga unë sot.

Ç'është e vërteta, Vali në shtëpinë e saj s'kishte vajtur, po kishte shkuar te shumë vajza e nuse të tjera, që s'i kishte në brigadë.

«Dhe këto i vënë re shumë të hyrat e të dalat. Kësaj ndoshta i ka mbetur qejfi... Po edhe mua se si më është dukur nganjëherë kjo Sanija! Si ndryshe nga të tjerat. Sikur ndruhet më shumë... sikur ka turp. Një herë seç desh të më thosh, po...»

Sanija ja .preu mendimet:

— Hajde!

I futi krahun dhe e tërhoqi. Valin sikur e çuditi ky gjallërim i papritur i shoqes. Nuk kundërshtoi dhe u nis pa ditur ta shpjegojë këtë ndryshim.

— Do të rrish për drekë. Mos kemi fjalë, — i tha pas pak Sanija, që diç gatuante përbrenda, po Vali nuk e shihte atë brumë.

— Ahu...u! Gjer të vijë dreka. Akoma është mëngjez. Le që më ka kritikuar edhe Aspasia, që mbeta dyerve të botës e s'po mblidhem në shtëpi.

— Aman dhe ti me gjithë atë kllloçkë, që ngroh vezët tërë ditën.

Qeshën me të madhe dhe e qeshura i ndoqi një copë rrugë. Po, me t'ju afruar shtëpisë, Sanijes po i fashitej ai gaz i fillimit.

Në dhomën e zjarrit s'gjetën njeri. Valit i bëri përshtypje pastërtia dhe po shikonte gjithçka me vëmendje. Kurse Sanija as që e kishte mendjen te perdet, te mbulesat e mindereve, apo te jastëkët e qosheve.

— Shkojmë në dhomën tjetër? Më mirë, jemi vetëm.

— Edhe këtu vetëm jemi.

— Këtu hyjnë e dalin njëqind.

Nga mënyra se si foli Sanija, Vali e mori me mend se vajzën e mundonte diçka e prandaj ndërhyri:

— Një ditë ke dashur të më thuash diçka... Po pastaj se si ndodhi e s'më the gjë.

— A do ndonjë djalë ti, Vali? — ja ktheu Sanija, duke ja ngulur sytë si me habi.

Vali qeshi.

— Këtë do të më thoshe?

Sanija s'u përgjegj.

— Jo, — tha Vali.

— Gënjën!

— Po të kem, s'kam pse të gënjëj.

Vali u bë serioze dhe po mendohej të merrte me mend ku desh të dilte Sanija.

— Ndoshta më ke parë që rri shumë me disa shokë në fshat dhe kushedi si të shkon mendja.

— Jo këtu, jo... Atje, në qytet.

— As atje. Kam njohur plot djem, po s'kam dashuruar njeri.

Sanijes s'i erdhi mirë nga sa dëgjoi. Vali kujtoi se mos mendonte që s'po i thoshte të vërtetën.

— Pse habitesh ti, Sanije? Të betohem që nuk dashuroj.

— Nuk e di pse më qe mbushur mendja.

Pasoi një heshtje e shkurtër.

— Unë dua një djalë, Vali.

— Si? Dashuron një djalë? — u tund Vali nga mendimet.

— Sh...t! — Sanija vuri gishtin tregues mbi buzët dhe bëri me kokë nga dera. Vali u tërhoq mbi minder dhe ju afrua.

— Ku është?

— Këtu, në fshat. Në brigadën tonë.

— Kush?

Sanija uli kokën.

— Ganiu, — tha.

Dhe u skuq.

Vali lëshoi një tufë pyetjesh rrufe dhe Sanija ju përgjegj me nga një jo ose po.

— E, sa ka kjo histori?

— Një vit.

— Sa, moj?

— Çfarë një vit. Më shumë. Që vjet në shkurt.

— E tmerrshme!

Kur pa që Vali u vrëjt e po humbiste në mendime, Sanija u çel.

— Asnjë s'e di veç teje.

Vali e pa në sy.

— Asnjë, asnjë, hiç. Po ta marrë vesh njeri, bëhet kiameti.

— Unë s'e marr me mend të jem në vendin tënd.

— Ndryshe është qyteti.

— Po mirë, nuk takoheni ju, nuk bisedoni?

— Kështu, tamam, vetëm tri herë jemi takuar.

— Tri herë?

— Jo, katër herë. Po ato kur jemi bashkë në sy të të tjerëve mos i quaj, se gjysmë fjale s'thua dot.

Valin përsëri po e rrëmbenin mendimet.

«Ç'forcë të madhe paskan këto zakonet! Sa i tmerrshëm qënka ky sfinks i padukshëm, që njerëzit këtu e quajnë nder!»

— Ganiu vendosi, — tha Sanija.

— Çfarë?

— Të më kërkojë te babai.

— Domethënë ta bëni sipas zakonit e të mos e marrë vesh njeri që u dashuroat.

— E kemi zor, Vali. Babai s'do pranojë. E di unë. S'është martuar asnjë çupë brënda fshatit gjer tani. Kam shumë frikë. Prandaj të thirra. Si më thua.

— Ç'të them unë! A e doni njëri tjetrin?

— Po.

— Atëhere mos kini frikë. Do ta kini ca zor, po do të fitoni.

Sanija donte të mbështeste diku ndjenjat e saj, frikën e saj. Qoftë dhe në një gënjeshtër. Po Vali e ndjeu se shpatullat e saj të njoma s'e mbanin dot tërë atë peshë. Ky nuk ishte një problem i zakonshëm, po një mal i madh e i rëndë, të cilin, për ta lëvizur, do të duheshin shpatullat e shëndosha të organizatës së partisë, të rinisë, të gjithë fshatit.

— Si ta ha mendja ty, Vali, do bëhet? — i tha Sanija kushedi për të satën herë kur po e përcillte.

— Mos ki frikë, budallaqe. Ty të gjithë do të të japin të drejtë e do të të ndihmojnë. Xha Veliu do japë do japë, po fundja s'ka ç'të bën hiç.

— S'e njeh ti atë, moj, jo!

Dhe Vali u nda me Sanijen duke marrë me vete një barrë shqetësime, që s'ju ndanë gjithë ditën.

Në fillim edhe ajo pati (ashtu si shumëkush me një shikim të parë) përshtypjen se vajzat e fshatit pothuaj ishin të gjitha njëloj. Po u zhgënjye shpejt dhe tani shihte se ato, ndonëse kishin gjëra të përbashkëta, ndryshonin shumë nga njëra tjetra. Secila kishte karakterin e vet, botën e vet. Kohën e lirë zakonisht Vali e kalonte midis tyre shetisnin bashkë apo mblidheshin grup herë në një shtëpi e herë në një tjetër. Dhe bisedat vashërore s'kishin të mbaruar. Sikur ta dinin që s'do të takoheshin përsëri të nesërmen, këto ndarje do të kishin qenë shumë të hidhura. Vali bisedonte me to edhe në brigadë, edhe në familje, në prani të prindërve. Po në këto grupe femërore bisedat izhin krejt ndryshe. Në brigadë mbretëronte

fjala e burrave, sidomos kur diskutoheshin probleme të rëndësishme. Në familje gjithashtu fjalët e tyre ishin të pakta: pyetje, përgjigje të shkurtëra, aprovime, diskutime për gjëra pa rëndësi. Kurse midis shoqeve... Sa ndryshe! Te ato lëvrinin ndjenja nga më të fortat e nga më të hollat. Larg ambienteve që i ndrydhnin, larg hijes së babait ato ishin guditërisht të çelura, flisnin papushim e s'dinin të pushonin. E ç'mendime! Ç'preokupime! Ç'dëshira! Këto shpërthime e rrëmbenin Valin, e entuziazmonin pa masë. Dhe nganjëherë, kur ndahej prej tyre, ndjente një boshllëk torturues, e përfshinte një zemërim i papërmbajtur: «Si është e mundur që këto vajza me një botë kaq të pasur, me tërë ato ndjenja, me tërë ato dëshira, me tërë ato energji, kur e do puna, kyçin gojën e s'ndjehen të gjalla!? Më shohin në sy, sikur do t'i shpëtoj unë. Si është e mundur që brenda tyre të jetojnë dy botë kaq të largëta!? Aq të ndryshme, në mos të kundërta!? Si është e mundur të jetojnë kaq pranë liria dhe nënshtimit!? Guximi për të menduar dhe frika për të vepruar!?»

Dhe Vali kujtonte shembuj të panumërt. Sanija guxoi t'i hapte rrugën ndjenjës së dashurisë për Ganiun, po tmerrohej kur mendonte se si do ta priste i ati kur të merrte vesh këtë gjë. Dhe, ndonëse kishin aq afërsi, dashurinë e saj s'e kishte marrë vesh asnjë tjetër, veç Valit. Agimja e kishte mbaruar shkollën tetëvjeçare shkëlqyeshëm. Mësuesi i kishte thënë të jatit të vajzës që ta linte të vazhdonte më tej. Edhe ajo e dëshironte shumë këtë gjë, po mjaftoi një «Jo» e xha Selfos që të merrte fund gjithçka. Agimja vuante për këtë e mundohej të ngushëllonte veten, se atëhere fshati

nuk ishte bërë kooperativë, kurse tani ishte ndryshe. Po Gonxhja! ? Po Shpresa!? Po Kristina!? Kristina!!! Po, po! Kristina që ishte qytetare, që kishte mbaruar edhe shkollën e mesme dhe që, në fund të fundit, nuk kishte as baba. Pse i mungonte guximi për të mbrojtur veten!? Që të mos dëmtonte shëndetin e së jëmës! Vetëm kjo të ishte? Fundja s'mund të gjendej një rrugë që dhe shëndeti i Aspasisë të mos dëmtohej? Po, sidoqoftë, ndryshe ishte puna e Kristinës, ndryshe nga vajzat e fshatit. Atë e ndiqnin pas llogaritë e së jëmës, kurse ato hija e fanatizmit, e kanunit, hija e babait, e burrit, e vëllait... dhe hija e tyre...

Ndonjëherë Vali s'qe përmbajtur e ishte grindur me shokët e partisë e të rinisë. Po tani u jepte të drejtë: «S'përmbysen shekujt me një ditë. E as me një vit e dy». Filloi të bëhej më e përmbajtur e, kur ndahej me vajzat pas bisedave të gjata e të zjarra, entuziazmi s'i kthehej më në revoltë. Tani i gëzohej tërë asaj pasurie të madhe shpirtërore, dëshirave të tyre. Duke ju hyrë thellë ndryshimeve të fshatit, ato nuk i dukeshin më ëndërra, po energji të mëdha, që shpërthenin herë pas here. Dy javë kishte Shpresa në grupin artistik, po sa kishte ndryshuar. Shpërthimi i saj krijoi vazhdë, që ndillte vërshime të tjera. Gonxhja e nisi rrugën e brigadieses si foshnja që fillon të çapitet, bie, ngrihet, bie, vritet e mendon se s'ka për të ecur kurrë, po tani këmba e saj po linte gjurmë, që i shihnin të gjithë. S'ishte e lehtë të linte gjurmë të tilla gruaja në këto male.

Shpirti vashëror fshatarak, ndjenjat, dëshirat, energjitë e tyre i ngjanin një rezervuari të madh, që sa vinte e rritej, zgjerohej e niveli i ujërave ngrihej. E, ndonëse muret mundoheshin të qëndro-

nin, po holloheshin përditë. Nga brenda i grryenin ujërat si pakuptuar. Nga jashtë vringëllinin kazmat. Dhe përditë muret hollohen, dhe përditë ujërat shtohen, dhe përditë ujërat rrjedhin. «Po, ujërat rrjedhin!» — Këtë Vali e bëri taban të mendimeve të veta. Diku muri shembej e niste vërshimi, diku dilte një curril i hollë (currilat ishin pa numër, ato rridhnin nga të gjitha anët), ai e grryente brimën e vogël të murit, kazmat i formonin shtrat nga jashtë dhe ai rritej e bëhej përrua. Dikush hidhte gurë. Disa currila mbylleshin, po shumica, pa ju tharë ende vazhda e rrjedhës, vërshonin duke marrë me vete edhe gurët. E çuditshme kjo lufta e ujërave të kthjellta, që duan vërshime, me muret e vjetra, që duan t'i mbajnë. Dhe ujërat rrjedhin. Po pse nuk i shembin këto mure të kalbur!? Mjaf-tojnë vetëm disa mina dhe... Si kudo te ne, edhe në Malas nuk mungonin këto mina.

Po ujërat s'i dinë rrugët... Do të formohen shtretërit, pa do të rrjedhin ujërat. A e kini parë kur vijnë vërshimet?! Rrugën e hap përroi, pastaj e ndjek lumi. Tani ujërat po rriten e po rrjedhin nga rezervuari, po një ditë ato do të ulen. Të çarat kanë filluar të shtohen. Dhe rezervuari do të shterë. Copat e mureve do të ngelen pa u shembur, do t'i mbulojnë vitet dhe do të mbeten dëshmitare për brezat që do të vijnë, si rrënojat e Apollonisë.

K T H E S A

Xha Shahini po bëhej nevrík. Dha e dha me vete e më s'priti.

— Ku do të shkosh? — e pyeti e shoqja, e cila e dinte ku i rrihte çekani të shoqit.

— Të shoh tët bijë... Doli e humbi. Ka tre sahat. Posi, isha budalla unë që thashë kjo valle këtë lodër do. Ec e mblidhe tani.

— Po ajo të tha që do të shkonte në mbledhje të kryesisë!

Ai u mat t'i zbrazej së shoqes, po ndërroi mendje dhe doli duke mërmëritur. Ndonëse kishin shkuar disa ditë, atij ende s'i ishin zbutur nervat nga mbledhja e brigadës.

Që larg xha Shahini mbërtheu sytë në dritaren e zyrës së kryetarit për të dalluar të bijën. ca dhe i doli dritares brinjas, nga e majta, ku errësira Po s'dallonte gjë. Tymi i duhanit i kishte mbështjellë njerëzit si një mjegull e dendur.

«Të marrtë dreqi, të marrtë, po më hën qepaze në sy të botës», — tha me vete dhe ngadalësoi hapin. Megjithatë, s'ju durua pa parë të bijën. U afrua dhe ca dhe i doli dritares brinjas, nga e majta, ku errësira ishte më e dendur. Gonxhja mbi njëren dorë kishte

mbështetur ballin, kurse me tjetrën diç shkruante me ngut.

«Domosdo, hyre në të thella tani...» — tha plaku prapë me vete dhe u tërhoq në errësirë. Ai e dinte që e bija ishte në mbledhje, e dinte edhe që do të vonohej. Po atëhere pse erdhi? Pse po priste?

Ai as që ja bënte këto pyetje vetes. U ul shesh mbi një ledh, ndezi çibukun dhe po rrinte me sy të mbërthyer mbi dritaren e asaj dhome të mbushur me tym, sikur atë çast do t'i shturej tërë ai lëmsh i pakuptueshëm i punës të së bijës. Dhe s'e kuptonte se ishte bërë vetë një lëmsh, ku fijet e vjetra po ngatërroheshin keq me ca të reja, të forta.

Hiqte çibukun xha Shahini dhe mundonte të vinte në kandar tërë ata njerëz e tërë ato probleme që mbushnin zyrën e kryetarit. Dhe veten as që i shkonte ndërmend ta peshonte.

U ngrit të fliste Gonxhja. Ai luajti vendit dhe ja qepi shikimin.

Gonxhes ju drodh lehtë fletorja ku ishin mbushur tri katër faqe me shënime; i dukej se nuk ishte shkrimi i saj. Të tjerët prisnin. Për të dhe brigadën e saj ishin thënë shumë gjëra. Fadili diç kishte lexuar në sytë e vajzës dhe dukej gazmor. Kurse ndonjërin e kishte trembur kureshtja, sikur kushedi ç'e papritur do të dilte nga ato buzë pak të mbufatura e të thara nga zjarrmia. Njerëzit prisnin në heshtje. Priste në errësirë dhe xha Shahini, i cili mbajti një çast frymën, ndonëse e dinte se s'kishte për të dëgjuar gjë.

Kryetari, për të lehtësuar brigadieren, u mundua ta thyente heshtjen me një të kollitur.

Gonxhja kafshoi të brendshmen e buzës së poshtme dhe ndjeu se nofulla ju drodh. Përmes kësaj të dridhure zëri i saj gjeti shteg dhe çau hutimin.

— Unë jam menduar shumë tërë këto ditë...

— I rrihnin tëmthat dhe i përvëlonte trupi. I qenë veshur sytë dhe s'lexonte dot ç'kish shkruar.

— Lëri, moj, ato, po hë, folë vençe, si yt atë,

— i tha një nga anëtarët e kryesisë dhe ja mbylli fletoren. Ajo sikur u lehtësua.

— Për brigadën time... (e kafshoi edhe një herë buzën dhe i pa të gjithë në sy, po ata s'treguan asnjë shenjë habie). Për brigadën tonë u thanë shumë gjëra. Kryetari edhe na lavdëroi. Të tjerët bënë dhe ca kritika të vogla. — Ajo filloi ta ndjente trupin të sajën dhe shikimi sikur po i kthjellohej. Kishte bërë tri ditë luftë me vete dhe në mbledhje kishte ardhur me mendjen top, ta thoshte copë ç'kishte vendosur. Kur të tjerët flisnin, ajo përgatitej edhe me shkrim. Po, sa më shumë i afrohej çasti kur do të ngrihej, aq më fort e shtrëngonte një dorë e padukshme në fyt. Ishte hera e parë që ajo fliste para asaj tryeze, ku qaheshin hallet e fshatit, ishte hera e parë që do t'i thoshte vetes brigadiere. Dhe, sadoqë ishte matur kaq e kaq herë, hapi i parë prapë ishte i vështirë.

Dhe ajo heshti përsëri. Kësaj here jo për të mposhtur ndrojtjen, po për të përmbajtur shpërthimin. Dhe filloi aty ku pat menduar me kohë.

— Më në fund vendosa, do ta mbaj brigadën.

Në fillim m'u duk se s'do ta bëja dot kurrë, sikur do të më tallnin të gjithë, sikur... As unë s'e di se si më dukej. S'jemi mësuar ne me këto gjëra. Dolën dhe ato fjalët pastaj dhe e humba fare. Kam lexuar nëpër gazeta për brigadiere të tjera, po thosha se kushedi si do të jenë ato, s'janë si unë. Tani m'u mbush mendja. Shumica e brigadës më ndihmojnë. Atyre nja tre a katër që më shohin akoma shtrembër, s'ua kam frikën. Fadili, kryetari, tërë shokët që sefte më thanë: «Ç'ke ti, ne do të ndihmojmë të gjithë, ke partinë me vete, ke kryesinë» Mua më dukeshin fjalë këto, po me ato që ngjanë, e pashë se, tërë ajo ndihmë, edhe qorr të jesh e të vë sy e jo unë që i kam në ballë. Veç po të mos duash të shikosh.

— Më duket se të paska bërë një shkollë të mirë ajo vullnetarja, — i tha dikush me të qeshur.

— Edhe ajo më ka folur shumë e më ka ndihmuar, po edhe vetë e pashë.

— E po shyqyr, de... Të zbrazim pushkë, — tha Reshati.

Gonxhen e kish rrëmbyer shpërthimi e as që desh t'ja dinte për shaka të tilla.

— Unë e di që brigada jonë ka mbetur ca prapa... Jo ca, po shumë. Tani unë do të punoj me sa të mundem. Nuk e di sa do ja dal, po do të përpiqem.

Xha Shahini, duke parë Gonxhen, kishte harruar të thitthe çibukun dhe ai që shuar me kohë. Ai s'e kishte parë kurrë të bijën të merrte zjarr. Kështu se si i dukej. Hem i trembej këtij shpërthimi, hem i vinte mirë që burrat më të mençur të

fshatit e shikonin të bijën në gojë. Kur mbaroi mbledhja, ai pa se Gonxhes i shtrënguan dorën fort, i rrahën shpatullat dhe ajo qeshte. Plaku mori rrugën drejt shtëpisë me një barrë mendime në kokë.

«Seç ka kurdisur ajo qafire vullnetare, që erdhi e m'u shtrua tri net në shtëpi e s'pushonte tërë natën, pësh, pësh me këtë timen.»

Vetëm kaq fill shihte atë çast xha Shahini nga tërë ai lëmsh i ngatërruar, që po zinte të çpështillej.

Kur hyri Gonxhja në kuzhinë, plaku ende s'kishte zënë vend mirë mbi minder. Ajo e kishte parë siluetën e tij para se të kalonte prakun e shtëpisë dhe merrte me mend një mbledhje të dytë.

— Shumë u vonuat, moj çupë, — tha e ëma, që s'kishte marrë vesh gjë nga i shoqi, veç e pa ashtu qiell shkurti dhe shpejtoi t'i priste rrugën shtrëngatës.

— Helbete, punëra të mëdha tani... Qeveris fshatin çupa.

Gonxhja e kishte përgjigjen gati, po s'e lëshoi, duke menduar se ajo gjuha e mbledhjes sikur nuk shkonte këtu.

Xha Shahinit s'i pritej sa të mësonte nga e bija se ç'tha në mbledhje. T'i thoshte urtë e butë, s'i bënte gjuha, t'i thërriste, s'e linte ajo krenaria fshatarake, që ju zgjua kur e bija la me gojë hapur tërë ata burra, që ai i çmonte dhe i respektonte. Dhe vazhdoi ashtu si e nisi, me thumba:

— E dinim memece çupën ne... Kjo na kish katër gjuhë. Posi, posi!

Gonxhja e kuptoi gjendjen e të jatit dhe i hapi zemrën, ja tregoi të gjitha. Ai e dëgjoi pothuaj në heshtje, duke folur nganjëherë me vete, dhe, pa prituri të mbaronte i tha së shoqes ta mbulonte dhe u shtri mbi minder. Po, para se të flinte, lllashiti shumë nëpër një dremitje të turbullt. Kurse Gonxhja atë natë desh t'i mbyllte derën gjumit. Ajo ishte ende e nxehtë nga zjarri i mbledhjes dhe e kapi një si frikë e pakuptueshme se mos gjumi do t'ja shuante këtë zjarr.

«Ah, sikur të kalonte kjo natë e gjatë me një të mbyllur e të hapur sytë!»

Me këtë mendim e zuri gjumi pas mesnate dhe po me këtë mendim u çua në mëngjes. Me të hapur sytë, u mundua t'i fshinte ato pak orë gjumë dhe të lidhej menjëherë me të mbrëmshmen. Dita ishte e bukur. Kjo sikur e ndihmoi për të ndjerë më shpejt që zjarrin e kishte gjallë. I ati, mbështetur pas gardhit, pinte kafe i menduar.

Kur arriti Gonxhja para zyrave të kryesisë, ishte mbledhur shumica e brigadës. Ata kishin marrë vesh për mbledhjen e mbrëmshme dhe e pritën me ca shikime që asaj ju dukën si të çuditshme. Parandjeu se do të përsëritej përsëri ai çast i vështirë i fillimit të diskutimit dhe u kapërdi disa herë.

Gratë dhe vajzat s'e fshihnin dot gëzimin dhe e përgëzonin shoqen e tyre kush me një buzëqeshje, kush me një të luajtur koke e kush duke i shtrënguar dorën vjedhurazi. Kurse disa burrave u kish rënë një hije e rëndë dhe prisnin ç'do të ndodhte, duke hetuar çdo fjalë e çdo lëvizje të «asaj».

Rruga e gjatë dhe fytyrat e çelura të shoqeve e të shokëve ja lehtësuan Gonxhes ndrojtjen e turpin, pa lënë që t'i shtrëngonin fytin si aty në mbledhje. Xha Shahini ecte heshtur e rëndë në fund të brigadës, si në një mort.

Me të arritur në vendin e punës dhe si u këshillua me më të vjetrit për punët e ditës, ajo ndau detyrat e skuadrave. Zëri i saj sa vinte e bëhej më i kthjelltë:

— Kemi mbetur një çikë prapa, prandaj t'i japim forca. U kritikua edhe në kryesi.

— Demek i dhe karar, hë? — tha pa të keq Çeçua dhe, pa pritur përgjigje, ngriti zërin: — Epo me këmbë të mbarë, moj shoqja brigadiere.

— Kjo brigadiere ka qenë që atë ditë që e zgjodhëm ne, po... — i doli krah, pa qenë nevoja, një nga shoqet.

— Epo asaj vetë s'ja kishte qejfi të bëhej brigadiere... I dukej më mirë kështu, me shatë, si të tjerët.

Xha Shahini kafshoi bishtin e mustaqeve dhe i pa vëngër atë që foli. Pastaj i hodhi sytë së bijës sikur t'i thosh: «E, moj, e shikon!? Janë punë për burra këto. Nuk je ti për këmborë!» Po ajo s'i la sytë e tij të flisnin më gjatë.

— S'më pengon shata, jo... Edhe tani unë do të punoj si ju edhe punën e brigadieses do ta bëj.

— Ja... a! T'i bësh dot të dyja, thua!?

— Në mos i bëfsha vetë, do t'i bëjmë tërë tok.

— Ajo hodhi shatën në krah dhe u nis. Xha Shahini priste me veshë ngrehur, duke bërë sikur rregullonte opingën. Po... heshtje. Kur ngriti kokën, brigada kishte hyrë në parcelë.

DUKE PRITUR SHIUN

Brigada punonte pothuaj në heshtje. Njerëzve u qe rënduar shata në duar. Fytyrat ishin të ngrysur. Edhe kur këmbehej ndonjë fjalë, dilnin ca zëra të zvarritur dhe të lodhur, si të mbështjellë me psherëtima. Dhe kjo topitje, kjo lodhje nuk ishte si në kohën kur, nën heshtje, zienin shqetësimet për thashethemet që i kishin dalë Gonxhes. Kjo punë e kishte marrë rrugën. Thashethemet ishin shuar. Qenë dukur ca shkëndija të tjera, po edhe ato ishin shuar shpejt. Gonxhja kishte ditë që drejtonte brigadën dhe anëtarët e saj po mësoheshin me këtë gjë. Punët nuk po shkonin keq. Megjithatë s'mund të thuhet se ishte kaluar çdo rrezik që ujërat të mos turbulloheshin përsëri. Po atë ditë të tjera shqetësime e preokuponin brigadën.

Vërtet mesi i qershorit e vapa kishte kohën, por rrallë ndodh që Malasi të shohë ditë aq të nxehta. Ajri dridhej si mbi një sobë të skuqur. S'luante gjeth ndër drurë, ndërsa fletët e misrit në mesditë erdhën e u varën e u mblodhën, duke marrë for-

mën e një tubi gome të prerë për së gjati. Gjinkalla të shponte veshët. Brigada, vargosur në tre rreshta, sipas skuadrave, kishte që nga mëngjezi që i ngjitej e i zbriste parcelës, duke ndjekur radhët e misrit. Njerëzit i kishte mbuluar djersa. Vajzave u digjnin sytë dhe gusha si t'i kishin lyer me piper. Burrat i shkonin nga një të fshirë ballit me llërë dhe i mëshonin shatës mbi tokën e ngjeshur e të çarë nga thatësira. Edhe fytyrat e tyre u ngjanin tokës, brazdat midis rrudhave qenë thelluar më tepër. Edhe bisedat ishin pa vlagë. Bima është barometri i gjendjes shpirtërore të fshatarëve, të cilët kanë ëndërruar, ndoshta më shumë se kushdo, për të pasur në dorë çelësat e të fshehtave të natyrës. U therte në shpirt kur, duke kaluar nga rreshti në rresht, fletët e misrit ligështoheshin dhe lëshoheshin si gjymtyrë të plakura para kohe. Thatësira po zgjaste shumë. Para ca ditësh, qielli sikur kishte nisur të vishej dhe ata kishin shpejtuar të hidhnin plehun kimik. Po qielli i kishte gënjyer. Dhe tani, tek punonin tokën e fortë dhe të etur, ata shikonin kokrrizat e bardha të plehut, si kokrra orizi, që kishin mbetur siç kishin qenë. Menduan t'i jepnin një shatë parcelës me shpresë se do ta treste plehun vllaga e pakët që mund të kish mbetur, po vllaga s'jepte shenjë gjëkund. Pas vargjeve të prashitësve ngrihej pluhur dhe shatat trokisnin sikur punonin mbi gur.

— Na përvëlove, moj e mallkuar... Na përvëlove, — ankohej xha Shahini.

— Këtu s'e puth as ujët... vjen ters, ta marrë djalli, — përsëriste kushedi për të satën herë Bequa.

— Na mbetën sytë lartë po me sa duket... Aha...

— I ka vënë saçin.

Dikush shkëputi një gjethe misri, e pa mirë e mirë, e mblodhi shuk në dorë e hapi përsëri. U kapërdi e psherëtiu. Valin po e prekte kjo skenë e rëndë, ku ato fjalë të rralla i ngacmonin njerëzit më keq se heshtja. Kishte filluar ta ndjente edhe ajo sadopak atë lidhje të çuditshme shpirtërore që kishte fshatari me bimën. Edhe vajzat (të cilat në prashitje viheshin njëra pas tjetrës dhe, sa herë gjenin rast, fillonin me ato të tyret pa e lënë punën) ishin të ngrysura e të heshtura. Gonxhja që prishur në fytyrë.

— Shyqyr i qoftë!

— Ahu... u! Të mbeti shyqyri në gojë dhe ty, Sadik.

— Po dogji nja dhjetë ditë kështu, as farën s'kemi për të nxjerrë. Më mirë t'i shkulum e t'ua hedhim lopëve pastaj.

— Dëgjomëni, bre, mua... — ngriti zërin Çeçua, — do të kemi shi. Për kokë të kalamajve që do të kemi shi. Më ther gjuri... Dëgjomëni mua, ju them.

— Ke një javë edhe ti... Do të kemi shi, do të kemi shi... Hë de, ku e ke të shkretën...

— Kushedi nga vjen vërdallë... Po shi do të kemi.

— S'duket gjëkundi, o Çeço, jo..!

— Na la pa bereqet, thuj...
.....

Heshtje. Kënga e cinxujve dhe e gjinkallave. Çak çuket e shatave. Ca fjalë për shiun. Dhe prapë heshtje, gjinkallat, cinxujt dhe shatat.

Edhe pushimi i drekës i asaj dite ishte ndryshe nga të tjerat. Njerëzit përtyreshin me zor dhe heshtnin. Duke e parë nga larg, nën dridhjen e ajrit të nxehtë, misri dukej ende më i venitur e sikur jepte shpirt ndër ethe.

— Ku e gjeti tamam tani që misri është në vaktë të vet, të hedhë trup e të presë kallëp!

— S'ka bërë vaki kjo e sivjetmja, or jo.

— Është tamam si puna e njeriut edhe bima. Po hoqi një sëmundje të rëndë në të ri, mbetet çyryk tërë jetën.

— Po dëgjoni, bre, mua... Po s'patëm shi, të më shponi në hundë. S'më gënjen gjuri mua. — S'luante nga e tija Çeçua.

— Ama dhe ti, a derëbardhë. Na mërзите. S'ke lllaf tjetër? Fajin na e ka koka ne... S'e dëgjuam rininë në dimër, të kishim bërë hauzin aty lart. Do ta kishim badjava. E tani mirë të na bëhet, se atë kokë kemi. Të mbajmë sytë lart. S'e kishim mendjen në vend kur na tha rinia.

— E pse s'e hapën ata që e kishin në vend?

— Ahu, edhe ti... majë kaçkës flet. Pse, pak bënë ata. Kush e hapi hauzin te gryka e Zylos? Po kanalin?

— Lena për kokë tënde... Ne na digjet mjekra, ti...

Zërat nisën të ashpërsohen. E, ndonëse të gjithë e dinin se fajin e kishte vapa, nuk ish çudi të shpërthente ndonjë sherr kot së koti. Nervat e tyre u ngjanin fitilave të minave, që janë shtrirë dhe presin vetëm shkrepshen. Të gjithë e ndjenin këtë, ndaj s'e zgjatën muhabetin. Burrat u ulën,

tu mbështetën dhe zunë të tymosnin duhan në he-shtje. Nja dy gra nxorën fanellat e çorapet nga trajsat dhe nisën të thurin, duke punuar shtizat me përtesë. Kurse vajzave nuk u lexohej.

Në fillim Vali ishte habitur. Me të mbaruar së ngrëni drekën, të gjitha gratë e vajzat e brigadës ja fillonin punës me shtiza. Ato s'dinin të pushonin. Të shtriheshin, u vinte zor prej burrave, të bënin muhabet, ndruheshin. Thurja e trikove, e fanellave apo e çorapeve të leshta i ndiqte kudo, edhe në pushimet e drekës, edhe në udhë, edhe nëpër mbledhje nganjëherë. Sa i thjeshtë mund të duket problemi i lehtësimit të gruas nga punët e shtëpisë, po t'i ndash me kalem në dorë, këto janë të burrit, këto të gruas!... Sa e thjeshtë do të ishte kjo! Kurse këtu punët e shtëpisë janë kthyer në instinkte, që i ndjekin vajzat dhe gratë në çdo hap. Asnjë nga burrat nuk çante kokën ç'po thurte e shoqja, e bija apo e kunata. Për ata mjaftonte që ato të mos argaliseshin në mes të brigadës.

Vali u kish folur disa herë. Edhe brigadierja s'e ndante nga trajsa trikon që punonte për pajë. Po kaluan ca ditë e s'e mori më me vete. Gjatë kohës së pushimit ajo hidhte shënimet në bllok dhe llogariste ditët e punës. Po të tjerat?

— Ju lodheni kaq shumë... Kini nevojë të pushoni në drekë. Prapë do ngriheni t'i bini shatës. Prapë do të punoni në darkë në shtëpi.

— Ç'të bëjmë?

— Shtrihuni e çlodhni trupin.

— Këtu, në mes të burrave?

— Po. Pastaj?

— Ku të lënë ata.

— Po mirë, fundja lërin ato pundoret tuaja dhe bëjmë muhabet.

— Këto s'na pengojnë për muhabet.

Po një ditë Vali e kishte mbushur trajnsën më shumë se të gjitha.

— Fshati ha bukë shumë, — i tha një nga burrat. — E shikon si të erdhi oreksi? Ma paske mbushur torben si për në mal. Ditët e para haje sa një mi. Shata do bukë, çupëëë!

Vali kishte qeshur. Në drekë, si kishin mbarruar së ngrëni e vajzat filluan të nxirrnin pundoret, ajo u ndau të gjithave nga një libër. Ato më të vjetrat kafshuan buzën, treguan burrat me kokë dhe ja kthyen. Disa nga vajzat filluan të shfletonin, kurse ndonjëra e la librin mbi prehër dhe s'dinte ç'të bënte. Vali që mësuar me hutimin e tyre në të tilla raste. Ajo e dinte se edhe veprimi i saj gjykohej në atë çast. Demiri, për ta ndihmuar, mori një nga librat që kishin kthyer gratë, e shfletoi dhe tha:

— Ky është shumë i bukur. E kam lexuar ndonjë muaj më parë. Flet për një malësore që luftoi me diversantët. Lexoje, Lule. — Dhe ja zgjati librin një vajze, i bindur se i ati nuk do të kundërshtonte.

— Po ai që ke ti, moj, ç'është? — ju drejtua së bijës Belul Cungu.

Ajo ngriti supet. Ai ju kthye Valit dhe e lëshoi fjalën ashtu si i erdhi.

— Seeë ka ca libra me dobiçllëqe, qëëë... e kupton ti.

Vali i buzëqeshi, i mori librin Gëzimes dhe ja

dha Belulit. Ai lexoi mbi kapak, duke i ndarë fjalët në rrokje.

— «Mbi pro-ple-min e gru-as...» Demek për gratë qenka, ë? Po... — Si duket deshte të pyeste kush e kish shkruar, po sytë i shkuan në krye të kopertinës. Pa një herë rrotull se mos po qeshte njeri dhe ja dha së bijës, i skuqur nga turpi:

— Na, këndoje... e vëri vesh të mësosh, dëgjove?!

Fjalët e tij sikur qenë komandë edhe për të tjerat. Ato i lanë kërrigat varur në qafë dhe filluan të shfletojnë librat.

— Unë e kam lexuar këtë, — i tha Shpresa Valit si qe afruar pranë saj. Edhe nja dy të tjera i kishin lexuar librat që u dha Vali. Ajo u tha t'i ndërronin.

Megjithatë, ditë e parë rrallë e tek u lexua ndonjë faqe. Më shumë u bisedua për librat. Tregoheshin ngjarje, bëheshin komente. Kur do të ngriheshin për të vazhduar punën, ato nisën t'i kthenin librat Valit, po ajo u tha t'i fushnin në trajsat e tyre dhe t'ja jepnin mbasi t'i mbaronin së lexuari. S'është lehtë të thyesh një zakon, të mposhtësh një instinkt! Disa ditë me radhë shtizat e librat shkonin e vinin bashkë nga shtëpia në parcelë e nga parcela në shtëpi. Po një nga një pundoret filluan të rrallohen.

Po atë pasdite të nxehtë, kur më shumë se vapa njerëzit i digjte merakun për misrin, as bisedat e as leximi s'merrnin për mbarë.

— Çohemi? T'i nxjerrim edhe këto rreshta që na kanë mbetur, që nesër të fillojmë nga Zajet, — tha Gonxhja pas një heshtjeje të gjatë. Ajo u

ngrit, rregulloi kapelen e kashtës mbi kokë, luajti nja dy herë qafën për t'u shpirë dhe mori shatën.

— Çohemi, moj çupë, çohemi, se vendi s'thotë kurrë ngrehu. Hop! — e pasoi Beqiri.

— Po na shkojnë krahët dëm... S'të bën zemra për punë në këtë qerrata kohë, — u ngrit i lodhur xha Shahini. Edhe të tjerët po ngriheshin, kush në heshtje e kush duke lëshuar ndonjë fjalë, sikur ta kishin bastun e do të mbështeteshin në të.

Dita po merrte për të thyer, po tabloja ishte po ajo e paradites.

Fletët e varura të misrit, ajri që dridhej, kënga e cinxurit, e gjikallës, çak-çuket e shatave, ndonjë fjalë ankuese.

Kjo melodi e shoqëroi brigadën nja dy orë të mira. Kur, papritur, nëpër misër kaloi një shushurimë, që bashkë me pluhurin e tokës që ngrinin shatat, mori me vete edhe heshtjen e topitjen e brigadës. Fytyrat u gjallëruan e dhjetëra sy filluan të vozisin qiellin. Mbi majën e malit po nxirrte krye një copë re e murme, si balli i një shtëllunge tymi. Ajo zgjatej duke shfryrë pulla-pulla. Sytë e kooperativistëve ndiqnin çdo lëvizje të saj.

— E... e, ju thashë, apo jo? — ju hap zëri Çeços. — Ju thashë që kemi shi? Dëgjoni, bre, budallanë ju, pa le t'ju dalë keq.

Shushurimën e parë e ndoqi një e dytë, më e gjatë dhe më e fortë, e cila i zhduku ato dridhje të ajrit. Brigada vazhdonte të ndiqte lëvizjet e resë. Si u zgjat ca, ajo u këput nga trupi i resë mëmë, që dukej sikur e pengonte mali, dhe mori me të shpejtë nëpër qiellin e kthjellët. Pas pak reja u nda më trish e pastaj u shndërrua në një

mjegull, si një napë e hirtë e hollë dhe e tejdukshme.

— U shkri e uruara. Paska qenë tym fare...

— Ajo ishte e sihariqit, bre, solli lajmin.

— O burrani t'u japim krahëve e t'i mbarojmë me vakt këto nja dhjetë radhë që kemi, se do na zërë shiu.

— Ku e ke, moj brigadiere, të hëngërt goja mjaltë... ku e ke të shkretën? Ne lagemi e thahemi, po ç't'i bëj këtij bablokut unë, që është urtuar keq. — Dhe Beluli i ra lehtë një misri, siç godasin nganjëherë fëmijët me përkëdheli...

Njerëzit filluan të nguten në punë. Dhe ka një rregull në prashitjen e misrit: gjithkush ndjek radhën e tij, duke punuar gjysmën e rripit të tokës në të dy krahët. Ka edhe një rregull tjetër: s'duhet të shkëputesh nga rreshti, se pengon ata që ke pas. Vali i dinte këto rregulla, po këtë herë e kishte pisk. Ajo si kish parë kurrë anëtarët e brigadës të punonin aq shpejt. Dhe as që kish menduar se mund të punohej aq shpejt me shatë. Po ja që punonin... Dhe thërrisnin... Dhe këndonin... Ishte një shpërthim i çuditshëm forcash. Ajo mundohej të ndiqte vargun pa u shkëputur, po s'ishte me inat. Dhe ajo e dinte se anëtarët e brigadës, shpesh pa i rënë në sy, mundoheshin ta vinin të punonte në vendin më të butë, atje ku s'kishte shumë bar, dhe rripin e tokës që i takonte, ja linin sa më të ngushtë. Kur e kuptonte Vali, s'pranonte lehtësira, po shpesh s'e merrte vesh. Ata e bënë këtë me shumë marifet. Fshatari e ka për turp ta vërë në lojë dhe ta mundojë atë që përpiqet me gjithë shpirt, po s'është i zoti t'u shkojë për krah në pu-

në. Pa ta bën edhe qejfin, të mburr, që të mos prekesh në sedër. Po atë çast brigada sikur e harroi vullnetaren, sikur i kishte dehur ky ndryshim i motit. Dhe Vali i jepte shatës me sa mundej. Mbas çdo goditjeje të tokës, ndjente një tronditje në tru. Po i rëndohej koka. E kishin mbytur djersët. Punonte pa ngritur sy e minutë për minutë fshinte fytyrën me llërë. Dhe as që kishte vënë re se njerëzit që kishte përpara e pas ishin ndërruar. Në vend të Selos i kishte dalë përpara Demiri, kurse pas i vinte Gonxhja. Këtë ajo e kuptoi kur pa se ai që shkonte para saj ja punonte tokën e rreshtit që ndiqte ajo, gjer te rrënjët e misrave. S'i erdhi mirë, po Demiri i buzëqeshi dhe i bëri shenjë me kokë që të mos rrëmbehej shumë. Gonxhja e arriti shpejt dhe i doli në krah. Edhe ajo filloi t'ja ngushtonte rripin e tokës nga ana tjetër.

— Po unë mbeta pa gjë!

— Po na vjen shiu... i tha Gonxhja në vend të përgjigjes.

— E nxori gjoksin buallica... Oho...ho, — thirri Beluli.

Të gjithë ngritën kokën e i hodhën sytë majës së malit. Një re e madhe, sterrë e zezë, u ngrit mbi majë të malit dhe u lëshua qiellit. Pas maleve po nxirrte kryet një varg i tërë resh, si të ishin ushtarë në pozicione që pregatiteshin për sulm.

— O burrani! — thirri Gonxhja.

Puna vazhdoi më me shpejtësi dhe me gaz. Valit i bëri përshtypje forca mobilizuese që patën fjalët e brigadieres dhe i ra shpatullave. Këmbyen nga një të qeshur dhe vazhduan punën. Vapës së drekës ja kishte zënë vendin një zagushi me një

ajër të lagësht e të rëndë, që s'të ngopte e të digjte hundët si mjegull. Taborret e reve, si një urdi e zezë, e kishin marrë qiellin skaj më skaj dhe në vijë frontale po i sulleshin maleve përkundruall. Reja që kishte dalë në ballë, ende e ruante postin e saj pararojë dhe shkoi e zuri diellin.

Kooperativistët mbaruan prashitjen e po pregatisnin torbat për t'u kthyer në fshat. Trupat u avullonin. Çeçua s'pushonte.

— S'më dëgjuat mua!? Po tha Çeçua, ka marrë fund, bre...

— Epo ç'ti bëjmë rinisë ne, që ja prishi xhaminë Hafëz Izetit, të të ndiznim një qiri...

— More tallu ti, tallu, po e solla shiun unë!

— E ke hak një darkë sonte.

— Darkë, the! Edhe të madhe, jo shaka... E kam vakëf gjurin unë, oj kokë.

— Mos e thuaj atë llaf, se erdhi rinia e të vuri kazmën, o derëzi... E dëgjon, moj Vali!

— Oj, po një fjalë s'thua dot këtu, bre...

Filluan ca pika të mëdha.

— O burrani, se na zuri!

Dhe brigada u nis në njëshkolonë me vrap. Çeçua mezi e hiqte këmbën e majtë e po mbetej në fund të rreshtit.

— A, qafirë, o qafirë... Kaq deshët, sa t'u sillja shiun e tani më latë në bisht... Prisni, bre... Dëgjoni, apo t'i them shiut të pushojë.

Njerëzit shpejtonin, qeshnin, lëshonin romuze e qyfyre. Pikat u shpeshuan. Demiri nxori xhaketën e tij prej kadifeje dhe ja hodhi krahëve Valit. Ajo deshi t'ja kthente, po qe e kotë. Disa qeshën. Ndonjëri edhe thumboi.

— Edhe këtë ta mbash mend nga ne ti, Vali, — i tha Bequa. — Mos u nis për rrugë pa gunë e pa bukë. Qoftë verë e qoftë dimër, pallton mbaje me vete. Më mirë të mbash, se të qash.

Valin e kishte pushtuar një gaz i madh, që s'e kishte provuar ndonjëherë, kur vraponte nëpër mezhde, ku bari i lagët i guduliste këmbët. Ky ishte një vrapim krejt ndryshe nga vrapimet për të kapur autobuzin urban, që e shpinte në ndërmarrje, për të arritur pa u mbyllur dera e kinemasë pesë minuta para fillimit të filmit, për të arritur atje ku e priste... Këtë të fundit s'e kishte provuar. Pas saj vraponte Demiri. Ajo i ndjente hapin dhe frymëmarrjen. Diçka i lëvizte në gjoks.

— Prisni, bre... do t'i them gjurit, — bërtiste me shaka Çeçua nga fundi. Njerëzit qeshnin dhe shpejtonin. Pas një copë rruge rreshti po shturej. Rinia ngiste vrap, kurse pleqtë një e nga një po i bëheshin shokë Çeços.

Pas i ndiqte shiu.

A ka më mirë se sa të të ndjekë shiu që do të mbarsë tokën me begati. Që i vjen bimës si një puthje lumturie!

A ka më mirë se sa të të ndjekë një puthje lumturie!!!

DHE GURI PO MERR VLAGË

Me gjithë vrapin e madh, anëtarët e brigadës së tretë nuk shpëtuan dot pa u lagur. Vali s'gjeti dot mbrojtje as nën xhaketën e Demirit. Rrobat u qenë ngjitur për trup e nga flokët u rridhnin currila. Duke ecur nëpër fshat, linin vargun e merrnin rrugicat, drejt shtëpive të tyre. Secili e luste Valin që të kthehej në shtëpinë e tij, të ndërrohej e të thahej. Kasëmi e zuri për krahu e bëri be e rrufe që s'e linte pa e kthyer, po s'qe punë që bëhej. Vali i dha xhaketën Demirit dhe vrapoi drejt shtëpisë. Ajo po shpejtonte të shpinte në atë dhomë të zymtë gazin e fshatarëve, gazin e shiut të vlagës. Kristina u shqetësua kur e pa si qe katandisur, e s'dinte ç'të bënte për ta ndihmuar që të ndërrohej. Vali qeshte dhe tregonte qyfyret e rrugës. Kjo e habiste Kristinën e sidomos Aspasinë.

— Qesh, ti, qesh... Pa kur të marrësh ndonjë të ftohur të mirë, pastaj flasim bashkë.

Vali u ndërrua dhe po fshinte flokët me peshqir. Trupi i avullonte si nga një dush i nxehtë.

— Vishe, — i tha Kristina dhe i zgjati trikon e saj të trashë prej leshi

— S'e mbaj dot. Kam vapë.
— Ti je e nxehtë, e djersitur, e lodhur... Vishe.
Kristina ja hodhi trikon krahëve, po ajo e hoqi.
— Ju të rejat jeni për të vrrarë. S'ja dini kimenë shëndetit. Po s'e pësuar, s'vini mend. Le që ti e ke marrë si me të lehtë këtë punën e fshatit.

Vali diç ndjeu nëpër këto fjalë, po dhe mirë s'ja dalloi shenjën Aspasisë. Para disa ditësh ishin grindur keq, ndaj mendoi të mos i përgjigjej aty për aty. Ajo me siguri do të vazhdonte. S'duronte dot të mos i përgjigjeshin të tjerët.

— Ky shi bën shumë mirë për shëndetin, — tha, duke dashur të ndërronte drejtimin e bisedës Kristina.

— Për këtë s'di ç'të them. Sa për bujqësinë, është penicilinë olioze, — tha Vali.

— S'ma paska prerë mendja se shiu i sjellka njerëzit kaq në qejf, — tha me një ton jo të zakonshëm Aspasia.

— Të shikoje fshatarët një herë, pastaj flisnim bashkë ne, — ja pat Vali aty për aty.

— Ja ku të shoh ty, njësoj është.

— Ata të shikoje ata. Punonin sa për shtatë.

— Po si të lanë kështu, qull ty? Si s'të futi ndonjë në shtëpi?

— Më lutën e sa s'më morën me forcë... Më gjashtë e gjysmë kemi provat e grupit.

Aspasia ja kish nisur shtruar e hollë e kushedi sa do ta kishte zgjatur bisedën, po, kur doli fjala te grupi artistik, palosi buzët përbrenda e u gëlltit sikur të deshte të kapërcente ato që kish për të thënë. Vali i shkeli syrin Kristinës. Kjo, si u bind që e ëma s'e shihte, diç i tha duke luajtur buzët pa zë e duke

shoqëruar me lëvizje të duarve. Po Vali nuk po e kuptonte. Veç një gjë dukej qartë: Kristina ishte e gëzuar. Ajo u mundua edhe një herë të shpjegohej me gjuhën e saj të heshtur, po s'i shpëtoi dot syrit vigjilent të Aspasisë.

— Thashë unë, ta do bishti vetë ty!

— Çfarë? — pyeti Vali.

— I them kësaj times, — ja preu rreptë Aspasia.

— Erdhi shoku Fadil sot këtu... — nisi të shpjegohej Kristina, po e ëma ja rrëmbeu fjalën:

— Jo erdhi, po e dërgove ti. Kjo tjetra po e ka fryrë... Domosdo...

— Mama!

— E ndrite mamanë!

— Pse nxehesh, teto Aspasi?

— Po unë pse kam ardhur këtu? Hë? Tërë këto punë të tuat janë. Kjo po fyryfyçkë... Ç'thua ti, kjo amin!

Vali nuk u nxeh. Ndonëse Aspasia bërtiste, ajo e ndjente se kishte filluar lëkundja, po e linin forcat. Pa Kristinën dhe nuk ju duk aq e trembur si dikur. Fytyra e saj këto kohët e fundit po ndërronte ngjyrë. Aspasia vazhdonte të zbrazej, po më shumë i ankohej vetëvetes se vajzave. Po, kur pa se Vali s'po ja ushqente fjalën, ju suall papritur.

— Ti shiko punën tënde, moj vajzë... Lëre rehat time bijë... — Ajo kishte nevojë të përplaste nervat diku. — Jot'ëmë të la ty të vish vetëm këtu e të bësh ç'të duash, po unë s'jam nga ato nëna.

— Vetëm ti ja dashke të mirën vajzës!..

— Se ja dua pa kam ardhur këtu në... Posi...

— Në fole të djallit...

— Të djallit e ca më tej...

— Aha... E paske patur keq me Fadilin sot.

— Moj po ja tregoja unë atij siç ja kam treguar një vit të tërë, po ç't'i bëj kësaj unë, që vete më merr mentë e tua të bukura.

Vali buzëqeshi.

— E, t'u bë qejfi?! Po s'do mend... Për këtë punë ke ardhur ti këtu, t'i heqësh për kapistalli çupat... Po s'ke gjetur ndonjë hundëlesh që ta marrësh vesh...

— Mama, mos bërtit kaq shumë, — tha Kristina duke treguar dritaren. — Dëgjohet jashtë.

— Pika që s'të bie.

Vali u ngrit dhe e kapi për krahu Aspasinë.

— Pse e prish gjakun kot? Kristina s'po bën ndonjë turp. Hajde se për mua të është mbushur mendja për keq... Më fyen shpesh, po unë s'të zemërohem. Në fund të fundit ti je nëna ime...

— E... e, mjaft, mjaft... Komplimentamadhe. E di që të pret shpata nga të dy anët... Që kur erdhe vetëm këtu, në mes të maleve...

— Fjala e partisë.

— Një e dy e fjala e partisë, fjala e partisë. Po mos thotë partia të vish këtu e të tërbosh vajzat, të bësh të nëntëdhjetenëntat.

— E moj teto Aspasi! Kam edhe unë një tetëkështu si ty. S'më foli me gojë kur u nisa. Edhe kur të kthehem, zor se do më flasë ca kohë. Po do të mësohet. Edhe ti do të mësohesh.

— Tani që të kemi ty, si s'do mësohemi! Po ne ishim prapa botës! Si s'na erdhe më parë... Folë, moj, mirë, se je nuse për burrë e s'të ka lezet. Njeriu për një nder rron.

— Epo nderi s'ruhet me polic.

— Kush tha me polic?! Po vajti puna gjer te polici, e ka marrë ferra uratën.

— Epo në fshat Kristinën e quajnë «çupa e policit».

— I marrshin të keqen, kësaj, se i ati ka qenë avokat. Ka qenë burrë me kulturë...

— Po ju bë e ëma polic... Mos m'u zemëro... po ty të thonë «polic»...

— Mua?!

— E ty.

— Kush?

— Rinia. Dhe — po bëjmë muhabet e mos m'u zemëro — më duket se kanë të drejtë... Mijëra arësimtare, infermiere, mami ka nëpër fshatra, po nënat që i ndjekin pas kështu si ti, janë me gisht. S'ka ndonjë të keqe se vjen, po të mos e lësh të bëjë hap! Prandaj thashë se kanë të drejtë.

— Posi s'kanë të drejtë... Duan çupa djemuria, të hargalisen... Duan edhe çupa qyteti, pa le...

— S'e thonë vetëm djemtë.

— Po dhe çupat, se mos janë më të mira... Shushkat!!!

Vali pa orën. Gjashtë e dhjetë. Sikur gjer në rënëgjez të vazhdonte ashtu si kish zënë me Aspasinë, s'do t'ja gjente dot fundin bisedës. U ngrit, rregulloi me dorë flokët që ende si ishin tharë mirë e, ndërsa po merrte xhaketën, i tha Kristinës.

— Si do bësh?

Ajo pa të jëmën.

— Vishu, — tha Vali.

— C'të vishet, moj, — u hodh Aspasia.

— Po ti vetë sikur the... Sikur bisedove me Fadil'n.

— Bisedova, po s'i thashë se ja dhashë çupën, de! I thashë të mendoj e të jap përgjigje, — dhe Aspasia ngriti zërin. — Moj po ç't'i bëj asaj punës së gazetës, se ja tregoja unë kësaj... Atë punë e kini kurdisur që të më trembni, e di unë... Le që aq ju rëndon juve... Ta bëni... Ta nxirrni emrin në gazetë e ta bëni të zezën. E hajde të ngrësh kokë pastaj. Aq duan njerëzit.

Vali s'kuptoi gjë. Kristina, si kishte ikur Fadili nga shtëpia, për t'u mbrojtur nga sulmet e së jëmës i kishte thënë se në fshat kishte ardhur një gazetar e do t'i kritikonte në gazetë që tregoheshin indiferente e s'ndihmonin për përparimin e fshatit. Dhe gazetari kishte ardhur vërtet në fshat, po për se do të shkruante, as Kristina s'dinte gjë. Megjithatë, fjalët e saj e kishin bërë punën dhe e ëma sikur ishte përmbajtur.

Aspasia filloi të vishej.

— Mama! Bie shi, — tha Kristina, duke menduar se kushedi ku do shkonte e ëma.

— Gurë s'rënkani! Vishu.

Kristina s'po merrte vesh gjë. Pyeti Valin me shikim. Ajo ngriti supet. Vali hapi derën të dilte.

— Prit! — e urdhëroi gjithë nerva Aspasia.

— Të na marrësh edhe ne, se mos humbasim.

— Ku? — pyeti Kristina.

— Atje, në atë të mallkuar grup, që u grupofsh.

Kristina u çel. Vali ju hodh në qafë, po ajo e largoi e mërzitur.

— Lëri lajkat, se s'të shkojnë te unë.

— Me të vërtetë do vish?

— Po ç'kujtove ti? Do vij të shoh me sytë e mi një herë ç'bëhet atje, pastaj të shohim.

Dolën të tria. Duke zbritur shkallët në gjysmë errësirë, Kristina i shtrëngoi dorën Valit në heshtje. Binte një shi i dendur e pikëmadh, që ja kishte nisur shtruar e me sa dukej s'do të pushonte gjer në mëngjez. Ato ecnin ngadalë në udhën e shtruar me kalldrëm. Aspasia mbrohej me çadër, kurse vajzat kishin hedhur mbi kokë një mushama të hirtë.

* * *

Vatra e kulturës ishte rrëmuje. Diletantët ishin mbledhur pothuajse të gjithë. Nëpër grupe, apo veç e veç, ata kishin filluar provat papritur orën. Në një qoshe të skenës, Shpresa këndonte me zë të ulët, duke provuar në i mbante mend fjalët e këngës. Demiri po mendohej të gjente një hyrje të përshtatshme në skenë. Një herë hynte duke u kollitur, një herë duke mërmëritur me vete, një herë rëndë-rëndë, pa folur. Po asnjë variant s'ja mbushte mendjen. Njëri nga mësuesit, Astriti, ishte ulur pas tryezës dhe diç shkruante me ngut, kurse tjetri, Bashkimi, që ishte dhe përgjegjësi i grupit, jepte e merrte me një djalë të gjatë aty në mes të skenës, i cili s'i hynte dot interpretimit të një monologu. Dy vajza, anëtarët më të vjetra të grupit, lexonin një letër në një qoshe të sallës e qeshnin me të madhe. S'merrej vesh në bënin prova, apo qeshnin vërtet me atë letër që kishin në duar, dhe e tërhiqnin sa njëra tjetra. Një djalë flokëkuq e trupngjeshur mendohej të recitonte me libër në duar. Gonxhja ishte mbështetur pas murit e shifte sa andej këtej.

Me të hyrë, Vali lëshoi me zë të fortë një:
— Mirëmbërëma, shoqëria!

Kur mbas saj u dukën në derë Aspasia me Kristinën, provat u ndërprejnë, po Vali fshehtas u jepte shenjë që të vazhdonin e të mos binin në sy. Diletantët filluan të mbledhen në skenë dhe, duke kaluar pranë, përshëndesnin me përzemërsi të porsaardhurit. Bashkimi i buzëqeshi Kristinës e, ndonëse kjo nuk ju përgjegjej, e ëma i tërhoqi cepin e trikos. (Aspasisë i ishte mbushur mendja se Bashkimi i vinte rrotull së bijës. I kishte mbajtur leksione të gjata për këtë dhe, ndonëse ajo gjithmonë i kishte kundërshtuar, Aspasia e ruante nga shikimet e Bashkimit me frikë në zemër). Ishin ulur mbi një stol në mes të sallës.

— Ju jeni spektatorët e para. Grupi s'ka shumë që filloi nga provat... — Jemi ende pak, pjesët nuk janë mësuar... Mos na i vini re gabimet, — u tha Vali dhe, mbasi u përqaftua me Gonxhen sikur të kishte një javë pa e parë, i tha të ulej pranë Kristinës. Aspasia rrinte si mbi gjemba. Salla bosh sikur i merrte frymën. Kurse Kristina ishte shumë kurioze e mezi priste të fillonin provat.

— Fillojmë, — tha Bashkimi dhe u ra shuplakave.

— Teto Aspasi, mos u mëzit, — tha Vali dhe u nis drejt skenës. Aspasia ishte turbullt e s'i ktheu përgjigje. Si duket përshtypjet e para s'ishin të mira.

Skena ende s'kishte perde. Diletantët ishin ulur mbi stola, në të dy anët. Në ballë të skenës doli ai djali i gjatë, që ishte me Bashkimin pak më parë.

— Të dashur shokë spektatorë, — tha ai me zë të lartë. — Mirëmbërëma! — Duke dashur ta bënte fjalën sa më të ngrohtë, i dha një ton shumë qesharak. Gonxhja ja dha gazit. Edhe Kristina qeshi, po me ndrojtje.

Konferencieri vazhdoi:

— Grupi diletant i kooperativës së Malasit po jep çfaqjen e parë të estradës. — U mendua një çast, krojti kokën e ju drejtua Bashkimit:

— Si ja shumë emrin, se harrova?

Kësaj here as Aspasia s'e mbajti dot të qeshurin. Kurse ata të skenës zunë ijet me duar.

— Ju thashë, bre, s'jam për këtë punë unë... Gjithë ky zdap, me këtë zë si të... — dhe s'e mbartoi fjalën konferencieri.

Provat filluan me një këngë për fshatin. Këndonte Shpresa dhe e shoqëronte Bashkimi me fizarmonikë. Kristinës i pëlqeu këngëtarja, kishte një zë karakteristik, këndonte thjesht e ëmbël. Pasi një dialog midis dy «pleqëve» fanatikë. Pastaj i erdhi radha një skeçi. Luante Demiri me Valin.

— Ç'është kjo Vali! Për se s'e ke! — i thoshte Gonxhja Kristinës. — S'ja gjen shoqen... Të kishim nja tre katër këshu demek... — Po u kujtua që foli pa u menduar, dhe kafshoi buzën e turpëruar. Kristinës i rënduan fjalët e saj, kurse Aspasia i hodhi një shikim mospërfillës.

Kur filloi të recitonte ai flokëkuqi (ai edhe fytyrën e kishte gjithë quka të kuqe e të gjithë i thërrisnin Qukanjor), Kristinën s'e mbante vendi. Poesia ishte e bukur, po ai e recitonte keq. I ndante vargjet vend e pa vend, ngrinte zërin aty ku duhej

recituar shtruar, vinte ca theksa të tmerrshëm e bënte ca lëvizje të sforcuara që të lodhnin tek e shihje.

— Ka të ndara prapa? — pyeti Aspasia.

Po Kristinës i qe zgjuar pasioni i recitimit. Vargjet që dëgjonte, mundohej t'i mbante mend, i zbërthente, i përsëriste me vete dhe... i kujtohej skena e shkollës ku kishte recituar dhjetëra herë.

— Ty, moj, të them... Ka të ndara prapa, — tha përsëri Aspasia dhe i ra me brinj. Kristina u tremb.

— Çfarë, mama?

— Ku të fluturojnë mentë? A ka të ndara, qcshka, dhoma, atje prapa skenës?

— Jo.

— Ashtu sikur më duket edhe mua.

— Pse?

— Pse, thotë. Atje, nëpër ato vrimat, nëpër ato qoshkat qorre kush e di ç'bëhet.

Kristinës i erdhi rëndë, po dhe për të qeshur nga mendimet e së jëmës. Doli përsëri Shpresa në skenë. Vali erdhi dhe u ul pranë Aspasisë.

— Jemi shumë keq. Vetëm një këngëtare. Asnjë recituese, asnjë konferenciere...

Aspasia rrinte rëndë-rëndë me shikim të ngulur diku larg, përtej skenës, dhe mendonte, mendonte.

— Kaba me gërnetë, — tha konferencieri. Në mes të skenës doli një mesoburrë. Dukej i qetë. E mbushte gërnetën sa i kërcenin sytë. I binte mirë. Nga të gjithë diletantët, ai ishte më i sigurti.

Papritmas dera u hap rrëmbimthi e në sallë, tok me ajrin e lagësht e pikat e shiut, hyri një njeri që kullonte ujë. Pantallonat dhe mëngët e

këmishës i kishte të përlyera me baltë. Nga jashtë u dëgjua një hingëllimë ankuese kali.

— Po këputet ledhi i kanalit...

Kabaja u pre si me thikë. Demiri zbriti nga skena. Pas tij edhe të tjerët.

— Ka ardhur shumë ujë... Te koria ledhi është shumë keq. Po u këput, e mori dreqi parcelën e perimeve. Unë isha në pyll për hunj... U mundova... E shkarkova tërë barrën e ja vura ledhit... Po s'kanë për të mbajtur gjë... — U dëgjua përsëri higëllima e kalit...

Diletantët këmbyen shigjeta shikimesh dhe instinktivisht filluan të mbërthenin kopsat e jakave e të çpërvishnin mëngët. Kuvendi që i shkurtër dhe i heshtur. Të porsaardhurin s'e lanë të vazh-donte.

— Ç'bëjmë? — pyeti Demiri.

— Ç'pyet kot!

Kaq ishin fjalët.

— Vetëm djemtë, — thirri Demiri dhe u sul jashtë. E ndoqën edhe të tjerët. Pa mbaruar së dali djemtë, u sul Gonxhja, Shpresa, Vali dhe dy vajza të tjera. Të gjitha këto ndodhën aq shpejt, sa Aspasia dhe Kristina u hutuan fare. Nga dera e hapur dëgjoheshin hapa që largoheshin me vrap, thirrje me zë të lartë dhe simfonia «Monotonia pa mbarim» e shiut. Si e përmendur nga një ëndërr, Kristina rrëmbeu mushamanë dhe doli me vrap.

— Va... a... ali... i! Va... a... ali... i!

Po s'ju përgjegj askush. Hyri përsëri në sallë. Aspasia përpëlitej ende nën hutimin e saj. Kurse Kristinën e kishte kapur një gjallëri e çu-

ditshme. Ishte elektrizuar. S'dinte ç'të bënte. Po pas pak e ndjeu trupin krejt të këputur.

— Ikim? — pyeti Aspasia dhe për herë të parë priti pëlqimin e së bijës. Kristina fiku dritat dhe mbylli derën. E provoi disa herë mbasi rrotulloi çelësin, po ngurroi të nisej.

— Merre, — tha Aspasia.

Kristina tërhoqi çelsin nga brava dhe e futi në xhep. E shtrëngonte midis gishtave atë copë të ftohtë metali, sikur të ishte diçka e çmuar dhe trembej mos ja rrëmbenin.

Filluan të çapiten ngadalë, të lodhura e të heshtura nën mushamanë e hirtë. Nga larg u dëgjua një thirrje e pakuptueshme, që nata e përhapte si jehonë kushtrimi. Në anën tjetër të fshatit dukeshin e zhdukeshin si xixëllonja tri katër njolla të verdha fenerësh. Pranë tyre kaluan dy silueta të panjohura me nga një thes në kokë.

— Edhe guri po merr vlagë me këtë shi. Do kemi bereqet! — nxori zë njëra prej siluetave.

Aspasia ndjeu të dridhura dhe ngriti jakën. Nuk ishin të dridhurat e të ftohtit.

MYSAFIRE TE XHA BEKTASHI

Bektash Metja nguchte zjarrin në kllanikun e gjerë dhe, duke ju fryrë hurëve përmes dhëmbëve të rrallë, shikonte Valin pa i rënë në sy. E shoqja i qe ulur pranë e s'i gëzohej dot vajzës. Herë i rregullonte trikon krahëve, herë i përkëdhelte shpatullat apo e afronte pas zjarrit. Demiri dukej i gëzuar e sikur u mburrej prindërve në heshtje për mysafiren që kishte sjellë.

— Ndoshta vetëm unë s'të njoha këtu në fshat, moj çupë. Jam bërë gjysmë uloku e s'para dal... Le, po jam edhe zonjë shtëpie; posi... posi... Plaka më punon në furrë, që thua ti... Shtëpia më ka mbetur mua për ta kumandarur... E që të kisha fjalën, Demiri përnatë na fliste për ty, po kështu për fytyrë s'të njihja. Ky djali ynë të mburr si shumë, po s'më dukesh e rënë nga qielli.

Vali qeshi me gjithë shpirt. Kurse Hamdia e pa qortueshëm të shoqin.

— Mos ja vërë re, se kështu e ka babai, — deshi të justifikohet Demiri.

Vali qeshte dhe s'e kuptonte që fjalët e plakut të kërrusur pas vatrës ishin provokuese.

— Ta thashë atë fjalë, se kisha dëgjuar që je e zonja e gojës... Po sonte s'paske llaf... Le që ke hak. Ju lodhi ai i uruar kanal e ju hyri uji në palcë... Po s'na i treguat mirë si qe puna.

Demiri dyshoi se mos edhe këtu plaku donte të provonte mendjen e Valit, ndaj ja nisi vetë të tregonte:

— Ç'është e drejta, ledhi këtej nga koria s'vinte aq i plotë... Kur vajtëm ne, ishte grryer keq... E ndonjë çerek ore mos kishim vajtur, iku parcela e perimeve. Po na lodhi, jo shaka.

— Mirë. Po çupat ç'i morët me vete, apo t'u mbanin bishtin? Turp s'patët?

— Ne u thamë të rrinin.

— Hajde burra, hajde... S'janë çupat e gratë për këto punë, more... Në mes të natës, në mes të pyllit, në mes të shiut, në mes të burrave.

Vali përsëri qeshi. Kjo s'para i pëlqeu xha Bektashit. Përmes të qeshurës, papritur Vali u drodh fort.

— E... e?! — tha plaku.

Hamdia ja rregulloi edhe një herë trikon kraheve dhe i hodhi zjarrit tre katër dru të thata.

— I thonë fshat këtu... u. Na është mësuar lëkura ne. Ti je rritur në qytet... ndryshe... Prandaj të them, mos kërko të hahesh pesë e pesë me këta, — dhe plaku tregoi të birin me kokë.

— Punon kjo, baba, që të habit... Hapnin sytë sonte të gjithë...

— Shih ky... Rri, mor bir... Punonte, thotë... Po e zë turpi tjetrën, si thua ti... Dëgjo, moj bijë... ti bëj atë që të kanë thënë, konferenca, mbledhje me gratë, a ç'ke për të bërë, e mos sul-

mo shumë. Edhe me shëndet sikur s'ma mbushke syrin... Ne i kemi çupat të shëndosha... Kjo havaja e malit i rrit ndryshe njerëzit.

Mbas të dridhurës Vali lëshoi një breshëri te-shtimash e sikur ndjeu të ngjethura, megjithëse zjarri kërciste si në palcë të dimrit e ajo kishte kohë që ishte ndërruar me rrobat e Hamdies. Ju hap disa herë goja sa i dhembën nofullat. Po ajo s'ndjente gjumë, nuk dremiste. Veç trupi sikur po i mpihej.

— Dëgjo plakun ti, pa le të të dalë keq. Mos e mundo veten. Edhe me fshatarët mos u ngatërro shumë, se... kështu sikur kam dëgjuar.

Valit ja kish qejfi të bisedonte shtruar me këtë plak muhabetçi e të qetë, po s'mundej. Po e kapte një rraskapitje, që s'e kish provuar tjetër herë. Fyti i digjte, trupi po i lëshohej e po i mbushej me djersë.

— Bjerë e fli tani, se je lodhur, pa këtu jemi e do bëjmë muhabet, — tha xha Bektashi dhe doli nga dhoma e zjarrit duke hequr këmbët zvarrë.

Hamdia i shtroi Valit mbi minder, në të majtë të vatrës, kurse për vete në dysheme, pranë saj. Vajza ju duk e lodhur e s'e bezdisi me muhabet.

Mbas mesnate Vali ishte përpjekur shumë në rroba dhe kishte folur përçart. Hamdia i qëndroi te koka gjer në mëngjez. I pikonte në zemër. I vinte lecka me uthull mbi ballin që i digjte. Pastaj ndezi zjarrin, ngrohu një shuk lesh të palarë dhensh e ja vuri në gjoks. Vali mundohej të mos e bënte veten. Në mëngjez temperatura ju ngrit më tepër, i përzihej, kishte ethe. Hamdia i foli Demirit e ai shkoi të thërriste Kristinën. Ajo erdhi

shpejt, bashkë me Aspasinë, që mezi mbushej me frymë. Kurrë Kristina s'ishte pikëlluar si kësaj here, ndonëse i qe dashur të jepte mendimin dhe ndihmën e parë edhe në raste shumë më të vështira. Seç kishte diçka që ja shtrydhte zemrën.

— E moj doktoreshë? Ç'duket? — pyeste Hamdia tërë merak.

— Është ftohur.

— Ishte çupa mirë e bukur. Ku u gjend ky i shkretë kanal... — i qahej Aspasisë Hamdia. Aspasia s'dinte ç'të bënte. Mbas pak Vali vulli e sikur u lehtësua. I vinte rëndë kur shikonte gjithë atë kujdes që tregohej për të. Kristina i dha një piramidon.

Erdhi edhe Bektashi me Demirin. Djali ishte pikëlluar shumë dhe i vinte të hante veten me dhëmbë, që s'kishte mundur t'i mbushte mendjen Valit të mos shkonte te kanali. Bektashi i vuri dorën mbi ballë, i kapi duart, i ngriti kapakët e syve dhe foli me një zë, që s'e mori vesh njeri në ishte vërtet aq i qetë, apo i shtirur për t'i dhënë zemër vazhës.

— S'ke gjë, hiç...! Asgjë s'ke...

— Po këto duan të më sëmurin me zor më duket, — tha Vali duke treguar gratë që i rrinin te koka.

— Sikur s'i di punët e grave! Dëgjo plakun ti... S'ke gjë, — dhe Bektashi ju kthye të birit. — E, ore, s'e shikon që vajti dielli në mes të oborrit?! Ç'pret akoma?!

Demiri dhe Vali këmbyen shikime. Ajo i buzëqeshi. Ai u ngrit i ndrojtur:

— U shërofsh sa më shpejt, — i tha dhe doli.

Seç kishte diçka prekëse në sytë e tij, në zërin e tij, në të ecurën e tij. Valit i kaloi një rrymë e ngrohtë nëpër trup.

— Edhe mua sikur më kaloi tani... Do ngrihem.

— Jo... jo... jo... Je në vete. S'e sheh, mbeti brigada për ty.

— Në punë s'ke për të shkuar, po ngrehu të shkojmë në shtëpi, — tha Kristina.

— Shih kjo! — u hodh plaku. — Ti veç të shposh njerëzit di... Mirë, moj, është çupa këtu. Ta lyejë një herë plaka me raki të fortë, të mbulohet me velenzë të leshtë, t'i vërë këmbët zjarrit e në darkë të ngrihet qiqër. Dëgjoni, moj, plakun.

Po ishte e pamundur t'i mbushej mendja Kristinës. Vali u vesh trashë. Kristina dhe Aspasia e vunë në mes dhe u nisën. Hamdia i përcolli gjer tutje.

— E shkreta çupë, — tha duke u kthyer.

— Kokë çilimiu, — ja ktheu plaku.

Valit në fillim ju duk e tepërt që Kristina e mbante për krahu, po në mes të rrugës e ndjeu nevojën e mbështetjes.

— A moj vajzë! — thoshte kohë më kohë Aspasia me një ton enigmatik.

TRI DITË NË SHTRAT

Mbas shiut të rrëmbyer të së djeshmes qielli u bë xham. Gjelbërimi u ndez nga uji dhe freskia. Dhe njerëzit ishin çelur dhe gjallëruar. Kurse Aspasia as që e kishte mendjen aty. Dukej sikur në dhomën e saj klima ishte gjithmonë njëlloj.

Vali rrinte shtrirë në shtratin e saj, me duar të kryqëzuara pas kokës e me sy të mbërthyer në tavan. Shtjellimet i qenë larguar, temperatura i kishte zbritur në 38 dhe trupin e ndjente më mirë. Kristina kishte shkuar në ambulancë dhe ato kishin mbetur vetëm. S'kishin qenë kurrë kaq pranë njëra tjetrës. Kaq të vetmuara. Aspasia, si gjithnjë, punonte *tantella* dhe i hidhte nga një sy të sëmurës e ndoshta as i shkonte ndërmend se ajo po mendonte për të:

«Në fillim Aspasia m'u neverit. E përbuza. Më dukej se s'mund të ndryshonte kurrë... As që mund ta mendoja se një ditë do më rrinte kaq pranë e do përkujdesej kaq shurnë për mua. Kur erdhi te Demiri për të më parë, më dukej e trembur, kurse tani më duket e dashur dhe e dhemshur si një nënë. Si i bërtiti Kristinës kur më shpoi dy

herë për penicilinën!? A thua të jetë vetëm dhemshuri kjo?! Po Hamdien sa mirë e priti, kur erdhi e më solli qumështin! Vetëm dhemshuri të jetë?!!!»

— Si dukesh?

— Po më kalon.

— Të të bëj një limonatë me limontoz?

—

— Apo të të ziej komposto?

«S'e pata menduar që Aspasia mund të flasë edhe kështu, me një zë kaq të ngrohtë»

— Si thua?

— Faleminderit, po tani s'dua gjë.

Ajo i luajti kokën qortueshëm dhe u ngrit.

«Ndoshta kjo është pika e dobët e nënave! Ta pyes ç'përshtypje i bëri grupi artistik?! Më mirë s'po e ngacmoj. Edhe Kristinës i erdhi shumë keq. S'ma merr mendja të jem aq e sëmurë. Po brigada ç'bën vallë? Me gjithë atë shi që ra sot, nuk hyhet në parcelë për prashitje. Me se po merren? Ama dhe unë, sikur i di të gjitha punët e fshatit. Sikur këtu vetëm prashitje ka. Një skenë si ajo e mbrëmshmja s'kam për ta harruar kurrë. Ç'njerëz! Sa pak i njohim njerëzit dhe sa keq i gjykojmë nganjëherë. Nëpër atë të ftohtë hynin deri në gjoks në ujë dhe as donin t'ja dinin. Për një shatë ujë, i vëllai i xha Bektashit dikur ka lënë kokën. Kurse sot...»

— Ta kam bërë një çikë të rëndë, po pije të gjithën, se të bën mirë... Limonata të mbledh stomakun.

— Faleminderit, po ç'e deshe.

— Ç'është kjo fjalë! Të kam si Kristinën.

—

— Pupu, pupu... po ti qenke bërë ujë në djersë... Ndërrohu, ndërrohu shpejt!

— Vetëm në fytyrë, se në trup s'kam djersitur.

— Do të të bëj një supë të prerë me vezë e me të thartë.

«E kam menduar Aspasinë vetëm si një njeri të rreptë e të egër, që di veç të bërtasë...»

Duke menduar, Valin e zuri gjumi. Aspasia i mbështolli me kujdes shpatullat me jorgan e, duke ecur me kujdes me majat e gishtrinjtve filloi të pregatiste supën.

Kristina, kur erdhi për të ngrënë drekën, e gjeti dhe e la në gjumë Valin. E ëma nuk e lejoi as t'i vinte dorën mbi ballë, që të mos e zgjonte. Para se të shkonte në ambulancë, Aspasia e dërgoi Kristinën të blinte karamеле, se mos kushedi u vinte njeri. Kristina u ngazëllye. Për herë të parë pas kaq kohësh po ndjente erë familje.

Dhe me të vërtetë, pasdite Aspasia pati shumë punë me të priturat e të përcjellat. Dhe e zuri turpi që ishte pa pregatitur. Karamelet s'ja mbushnin syrin. Si s'ju ndodh një lugë kafe, një gotë raki! E... e, si e mbante bufenë në shtëpinë e saj! S'kish grua t'ja kalonte në të pritur Aspasisë.

Hamdia kishte shkuar tri katër herë për të pyetur e për t'i shpënë ndonjë gjë Valit. Nga dreka trokiti Bashkimi.

— Si është Vali?

— Më mirë. — Po Aspasia s'e ftoj të futej brenda.

Kristina i bëri shenjë Bashkimit, duke vënë gishtin mbi buzë, që të mos e ngrinte zërin. Ai hyri në dhomën e tij. Aspasia i luajti kokën qor-

tueshëm së bijës. Në të perënduar të diellit, dera trokiti përsëri.

— A do miq? — pyeti Fadili. — Na fal se po të bezdisim.

— Uuu! Fjalë është ajo? Urdhëroni. — Dhe, si fshiu dorën në përparëse, ja zgjati mikut. — Urdhëroni!

Pas tij hynë Reshati, Demiri e Bujari. Dy më të vjetrit u ulën në karriget pranë shtratit të Valit, kurse dy të tjerët, meqë s'kishte karrige, u ulën mbi shtratin e Kristinës. Kur e pa shtëpinë plot me njerëz, Kristinës ju duk dhoma e madhe, shumë e madhe, dhe u mbush me një buzëqeshje të çilter. Aspasia vinte rrotull e hutuar, sikur të qe hera e parë që priste njerëz. Pastaj shkoi në dhomën e mësuesve dhe u kërkoi karrige. Bashkimi i dha një asaj dhe dy i mori vetë. Vali qe ngritur ndenjgur. Miqtë ja kishin nisur bisedës.

— Hajde, moj Vali, hajde, — thoshte Fadili. — S'dole gjë. Një të lagur e zure krevatin. Le, po na paske qenë edhe sportiste, demek, — dhe qeshte.

— Rini, e... s'e ruajnë shëndetin, — tha me sinqeritet Aspasia dhe i ftoi të tjerët të uleshin në karrige, pranë Valit.

— Epo, domosdo... Ke ardhur të na shpëtosh fshatin, se po e merr lumi... Po sa herë të kam thënë, moj derëbardhë: «Merre shtruar. Mos kërkto pjesë në tërë punët», — e ngau bisedën Reshati.

Biseda qe e ngrohtë, plot humor dhe e mbushi atë dhomë, që qe mësuar me heshtje e fjalë të vrazhda, me fllade e me aroma, që më shumë se kushdo i ndjente Kristina. Vali jepte e merrte në bisedë, po hera herës shikonte Kristinën dhe buzë-

qeshte. Aspasia i keqkuptonte këto buzëqeshje dhe, megjithëse e zënë me telashet e mikpritjes, s'pushonte së hetuari të bijën. Ardhja e Bashkimit e kishte shqetësuar. Kjo dallonte si një fill i kuq në atë përzierje ndjenjash, që e kishin pushtuar. Demiri e shihte Valin si me ndrojtje dhe, kur shikimet e tyre takoheshin, ai ulte kokën. Si biseduan për shëndetin e Valit, për të mirat e shiut, për kanalën e punët e brigadës, Fadili tha:

— Sot isha në komitetin e partisë. Kam ngrënë një dajak, që akoma po më dhembnin brinjët. Vetë sekretari i parë na kishte mbledhur. Për punë të grupeve artistike. «Disa shokë s'e kanë kuptuar drejt porosinë e partisë», — na tha. Mua me erdhi çudi. «Ç'paskemi bërë e s'e paskemi ditur», — thashë me vete. E çfarë nuk shkova nëpër mend. «S'e marr vesh, shoku Fadil, — vazhdoi sekretari, — si është e mundur që kooperativa juaj të jetë nga të parat në punët e bujqësisë e në ca anë të tjera në bisht fare. Ja, të marrim grupin artistik. Vjet s'muarët pjesë fare në festivalin e rrethit. Prapë ky avaz sivjet? Me sa kam marrë vesh s'jeni gjëkund. Sa do të vazhdojmë kështu? Akoma s'e merrni vesh ju që socializmi nuk ndërtohet vetëm me misër e me patate?! Ç'bëjnë komunistët? Po ti, ç'bën si sekretar? Kini gjetur një fjalë: Na mungon elementi femër. Se s'punoni, prandaj. S'jepni shembull. Pa nxire çupën ti i pari. Në mos paç çupë, gruan. E tjetri e tjetri. Pse themi ne, komunistët në ballë. Për të hapur tokë të re e di unë që ty të vënë në bisht të gjithë, përmbysin malin të tjerët. Po këtu, këtu duhen komunistët. Duhet shembull personal. Punë me durim... E, ç'thua? Do ta bëni, apo jo?»

«Do ta bëjmë», — i thashë. — Fadili bisedonte me Valin, po herë pas here u drejtohej edhe të tjerëve për të marrë pëlqim.

— E do ta bëjmë se s'bën. Tani patëm një mbledhje të komunistëve. E bëmë ashtu shpejt e shpejt, pa fjalë shumë. Vajzën e Muhamerit e të Zihniut i ke në grup që sot. Na ndihmove shumë me atë punën e Shpresës. Po edhe ne s'kemi punuar si duhet për këtë çështje. Nejse, që u thye Bequa, na u bë goxha punë... Se kështu e kanë këto punë, de, shih rrushi rrushin e piqu. Edhe time shoqe merreni... E kam pa shaka. — Fadili e ndërpreu një çast fjalën, pastaj ju drejtua Valit:

— Ne, si organizatë, vendosëm që ti ta lësh brigadën e të punosh në vatrën e kulturës.

— Si të shërohesh mirë e mirë një herë, — tha Reshati.

— Ajo s'do mend.

Valit s'i erdhi mirë. Mendonte se po ja bënin këtë për t'i dhënë një punë të lehtë. Dhe i erdhi inat me veten, që ishte sëmurrur. Nuk e duronte dot mëshirën.

— Me vatrën e kulturës merren arësimitarët. Grupin e drejton Bashkimi. Unë s'mund të bëj kurrë më shumë se ata.

— Arësimitarët na ndihmojnë shumë. Edhe Bashkimi e drejton mirë grupin, po ti duhesh atje.

— Po...

— Është vendim i organizatës.

Vali pa Demirin dhe ju duk se edhe ai s'e kish-te pritur mirë këtë vendim.

— Unë besoj se sivjet do të bëjmë diçka, — tha Bashkimi; — provat s'kanë filluar keq, veç pengohemi nga vajzat.

— Epo ç'thamë tani?

— Dakord, po as me dy nuk zgjidhet problemi.

— Do vijnë edhe të tjera.

Aspasia vazhdonte të kujdesej si dhe më parë për të nderuar mysafirët, po Vali tani vinte re se, përveç shqetësimit që i shkaktoi ardhja e Bashkimit, ju çfaq edhe një shqetësim tjetër. Megjithatë, kur mori vesh se Vali do të qëndronte në vatrën e kulturës, i erdhi mirë.

— Sikur ma dhe gjysmë fjale dje? — i tha Fadili.

— Epo... Ç'të bësh! — s'diti si të përgjigjej Aspasia.

— Vajzat e fshatit po shtohen në grup. Lëre dhe Kristinën. Ajo s'ka ndonjë kundërshtim. Apo jo, moj kapedane?

Kristina qeshi me ndrojtje.

— Epo fundja, veç dynjasë s'do bëjmë, de... Si për të gjithë.

— Kristina ishte që mbrëmë në provat e grupit, — tha Vali. Aspasisë i erdhi mirë nga fjalët e saj.

Dikush trokiti. Kristina shpejtoi dhe hapi derën. Ishin Gonxhja, Shpresa e tri vajza të tjera të brigadës së Valit.

— Çohuni, se erdhi turni tjetër, — tha Reshati dhe u ngrit.

— Të shkuara.

— Faleminderit.

Më shumë falënderonte Aspasia se sa Vali. Ajo i përcolli miqtë gjer poshtë shkallëve.

Shoqet ju mblodhën Valit mbi kokë. Dikush mbante dorën në pëllëmbë të saj, dikush i ngrinte

jakën, një tjetër i rregullonte krevatin. Secila donte të bënte diçka.

Te dera Aspasia i ankohej së bijës e më shumë vetes:

— Turp! Turp! Turp!.. Si e humba fare unë. Le kafe e raki që s'nxora, po një cigare të paktën. Kjo e sotmja s'më ka ndodhur kurrë.

Kristina qeshte. Asaj i dukej sikur e ëma i kishte gostitur miqtë me gjërat më të mira të botës.

— Të paktën për këto çupat, — s'pushonte Aspasia. — T'u nxirrnim ndonjë gjë. Hidhu e na merr ca llokume. Na.

Kristina fluturoi. Ishte errur. Ajo s'ngopej dot me ajër. Ishte hera e parë që shkonte diku natën vetëm. Dyqani ishte mbyllur dhe ajo u nis për nga klubi. Duke ecur midis tryezave, nëpër atë tym cigaresh, i dukej sikur rendte përmes mjegullash dhe e hidhte hapin pa parë ku shkelte. Po, me të dalë, shqetësimet i la në prak të klubit dhe vrapoi si ndonjë, që gazi i jep krahë. Kur po ngjiste shkallët, dëgjoi Bashkimin që vërshëllente një këngë të njohur. Ju kujtua e ëma.

«Antikë është kjo mamaja! I është mbushur mendja se... Bashkimi është shumë i mirë. Megjithatë, unë s'kam asgjë me të...»

Hyri në dhomë si furtunë.

Gonxhja me shoqet e tjera s'kishin ndërmend të rrinin gjatë, po Vali e Kristina ju lutën e ato qëndruan gati dy orë. Në fillim rrinin si të ndrojtura e u përgjigjeshin me turp pyetjeve të Aspasisë. Po dalëngadalë gardhi i ndrojtjes u çua e nisi të rrjedhë një bisedë e gjallë, plot humor dhe shaka,

që i mbuloi rregullat dhe shqetësimet e mikpritjes së Aspasisë.

Kristinën e pushtoi një ndjenjë e vagëlluar, që s'ju zbeh as kur kujtoi se tamam këto mysafire kishin folur keq për të dhe e kishin quajtur «çupa e policit».

Mbi tryezë avullonte pjata me supë.

— S'ju mbetet qejfi ju, vajza, po të hajë Vali një çikë bukë.

— Teto Aspasi...

— Mos ki turp. Duhet të hash, se pastaj do pish ilaçin. Po vete ora tetë e gjysmë. Ka rregulla këtu.

— As në spital s'ka kaq rregulla... — tha me seriozitet Vali dhe ja shkrepri gazit.

Kristina shtroi një pecetë të pastër dhe i lëshoi përpara një pjatë supë e një pjatë kos.

— Bujrum!

— Të bëftë mirë!

U bë një heshtje e shkurtër.

— Po kjo gjella ç'është? — pyeti Gonxhja.

— Çorbë! — ju përgjegj një tjetër.

— Jo... Ajo është supë me vezë të prerë, — shpjegoi Aspasia duke përkëdhelur zërin.

— Ne s'e gatuajmë. Bëhet e mirë?

— Të hap oreksin. Është edhe me të thartë, — vazhdoi gjithë njësoj Aspasia. Vali mbushi lugën dhe ja zgjati Gonxhes.

— Hape.

Ajo u turpërua.

— Jemi në shtëpinë tonë këtu. Mos ki turp. Apo ke merak për lugën.

— Prit të sjell një tjetër, — tha Kristina...

— Jo, po... — Gonxhja kafshoi buzën.

— Të lutem shumë, shoqja brigadiere, hape gojën, se do të marrim masë. Këtu jam unë brigadiere e ta mbledh. Hape.

Gonxhja u detyrua ta provonte supën. Të qeshurat e vajzave mbushën dhomën qoshe më qoshe.

— E? — pyeti Vali.

— Qenka e mirë me gjithë mend. Po si bëhet?

Aspasië ju mpreh sedra dhe filloi të shpjegonte jo pa u krekosur një çikë. Vajzat dëgjonin me vëmendje.

— Di dhe ca gjellë të tjera teto Aspasia, që të lësh thonjtë, — ja ngacmoi më tej sedrën Vali.

— Keni ngrënë byrek me lëpjeta?

— Me lëpjeta????!!!

— E... e! Ta provosh, pa të shohësh.

— Po burani?

— Si? Si?!

— Bu-ra-ni...

Vajzat qeshën me të madhe.

— Emrin e ka kështu, po e hanë edhe gratë, jo vetëm burrat, — qeshi Vali.

— E si bëhet?

— Pse, të gjitha për një natë do t'i mësoni ju? Teto Aspasia këtu është.

— Në rrethin tonë mua më mbanin në gojë për gatimin, — u mburr Aspasia.

— Sa mirë! — tha Vali. Aspasia s'e kuptoi ç'donte të thoshte. Po as e pyeti. Dhe as i shkoi ndërmend se «rrodhja» do të fillonte t'i qepej edhe asaj që të drejtonte me gratë e fshatit një kurs për gatimin e gjellëve.

Vajzat ikën me zemër të thyer. Ato donin që

ajo bisedë gazmore të mos mbaronte gjer në mëngjes.

Edhe pas ikjes së tyre Aspasia ishte në ethet e mikpritjes. I pështjellohej diçka e turbullt, po e vakët...

— Vajza të mira, — tha përmes turbullirës, po u kujtua se një ditë më parë i kishte sharë dhe, si e përmendur nga një gabim i befasishëm, vështroi Valin me një shikim sikur donte të tërhiqte fjalën.

Seç kishte një freski dhoma e tyre atë natë. Bisedat ishin të ngrohta, shikimet të çelura.

«Më në fund Aspasia po kupton se edhe këtu ka njerëz». — mendoi Vali me vete. Kurse në faqen e ditarit të asaj dite, para se të binte për të fjetur, shkroi:

«Sonte dhoma jonë ka qenë si asnjëherë tjetër. Si gjithmonë jemi ne të tria, po ata që erdhën, seç sollën këtu në kullën tonë... Më vjen keq që s'di të shprehem bukur. Por po e krahasoj me pranverën. Ato sollën diçka të tillë, siç sjell pranvera erën e luleve, flladin e përtëritjes. Kristina duket si e dehur, ndërsa Aspasia si e hutuar. Sa natë e bukur është sonte! Siç janë netët kur vjen pranvera!...»

* * *

Po pranvera nuk i respekton shumë kalendarët. Nuk shkrijnë të gjitha borërat më 21 mars e nuk çelin të gjitha lulet. Po ndodh që të jenë edhe gënjeshtarë pranverat. Zë të ngrohë dielli, lëvizin gjethet e nisin të shpërthejnë gonxhet, po dimri lëshon ato që kanë tepruar nga ngricat e nga cik-

nat, dhe lulet e gënjyera thahen. Dimri i ngjan një gjenerali të rreptë dhe të zotë. Ai, kur e sheh; se po i vjen fundi, tërhiqet ngadalë, duke mos përtuar të dëmtojë edhe në tërheqje. Pranvera ja di huqet. Dhe ajo ja merr mengadalë pozicionet, pëllëmbë për pëllëmbë. Në fillim fushat, pastaj bokat, kodrat... Pastaj fillon të futet luginave e grykave e t'u ngjitet shpateve me durim e pa u ngutur, derisa del në majë të malit. Dimri mundohet të gënjejë lulet, barin, shpresat e njerëzve, si ujku në atë përrallëzën kur shkoi e leu këmbën me miell dhe u mundua t'u tregohej kecape si dhi...

Po ato ndjenja që u zgjuan te Aspasia ditët e fundit, nuk ishin një gënjeshtëri e tillë... Po as dhe një shpërthim i pranverës. Ato ishin fillade, që tregonin se pranvera mund ta merrte edhe atë majë.

Vali mërzzitej, sidomos paradite, kur të gjithë shkonin në punë dhe ajo mbetej vetëm me Aspasinë. Ditën e tretë deshi të ngrihej e të shkonte në vatrën e kulturës, po Kristina nuk e la. Dhe tani mezi po i shtynte ato orët e stërgjata të mëngjezit. Të paktën të lexonte. Po nuk donte t'ja prishte fjalën Aspasisë, e cila kishte nisur një bisedë të mërzzitshme e monotone, sikur i mbante ritmin thurjes së tantenës, që s'e lëshonte kurrë nga dora.

— Ka lezet kur del vajza me plaçkë të mirë nga shtëpia. Unë të dy çupat e mëdha i kam nxjerrë me faqe të bardhë. Edhe me Kristinën nuk do turpërohem. Ca gjëra të vogla më kanë mbetur. Ja kam bërë të tëra katër e nga katër... Kam një komplet tavoline prej belluzi... vishnje me

trëndafila. Të lot koka ta shohësh. Kam pastaj një gjiro krevati... Ma kishte sjellë, ndjesë pastë, vjeh- rri nga Selaniku... Plaçka e nderon njeriun. Apo ç'janë ato perdet e damaskut!..

Valit i jepte zagushi kjo bisedë... i merrte frymën.

— Kam një tapita arabe...

«Sa e tmerrshme sikur të gjithë prindërit të kenë këto preokupime për vajzat e tyre?!»

— Çentrot ja kam punuar vetë, me grep të hollë dhe i kam kollarisur të gjitha.

«Sa e thjeshtësojmë nganjëherë punën e pajës! E gjykojmë thjesht nga ana ekonomike. Kurse ajo ka të bëjë me tërë mendimet, me tërë kuptimin e jetës së vajzave. S'mund ta ndash dot këtë bisedë të Aspasisë nga qëllimet e saj për «fatin» e Kristinës. Si e duron ajo këtë?! Dhe mua nganjëherë më gënjen mendja e më duket se Kristina doli nga guacka. E ëma e lë të vijë në grupin artistik. Po kjo ende nuk është zgjidhje».

— Njërin komplet të krevatit, atë të mënda- fshtin, ja kam punuar me kafaska... Po i ka dalë!.. Lëre...

«Edhe vetes Aspasia ja ka lëshuar pak litarin këto ditë. Çudi! Pse ndryshon aq shumë kur vijnë njerëz këtu! Gjallërohet, çelet! Mos është vetëm sedra e mikpritjes!? Mbas ikjes së tyre, gjallëria fillon të shuhet e ajo kthehet përsëri te vetëvetja. Dhe gjithë ditën shkroi letra. Ato letra që të çmendin. Të isha karikaturiste, Aspasinë do ta paraqisja si një vandak letrash të mbështjella me tantene e me një palë dylbi të gjata, duke vrojtuar mos po duket gjëkund «fati». Si s'e kupton? Kris-

tina më tha se i vijnë shumë pak përgjigje, a merr a s'merr një për dhjetë letra që dërgon. Përgjigjet shpesh nuk ja lexon së bijës. S'do mend! Kushedi ç'i shkruajnë. Se, në fund të fundit, ajo vetëm një përgjigje pret. Po letra që i hapëm ne me Kristinën dje? Kulmi! Ç'do të bënte sikur ta lexonte? A do të shkruante më?! Ndoshta ka lexuar përgjigje edhe më të forta e shkruan përsëri. Shpreson. Po më mbushet mendja se Kristina s'ka për ta pranuar kurrë një rrugë të tillë për të gjetur një copë burrë, prej të cilit kërkohet vetëm një «virtut» i lartë: të ketë punën në qytet dhe të tërheqë atje «dy fatkeqet». Kristina s'ka për ta bërë kurrë këtë. Po pse s'i jep fund?! Njëqind herë më të ndershme janë martesat me mblesëri që bëjnë tani fshatarët, se sa ajo që mendon Aspasia. S'besoj të ketë letra më të ndyra. Kjo është një tregëti moderne. Ajo kërkon vetëm një djalë (mosha s'ka rëndësi) që t'i sigurojë një qoshe të vogël në qytet e kjo do t'i japë vajzën e saj të bukur, të mbuluar me belluze, tapitara e gjiro Selaniku... Ç'poshtërsi moderne! Dhe ne, kur flasim për shtypjen e vajzave dhe të grave, ja hedhim të gjithë fajin Lekë Dukagjinit. Sikur ai të ishte në dasmën e Kristinës, ashtu si e mendon Aspasia, do të zbraste pushkën e tij ugruzezë. Dhe do të mos e kuptonte se po bëhej një martesë me kanun, meqenëse çiftet kërcejnë nën tingujt e saksit e të kitarës elektrike dhe nusja e ka fustanin e bardhë katër gisht mbi gjunjë.

Sikur t'ja thosha të gjitha këto gazetarit që ka ardhur në fshat, me siguri do të dilte një fejtton i bukur. Ende më qeshet me përgjigjen që i çoi

Frosina Aspasisë; «Atë që më thua ti, Aspasi, për Kristinën, s'ta bëj dot. Por, po të duash... Të kam gjetur një burrë për vete. Ligorin e Gaqollarëve. Ka vendosur të martohet tani në pleqëri. Vërtet po bëhet shtatëdhjetë vjeç, po është i fortë akoma dhe...» U shkulëm gazit me Kristinën. Po sikur t'ja kishim dhënë Aspasisë ta lexonte!? Apo të bëjmë një skeç për estradën tonë! Disa herë në estradat e qyteteve gjysma e repertorit u kushtohet të metave të fshatit. Pse të mos i fusim edhe ne një shkop qytetit!? A nuk është Aspasia një çiban i qelbur mbi lëkurën e argasur fshatarake!?»

Aspasinë e kishte rrëmbyer ai fill që po tirrte, e s'dinte të pushonte:

— Kristina e punon grepin për qejf. Apo shtizat! Le për të qëndisur që s'e ka shoqen. E ke parë atë kompletin e zi të tavolinës? Vetë e ka bërë. Po edhe unë, ama, s'i jam ndarë, çekan ju bëra, që kur ishte na, një pëllëmbë.

— E moj teto Aspasi!

— Kështu posi? Po s'e mësove vajzën, turpëroresh kur të shkojë në derë të botës.

Vali u ngrit ndenjtur. Me sa dukej mendonte të niste një bisedë të shtruar e të gjatë. Po në koridor u dëgjuan zëra. Aspasia u ngrit dhe i hodhi një sy shtëpisë. Dikush trokiti.

— Urdhëroni! Urdhëroni!

Ishte Reshati me një djalë të ri, truphedhur e fytyrë hequr. Këpucët e llangosura me baltë tregonin se vinin nga parcelat.

— Na fal, o zonja e shtëpisë, se të sollëm baltën brenda. Po fshati kështu e ka, — tha Reshati.

— U... u! Ç'është ajo! Rrini pa merak.
U përshëndetën.

— Ky shoku është gazetar. Ka nja tri katër ditë këtu në fshat. Do shkruajë për kooperativën tonë, — e mori përsëri fjalën Reshati, si kishin zënë vend.

— Shumë mirë, shumë mirë... — s'diti ç'të thoshte Aspasia.

— Si ju duket kooperativa jonë? — pyeti Vali.

— Ka shumë gjëra të mira... Edhe të meta, natyrisht. — Ndërsa fliste, gazetari diç shënonte në bllok. Ndoshta i bëri përshtypje që Vali tha: «Kooperativa jonë».

Reshati qeshi.

— Është bela me këta gazetarët. Ti fillon e i thua: Kemi bërë këtë e këtë. «Po, po», të thonë e të dëgjojnë. Po, kur je duke bërë muhabet vërtetë, që flet mbarë e prapë, atëhere nxjerrin bllokun e të regjistrojnë.

Edhe gazetari qeshi.

— Ju kini ardhur vullnetare këtu? — pyeti Valin.

Ajo pohoi.

— Këta shokët më folën gjatë për ju, më thanë shumë gjëra.

— Sidoqoftë duhet t'i verifikoni me mua, se këta i shtojnë dhe i ntrashin shumë, — dhe Vali pa buzagaz Reshatin.

— Desha të më thoshit edhe ju diçka, për punën tuaj, për ndjenjat tuaja.

— Ç'të them unë?

— Si ç'të thoni? Ju, siç më thanë, bëni gjithë këtë punë këtu!

— Punë të madhe... Lëre! Ju e shikoni vetë, shtrirë në shtrat. Shkruani për fshatarët... Ata...

— Të thashë, o byrazer, që s'nxjerr gjë nga goja e kësaj! — i tha Reshati gazetarit. — S'ja di kokën ti, — dhe ju drejtua Valit: — Po folë, moj. Pse pak bëre ti në brigadë? Po me xha Beqon? Po te kanali?

— Tani e gjete. Të mos isha unë, kanali s'kishte për t'u mbyllur.

— Lëri, moj ato.

— Tani zura shtratin e shoh ëndërra gjithë ditën; kushedi ç'i kini thënë këtij shokut?

— Atë e dimë ne.

— Shkruaj për xha Beqon ti, shoku gazetar. Për Shpresën, për komunistët e fshatit. Për Gonxhen. A e njeh Gonxhen?

— Po.

— Sa vështirë e ka pasur. Për mendimin tim, një gjë ka shumë rëndësi: asaj i vinte rëndë të drejtonte. Dhe punonte tok me brigadën. Edhe kur filloi drejtimin, kështu e nisi: pa e lënë punën me shatë. Edhe tani punon me brigadën. Dhe drejton shumë mirë.

Reshati e ndërpreu:

— Moj po këtë e di ky, ja thamë ne. Për vete folë, për vete. Dhe në paç kritikë për ne, thuaja copë.

— Mirë, ja po them edhe për vete: shkruaj, shoku gazetar. Këta shokët e kryesisë e të partisë nuk më ndihmojnë. Duan të më llastojnë. U ftoha pak e më hoqën nga brigada. Duan të më lënë në vatrën e kulturës.

— Shih, shih... — ja bëri Reshati.

— Ashtu posi... Dhe po të ankohesh të zënë gojën. «Është vendimi i organizatës», të thonë.

— Dale, or një herë, dale, — i tha Reshati gazetarit që po shkruante dhe i kapi dorën. — Dale, bre, se nuk është kështu. Ne e hoqëm nga brigada, se duam të vëmë në vijë estradën.

— Estradën e drejtojnë arësimtarët, — tha Vali.

— Nuk jua ha njeri hakun arësimtarëve. Dëgjon ti, burazer? Po mos që kjo, s'kishin për të shkuar çupat në grupin artistik. Lëre ç'thotë kjo.

— E shikon si i zmadhojnë gjërat? — tha Vali.

— Jo. Kështu është.

— Posi!

— Këtë ndihmë që po na jep, s'ta shpërblejmë dot.

— Shoku. Reshat.

— Lëre tani. Të themi atë që është.

Aspasia bënte ç'bënte dhe dilte në dritare. E kishte pushtuar një shqetësim i papritur. Po i lëvrinte një dëshirë e ndezur. Mori një fotografi të së bijës dhe e vuri mbi tryezë, përballë gazetarit. Po bëhej nervoze. Ora kishte kaluar nga dymbëdhjeta dhe Kristina s'po dukej ende. As që mendonte se nga kishte shkuar dhe ç'po bënte e bija, veç i vinte inat që e gjeti tamam ditën të vonohej. «Kushedi, e... Këto punë kështu e kanë... Dale t'ja shoh një herë duart! Në gisht s'paska gjë. Edhe kështu, si kallëp s'qenka keq. Ndonjë bukuri të madhe s'ka, po... Ama dhe unë sikur e dua për në vitrinë».

Reshati e Vali vazhdonin të kundërshtonin njëri tjetrin e s'e kishin vënë re fare gazetarin, që

po mbushte faqet e bllokut e buzëqeshte pa u ndjerë.

— Ne po mësojmë shumë nga ti.

— Unë po mësoj nga ju.

— Pa pyet Beqon ç'thotë?

— Pa më pyet mua për të? E se mos vetëm prej tij.

— Ahu dhe ti...

Vali pa gazetarin që i fluturonte lapsi në dorë.

— S'kam ç'të them për vete.

— Faleminderit! Më the boll! — tha i kënaqur gazetari.

Reshati u hodh:

— Jo, bre, s'është kështu. Shkruaj ato që të dhamë ne.

Gazetari shfletoi katër faqet që kishte mbushur me shënime gjatë asaj bisede dhe diç shkroi me germa të mëdha. Ndoshta ishte nëntitulli i ndonjërit prej kapitujve të reportazhit të tij.

— Na fal, moj Aspasi, se ramë pas llafit dhe e humbëm fare. Të ngatërron kjo shejtankë... Si ke qenë?! — pyeti Reshati.

— Faleminderit.

— Çupën mirë e ke?

— Mirë, mirë... Ja, më mbetën sytë nga rruga, po s'po duket. Ora po vete 12 e gjysmë.

— E, moj, se s'ta rrëmben njeri çupën, jo. Ti ja mbledh rripat më keq se ca këtu ndër ne.

Aspasisë s'i erdhi mirë nga fjalët e Reshatit, po s'e bëri veten dhe u mundua ta përcillte fjalën me një të buzëqeshur, ndërsa sytë i mbante nga gazetari, e trembur se mos shkruante gjë në bllok.

— Punon mirë Kristina, — tha gazetari.

— Mundohet e shkreta, — u llastua Aspasia.
— Fundja për atë punë e ka dërguar shteti këtu...
Po pse vonohet, xhanëm? — dhe e zgjati përsëri
kokën nga dritarja.

— Ambulancën e mban mirë.

— Pse, ishit atje?!

— Isha.

Aspasië i shkrepninë sytë.

— Biseduam pak për higjenën, për punën me
gratë, me vajzat...

— Kristina gjilpërat e mjekimet i bën mirë.
Gjynah të qahemi. Po nga ato të tjerat sikur s'pa-
ra... Apo jo, Aspasi? Të themi atë që është.

Sytë e saj u shuan njëherësh e gjuha ju lidh.
Herë shikonte gazetarin se mos hapte bllokun e
herë Valin, me frikë se mos ja niste edhe ajo nga
ato të sajat.

— Sidoqoftë, në grupin artistik bën pjesë, apo
jo? — pyeti gazetari.

— Po, po, — s'la vend për heshtje Aspasia.

— Me njëqind bela edhe atje, — tha Reshati.
Vali po buzëqeshte.

— Epo si të thuash... Këto punë... Janë një
çikë edhe si me të dhënë... Një është e afruar, i
vjen më përdorësh... një tjetër... S'janë tërë nje-
rëzit njësoj. — Dhe Aspasia pa Valin gjithë frikë,
sikur t'i thoshte: «Mos m'u zemëro. S'e kam me ty».
Dhe as ja priste mendja se Vali do ta përkrahte:

— Kristina është vajzë e mirë. Në fillim e
pati pak vështirë, po tani do të ndihmojë shumë.
— Ca nga ca, — tha Aspasia. — Po ti nga je,
mor djalë?

— Jam nga veriu. Prindërit i kam në fshat,

kurse vetë në Tiranë. Mbarova shkollën dhe më mbajtën aty.

— Si lum ti! Ke punë të bukur. Po-o, në Tiranë vetëm je?

— Vetëm.

— Po ku banon?

— Jemi tre beqarë. Kemi një dhomë...

— Bukuri, bukuri. Ja, do të krijoni familje, do të rehatoheni... Je i fejuar gjë?

— Jo.

Gazetari uli kokën. Kushedi se ç'shkrim të bukur do të kishte qëndisur, sikur ta dinte se ç'teli i binte Aspasia.

Kristina erdhi kur po dilte Reshati me gazetarin. Aspasia ju lut të rrinin për drekë. Kur pa të bijën, sa s'e përpiu me sy. Ajo u dha dorën mysafirëve dhe hyri në dhomë. E ëma i përcolli deri në rrugë.

— Ç'u bëre, moj Kristë, se i ra goja teto Aspasisë.

— Lëre, se u turpërova. Më pyeti ai gazetari për disa gjëra e s'dija t'i thosha një fjalë. E mora vesh që do vinte këtu, prandaj u vonova. E di si më vinte? Më kapi shah fare...

— Më duket se i thonë mat.

— S'e mos marr vesh dhe ti... Po fotografia ime ç'do këtu mbi tryezë?

— Të prezantoi mamaja me gazetarin.

— Aman Vali!

Aspasia u kthye e dërmuar.

— Ku e gjete ditën të vonohesh? — i shfryu së bijës.

— Kisha punë.

— Të vjen në derë dhe... — Po s'e vazhdoi fjalën më tej, se u kujtua që ishte Vali në dhomë. Kurse ajo ja pat:

— Ishte goxha djalë, — dhe i shkeli syrin Kristinës.

Aspasia i peshoi mirë fjalët para se të përgjigjej:

— Dukej i zgjuar.

— Apo s'e kishte shpatë atë majën e lapsit. Të lexosh ato shkrimet e tij...

Aspasia mbajti një çast frymën. Dëshirat e mëparshme u zhdukën nga sytë e saj si të kishin qenë një cipëz e hollë pluhuri, dhe ja lanë vendin frikës.

Kristina i buzëqeshi Valit dhe e falënderoi në heshtje që e kishte shpëtuar nga leksionet e gjata të së jëmës për «fatin që i kishte ardhur në derë».

REPORTAZHI

Të nesërmen Vali doli në punë. Atje ku e caktuan, në vatrën e kulturës. Ditën e parë e ngrysi si e ngrysi, po ditët e tjera mërzitej shumë. Jo s'e s'kishte me se të merrej. Librat ishin të pasistemuara, salla ende nuk ishte pajisur si duhet me parulla, me zbukurime, me fotografi... Arësimtarët kishin bërë punë të madhe, po kohët e fundit i qenë kushtuar sidomos grupit artistik, përveç punëve të shumta që kishin në shkollë, meqë po mbaronte viti shkollor.

Orë të tëra Vali i kalonte në vetmi. Kjo e torturonte. Herë-herë jepej e gjitha pas punës e mundohej të largonte mërzitjen, shkruante, priste, ngjiste, shkante e vinte në kryesi, në magazinë, në dyqan... «Dua letër, dua penjë, dua zamkë, dua bojë... Duhet gëlqere, duhen ca vazo lulesh... Të bëjmë këtë, të bëjmë atë...»

«Aman moj, po ç'na u desh që të lamë këtu?! M'u bëre...» — qeshi Reshati.

Po përsëri s'e mbushte dot atë boshllëk të madh që ndjente përbrenda. Ajo deshte njerëz. E mbyste vetmia. Heshtja e bënte nervoze. Një ditë,

pas ndonjë jave, u nis që në mëngjez me brigadën dhe u kthye tok me diletantët në orën e provave. Fadili i hoqi vërejtjen.

— Ne s'të lëmë kot aty.

— Nuk rri dot.

— Është vendim i organizatës.

— Edhe organizata mund të marrë vendime jo të drejta. Ç'të bëj unë gjithë ditën aty????!! Në mëngjez të gjithë janë në punë, s'vjen njeri në vatrën e kulturës. Ato punë që janë për të bërë, do t'i bëj të dielave me rininë.

Dhe Vali shkoi përsëri në brigadë, e cila gjithashtu e ndjente mungesën e saj.

— More, po ç'ç na kish lezet brigada.

— U mësuam me atë shejtan.

— Apo s'ishte e muhabetit qafirja.

— Kot që i thonë çupë asaj.

Ndoshta më shumë se të gjithë mungesën e Valit e ndjente Demiri. Ishte bërë më i heshtur, mendonte shumë për të dhe mezi priste ta takonte në provat e grupit artistik. Po se ç'ishte ajo ndjenjë që e ngacmonte kaq tepër, as ai vetë s'e kuptonte dhe as guxonte ta gërmonte veten. Kur e pa Valin që shkoi prapë me ta, u gëzua.

Reportazhi u botua nja pesë gjashtë ditë pas largimit të gazetarit. Atë ditë s'u prit që të ktheheshin kooperativistët nga fusha. Korieri, me të ardhur në fshat, s'qëndroi fare, po e mbajti vrapin nëpër brigada.

Botimi i reportazhit ishte ngjarja më e shënuar e ditës. Brigada e tretë e kishte mbaruar pushimin e drekës, po, me të ardhur gazeta, bënë një pushim

tjetër, atje ku ishin, në mes të parcelës. Gazeta kaloi dorë më dorë. Njerëzit e matnin shkrimin me sy, lexonin ndonjë rresht nëpër të, hidhnin ndonjë fjalë.

— S'po marrim vesh gjë kështu... Ta lexojë njëri.

— Tërë kjo që ka shkruar aty, do dy sahat të këndohet.

— Hajde, kush do ta marrë?

— Të nxjerrim radhët një herë.

— Hë mo, se rrimë një orë më vonë, a derëbardhë.

— Merre, brigadiere.

— Hajde, Demir, Demir.

Dhe Demiri s'e zgjati më. Lexonte shpejt. Disa ankoheshin dhe i thërrisnin ta përsëriste, po ai vazhdonte në të tijën. Kur arriti në atë pjesë që flitej për brigadën e tyre, u detyrua t'i përsëriste disa herë paragrafët, se nuk e linin të vazhdonte më tej.

— Opo dorë paska qerratai.

— Tamam e ka bërë.

— Po, bukur e ka lidhur, jo shaka.

— Vullnetarja! — Lexoi Demiri nëntitullin e kapitullit tjetër.

— Shëëët! Dale, dale.

Demiri lexonte ngadalë dhe i ndante fjalët mirë.

«... Është çupë për kokën e çupës. Na u bë bijë e shkuar bijës. Ka gjak të ëmbël».

— Këtë ja thashë unë, — u mburr Shahini.

— Ja thashë unë, — kundërshtoi Çeçua.

— Jo, more!

— Pushoni një herë të dëgjojmë. Oj këta!

«... Po na bën borxhli kjo çupa. Mua s'ka pasur burrë të më mundë në fjalë, e ajo më mundi».

— Tamam! — Dhe Bequa u sheshua mbi ledh. — Siç ja thashë. Po hë më poshtë.

Demiri po emocionohet nga leximi si ndonjë që e kanë detyruar të lexojë para të tjerëve vjer-shën e tij të parë. Si mbaroi nënkapitulli që bënte fjalë për Valin, ai ja dha gazetën një tjetri për të vazhduar leximin. Megjithëse vullnetaren e njihte më mirë se gazetari, ju duk sikur ai shkrim po i zbulonte një të fshehtë.

Si u mbarua së lexuari reportazhi, brigada rifilloi punën, po diskutimet për ato çka kishte shkruar gazetari nuk reshtën derisa lanë punën. Madje as rrugës duke u kthyer për në fshat.

Vali atë ditë e ndjente veten ngushtë. (Ajo s'ishte kthyer ende në brigadë). Kur i shpunë gazetën në vatrën e kulturës, ishte vetëm. E lexoi deri në fund reportazhin. Me përjashtim të asaj pjese që fliste për të, shkrimi i pëlqeu. Pas pak u duk në derë kryetari. Sa e pa me gazetë në dorë e gjithë gaz, Valit ju skuqën faqet.

— Të thashë, apo jo, që gjen belanë me gazetaret?! I ka marrë të gjitha ato fjalët që këmbuem te Aspasia. Një për një. — Ai shfletoi gazetën dhe i lexoi riprodhimin e dialogut të tyre. — Po i ka qëndisur bukur, ama. Dukej që ishte i hollë, qerratai. — Dhe vazhdoi të lexonte. Vali ja mori gazetën nga dora, e palosi dhe ja futi në xhep.

— I lumtë dora, — tha përsëri Reshati.

— Nejse, po në ca vende e ka tepruar.

— Posi...! Hiç s'e ka tepruar. Ty, po s'të pëlqeu, bëji një letër redaksisë dhe ankohu.

— Pse, s'e bëj, thua?

— Bëje, bëje, pa të shohësh... Kur ta botojnë rresht për rresht e t'i bëjnë poshtë një shënim ustallëkshe, që të çuditësh.

Reshati nuk qëndroi gjatë, po telashet për Valin nuk mbaruan me kaq. Kur vinin diletantët për provat, që me të hedhur prakun i buzëqeshnin me përzemërsi sikur t'i thoshin:

— E lexuam!

Dhe fillonin bisedat. E hutonte sidomos shikimi admirues i Demirit.

— I lëmë tani këto. Fillojmë nga provat, — përpiquej t'u shmangej bisedave dhe shikimeve Vali. Dhe, pas provave, ishte ajo që tha e para «Natën e mirë» dhe u nis për në shtëpi me Kristinën.

— Ç'janë këta gazetarët, moj Vali!

— E pe ç'ka bërë për mua!?

— Për ty s'ka ndonjë gjë... Ato të tuat i dinë të gjithë. Unë habitem pse u bën kaq përshtypje fshatarëve!

.....
— Puna ime është ndryshe

— Kur e dije që do të të vinte keq, mos ja thoshe.

— Më shumë kam hallin e mamasë.

— Ama dhe ti, Krista!

— Këto ditë s'ka genë aq mirë, e kam frikë mos e zërë ndonjë krizë.

— Epo pse s'i the atëhere gazetarit?

— S'kisha ç'ti thosha tjetër. Po ju luta që të mos i shkruante.

— Gjete kujt ti tregosh sekrete.

— Po ai më premtoi.

— Kështu e ka profesioni i tyre.

— Më mirë mos ja tregojmë gazetën sonte mamasë.

Po kot shqetësohej Kristina. Aspasia e kishte lexuar gazetën. I kishte kërcyer damari, qe mbushur brinjë më brinjë e mezi po priste të zbrazej. Me të parë të bijën në derë, s'priti më.

— Bravo të qoftë! Tani i vure vulën. I vure kapakun.

— Mama! Po, përse!?

— Për sytë e bukur që më ke. Për mentë që të kanë rrjedhur. Për këtë, ja, — dhe i hodhi gazetën në fytyrë.

— Mos e bëj kaq të madhe, teto Aspasi, — tha Vali.

— Ti rri, ti... — dhe ju kthye së bijës. — Ç'është kjo e pabërë që na bërë, moj ditëprerë? Ç'janë këto proçka!? Moj, po u çmende, apo si e ke hallin?!

Kristinës ju duk më me vend të heshtte. Po të përpiqej t'i mbushte mendjen, ajo do të nxehej më keq.

— Dëgjo, moj teto Aspasi... — u mundua edhe një herë ta qetësonte Vali.

— Avazet e tua janë këto, ja.

— Epo, s'u bë kiameti se ka thënë një fjalë Kristina.

— E lexon tërë Shqipëria këtë, — dhe i tundi gazetën para fytyrës. — E di, apo s'e di?

— E pastaj?

— Si moj «e pastaj»? Me kë flas edhe unë! Pse mos bësh ti. Të kanë ngopur me lëvdata zotrote. Pas

një muaji i lë hijen këtij qymezi këtu. Atje ku do të shkosh, do të të presin me lule. Në mos të dhëncin ndonjë dekoratë. Po ne, ne të zezat, që u mbytëm këtu. Edhe kjo na duhej, që të mos shkulemi kurrë. Edhe ndonjë shpresë që kemi, po i japim shqelmin vetë.

Valit ju kujtuan letrat.

Aspasia ju suall përsëri së bijës:

— Ti ke lajthitur, moj qyqe... Ku i ke mentë?

— S'kisha ç'të bëja tjetër. Ç'të thosha?

— Si, moj ç'të thoshe?

— Ai më pyeti si ndihmoi fshatin... Për higjenën, për...

— Pse, pak bën ti në ambulancë?

— Edhe ai s'ka shkruar pak për këtë, — ndërhyri Vali.

Po këto të tjerat ç't'u desh t'ja thoshe?

— Epo ai më pyeti, e s'kisha ç't'i thosha tjetër.

— Mos e hapje gojën fare.

— Më keq ashtu.

— Po mos i flisje ti, ç'do të shkruante ai...

— Më shumë e më keq do të shkruante.

Vali e kuptonte se edhe Kristina ishte nxehur, po përmbahej.

— Ku e solli kokën edhe ai, që mos e sjelltë? Le, po dukej edhe djalë i mirë, i turpshëm, i sjellshëm.

Vajzat u panë në sy e sa s'ja dhanë gazit. Aspasia mori gazetën dhe po komentonte frazat. Tani nuk bërtiste më, po inati i ziente përbrenda.

— Më mirë ka për të dalë kështu, — tha Vali.

— Lëre mos e pyet, aq mirë, sa s'thuhet. Prit.

nesër, kur të sulen dhëndurët për të kërkuar time
bijë.

Kristina u skuq. Vali s'e pa me vend të kapej
pas fjalëve të Aspasisë.

— Si s'po na bëhet për mbarë, xhanëm! Sikur
na ka mallkuar njeri, — psherëtiu Aspasia.

Vajzat qeshën nën buzë.

NË MBROJTJE TË DASHURISË

Provat e grupit artistik po viheshin në vijë. Ishin bërë nëntë shoqe. Programi ishte pasuruar me material. Koha vërtet ishte e shkurtër, mbeteshin vetëm nja tri javë gjersa të fillonte festivali, po Vali kishte besim se nuk do të dilnin keq. Diletantët linin punën nëpër brigada tri orë para të tjerëve dhe vazhdonin provat deri vonë. Arësimtarët s'ndjenin të lodhur. Po zgjerimi i grupit nxori probleme të tjera. Filluan ndërrimet e roleve, kalimi nga një material në një tjetër. Vështirë ishte sidomos me vajzat që luanin në skeçe tok me djemtë. Pas Valit, që luante me Demirin në dy skeçe, mori dhe Shpresa një rol si partnere e Qukanjazit, megjithëse në skeçe s'para ja shkreppte. Pas tyre filluan të luanin edhe Sanija me Ganiun. Akulli po thyhej. Po ndodhi diçka e papritur.

Sanija nuk erdhi një ditë në prova. Ajo kishte rolin kryesor në një nga skeçet më të rëndësishme. Shoqet shkuan ta thërrisnin në shtëpi, po doli e ëma dhe u tha se nuk e linte i ati. Kishte rrezik që ato të çara që ishin hapur, t'i mbulonte prapë akulli. Koha s'priste. Vali u nis të takonte Fadilin, po Ganiu e hoqi mënjanë dhe diç i tha. Puna qëndronte kështu.

Ganiu, megjithëse me shumë vështirësi, po më në fund ja kishte mbushur mendjen të jatit që ta kërkonte Sanijen. Sadiku dërgoi njerëzit e tij dhe ja kërkoi Veliut të bijën për djalin. Po fjalët që u këmbyen ishin të pakta. Veliu ua preu që me të parën e jo vetëm që nuk deshte ta jepte të bijën te Sadiku, po u rëndua keq dhe vendosi të mos i fliste më me gojë. Ai s'e merrte me mend si mund ta jepte të bijën nuse në fshat. S'mbahej mend ta kishte bërë njeri këtë turp.

«I kanë rrjedhur Sadikut. I kanë lojtur drasakat matufit! Ne jemi një fshat, një gjak e një xhins. E ai vjen më kërkon krushqi. Ka roitur, për përrëndi!»

Nga i ati Veliu kishte dëgjuar se i gjyshi na paskej qenë nip në derë të Safetllarëve. Kështuqë binin kushërinj. Në mos të gjashtë, të shtatë po se po.

Dhe që nga ajo ditë s'e la të bijën të shkonte në grupin artistik. Sanijen nuk e pyeti fare, se s'ja hante mendja që të qe ngatërruar me të birin e Sadikut. Edhe ajo vetë s'guxoi të hapte gojë e të thoshte të vërtetën. Gjithashtu edhe Sadiku s'dinte gjë që dy të rinjtë duheshin. I biri i kishte thënë vetëm se i pëlqente vajza.

Njerëzit e Sadikut i shkuan Veliut për së dyti në shtëpi, po ai s'i la as të hapnin gojën.

— Dale një herë, o Veli.

— Kemi shkuar mirë e të mos hapim sherrtani në pleqëri. Ç'janë këto budallallëqe?!

— Dëgjo, bre, një herë.

— O e lini këtë fjalë, o nuk ju them as mirse na erdhët.

Dhe kështu mbaroi kjo bisedë. S'kishte top

ta tundte Veliun. Edhe Sadiku ja preu të birit:

— Hiq mendjen nga ajo. Sikur u sosën çupat. Të thashë që s'bëhen këto punë. Na hape avaze kot së koti. Në s'të rrihet dot pa nuse, më thuaj e të të gjejmë atje ku i gjejnë të tjerët.

Ganiu ishte nxehur:

— Epo unë do ta marr atë sikur të bëhet kiameti.

— Ore, u çmende ti, a si e ke hallin?

— Këtu do të jemi.

— Shiko, djalë... Mos na bësh ndonjë të pabërë, se s'më mban kurrizi mua... S'ta fus në shtëpi unë... Dëgjove?! Dëgjova thuaj. As atë e as ty. Thyejeni qafën ku të doni.

Si Sanija, si Ganiu, ishin bërë pikë e vrer. Ajo e kishte humbur fare. Asnjëri nuk thoshte hapur se e dashuronte tjetrin e t'i vinin gjoksin furtunës.

Vali ja tha të gjitha Fadilit dhe ai shkoi te Veliu t'i mbushte mendjen që mos e pengonte të bijën për të vajtur në provat e grupit artistik. Po Veliu s'tundej.

— Punë që s'bëhet, Fadil. Të kam xhan, të kam shpirt, po këtë s'ta bëj dot.

— O kjo, o i biri i Sadikut atje... Ndryshe s'e kapërcen prakun. E, po më ra në vesh se i ka parë njeri tok, më paç në qafë pastaj.

Fadili u mundua gjatë, po s'ja mbushi dot mendjen. Që të hiqnin Ganiu nga grupi e të mbanin Sanijen... kjo s'u zgjidhte punë. Disa vajza ju lutën Valit që të shkonte një natë në shtëpinë e xha Veliut e të bënte ashtu si bëri me xha Beqon. Ato kishin besim të madh te ajo. Kurse Vali s'kishte asnjë shpresë. Megjithatë shkoi, më tepër

për të mos ua prishur shoqeve. Po, pa i thënë ende «mirëse vjen», Veliu i vuri sinorin.

— Dëgjo ti, vullnetare. Tani të njohim e na njeh e le të flasim troç. Në ke ardhur me ato mend që shkove te Beqiri, as mos u lodh të hapësh gojën. Për këto punë unë s'dua lugë të më trazojë çorbën («Prapë çorba», — mendoj Vali). Në ke ardhur mysafire, bujrum si në shtëpinë tënde.

Valit nuk i erdhi mirë, jo vetëm sepse e pa që s'kishte për të nxjerrë gjë, po sidomos sepse ju duk sikur në gjithë fshatin ajo kishte lënë opinionin e keq të lugës që trazon çorbat e botës. Po nuk e bëri veten. Ndenji pak dhe u ngrit të ikte, po Veliu s'e la të largohej pa ngrënë darkën.

Kur u kthye në dhomën e saj, Vali shkroi në ditar:

«... Kësaj here do ta kemi shumë të vështirë. Jo vetëm se Veliu është nga më fanatikët e fshatit, po dhe problemi është shumë delikat. Sanija dhe Ganiu po tregohen shumë të ngathët. Edhe Fadili, me sa po shoh, s'e ka aq me zemër këtë punë. Ai më shumë ka hallin e grupit që po dëmtohet nga mungesa e Sanijes.

Do të kemi shumë punë.»

Megjithëse Sanija e Ganiu mundoheshin t'i mbanin fshehur shqetësimet e tyre, fjala kaloi vesh më vesh. Vetëm Veliu nuk e dinte që e bija ishte mpleksur me djalin e Sadikut. Duke ja njohur kokën, njerëzit ndruheshin t'ja thoshin troç. Po, sidoqoftë, shpejt edhe ai do ta merrte vesh të vërtetën. Sanija i trembej shumë atij çasti. Edhe Vali ishte mjaft e shqetësuar. Veliu do të shpërthente, ndaj s'duhej pritur gjatë. Dukej qartë se retë ishin

ngarkuar rëndë, ndaj duheshin marrë masat për t'ju shmangur dëmeve të shtrëngatës.

— Ç'të bëjmë?

— Duhet t'i ndihmojmë.

— Si?

—

— Unë them të bëjmë mbledhjen e rinisë.

— Hë!!!

— A thua të nxjerrim gjë.

— Po s'ngritëm gjithë rininë, gjithë fshatin, s'i ndihmojmë dot. Nuk është puna vetëm te Veliu... Shumica e pleqve ashtu mendojnë.

— Ama dhe ky Ganiu, qull fare.

— Nejse...

— Ç'nejse! Ta merrte e ta shpinte në shtëpi...

— S'ka ndonjë zor të madh të bësh këtë, po ne s'na intereson të hapim sherre... S'na duhen fitore si të Piros. Ke dëgjuar për Piron?

— Atë që vranë me tullë?

— Po.

— Kështu ta lëmë. Bëjmë mbledhjen e organizatës. Të bisedojmë një herë edhe me Fadilin.

Kështu e përfunduan bisedën atë mëngjez qershori Vali, Bujari e Demiri duke ikur për në punë. Në drekë u bë mbledhja e byrosë së rinisë. Dy prej anëtarëve të saj në fillim nuk ishin dakord për mbledhjen.

— S'bëhen këto gjëra me mbledhje. Veliu i tregoi rrugën Fadilit e jo neve?!

— Është e kotë... Mbledhja s'ka për t'u bërë. Vajzat s'kanë për të shkelur... Kot...

Megjithatë u vendos që mbledhja të bëhej. Edhe Fadili e përkrahu këtë mendim, ndonëse një

çikë si pa qejf, dhe e porositi Bujarin të kishin kujdes, se «këto janë gjëra me zarar». Bujari shkoi vetë, brigadë më brigadë, të lajmëronte, pastaj hiqte njërin mënjanë dhe i thoshte të sqaronte të tjerët për se do të bëhej mbledhja.

Megjithëse e kishin lënë për më gjashtë, Bujari, Demiri e Vali ishin mbledhur kokë më kokë aty para vatrës së kulturës pothuaj që në pesë e gjysmë. Vali s'para ishte e qetë. Kujtonte dialogun që pati me Fadilin.

«— Kini kujdes në këtë mbledhjen e sotme. Unë do të vija vetë, po kemi mbledhjen e byrosë e do të vonohemi shumë. Është një mbledhje që s'mund ta shtyjmë dot. Ju kur do të filloni?

— Më gjashtë.

— Si, në gjashtë?

— Pse?

— Po provat e estradës?

— I lamë sonte.

— O... o... Kjo na qenka punë e bukur. Ç'është kjo? Ti e di që e kemi litarin në fyt. Edhe dy javë na mbetën.

— Do të punojmë nesër më shumë.

— Të bëhen provat, pastaj të fillojë mbledhja.

— Mbledhja do të shkojë gjatë. Pastaj kush e ka mëndjen te provat?

— Shumë keq.

— E ke gabim, shoku Fadil.

— Posi, posi... Mua më dhemb akoma kurrizi nga druri që hëngra në komitet të partisë për grupin... Ta thashë më duket... E kemi detyrë partie.

— Po mbledhjes si t'ja bënim?

- Ta shtynit.
- Nuk pret puna.
- Ata kanë pritur një vit të tërë e s'pritkan dot dy javë?!..
- Nuk është kështu.
- Mo, po e kupton ti se na e kanë vënë detyrë partie të marrim pjesë në festival?
- Do të marrim pjesë.
- Si e kemi zënë, posi, do të marrim! Në mos na e shpënçi dy ditë këtë mbedhje.
- Po u desh edhe tri do të vejë.
- Ma prishe qejfin.
- Qejfi shkon e vjen, shoku Fadil, puna të mos priset.
- Epo kur e ditke këtë, pse prish punë?
- Për mbledhjen vendosi byroja e rinisë. Unë s'kam asnjë të drejtë. Dhe bënë shumë mirë.
- Shumë keq.
- Më fal që po ta them, shoku Fadil, po më duket se punë po prishni ju e jo rinia. Sikur vetëm estrada na qenka...
- Gjërat kanë radhë, moj çupë... Ke qenë në mulli ti?
- Epo revolucionin nuk është mulli.
- Pse, paskam arritur të ma thuash edhe këtë?
- S'e kam aty. Në është puna e estradës detyrë partie një herë, kjo është dhjetë herë... Nga kjo anë fshati është shumë prapa...
- Atë fjalë mos e thuaj, se ne ishim të parët pas Gjashtë Shkurtit që prishëm...
- E di.
- Na mori dhe gazeta.
- Po Gjashtë Shkurti s'thoshte vetëm të pri-

shësh, po edhe të ndërtosh. E nga kjo anë kooperativa jonë nuk është gjëkundi. Se s'kuptohej ç'do të thotë të luftosh për krijimin e familjes së re, për të mbrojtur dashurinë. Nuk lëftojnë një-rëzit.

— Kush?

— Kush?! Të gjithë. Organizata e partisë në radhë të parë... Unë s'jam komuniste, po atë që mendoj, e them... Edhe ju si sekretar. Pse s'i mori në mbrojtje organizata e partisë Sanijen e Ganiun?

— Kështu, ë?

— Kështu, posi!?

..... »
— Ç'mendohesh? — e shkundi nga kujtimet Valin zëri i Bujarit. — Apo edhe ti po e humbet besimin te mbledhja.

— Jo... Mendoja tjetër gjë. Bëra fjalë me Fadilin.

— Për mbledhjen?

— Po. U acarua. Megjithatë, më duket se i thashë të vërtetën.

— Po vijnë, — tha Demiri. Ata kthyen kokën dhe panë një grumbull djemsh që po afroreshin duke diskutuar.

— Unë e kam hallin te vajzat, — tha Bujari.

— Do të vijnë. — Zëri i Valit ishte i vendosur. Në orën gjashtë pa dhjetë salla ishte mbushur.

— Në asnjë mbledhje të organizatës s'kam parë kaq shumë njerëz, — tha Vali.

Bujari kontrolloi sallën me sy.

— Më duket se s'mungon njeri.

— Mua s'më besohej, — tha Demiri.

— Për këto gjëra të gjithë ndjejnë e mendojnë.

Të gjithë kanë ç'të thonë. Është një nga problemet më të rëndësishme të rinisë.

Vali vuri re se Bujari dukej i shqetësuar.

— S'je i qetë më duket?

— Se si më vjen. Kam drejtuar kaq mbedhje, po kjo e sotmja se si më duket. Ne s'kemi diskutuar kurrë për gjëra të tilla. Të gjithë sot më duken si ndryshe. Ne bëmë luftë gjersa përziem në mbledhje djem e vajza, se rrinin të ndarë. Sot përsëri janë veçuar.

Vali i kishte ngulur sytë sallës. Vajzat ishin ulur në stolat e krahut të majtë. Dukeshin të ndrojtura dhe prisnin si me frikë fillimin e mbledhjes, sikur do të dëgjonin ndonjë fjalë të turpshme. Çu-çurisnin vesh më vesh dhe ulnin kokat. Po në sytë e tyre Vali shihte dallgë. Djemtë ishin më të çelur, po në përgjithësi të matur e seriozë. Disave u kishte rënë një hije e tepruar burrërie. Ndonjë e kishte rrëmbyer padurimi për të filluar mbledhja.

— Kanë ardhur të gjithë. Ç'presim akoma?

— Fillojmë.

— Fillojmë, — tha Demiri.

Bujari doli në ballë të sallës. Vali u fut midis vajzave, kurse Demiri zuri vend midis djemve, paralelisht me të.

— Epo... fillojmë, — tha Bujari. — Të gjithë e dini pse jemi mbledhur. S'do të mbajmë as raport, as do të lexojmë leksione. Le të flasim ashtu si na e pret. Të flasim drejt.

— Për se? — u drejtua një zë provokues, që e ngacmoi më keq valën e pëshpëritjeve. Vali ktheu kokën dhe pa Selimin, Qukanjozin fytyrëhequr, me mollëza të kërcyera e me një mjekër

të mprehtë, që i dilte pak përpara, sidomos kur qeshte.

Bujarit s'i erdhi mirë nga ngacmimi i Selimit, po, për të mos lejuar që mbledhja të fillonte me rrëmujë, ju përgjegj:

— Po ju e dini, që Ganiu me Sanijen... dashurohen (vajzat kafshuan buzët, ulën kokat. Djemtë luajtën vendit. Ganiu e Sanija u skuqën, sikur t'u kishte hequr lëkurën e fytyrës. Qukanjozi kishte çaplyer sytë dhe buzëqeshte). Po zakonet prapanike s'i lënë të fejohen. Për këtë jemi mbledhur. Ç'duhet të bëjmë ne?

— E ç'duhet të bëjmë?

— Të diskutojmë.

Pëshpëritje. Dhe përsëri Qukanjozi:

— Kësaj i them mbledhje unë dhe i ra me brryl shokut që kishte në krah. Ai mblodhi buzët dhe rrudhi vetullat i pakënaqur.

Heshtje! Një heshtje e gjatë, e tendosur, që kërciste vende-vende si një mushama, që e tërheqin në të gjitha anët me forcë e kërcet, derisa çahet. Nën të lëvrinin qindra ndjenja, qindra mendime. Vetëm vështrimi i Qukanjozit voziste pa timon në hapësirën e zbrazët përmbi heshtjen. Demiri pa Valin dhe luajti paksa kokën mendueshëm. Ajo ju përgjegj me buzëqeshje.

— Kush e do fjalën?

Fijet e tendosura të heshtjes vazhdojnë të kërcasin herë aty e herë këtu.

— Si e kuptojmë ne dashurinë?

Ujërat po turbulloheshin. Djemtë lëviznin, vajzat strukeshin.

— Do të flisni, apo jo? Të gjithë kemi ç'të themi. — Zëri i Bujarit po acarohet.

— Pse s'ja nis ti, — ja pat dikush.

— Hajde, jepi, — pasoi Qukanjozi.

— Edhe unë do të flas... po... — Bujari u zu ngushtë dhe po matej të ngrihej.

— Po them unë nja dy fjalë, — tha Demiri dhe u ngrit.

— Kjo është mbledhje. Ç'ka për të vajtur! — dhe Qukanjozi fërkoj pëllëmbët gjithë qejf.

— Si s'vure mend një herë ti, bre!? Gjithmonë një avaz. Dhe mos harro se ke një vërejtje. Në vend që të vraç mendjen e të diskutosh, zgërdhihesh. — Demiri e nxori dufin e parë që i kishte mbledhur heshtja. Selimi u krekos.

— Ngadalë, shoku Demir, e mos merr kaq nxituar, se do harrosh ato që kishe për të thënë...

— Dhe qeshi përsëri, po e qeshura e tij s'ngjiti gjëkund e, si u suall një herë qark sallës si fjo-llë tymi, humbi përsëri midis buzëve të tij.

— Sado të harrojmë, kemi për të thënë sa të duash. S'jemi gjëkund. — Toni i tij i prerë i platiti pëshpëritjet dhe ndolli shikimet e të gjithëve. — Posi... Ganiut e Sanijes i lumtë! Ata u ngritën kundër zakoneve të vjetra.

— Kundër zakoneve u ngritëm të gjithë. Apo e harrove kuvendin? — e ndërpreu dikush i prekur në sedër.

— Të gjithë u ngritëm, po këta e futën kazmën një çikë si më thellë.

Dikush qeshi dhe i pëshpëriti një tjetri në vesh. Edhe ai qeshi duke i marrë me kuptim të

keq fjalët e Demirit. Qukanjozi ziente përbrenda,
po s'ja mbante të shpërthente.

— Lërimi qyfyret tani, — tërhoqi vërejtjen
Bujari.

Demiri s'pritti të vendosej qetësia.

— Duhet të mundohemi t'i mbushim mendjen.
xha Veliut.

Dikush s'u përmbajt.

— E kujt, se! Xha Veliut! Pyet shumë ai!
S'bëhet.

— S'do mend që s'bëhet po s'mbushëm një
herë kokën tonë. — Demiri kishte për të folur
gjatë, po as vetë s'e kuptoi pse u ul.

Pëshpëritje. Diskutime vesh më vesh.

— Kush e do fjalën?

— Le të ngrihen e të flasin vetë një herë...
T'i dëgjojmë me veshët tonë. Ku ka arritur puna.
Qysh e tek, — propozoi dikush. Pasant shtatë a
tetë zëra aprovues. Sanijes sa s'i ra pika. Ganiu
ndjeu t'i qe tharë goja e t'i digjnin buzët.

— Po s'i dëgjuam këta, ç'të themi ne?

Shikimet, si një tufë rrezesh përvëluese, ka-
lonin sa mbi Sanijen mbi Ganiun. Ajo po djersinte.
Ai lagte buzët. Më në fund Ganiu u çua. Pëshpë-
ritjet u prenë njëherësh dhe humbën diku, poshtë
stolave. Midis djemve dhe vajzave këmbëshin
shikime telegrafike. Ai u përtyp një çast, u kapërdi
disa herë si për t'u siguruar se s'e kishte fytin të
zënë dhe, pa i ngritur sytë nga toka, nisi të nxje-
rre një zë të dobët e të pasigurtë.

— Ç'të them unë!? Ju... i dini të gjitha.

— Gjer ku e kini shpënë punën?

— S'do i ati.

— E di ai që ju kini... Jeni...

— Thuaje, mor copë... E di që dashuroheni...
Ganiut i dogjën sytë.

— Jo.

Të tjerët fillojnë të shkëputen një e nga një
prej rrjetës së heshtjes.

— Pse nuk ja thoni copë?

— Ç'flet, mo, je në vete?

— Ai bën kiametin.

— Ka patur burra më të mirë se ai e s'kanë
guxuar të bëjnë gjë. Pak kemi lexuar e dëgjuar?

— Pse s'e rrëmben ti, Gani?

— Mirë thotë, merre shpjere në shtëpi.

— Apo ke frikë?

— Jo.

— Lëri ato... S'ta mban.

— Nuk e bëj dot.

— Epo?..

— S'ka dashuri këtu...

— E do, apo jo? — pyeti dikush me zë të
plotë. Fjalët e tij të guximshme mbollën habi në
sallë.

Ganiu nuk u përgjegj. Zëri i plotë u dëgjua
përsëri. Këtë herë i drejtohej Bujarit:

— Epo, ç'na mblidhni kot këtu? Apo të bëjmë
krushqi në organizatë.

— Dale një herë, dale.

— Po s'e shikon?! Këtij s'ja mban të thotë
këtu e jo të luftojë me xha Veliun. Ai ha dhjetë
si Ganiu. Fundja, i zoti e nxjerr gomarin nga
balta.

Ganiu mori hov papritur, si një maqinë që
niset drejt e në marsh të katërt.

— Ama ç'ja fut kot edhe ti! Po mos qe ashtu, s'vinim këtu. Apo doni hallatkë?

— Po pse bërtet?

— Po çfarë! E dua, hə... Këtë deshët të dëgjonit? E morët vesh tani? Ta them edhe një herë? E dua dhe më do. — Dhe u ul duke e prerë fjalën njëherësh. Përsëri ai i ngjau maqinës që fre-non në marsh të katërt.

— Dakord. E morëm vesh. Po ti, Sanije? — pyeti jo pa qëllim Qukanjozi. Ganiu kërcëu:

— Shiko, mbaj gojën ti, dëgjove?

— Ti mbaj gojën, — u krekos tjetri. — Jemi në mbledhje këtu. Unë kam të drejtë të pyes.

Dikush e hoqi për cepit të xhakëtës dhe Qukanjozi u ul. Po u revoltua:

— Po s'e tha me gojën e saj, unë s'e besoj.

Disa u ankuan. Njëri propozoi ta nxirrnin jashtë. Megjithatë kishte edhe të tjerë që prisnin të dëgjonin Sanijen. Jo aq për të vërtetuar fjalët e Ganiut, se sa për të shuar atë kureshtje të madhe se si mund të thotë një vajzë aty, midis 40 vetëve, «e dua».

Vali diç po i thoshte Sanijes.

— Vazhdojmë, — tha Bujari.

Heshtje. Pritje. Shikime mbi Sanijen.

— Kush e do fjalën?

— Hë, moj, thuaj dhe ti. U pa kjo punë, — shkrepiti Ganiu.

— Po... — tha Sanija si pa vetëdije dhe i mbet goja hapur.

Salla u mbush me frymë. Njerëzit lëviznin. Disa nga vajzat shikonin të trembura njëra tjetrën,

sikur fjala e Sanijes ishte një dorë e çuditshme, që po zgjatej drejt tyre me një damkë turpi.

Zemra kishte filluar t'u rrihte fort. Kristina ishte hutuar fare. S'e përqëndronte askund shikimin, s'i kthjellonte dot mendimet. Kur shikonte Valin, ajo i buzëqeshte dhe i bënte ca shenja, që s'i kuptonte dhe e hutonin më tepër.

— Vazhdojmë.

— Unë e thashë, o vëlla, ta marrë Ganiu e ta shpjerë në shtëpi. Që sonte. Ca nga ne të shkojmë e t'i themi Veliut. T'i dalim borxhit, — tha prapë ai që kishte propozuar këtë zgjidhje.

— S'jam dakord! — u ngrit Bardhi.— Unë jam me Demirin. Të mos e marrim rrëmbyer. T'ja mbushim një herë mendjen Veliut, pastaj...

— Epo prit gomar të mbijë bar. Për t'u fejuar kanë këta... Veç kur të marrim vesh ndonjë dite që xha Veliu e dërgoi te burri Sanijen.

— Po ta lëmë ne.

— Posi, posi... Ja, le të flasim dhe të tjerët.

— Hë, moj Vali, na thuaj ti një fjalë?

Ai që foli sikur ta dinte që ajo po bëhej gati të ngrihej. Vali i hodhi sytë sallës. E ndjente që nuk do ta kishte të lehtë të diskutonte. Diku, nëpër sallë lëviznin, si urithi nën dhe, ngacmime, provokime, thumba, që s'do kurseheshin po të fliste ashtu si kishte menduar ajo. Megjithatë nuk u ndruajt. Për herë të parë gjatë gjithë mbledhjes sytë e vajzave u ngritën të gjithë e shikimet e tyre po merrnin një farë përqëndrimi. Kristina mendohej të merrte me mend se ç'mund të thoshte Vali. Demiri mezi popriste që të fillonte. Seç kishte ca emocione, ca turbullira të pakuptueshme, që ju duk se e mbytn

kur sytë e tyre u takuan. Qukanjozi i kishte bërë apel vëmendjes së tij të çoroditur dhe me dorën nën mjekër po priste gjithë ankth. Valit ju ngatërruan mendimet. U përpoq të përçëndrohej e të kapte fillin që kishte përgatitur, po ishte e pamundur. Ashtu ulur, ajo s'i kishte ndjerë sa duhet emocionet e sallës e nganjëherë ishte gati ta merrte fjalën kur ndonjërit prej atyre që fliste, i lidhej gjuha e s'thoshte dot dy fjalë. Po tani që qëndronte më këmbë, i dukej vetja si midis grykash ku të rrahin rryma të ndryshme erërash. Shikimet në sallë bënin korent. Valit i shkuan sytë te flamuri i kuq dhe i mëndafshët, që ishte vendosur mbi murin përballë: «Organizatës së rinisë së Malasit, dalluar në hapjen e tokave të reja. Komiteti i rinisë së rrethit», — ishte shkruar mbi të me penjë të verdhë. Dhe aty për aty Vali filloi nga diskutimi me flamurin, pa e menduar gjatë në do t'i dilte dot në krye asaj që mendonte.

— Me këtë flamur ne mburremi.

— Me të drejtë. Se jo, a? E fituam me punë. Mos na e dhanë për shpirt të babagjyshit? — mbrojti me sedër krenarinë e organizatës dikush.

— Edhe gazetari që erdhi, përsëri shkroi për të. Dhe mirë bëri.

— Shojja vullnetare! Lëre flamurin dhe bjeri drejt, — s'u përmbajt Qukanjozi.

— Aty do të dal... Po s'jemi mbledhur vetëm për Sanijen e Ganiun.

— Si?!

— Prit, or ti se paska të tjerë. Hajd'or hajde... Po ne paskemi qënë, qorra bre... Kërcitka dashuria në fshat e ne s'dim gjë fare...

— Ç'interesant njeri që qenke! — ju suall Vali

ashpër Qukanjozit. — Vetëm të ngatërrosh e të turbullosh di. Ka faj organizata që s'të bën për ujë të ftohtë. Rrëmujaxhi.

— Shiko, mbaj gojën. Ashtu!

— Gojën ta mbash ti, që po na prish mbledhjen.

Qukanjozit ju sulën breshëri zërash nga të gjitha anët.

— Po ç'bëra unë? Ajo vetë tha... «S'jemi mbledhur vetëm për Sanijen e Ganiun».

— Ashtu është, — i rëndoi zërit Vali.

— Ja, e shikoni?

— Po jo ashtu si të shkon mendja ty. Prandaj e përmenda flamurin. Se nëpër mbledhje s'pushojmë ne... «jemi revolucionarë ... jemi kështu e jemi ashtu...» Me fjalë...

U ngritën të tjerë, djem e vajza, dhe i dhanë të drejtë Valit.

— S'e shikoni ç'thotë! S'është bërë gjë prej gjëje! — qëndronte në të vetën Agroni, një djalë që vinte pak ziosh, me sedër, që s'duronte t'ja prekje as me pendë, dhe shumë i ngutur në të folur.

— Unë s'thashë që s'është bërë gjë, shok i dashur. Ti më kuptove keq. Ca gjëra janë harruar fare. Po janë ca gjëra të mëdha, — u mundua ta sqaronte Vali.

— Kush tha?

— Ju.

— Ne?!

— Hamdiu.

— Unë?!

— Belka.

— Jo, moj Vali.

— Edhe të tjerë.

— Prit, moj motër. Prit një herë. Mos e lësho fjalën ashtu. Ku më ke dëgjuar mua ti të të them s'punon organizata? E marrin me gjithë mend këta.

— Po ti punon?

— Si të gjithë.

— Lëri normat, se e dimë që s'ta del njeri; për të tjerat.

— Edhe për të tjerat punoj,— tha Hamdiu.

— Me sa kam dëgjuar, ti e ke prishur fejesën pas Gjashtë Shkurtit.

— I pari.

— Dhe u fejove përsëri.

— Po.

— Dhe bërë një fejesë si ajo që prishe.

— Jo. S'është e vërtetë. Unë jam fejuar me pëlqimin tim.

— E di. Babai porositi mblesin. Mblesi doli për kësmet e të gjeti një nuse. Pastaj të pyetën ty. dhe ti the «po». Ky ishte pëlqimi yt.

— Të lutem shumë, mua mos më merr nëpër gojë. Unë jam fejuar vetë... Pa para, pa prikë.

— Domethënë pa dashuri, po me pëlqim, — gjeti shteg Qukanjozi.

— S'thashë me dashuri, po me pëlqim. Hapi veshët. Furdia tërë me dashuri s'do martohen, de.

— Ashtu është, — tha Vali. — Po kjo nuk është mblesëri si ajo e para. Kjo është, si të thuash, një ndërmjetësi... Për të ndihmuar të rinjtë që të njihen... Kurse ti s'e njuh fare të fejuarën tënde... S'ke këmbyer një fjalë... Ty të ka fejuar babai... Edhe Belka kështu si ti. Kur e kishin fejuar që kur ishte fëmijë, s'e kishin pyetur. Tani e pyetën. Jo e pyetën, po e njoftuan: «Do të fejojmë»... «Jo»... I ati i tha: «Të kërkoi filani për të birin e filanit. Unë e dha-

shë fjalën. I pimë kafetë.». Ajo s'foli. Pastaj e shpunë në lokalitet, ku bënë celebrimin. Asnjë fjalë s'këmbeu me të fejuarin. As dorën nuk i dha. As fytyrën nuk ja mban mend. Pa shko pyet të jatin se?! «Dha pëlqimin vetë vajza... E deshi dhe u fejua...» Këto janë të tmerrshme.

— Më duket se po bëjmë një kuvend tjetër si ai i Gjashtë Shkurtit, — tha dikush.

— Këto gjera s'bëhen vetëm me kuvende. T'i themi partisë: «Boto përditë nga një dekument». T'i themi shokut Enver: «Mbaj përditë nga një fjallim që të bëjmë nga një kuvend e t'i zgjidhim gjithë problemet... Mezi lindi një dashuri në fshat dhe s'po dimë ta mbrojmë...»

Demiri ishte rrëmbyer i tëri nga fjalët e Valit. Vajzat qenë gjallëruar.

— Si të mos pranojë rinia që të bëhen fejesa brenda fshatit? Hë mor shokë?! Flisni, moj shoqe. Heshtje.

— Hë pra, është apo s'është kanun ky? Kanuni s'ka brirë.

— Ke të drejtë.

Aprovime.

— E ç'mendon ti, Vali, të bëjmë?

— Të punojnë me njerëzit... Me veten tonë në radhë të parë... Të mos lejojmë të bëhen fejesa si të Belkës e të Handiut.

— Me një fjalë, të mos ketë mblesëri.

— Do të ketë edhe mblesëri hëpërhë, po një tjetër lloj mblesërie. Ndërmjetësi...

— Unë them të mos ketë fare. T'i japim fund, — ngriti zërin, si gjithmonë, i papërmbajtur Agroni.

— Është shpejt akoma.

— Ta hedhim në votë... Kush është për mble-
sëri e kush për dashuri. Unë votoj për dashurinë,
— dhe Qukanjozi ngriti dorën.

Disa qeshën.

— Të paralajmëroj për herë të fundit, —
i foli ashpër Bujari.

U suall nga u suall fjala dhe ra prapë te Sa-
nija dhe te Ganiu.

— Ç'do bëjmë?

— Ç'do bëjnë këta të dy një herë?

— Akoma s'e merr vesh ti? Do martohemi. —
Fjalët e Ganiut qenë të papritura dhe për herë të
parë salla u mbush me të qeshurat e të gjithëve.

— Epo gjer të bësh bukën e re, do të hash një
killë dhe... Mirë e kanë thënë pleqtë... Duhet punë,
— tha Demiri.

— Të marrim vendim.

— Ti me vendim i do të gjitha.

Agroni kërcëu përsëri.

— More, ç'janë këto vendime. Siç jemi këtu,
shkojmë në shtëpi të Ganiut e bëjmë dasmën. Kështu
e kanë këto punë.

— Jo.

— Edhe unë jo, them.

— Unë jam me Valin, të mos rrëmbehemi.

— Të punojmë me prindërit, — tha Demiri.

— S'kemi gjë në torbë.

— S'kemi, po do fusim.

— Prisni, bre, një herë... E ç'do bëjmë me xha
Veliun?

— Jo vetëm me xha Veliun, po me të gjithë
pleqtë.

— Me pleqtë ca më shumë, po jo vetëm me
pleqtë... Edhe me të rinjtë. Ka edhe këtu...

— Kush?
— Se mos një...
— Kush?
— Skënderi...
— Unë?.. Unë s'kam folur fare.
— Të dëgjova vetë kur i the Cenit... «Ganiu s'ka për ta marrë kurrë Sanijen».

.....
— E the apo s'e the?... Apo të ka dërguar xha Veliu ta ruash Sanijen se mos e rrëmbejnë.

— Ti e ke çupë xhaxhai... Në vend që ta ndihmosh...

— Ahu... u!

Tani flisnin pothuaj të gjithë.

— T'i vëmë fletë-rrufe Veliut.

— Pesë me hiç është.

Dhe u vendos që puna e Sanijes dhe e Ganiut të zgjidhej pa sherr e shamatë.

— Kështu! — tha Bujari kur po mbyllte mbledhjen. — Të punojmë të gjithë. Të luftojmë nëpër shtëpitë tona... Edhe me të tjerët. Po s'bëmë këtë, s'ja dalim dot me xha Veliun. Le që s'është puna vetëm te ai. Veç kjo gjë s'pret gjatë, prandaj duhet sulm.

— Të bëjmë edhe një kuvend.

— Atë ta shohim. Si të na shkojë puna.

— Kot s'më dëgjuat mua. Ganiu ta kishte marrë Sanijen që sonte. Pse kini frikë?

— Nuk kemi frikë, jo... Po kështu është më mirë. Ti je bari vetë. Si thua është më mirë... Ja, të hyri ujku në kope... Si është më mirë, t'i marrësh ujkut delen nga dhëmbët e ta lesh të ikë, apo ta vrasësh ujkun.

— Kush është ujku në këtë mes? Veliu?

— Jo, zakoni. E mbyllim tani?

— Unë kam një propozim, — tha Vali. — Të bëjmë një mbrëmje të vogël vallzimi... Jemi që jemi të mbledhur.

— Të lumtë goja, — thirri Demiri.

Miratuan dhe disa të tjerë. Vajzat, veç Gonxhes e Shpresës, nuk folën, po qejfi ua kishte.

Filluan të hiqeshin stolat e të viheshn anës mureve.

— S'e kemi as Bashkimin sonte.

— I bie unë fizarmonikës, — u hodh Shpendi.

— E dimë si i bie ti...

— Aq sa di...

Përsëri vajzat u ndanë, si në mbledhje.

Fizarmoniçisti filloi një valle. U ngritën pesë-gjashtë djem. Vali mori Gonxhen dhe Sanijen për dore dhe hynë në vargun e valltarëve. Pas tyre filluan të ngrihen edhe të tjerat. Pothuaj s'mbeti njeri pa hyrë në valle.

Pas valles nisi një tango e shtruar. Askush s'po ngrihej.

— Dhëndrri me nusen ta hapi, — thirri Vali.

— Mirë thotë... çohu, Gani.

Filluan ta ngacmonin. Ai kundërshtonte. Vali shkoi e kapi për dore dhe e shpuri te Sanija. E ngriti edhe atë. Skënderi i luajti kokën qortueshëm së kushërirës, po Sanija s'pati fuqi të kundërshtonte. «Dhëndrri» me «nusen» u bënë lulkuqë, u kapën të turpëruar, si dy të panjohur, dhe nisën të hedhin këmbët, që u dridheshin.

— Mos i lëmë vetëm, se s'ka lezet, — tha Vali. Demiri u nis drejt saj, po ajo s'e vuri re dhe shkoi te Qukanjozi.

- Shoku Selo!
- Shoku Selo!
- Çfarë? — u habit djali.
- Të kërcejmë.
- Me mua?!

— Kaq i turpshëm qenke! Ti në mbledhje...
Selimit ju zhdukën qukat në të kuqtë e fytyrës.

U ngrit i hutuar. Demiri mbeti në mes të sallës. Disa që e vunë re, qeshën. Atij i vinte zor të kthehej. U mat të merrte Gonxhen, po kujtoi fjalët që i kishin dalë ca kohë më parë, dhe s'ja mbajti. Ju drejtua Kristinës me frikë se mos nuk pranonte. Ajo u ngrit e turpëruar. U ngritën dhe dy djem të tjerë, njëri me motrën e tjetri me kushërirën. Vali seç bisedonte me zë të ulët me Selimin. Atij s'po i ikte të kuqtë e fytyrës. Demirin nisi ta brente një djenjë xhelozie. Po, kur sytë e tyre u takuan, ajo i buzëqeshi. Ai u mbush thellë me frymë.

Fizarmoniçisti e la tangon e mori një foks. Po s'ja mbante dot ritmin. Demiri, duke u munduar t'i përshtatej muzikës, e shkeli Kristinën.

— Më fal, se në këto të shpejtat s'para ja them.

Qukanjozi po e merrte veten dhe filloi ta rrotulloonte Valin me shpejtësi.

— Qenke i tmershëm ti?

— Kam mësuar në ushtri. Po kam kërcyer vetëm me djem.

Ganiu me Sanijen ranë në hall me foks. Filluan t'i shkëpusin duart e qullura nga djersa, po të tjerët:

- I hyre valles, nxirre gjer në fund...
- E qelbe, Gano.
- Po e le për gjysëm...

Po i mbeti fjala për gjysmë atij që po fliste. Dera u hap me forcë, sikur ta kish përplasur fur-tuna, dhe brenda hyri Veliu me sy të çakëritur. I pa një herë të gjithë, sikur do t'i përpinte, pastaj ju sul së bijës dhe e përfshiu për krahu:

— Zuskë! — dhe e tërhoqi.

Duke u munduar të mos rrëzohej, ajo i shtrëngoi dorën Ganiut. Edhe ai ja shtrëngoi dhe përnjëherësh i hipi në kokë që mos ja lëshonte. Të gjithë shtangën. Vajzat u trembën. Fizarmonika ju hap Shpendit në gjoks dhe lëshoi një tingull të lodhur.

Veliut s'ja kishte prerë mendja se mund ta pengonte njeri, të merrte të bijën dhe sa s'u çmend kur pa se e tërhoqi fort e s'bëri dot çap.

— Ej, xha Veli! — foli dikush.

Kaq u desh që rinia të shkundej nga hutimi. Shtatë-tetë djem u bënë gardh para derës. Bujari ju afrua plakut.

— S'bën kështu, xha Veli!

— Hiqmu... dhe atë çast pa se ku po mbahej e bija. I shkrepinë sytë

— Këto më bëke ti, hë? Zuskë! — dhe e tërhoqi me fort. Ajo u tremb dhe desh të shkëpuste dorën nga Ganiu, po ai nuk ja lëshoi. Plaku turfulloi dhe u mat të godiste të bijën, po Demiri ja mbërtheu krahun.

— Ç'bën kështu, xha Veli. Prit një herë.

— Fajin e kam unë... Unë e kam...

— Fajin e kanë këto, që s'më dëgjuan mua, — gjëmoi zëri i Agronit.

Plaku e pa vrëjtur atë që foli, pastaj i hungëroi Ganiut:

— Lëshoje.

Ai vazhdonte ta mbante.

Vali shkoi dhe ndau duart e dy të rinjëve.

— Kur të vdes unë, atëhere mund të qeshni ju me nderin tim... Po ti, hajvan? — i shfryu Skënderit. Ai uli kokën si fajtor.

—Baba!

— Hajde, bijë e babajt, hajde...— Në zërin e tij kishte një ironi të tmerrshme. Kristina u ngjeth nga frika.

Veliu e tërhoqi Sanijen drejt derës, po ndeshi në gardhin e të rinjve.

— Hapmëni rrugën.

— Prit një herë. Të bisedojmë.

— S'kam punë me horrat unë... Hapmëni rrugën.

— Ne jemi organizatë rinie e mbaj gojën kur të flaç... Dhe mos guxo ti bësh gjë Sanijes, se të piu e zeza.

— Tri orë mbledhje kemi bërë për ty.

— Tre vjet bëni në daçi, po hapmëni rrugën.

— Mor po ç't'i bëj këtij të humburit unë... Dhe këtyre që s'më dëgjuan, pa e shikoje ti... Të isha unë në vend të Ganiut, pa flisnim bashkë ne, — tha Agroni.

— Ikë, more, këput qafën.

— Po dëgjo, mor xha Veli... Prit një herë... Dëgjo,— mudohej ta zbuste Vali.

— Rri ti... Punët e tua janë këto... Na vure zjarrin...

— Kanunit ja ka vënë zjarrin partia, — tha Gonxhja.

— S'jam yt atë unë... Që e ha turpin me bukë ... Hapmëni derën ju them.

Si e panë që s'e shtronin dot për të biseduar, i lëshuan rrugën, po e këshilluan të kishte mendjen e mos ngrinte dorë mbi Sanijen, se...

Kështu u mbyll mbrëmja e vallzimit... Njerëzit të shqetësuar filluan të shpërndahen shtigjeve të errësirës. Bujari, Demiri, Vali dhe Kristina mbetën një çast në heshtje aty para derës

— Ka për ta rrahur, — tha Bujari.

— S'ja mban.

— Është kokëkrisur Veliu.

U nisën të katër drejt shtëpisë së vajzave.

— Duhet bërë diçka që sonte, — tha Demiri

— Çfarë mund të bëjmë?

— As unë s'e di, po diçka duhet

— Ti shkojmë në shtëpi.

— Kot. Ai është xhindosur.

— Jo vetëm ne, jo... Të marrim dhe Fadilin dhe

Reshatin.

— Është shumë vonë.

— Se mos po shkojmë, për vizitë?!

— E provojmë një herë.

— Do të vij dhe unë, — tha Vali.

— Rri ti, më mirë... Të kamarrë shumë inat.

— Do të vij.

— Mirë. Hajde përcjellim Kristinën dhe shko-

jmë nga Fadili.

— Ikni ju, se shkoj vetë unë.

— Të shpiem ne. Ja vajtëm.

— Jo, jo.

— Mos të thotë gjë mamaja, Krista?

— Çfarëdo që të thotë mamaja, s'është xha Ve-

liu. Sa i tmershëm m'u duk! Natën e mirë.

— Natën e mirë!

NJË LETËR ANONIME

Shqetësimet e mbledhjes së rinisë i shtrinë kra-hët vatër më vatër. Edhe organizata e partisë filloi të merrej më seriozisht me këtë problem, që kishte vluar e vluar përbrenda, derisa u hoq kapaku e shpërtheu.

Atë natë pas mbledhjes, Vali me të tjerët qëndruan te Veliu gjer afër mesit të natës. Dhanë e muarën, po ai qëndronte në të tijën e s'qe e mundur t'i mbushej mendja.

Të nesërmen për Valin filluan të dalin fjalë. Dikush vuri një fletë-rrufe në mes të fshatit, po disa të rinj, që e panë të parët, e hoqën, sepse ju duk krejt shpifje e, për më tepër ai që e kishte shkruar, s'kishte vënë emrin.

Komunistët dhe rinia po e bënë të tyren dhe Veliun s'kishte pozicion që ta mbronte nga zjarri i së resë. Megjithatë bënte një mbrojtje të vendosur, po të dëshpëruar. Një mbrojtje e tillë është shenjë fitoreje për kundërshtarin. Veliut disa ja thoshin copë atë që mendonin, disa i këpusnin ndonjë thumb, të tjerë i flisnin me heshtjen e tyre, me shikime, me buzëqeshje, të cilat ja kuptonte shumë mirë dhe i ndjente thellë, si plasje «dum-dumësh».

Revolta e tij po zbehej. I vinte plasje sidomos kur shikonte se edhe disa nga pleqtë po merrnin anën e rinisë. Po bëhej i rëndë e i heshtur si një gur, po shpresë s'jepte. Pas një jave mezi mundën ta tërhiqnin përsëri Sanijen në grupin artistik. Kur ajo po dilte nga shtëpia me Fadilin, i ati i lëshoi nga pas një zë nga thellësitë e fundme të mushkërive.

— E, në do bësh atë që ke ndërmend, s'je më ime bijë!

Sanija u drodh, kurse Fadili buzëqeshi si për t'i premtuar asaj se çdo gjë do të rregullohej.

Po nuk mund ta shëronte dot buzëqeshja e tij. Zëri i të jatit ishte një klithje e dhimbshme.

Të nesërmen e asaj dite ndodhi diçka e papritur. Në fshat erdhi instruktori i komitetit të partisë së rrethit. Kërkoj Fadilin në fshat, po i thanë se mund ta gjente nga brigadat. Dhe ai u nis. Dita po thyhej e pas ndonjë ore kooperativistët duhej të linin punën. Brigada e tretë po merrej me mbushjen e patateve.

— Puna e mbarë!

— Mbarë paç e të lumshin këmbët.

— Sivjet paski patate të mira, jo haka... Jo si ato të vjetmet...

— Edhe ne s'ja kemi kursyer punën.

— Edhe misri s'dukej keq.

— Bereqavers... Mirë... Na ka ndihmuar edhe koha.

— Edhe krahët na kanë ndihmuar...

—

— Si shumë na u vonove këtë radhë, o Shpëtim.

— Isha me provime në Shkollën e Partisë
ndonjë muaj.

— Po shiko, se na ke dhënë llafin të vish ta
bësh këtu punën fizike sivjet... Mos harrosh?

— Po shatën a ma ke bërë gati, xha Shahin?

— Shatën, the? Të kam bërë një shatë, që s'e
ka kush, s'e ka. Një pëllëmbë bisht i kam vënë,
që t'i rrish tokës afër e t'i marrësh erë... Që mos
harrosh se je bujk, de...

Qeshën të gjithë. Pastaj ata vazhduan punën,
po, duke i rënë shatës, s'e këputnin fjalën. Vali
atë ditë kishte shkuar në qytet me një nga mësuesit
për të marrë libra për bibliotekën e vatrës së kul-
turës. Shpëtimin nuk i erdhi mirë kur e mori vesh.

— Po Fadili s'qenka këtej?

Dikush i hodhi kutinë e duhanit.

— Dridhe një të fortë, o Shpëtim...

— Fadili!? Ja, sikur ka ardhur.

Dhe Fadili vërtet s'vonoi të vinte. U përshën-
detën si miq të vjetër dhe u ulën shesh mbi një
mezhdë të qethur rishtas.

— Si shkojnë punët? — pyeti Shpëtimi.

— Po... jo keq... Do dalim mirë sivjet.

— Po, me të tjerat?

Tjetri s'theu kokën.

— Vali si i ka hallet?!

— Shpuzë... Çapajeve...

— Po fshati ç'thotë?! E duan, apo jo?

— Si s'e duan? Edhe llafe ka patur, po të
paktë janë ata që kanë folur. Vajzat e gratë një
herë...

Shpëtimi hapi në heshtje çantën ushtarake që
mbante në sup, dhe nxori një fletë fletoreje të pa-
losur kátërsh. Ja zgjati Fadilit.

— Ç'është?

— Lexoje.

Fadili e lexoi me një frymë.

— Kush e ka dërguar?

— S'ka shënuar emër... Po... si të duket?

— Gënjen. Është punë inati... Shpifje.

— Për të gjitha?

— Për të gjitha. — Fadili e shpalosi përsëri letrën dhe lexoi me zë:

«...Kjo vullnetarja që ka ardhur këtu, po na prish çupat. Do t'i bëjë si vetja, që të hargalisen me djemtë e fshatit...» Ç'është ky maskara që e ka shkruar?! «Ajo do që të na nxjerrë gënjeshtarë përpara partisë. Thotë se ne s'kemi bërë asgjë pas Gjashtë Shkurtit e dashka të na bëjë një kuvend tjetër. Bëri mbledhjen e rinisë e u tha djemve e çupave të... të mos pyesin më as për prind e as për njeri... Ç'na i sillni këta njerëz për të na prishur fshatin».

Fadilit i rrahën tëmthata fort.

— Veç mos e marrça vesh kush e ka shkruar! Qindin kam për t'i punuar.

— Mos u nxeh. Mbase Valit i ka munguar takti... Mbase e ka tepruar.

— Jo.

— Kaq i sigurtë je?

— Kur do bëhej mbledhja e rinisë, edhe mua m'u duk se e teproi. Bëmë edhe fjalë. — Dhe Fadili filloi t'i shpjegojë fije e për pe si qëndronte puna në fshat me Sanijen, Ganiun, xha Velinë e të tjerë. Po nuk kishte durim.

— Ne po luftojmë e po ja dalim... Po këtë letër kush e ka bërë? Të tëra gënjeshtër janë...

Të tëra, për ideal! Po do ta gjejmë... Do ta gjejmë e do ta shkundim...

— Sidoqoftë s'duhet rrëmbyer. Problemi që ngre letra është shumë delikat. Thirrje për shturje, për imoralitet... Këtë kuptim ka letra. — Shpëtimi shkuli një dredhëzë dhe filloi t'i këpuste gjethet një e nga një. Fadili po bëhej nevrrik.

— Kështu me qëndrim... dua të them, me moral, si është Vali?

— Gjer tani s'dimë gjë të keqe...

— Se... lexoje, lexoje këtej prapa.

«Në ka ardhur këtu për punë, të bëjë punën. Jo po në ka ardhur të zhgryhet me djemtë e fshatit, le të veshë opingat së prapthi. Ne e kemi parë me sytë tanë, në mes të natës. Me të birim e Bektash Metes, Demirin.

Fadili sa s'e grisi letrën.

— Turp!

— Mbase kanë parë gjë vërtet. Masat shikojnë më larg e më thellë...

— Ama dhe ti... Konferencë do më bësh tani? Ajo Demirin e ka shok. Se mos vetëm atë! Të gjithë i ka shokë. Edhe me mua ka ndenjtur vetëm gjer vonë. Se mos një herë...

— Sidoqoftë, kjo punë duhet shkoqitur me kujdes. Është mirë të bëhet mbledhja e organizatës.

— More organizatën edhe fshatin e mbledhim, po të duash.

Brigada ishte afruar në krye të parcelës. Disa e kishin lënë punën e po dëgjonin. Edhe të tjerët e hiqnin shatën ngadalë dhe mbanin veshët bigë.

— Le të flasim këta, — tha Fadili. — Brigada e njeh më mirë se të gjithë.

— Ç'është? — pyeti Kasëmi.

Fadili s'priti të merrte pëlqimin e instruktorit.
U ngrit.

— Kemi një hall.

— Hë?

— Në komitetin e partisë kanë dërguar një letër për Valin.

Kooperativistët s'kuptuan gjë dhe u panë sy ndër sy. U ngrit edhe Shpëtimi.

— E pastaj? — pyeti Bequa.

— E shajnë.

— Jo... ore?!

— Ja, dëgjoni. — Dhe Fadili lexoi letrën gjithë nerva. Ata rreshta, ku flitej për Demirin, nuk i lexoi. Shpëtimi hetonte kooperativistët. Ata po vrënjteshin.

— Shpifje, — tha Gonxhja.

— Ç'janë këto maskarallëqe? Ç'është ky maskara?

— Valit i marrshin të keqen.

— Ju thaftë dora kush e ka shkruar.

— Pse s'na thoni kush e ka bërë këtë proçkë.

— As ne s'e dimë, — tha Shpëtimi, — s'ka vënë emër.

— Epo duket sheshit që është gënjeshtër... Burri, kur e thotë fjalën, nxjerr pallën.

— Epo kush e ka bërë? — pyeti Fadili jo për të marrë përgjigje.

— Armiku. Ai qafir hedh gurin e fsheh dorën.

— Dale një herë, dale, — tha Shpëtimi.

— Çfarë dale, mor burrë, po ne sytë në ballë i kemi! O e njohim Valin ne, o se njeh njeri në fshat. Në punë tok, tërë ditën; mbrëmavet është me këta, rininë, në provat e grupit... Të gjithëve na

është bërë e shtëpisë. S'janë gjë ato të letrës... Gënjeshtra me bisht.

— Të dinte të shkruante mirë Veliu, unë atij do t'ja vija gishtin, — tha Bequa.

— Do gjetur njeriu.

— Do gjetur e do nxjerrë para fshatit. — Fadili e hoqi mënjanë Demirin dhe i lexoi ato rreshtat e faqes së pasme. Atij ju ndez gjaku papritur. Fjala për letrën u hap që atë natë gojë më gojë dhe lajmi mbolli zemërim e kureshtje për të mësuar kush e kishte shkruar. Bëheshin hipoteza nga më të ndryshmet.

Vali ishte kthyer nga qyteti. Të parët që takoi, i thanë për letrën dhe ajo shkoi të fliste me instruktorin. Shpëtimi nisi t'i shpjegonte, po Fadili i zgjati letrën.

— Na, lexoje.

Si mbaroi së lexuari, Vali u mbush thellë me frymë.

— Si të duket? — pyeti Shpëtimi.

Ajo ngriti supet e shtriu pak buzët përpara.

— Mbase kanë edhe të drejtë! — tha Vali pas pak.

— Ashtu?! — pyeti i interesuar instruktori.

Fadili u nxeh dhe i rrëmbeu letrën.

— Ama dhe ti, një avaz... çdo gjë të të thonë, je gati ta pranosh. Pse nuk e thua copë?! Nuk është kështu.

— Kush e organizoi mbledhjen e rinisë? — pyeti Shpëtimi.

— Byroja.

— E kush e drejtoi?

— Sekretari.

— Po ti?

— Unë?! — Vali s'dinte si t'i përgjigjej pyetjes së pakuptueshme.

— Kjo diskutoi si të gjithë... Dhe bëri një diskutim, që i tundi ca njerëz.

— Ashtu?

— Kështu posi?

— Po mbrëmjen kush e organizoi?

— Organizata, — tha Fadili.

— Propozimi ishte imi, — pasoi Vali.

Fadilit ju duk sikur Shpëtimit i vranë veshin fjalët e Valit, ndaj u ngut të shpjegohet.

— Ç'të keqe ka këtu! Se ndodhi ajo që ndodhi, s'ka faj kjo.

— Po ti pse nxelesh?! Unë s'thashë gjë, po pyes. Ti sikur ke qenë më i përmbajtur.

Fadili bëri një gjest me kokë e me dorë, duke zbrazur mushkëritë, sikur deshte të përzinte zemërimin.

— Qenkan të ngatërruara këto gjëra... Dashkan nerva të forta.

Shpëtimi filloi të bisedonte me Valin për gjëra të zakonshme. Ajo, mbasi e kishte marrë vesh mirë ç'ishte ajo letër, ishte qetësuar. Kjo i bëri shumë përshtypje atij.

— Mbledhjen do ta bëjmë që sonte, — tha Fadili.

— Prit një herë...

Kishte shkuar ora e fillimit të provave dhe ata u nisën nga vatra e kulturës. Grupi ishte mbledhur. Vali shkoi në skenë, kurse Shpëtimi e Fadili u ulën t'i shikonin provat. Letra anonime u kishte prishur humorin diletantëve. Gonxhja shfrynte më shkak

e pa shkak, Demiri vlonte përbrenda e s'guxonte të shihte Valin. Kristina ishte e menduar.

— Ç'është ky maskara? — tha një djalë.

Dhe filloi biseda rreth letrës.

— Fillojmë tani, — tha Vali. — Lëreni atë punë. Ka ardhur edhe Fadili me instruktorin.

Po të rinjtë ishin bërë nervozë.

— S'kanë ç'i bëjnë gomarit, i bien samarit. Mbledhjen e bëri organizata. Ne folëm të gjithë.

— Veliu e ka bërë.

— Jo. Unë mendoj për një tjetër.

— I lëmë këto tani.

— Ai që e ka bërë, do pështyrë në surrat, — dhe Shpresës i vetëtinë sytë.

— Hapeni perden, — urdhëroi Vali.

Skënderi u turr dhe zuri të dy fletët e perdes që sapo zunë të hapen.

— Prit.

— Mirë thotë, s'bëhen provat me nerva, — tha Ganiu.

Skënderit ju muar fryma.

— Unë... Nuk desha... U zura ngushtë...

— Si??? !!!

— Letrën...

— Ti?

— Unë.

Frymëmarrjet mbetën pezull.

— Turp të kesh.

— Ptu! — pështyu dikush përtokë. Atij ju duk sikur ja përplasën në fytyrë. Dora ju var poshtë. Fletët e perdes u hapën. Ai qëndronte kokulur. Të tjerët e kishin futur në zjarrin e shikimeve të ndezura. Sania qante.

— Më detyroi xha Veliu me babanë.

Shpëtimi la fjalën për gjysmë dhe nderi vëmendjen, duke kujtuar se filluan provat. E rrëmbyen ato nota dramatike që sundonin skenën. Fadili u ngrit.

— Ku vete?

— Seç ka ndodhur!

Instruktori puliti nja dy herë sytë.

Provat filluan pas gjysmë ore. Trupa ishte freskuar dhe luajti mirë. Vali ishte e qetë sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Fadili i shpjegonte instruktorit:

— Ka të drejtë Vali! Vajzat janë të mbyllura, po me ato punohet më lehtë. Djemtë janë ndryshe, janë më të hedhur e dinë ta mbrojnë më mirë veten, po, kur është fjala për motrat, o për kushërirat, janë ndryshe. Kështu dhe kjo e Skënderit. Djalë i gjallë e i hedhur, thua ti s'ka shok. Po, kur erdhi puna te e kushërira, se Velinë e ka khaxha shejtani, na u bashkua me pleqtë. Ç'është kjo lufta e klasës përbrenda njerëzve... Lëmsh fare. Ne e kemi gabim nganjëherë kur mendojmë se, për të luftuar të vjetrën, ke punë vetëm me pleqtë.

Shpëtimi kishte humbur duke ndjekur provat.

— Ai djali i Bektashit s'ja ndan sytë Valit. E dhe ajo si shumë qesh. I ke vënë re? — i tha Fadilit.

— U plakmë ne, dhe të tëra lulet na duken trëndafila... Rini këta, o vëlla!

KUJTIME RINIE

Vali u mendua një çast para se të fillonte faqen e dytë të letrës.

«... Liza!

Ti më thoshe se kini shkuar shumë përpara me provat e grupit dhe pretendoni për vend të parë. Ju lumtë, po mos i nënvleftësoni kaq shumë të tjerët. Grupi ynë është i porsakrijuar, po s'jemi dhe aq keq.

Më shkruaje se kishe marrë letër nga Fotaqi. E ligë je, Liza! Pse s'ma dërgove dhe mua letrën e tij? Me siguri ka qenë kryevepër! Ç'numër është Fotaqi! Si nuk mërzhitet?! Ju bënë tri vjet më duket. Pullë poste t'u bë. Fejohu shpejt, se do të të rrëmbejë. Si na thoshte kur na dilte përpara!? E mban mend? Më thoshte mua: «Më falni një minutë. Kam një bisedë tepër serioze e shumë sekrete me shoqen Liza». Ç'kokë që ishte! Po dhe ti... Habitem si ke duruar. Unë do të kisha bërë skandal.

Po të ngacmoj si shumë e në letrën tjetër me siguri do të hakmerresh. Do më kujtosh «Moris Ronenë». E di unë, s'ta lë borxhin ti... Po unë t'i kujtoj vetë...Thuaj si të duash, po «Roneja» ishte më simpa-

tik se ai yti. Alarret flokësh kishte, ë? Apo kur vishte ato pantallonat me tegele të gjera si shina.

«Momento»! — Shkulem gazit kur e kujtoj. E mban mend atë mbrëmje kur ktheheshim nga shkolla? Po atje te rrobaqepsia! Kjo s'është gjë hiç, po atë ditë kur dolëm nga «Pasticeria». Ti u trembe dhe të ra akullorja nga dora. Dhe atë ditë i ngjite emrin «Moris Rone».

Po një herë tjetër... Që s'na ndahej. Të kujtohet?!.. Ti thirre policin. Ç'ka qenë ajo ditë!

— Shoku qytetar, pse ngacmoni vajzat e botës?

— Shoku polic, unë kam punë vetëm me këtë.

— Edhe kjo është e botës.

— E dua.

— Drejtohu në familje.

Numër! Numër!

Kurse për atë tjetrin m'u qepe ti. M'u bëre «Kali i Trojës». Mos m'u zemëro, po unë dyshoj. E kupton për kë e kam fjalën? Për inxhinierin e uzinës, për Piron. Ai dukej djalë i mirë dhe e kishte seriozisht, po s'më ngrohu kurrë, s'ndjeva gjë për të. Babait ju mbush mendja një herë...»

Kristina kishte një hop që po shikonte me vërejtje Valin. Mendohej të merrte me mend se çfarë po shkruante ajo, që qeshte me vete. Siç ishte ashtu shtrirë në shtrat, seç i shkroi një copë letër, e mblodhi shuk dhe ja hodhi mbi tryezë. Vali ktheu kokën e trembur. Kristina i bëri shenjë me dorë që ta lexonte.

«Me këto letra m'u bëre më keq se mamaja. Ulesh e s'di të ngrihesh. Apo dhe ti...»

Vali ju përgjegj me një të qeshur dhe vazhdoi të shkruante: 7

«Kristina të bën të fala. Ka ndryshuar shumë. Do të të prezantoj në festival. S'besoj të ketë ndonjë grup tjetër recituese më të mirë. Më thotë se jam bërë më keq se e ëma me letrat... Aspasia e vazhdon korespondencën e saj të çuditshme. Po s'është më ajo e para. I mbushëm mendjen të drejtë një kurs për kuzhinë e prerje e qepje. Megjithatë vazhdon të kërkojë «fatin» e Kristinës. I është bërë ferra Ibrahim. I është mbushur mendja se njëri nga mësuesit, Bashkimi, i vjen rrotull së bijës... Kurse midis tyre nuk ka asgjë.

Sot isha për drekë te Demiri. Kam ngrënë përveç misri me kulaçka. Ishte e mrekullueshme. Demiri është alamet djali... Kështu si kallëp s'është ndonjë gjë... Po sa i mirë, moj Liza! Edhe prindërit i ka shumë të mirë. Sa më do e ëma! E di që do të bësh ndonjë nga ato pyetjet e tua rrufe: «Po i biri?»... E kam shok, moj dreq... E kam shumë shok. Ndoshta... Rri, se më ngatërrove tani.

Po detyrohem ta mbyll letrën, se Aspasia po vjen rrotull. Si duket pret t'i lëshoj vendin.

Mirë u pafshim pas një jave, në festival.

Të uth
Vali».

Vali e palosi letrën dhe e futi në zarf. Pastaj mori fletushkën që i kishte hedhur Kristina, dhe i ktheu gjuajtjen.

— E bëre tërkuzë, — i tha ajo.

Vali ju afrua dhe i pëshpëriti:

— Për ty ishte. Ja nisa një vajzës së hallës së kushuririt të dytë të nuses së djalit të xhaxhait të

mamasë të të rregullojë djalin e kunatës së baxhanakut të vëllait.

Ja dhanë gazit me të madhe.

— Ç'është kjo e kakarisur? — tha Aspasia.

— E dielë gazmore!

Ora s'kishte shkuar ende tre. Provat e grupit, meqë ishte e dielë, i kishin bërë paradite.

— Dalim një herë? — tha Kristina.

— Ku do të shkoni, në opera? — shpotiti Aspasia. — Lopët pëllasin mëngjezeve, kur i lëshojnë nga stalla.

— U mërzitëm.

— Ja ku e ke tantenen.

— Ahu. . .

— Unë kam menduar diçka tjetër, — tha Vali; — shkojmë te xha Bektashi? I hyjmë një herë shtëpisë dhe ja bëjmë model. Me Demirin kam folur. I ka bërë pregatitjet.

— Kjo ka punë. Ti shko po deshe, — ja priti Aspasia.

— Teto Aspasi, mos ma prish, të lutem.

— Epo kësaj s'di ç'ti them unë. Janë apo s'janë gra këto të shkreta! Edhe për të larë e për të fshirë do t'i mësoni ju?!

— Hajde Kristina. Hajde dhe ti, teto Aspasi, po të duash.

— Unë?!

— Epo Kristinën do ta marr.

Kristina kishte filluar të vishej pa dhënë ende pëlqimin e ëma.

Ato dolën. Ajo s'foli.

— Shiko, mos të zërë nata atje? — i tha së bijës nga dritarja dhe i luajti kokën qortueshëm.

Vajzat i premtuan dhe vazhduan rrugën.

— Seç të kishte rënë një nur sot kur shkruaje letrën, — i tha Kristina. — Çfarë shkruaje?

— Kujtime rinie.

— Na... se u plake demek.

— Në mos u plaka, iku ajo kohë kur na ndalnin djemtë rrugëve e na bënë propozime... kurse ti ke shpëtuar nga këto telashe. Ke polic ti... Kush të afrohet ty...

— Domethënë e paske gjetur...

— Jo, moj budallaqe, po...

— Lëre.

— Se si jam kështu sot, Krista... Se si më duket...

Demiri kishte dalë te porta dhe po i priste.

«TË KAM GJETUR. XHA BEKTASH!»

— Mir se të gjetëm, xha Bektash!

— Bujrum e mirse më erdhët. Ju lumshin këmbët.

Plaku u ngrit, u dha dorën vajzave dhe zuri përsëri qoshen e minderit.

— Ma bëtë qejfin. Unë u plaka e s'para dal dot, ndaj dua miq në shtëpi... Epo si jeni, moj kapedane? A po lodhi? A po mërziti?

—

— E ku doni t'ja dini ju..! Rini hesapi. Kur isha i ri, unë haja gurin me dhëmbë... Tani s'më mbajnë këllqet. Po shyqyr që patëm ditë të bardha.

Mbas asaj nate që u sëmur, Vali kishte shkuar edhe herë të tjera në shtëpinë e xha Bektashit e atij po i hynte në zemër. I pëlqente, se ishte e muhabetit e kish një fjalë të ëmbël e të peshuar, që ta kish qejfi ta dëgjoje.

Hamdia hyri me dy gota dhallë në duar.

— Ç'i deshe këto?

— Hë, se bën mirë dhalla në vapë.

— Burrat i pret me raki ti, xha Bektash, kurse çupat me dhallë... S'ta mbushim syrin ne.

Kristina u turpërua.

— Pse, moj e uruar, ja thua dhe asaj viraneje ti, a? Hajde, djall, hajde! O plakë! Sillna, moj, nga një kupë raki, se s'dashkan dhallë çupat.

— Do ta pimë edhe rakinë, po dale... Kemi ardhur për tjetër gjë.

— Hair ishallah?!

— Do të të ngremë nga qoshja.

— Si, moj, si?

— Të na e lirosh këtë dhomën këtu, se kemi ca punë.

— Ndonjë mbledhje, moj?

— Jo, një punë tjetër.

— ~~Ja~~ ~~Do~~ ta bëjmë alla franga, si i thua ti.

Plaku hungërroi. S'kishte patur burrë që të vinte e ta ngrinte nga qoshja e tij, ku kish lëshuar rrënjë, e tani po ja thoshte këtë një çupërlinë si duke qeshur. Krojti një herë mjekrën e zbardhur e të ashpër, pa vajzat rrëshqanthi dhe u ngrit sikur ta kishin rrahur. Vali i futi krahun ta ndihmonte.

— S'jam aq keq, jo... — Dhe doli jashtë duke shfryrë me vete.

Kur u kthye ai, qe ngrysur. Vajzat po bënëin pastrimet e fundit.

— Ç'paski bërë kështu, moj? — u step ai me të hyrë brenda dhe ju duk se kishte hyrë në shtëpi të huaj.

— Si shtëpi qyteti, — tha Kristina.

— Shtëpia e qytetit në qytet, shtëpia e fshatit në fshat... Ç'na e ngrini rehatin tani në pleqëri... Ti e dhe këtë mendje, moj? — pyeti të shoqen dhe i nguli sytë.

— Demiri.

— Atij po i pëlqeu, po s'i pëlqeu, kur të marrë nusen, sytë le të nxjerrë. Oj! Ç'jam unë këtu? Gur varri! Domosdo, pleq tani... s'na pyet njeri...

Vajzat dhe Demiri qeshnin. Gjithçka kishte mbaruar dhe ai kot që grindej. Edhe plaku e dinte këtë, po s'përmbahej dot. Shikonte sa andej këtej.

— Si shtëpi firaunësh.

Demiri nguli një gozhdë në mur. Vali vari aty një pasqyrë. Kristina shkoi në dy shkopinj të gjatë perdet e reja dhe ja dha Demirit t'i varte. Dhoma binte erë gëlqere. Plakut sikur i vranë sytë. Ju afrua pasqyrës.

— Ç'janë këto xhingla? — Po, si pa e kuptuar as vetë, filloi të shohë me vëmendje atë fytyrë të rreshkur që ju çfaq përballë. Mblodhi një herë hundën. Krojti mjekrën. Në murin përballë Vali mbërtheu një fotografi me ngjyra. të këputur nga ndonjë revishtë. Një tufë dhish duke kullotur shpatit. Bariu me brucë krahëve mbante një keç ndër duar.

Për pikturën Bektashi s'tha gjë.

— Ulu, baba, — i tha Demiri që deshte të hiqte ca dërrasa nën këmbët e tij.

— Hej taksirat! — bëri me vete plaku dhe u ul mbi minderin e lartë.

— Si të duket shtëpia? — e pyeti Vali buzagaz.

— Hic s'më ngrohet. Sikur kam ardhur në shtëpi të botës më duket.

Hamdia me Kristinën prunë një dollap buke dhe e vendosën në qoshe. Mbi të vunë radion, së cilës i kishin hedhur sipër një mbulesë të qëndisur.

— Akoma s'mbaruat të shkretën?

— Ja, i dhamë fund.

Plaku e pa edhe një herë dhomën qoshe më qoshe.

— Moj, po nishan s'kini lënë. S'më bie herë shtëpia ime hiç.

Vajzat, Hamdia e Demiri shkuan të pastroheshin. Plaku jepte e merrte me vete nën zë:

«Ç'ju pjell mendja!? Ku isha në drekë e ku jam tani. Mor po dhe kjo drita sikur të vraka sytë... Të kenë ndëruar llampën?! Jo, mor, ajo është...» — U tund nja dy herë në minder, ashtu siç që, ndenjtur. «Ç'ma prishën rehatin!» — Po u tund përsëri. «More, po sikur s'qenka keq...! Sikur je kaluar të duket. Po ky me këto dhi ç'të jetë?! Sikur s'më ngjan me tanët. Le që s'më bëjnë as sytë, po s'është nga këto anë! — u tund përsëri mbi minder. «S'e ka bërë keq qerrataj, jo...»

Demiri e kish vënë re.

— Si të duket? — e pyeti duke fshirë fytyrën me peshqir.

— Po kur të ndezim zjarrin e dimrit, si do ngrohemi? Apo t'i rrijmë zjarrit përsipër. Po kur të shtrojmë sofrën? Si do të hamë, përmbys? Na dolët të mençëm ju! Ishim budallenj ne që i bënim minderet të ulët. E kam parë diellin para teje unë. Hë de, si do ngrohesh për dimër?

— Do vëmë sobë e s'do na duhet më vatra.

— Qysh, ore?

— Sobë.

Hynë edhe vajzat me Hamdien dhe filluan të fshihen e të rregullohen.

— S'të mora vesh! — tha Bektashi. — Ç'është kjo soba? Por është?

— Më e mirë se pori. Atje edhe zjarr për t'u ngrohur bën, edhe zien, edhe pjek...

— Kristina! — ja preu fjalën Demirit dikush që thirri nga jashtë.

— Mamaja! — tha ajo.

Hamdia doli.

— Thuaji të hyjë brenda, — e porositi plaku.

Po Aspasia nuk pranonte të hynte.

— Hajde, moj, se s'ta japim çupën, — thirri Bektashi që brenda me zë të lartë. Ajo u duk në derë. Plaku luajti vendit.

— Bujrum.

— Ju faleminderit, po... Erdha të marr Kristinën.

— Se mos të humbasë, a si?

— Kristina mbathi sandalet.

— Prit, moj çupë, s'ikën sonte pa ngrënë darkën,

jo.

— Faleminderit, po... — përgjigjej Aspasia për të bijën.

— Edhe ti do të rrish.

— Kristinën e kërkojnë për një gjilpërë.

— Mirë, mirë. Rri ti, ulu... pa e shpie plaka.

tejtj. — Një herë tjetër. — Dhe Aspasia s'priti më

— Natën e mirë.

— Po dale, moj motër...

— Natën e mirë! — uroi pa qejf Kristina.

— Dale, moj bijë...

Po ato kishin dalë në rrugë. Plakut i mbeti qejfi.

Në koridor u dëgjuan trokëllitje pjatash. Vali doli. Bektashi mbeti vetëm me të birin.

— E dija vetëm të llafit këtë vullnetare. Po kjo edhe për punë s'paska shoqe.

— U bë mirë dhoma, — tha Demiri.

— Mua se si më duket. Më vjen si të ftohtë,
si mërzë.

Hamdia me Valin futën një tryezë katrore,
mbuluar me një basme.

— Po kjo?

— Të hamë darkë.

— Po sofrë?

— Ja, kjo është sofrë, xha Bektash.

— Hiqeni, hiqeni këtë. Ç'është kjo me këto dras-
ka si këmbët e dhisë? Oj... Sillni sofrën të na shkojë
buka në bark...

— Me këtë shkon më mirë, — tha Vali dhe filloi
të shtrojë pjatat e lugët.

S'e pakam dot këtë soj unë... S'ha dot bukë-
kështu... Sofrën.

— Do të mësohesh, baba.

— E shoh, bir i babait, që do të më mësosh arat-
tani në pleqëri, — i tha me keqardhje të birit dhe ju
suall së shoqes me inat:

— Sillmë sofrën e vogël mua.

Hamdia e kreu porosinë pa kthyer fjalë. Edhe
të tjerët aty për aty nuk kundërshtuan. Bektashi e
afroi sofrën e vogël të këmbët e mbledhura kryq.
Vali i vuri përpara një pjatë, lugën e pirunin...

— Sahanin, — i tha së shoqes Bektashi dhe
e vuri mbi tryezë pjatën që kishte përpara. Pastaj
hodhi edhe pirunin:

— Këto janë për të nxjerrë plehun nga ahuri
e jo për të ngrënë.

Hamdia i solli një sahan balte.

— Sillmë dhe një filxhan farmak.

Ajo i mbushi një filxhan raki dhe ja lëshoi
përpara. Ai hoqi një herë i ngrysur.

— S'e mbajte fjalën, xha Bektash! — tha Vali dhe mori shishen e rakisë. Mbushi një filxhan për vete. Plaku hapi sytë.

S'ma preu mendja se e bëje edhe këtë. Të bëftë mirë. Pije.

— Unëdo ta pi, po ju seç kini ca zakone këtej për rakinë. I kam mësuar dhe unë.

I zënë ngushtë, plaku tundi kokën, pa ditur ç'të thotë. Vali kishte marrë filxhanin në dorë.

— Epo s'e tokëm, xha Bektash?!

— Hej bela... — dhe ai tundi përsëri kokën.

Demiri mori dhe dy filxhanë të tjerë. Mbushi një për vete, një për të jëmën. Hamdia i tregoi Bektashin me kokë dhe kafshoi buzën. Vali po prieste me gotë në dorë. Bektashi jepte e merrte me vete.

— Epo hajde këtu në daç ta tokim, — tha më në fund.

— Unë vij, po miku sikur s'luhet nga vendi.

— Po plaku luhet?

— Për mikun edhe luan. Unë kështu kam parë këtu në fshat.

— S'ta dal dot ty, jo...o. — Ai mezi shpleksi këmbët e thurura kryq e ju afrua më gjunjë tryezës.

— Hajde... toke. Gëzuar e më dasmë...

Bektashi ngriti filxhanin dhe po tërhijej përsëri te sofrë.

— Po rri këtu tani, xha Bektash. Do pimë e do bëjmë muhabet. Ju kini dhe ca këngë këtej...

Pa më rri përballë,
se të kam një fjalë.
Pa më rri karshi,
të të ngre dolli.

Pa e ç'pa Bektashi dhe zuri vend pas tryezës.
— Tani gëzuar! — tha Vali dhe e toku me plakun e me të tjerët. Po, kur e kapërdiu atë lëng kumbulle të zier, e mbyti kolla e sytë ju mbushën me lot.

— Rakinë s'e pike, po havazin ja ditke, — qeshi i zoti i shtëpisë. Dhe, si e boshatisi filxhanin, tha:

— Ma hodhe. Ma bëre si ata që ndjellin kuajt e hazdisur. Ke parë? Ke parë? Jo, s'ke parë. Kur shpëtojnë nga litari kuajt e hazdisur, s'dinë të mbli-dhen, që thua ti. Dhe shkon i zoti e ndjell me një dorë bar. Avash-avash, avash-avash, gjersa e fut në ahur. Pastaj ja tregon qejfin.

— Jo, xha Bektash.

— Domosdo... Unë jam kalë i ngordhur, po fjala që vjen. Nejse, më fute në vathë tani dhe ec e luaj po deshe. Ngrehu, moj grua, hiqe atë sofrën. Është keq të jenë dy sofrat shtruar, njëra plot e tjetra bosh.

Kurse Vali kishte dëshirë ta shihte gjatë atë sofër të vjetër e të heshtur, si një llogore të braktisur të armikut.

«NATË E BUKUR!»

Ndonëse dita kishte qenë mjaft e nxehtë, nata ishte e freskët. Fshati bënte një gjumë të qetë. Nga larg dëgjohej zëri i dredhur i spikerit që jepte lajmet e fundit. Diku këndonte një zog nate. Ajri pak i lagësht nga vesa të përkëdhelte mushkëritë. Hëna e plotë kishte nxjerrë vetullën mbi majat e pishave të kories.

— Sa natë e bukur!

— Kështu janë natët në verë këtu.

S'e kisha vënë re! Seç ka diçka që s'di ta them.

.....

Demiri po përcillte Valin. Hamdia e Bektashi e kishin lutur që të flinte atje, po ajo s'kishte dëgjuar. Ndoshta për të parë këtë natë të bukur.

— Babait i mbeti qejfi që s'ndenje.

— Unë prisja ftesën tënde.

Ai s'u përgjegj. Vërtet që s'kishte hapur gojë. Bile i erdhi mirë që Vali s'pranoi ta kalonte natën aty. Ndoshta edhe ai për të parë këtë natë të bukur!? Atë e kishin rritur këto net, po kjo natë i dukej e jashtëzakonshme. Po përse?!

Ecnin ngadalë. Flisnin pak e mendonin shumë.
Dhe ashtu si pa e kuptuar morën udhën më të gjatë.
Kur heshtja zgjatej, u rëndonte dhe i ngacmonte të dy.

— Kur ishja e vogël, kisha frikë të dilja natën.

— Unë kam fjetur në mal që 10 vjeç.

— Kushedi sa e bukur është nata në mal?!

.....
Zërave të pakët të natës ju shtua dhe e lehura e qenit të stallave. Ajo gjeti shkas të fliste.

— Çudi, gjithmonë kisha menduar se fshatet ishin të mbushur me qenër.

— Edhe këtu ka patur shumë. Tani janë vetëm katër, një i stallave e tre të kopesë.

— Kujt i leh ky qeni tani?

— Hënës.

— Hënës?!

Ai s'foli, ajo pa hënën pas pishave.

— Po hëna pse fshihet kështu?

— Ka turp nga ne.

Heshtje. Fjalët e fundit i kishin ngacmuar të dy. Këmbyen vjedhurazi nga një shikim me bisht të syrit. Ajo u pengua në një gur. Ai e kapi për krahu. Vali qëndroi. Demiri ja lëshoi krahun si i trembur. Filluan përsëri të çapiten në heshtje, duke kërkuar biseda të kota.

— Xha Nevruzi është shumë burrë i mirë, — tha Vali.

Po kalonin para shtëpisë së tij.

— Ka ca huqe.

.....
Të gjitha bisedat që hapnin, i linin për gjysmë.
Demirit sikur po i dridheshin këmbët. Kohë pas

kohe i çfaqeshin ca dridhma ethesh, që e mbushnin me mornica.

— Atje në ndërmarrje kemi një llogaritar antik. Për çdo gjë thotë: «Jo, po të lutem shumë, që thua ti». Një ditë ja kam numëruar. Për dy orë e tha tridhjetë herë. Ç'antik!

— I vjetër është?

— Nja dyzet e pesë vjeç.

— Prandaj.

E ndonëse këto fjalë ishin krejt pa vend, asnjërit s'i bënin përshtypje. Mornicat Demirit ju bënë më të shpeshta. Vali nuk ngopej me ajrin e natës. Derisa arritën te shtëpia s'nxori zë asnjëri. Qëndruan.

— Natë e bukur, — tha Demiri.

Ajo ngriti kokën. Ai s'guxoi ta shihte në sy.

Heshtje. Brenda tyre pështilleshin rryma të nxeha, që s'gjenin shteg. Duke mos gjetur dot fjalë tjetër, Demiri vendosi t'i thoshte diçka, megjithëqë s'i vinte mirë ta merrte vesh nga goja e tij.

— Sot në drekë më thirri kryetari.

Ajo priti.

— Më tha të lë brigadën.

— Pse?

— Do të kaloj në blegtori.

— Në blegtori?!

— Urimet *Pengjapës!*

Duart e tyre u tokën duke u dridhur.

Dhe përsëri heshtje. Një heshtje si një balon i stërfryrë, që shpërthen me një majë gjilpëre. Kërciti diçka, që Demirit i ngjau me kërcitjen e kanatës së dritares.

— Po shikon Aspasia?

— Le të shohë. — Vali kafshoi buzën e poshtme.
Atij ju ntrash fundi i gjuhës e sikur i zuri fytyrën.
Diku rrotull u dëgjua një e kollitur.

Duart e qullura nga djersa u shkëputën.

— Natën e mirë!

Kolla u përsërit.

— Natën e mirë!

«E, KJO DASHURIA»

Me gjithë gjumin e pakët, Vali u ngrit me një gaz të madh në mëngjez.

— Kur erdhe mbrëmë? — e pyeti Kristina.

— Vonë.

— Nuk e shikon që i janë bërë sytë si gorrica të zjera? — tha Aspasia.

— S'bëtë mirë që s'qëndruat, — tha Vali, ndër-
sa me vete i falënderonte, se ndryshe ato do të qenë
kthyer të tria e kushedi sa do të kish vonuar ajo
natë e bukur.

Vali kishte një shkathtësi të çuditshme. Kën-
donte me vete. Qeshte.

— Ke parë ndonjë ëndërr, a si e ke hallin?
— habitej Aspasia. — Edhe Kristina e shihte me
habi. Kur e ëma doli të mbushte ujë, e pyeti Valin:

— S'të kam parë kurrë kështu. Ti seç ke?

— Kam një gjë.

— Ç'është ky gaz?

Vali s'e mbajti dot dhe i tha të vërtetën. Kristi-
nës i erdhi e papritur.

— Si thua ti? — e pyeti Vali.

Përmes hutimit ajo mblodhi buzët e ngriti su-
pet.

— Se si je ti, Vali, kështu... Se si je...

Vali e puthi në të dy faqet e doli me të shpejtë, duke e lënë Kristinën në mes të dhomës me një lëmsh të ngatërruar mendimesh në kokë.

Edhe shoqet e brigadës e vunë re menjëherë gjallërinë e saj të pazakontë. Ajo s'mbahej në punë atë ditë. Ato e mbytnin me pyetje, po ajo s'u tregonte, ndonëse e dinte që u ishte borxhlie. Po se si i vinte. Në drekë i tregoi vetëm Gonxhes. I tha vetëm se dashuronte një djalë, po emrin s'ja zuri në gojë.

Pas pushimit, kur u ngritën për të vazhduar punën, Vali ndërroi krejt papritur. U bë e heshtur, e vrëjtur dhe shata ju rëndua. Gonxhja habitej me ndryshimin e saj. Mendimet dhe shqetësimet e lodhshme s'ju ndanë vajzës, gjersa mbaruan punën.

Çudi kjo dashuria! Një dorë e ka të butë e të përkëdhel, kurse me tjetrën të rreh. Po ajo, si një që s'di asgjë për detin, s'i kuptonte flukset dhe reflukset e dashurisë.

E mbrëmshmja i dukej si një natë e largët. E mbysnin pikëpyetjet, përfytyrimet e prindërve, të miqve, të shoqeve, të fshatarëve... Dhe nganjëherë i ngjanin të gjitha me një lodër, të cilën do ta linte pas, këtu, midis maleve, pas disa javësh, kur të zbriste me valixhe në dorë udhëzës dredharake.

Pas pune, kur u kthyen në fshat dhe shoqet e brigadës u shpërndanë nëpër shtëpia, ajo mbeti, pa ditur ç'të bëjë. Para zyrave të kryesisë ju afrua stendës së emulacionit.

«Brigada e parë është zotuar të marrë 200 kuintalë misër mbi planin.

«Brigada e dytë.

.....

Më tej i hodhi një sy gazetës së shpalosur. I tërhoqi vëmendjen titulli i një fejtoni. Filloi të lexonte, po nuk mund të përqëndrohej. Mbajti sytë një çast nga jugu e këmbët ju vunë në lëvizje si pa dashje. U fut në udhën që i ngjante shtratit të një përroi dhe nisi të shpejtojë hapin. Fytyra po i çelej e mendimet po i kthjelloheshin.

Mbas parcelës së mbjellë me patate u ndodh në oborrin e stallave. Para njërës prej tyre, Myrtua po hapte me cfurk një kapicë bari të porsakorur. Ai i kishte kthyer shpinën e s'e vuri re. Dhe Valit i erdhi mirë. Ishte hera e parë që i ndruhej shikimit të njerëzve. U fut në stallën tjetër. Mjelëset kishin mbaruar punë e ishin larguar. Lopët, rreshtuar njëshkolonë pas grazhdeve, përtyreshin më nge. U dëgjuan nja dy të goditura sqepari mbi gozhdë. Ajo priti në ankth. Nga mesi i stallës, midis lopëve, u ngrit Demiri. U dha flokëve prapa dhe fshiu ballin me llërën e përveshur. Vali mbajti frymën, kurse ai, kur e pa, i mbeti dora lart dhe uli kokën, si i zënë në faj. Vali u mundua të mposhte ndrojtjen.

— Puna mbarë, shoku përgjegjës.

— E kishte hapur grazhdin kjo Bala... e mbërtheva një çikë.

Ajo ju afrua. Një lopë palli me sa i hante gurmazi.

— Përse pëllasin lopët?

Ai ngriti supet. Ju kujtuan bisedat e kota të së mbrëmshmes.

— Cila është lopa më e mirë? — pyeti ai për të mos lënë vend për heshtje.

Ajo i hodhi një sy të shpejtë stallës, megj-

thëse e dinte që përgjigja e saj s'kishte asnjë rëndësi.

— Ajo me pulla në kurriz.

— Jo.

— Ajo atje, e dyta nga fundi.

— Jo.

— Kjo e zeza këtu, me bri të thyer.

— Jo.

— Ku marr vesh nga lopët unë!

— Kjo është më e mira, Suzana.

— Sa emër të bukur paska!

— Është nga ato që na dhuruan kooperativat e fushës. Jep njëzet litra qumësht në ditë. Demiri ju afrua lopës dhe po i shkonte dorën mbi qimet që i ndrishnin prej shëndetit. Lopa kënaqej e tundte bishtin. U afrua edhe Vali. Si me frikë, edhe ajo filloi të fërkonte kurrizin.

— Qenka shumë e urtë.

— Shumë.

Zërat e tyre seç kishin një si të dridhur.

— Pse s'ja heq këtë rrodhen këtu? — dhe ajo zgjati dorën.

— Po... — zgjati dhe ai të djathtën, po dora e tij ra mbi atë të Valit. Shikimet e tyre u përplasën dhe lëshuan shkëndija. Demiri lëvizi pak buzën e poshtme... Valit ju drodh mjekra. Pastaj u bë mjegull dhe...

Buzët e tyre u bashkuan.

Kur u shkëputën prej njëri tjetrit, s'ngopeshin me frymë, sikur kishin dalë nga fundi i detit. Vali papritur ja dha vrapit.

Demiri kishte mbetur aty, pas grazhdit, me një rëndë dorë te cepi i buzëve që i digjnin, e me

tjetrën në kurriz të Suzanës. Lopa i lëpiu pantallonat dhe lëshoi ca tinguj të butë lutës, për ta kujtuar që t'i fërkonte kurrizin.

— Budallaqe! Hallin tënd kam unë! Nuk e sheh ç'po bëhet?! — Dhe e derdhi shikimin andej nga kishte ikur Vali. Doli nga stalla me shpresë se do ta gjente aty. Po ajo nuk dukej. U mbush me frymë dhe u kënaq, sikur ishte në një kopsht me trëndafila.

E, kjo dashuria!!!!

KOHA JONË

Pregatitja e grupit artistik tani ishte preokupimi kryesor për organizatën e partisë. Festivali do të fillonte pas pesë-gjashtë ditësh. Diletantët punonin gjer në drekë, kurse gjithë pasditen e gjer në mbrëmje vonë jepnin e merrnin me provat në vatrën e kulturës. Edhe Fadili vinte nga vinte e ngulej në sallë. Po i mbushej mendja se s'do të turpëroheshin. Këngët dhe recitimet ishin mjaft mirë. Vetëm nja dy skeçe donin ende punë. Mësuesit dhe Vali s'ndjenin të lodhur. Diletantët vetë kërkonin të përsëriteshin provat, derisa t'u mbushej mendja se po bënin diçka.

Sanija, që në fillim qe dukur e ndrojtur dhe e ngathët, tani luante mjaft mirë. Atë dhe Ganiun të gjithë tani i quanin dhëndri e nusja. Xha Veliu s'po bënte më zhurmë, po fjalën për fejesën e së bijës s'e jepte që s'e jepte.

Ora po shkonte tetë. Provat ishin përsëritur tri herë.

— Mjaft, se u lodhët, — tha Fadili.

— Do t'i bëjmë edhe një herë.

— Lëreni për nesër. Mjaft.

U përsëritën vetëm tri skeçe. Fadili, sa herë

ndeshte me sytë e Valit, i luante kokën dhe qeshte.
«E paska marrë vesh», — mendonte ajo.

Kur diletantët zbritën nga skena dhe po shpërndaheshin, ai i tha:

— Të fortë të dija, po që të arrije gjer këtu, s'ma ka prerë mendja. Kurrë!

Ajo uli kokën.

— Hajde, Fadil, — i tha Demiri kur po dilnin.

— Ikni ju, ikni... — dhe qeshi. — Hajde natën e mirë.

— Unë i tregova Fadilit... Thashë ta bisedoja një herë me ty më parë, po s'u përmbajta. Ai fliste si i ndrojtur.

— Mirë bëre, — i tha Vali. — Po kur ta marrë vesh babai?

— Ja hodha një fjalë kështu si larg e larg... Ai do ta marrë që do ta marrë vesh.

Bektashit i pëlqente Vali dhe, kur i tha Demiri se ajo i dukej çupë e mirë, s'e priti me këmbët e para.

— Më ka rënë era që ta ka qejfi, po hap sytë mos na nxjerrç avaze. — Vetëm kaq i tha aty për aty të birit. Pastaj e mendoj gjatë e thellë këtë punë. Hamdia e ushqente me ndonjë fjalë. Ajo s'dinte gjë të saktë, po ja kish qejfi ta bënte nuse Valin, se s'kishte për të gjetur rast më të mirë.

— E mirë është çupa, moj, e mirë... Po çupë qyteti ajo, është rritur ndryshe... A e shkon dot jetën këtu? Tani është fillimi, po dalin avaze më vonë. Është jetë kjo e shkretë...! Pastaj njerëzit s'ja njohim, kë ka e qysh ka... Si e tek...

Aspasia mezi po e priste Valin. Me t'u dukur në derë, u afrua dhe i dha dorën:

— Të trashëgohesh! — i tha me një ligësi të mbështjellë me një buzëqeshje fallso. Valit se si i erdhi. Se' kishte uruar njeri gjer në atë çast.

— Po unë... Kush tha se...-

— Epo ne këtu rrojmë... Sytë në ballë i kemi... Edhe veshët s'më kanë lënë.

Vali pa Kristinën. Ajo u justifikua pa folur.

— Dukej puna jote, — mprehu zërin Aspasia.

— S'të kuptoj?

— Ti e nise me pallë që kur erdhe... E gjete dhe burrin, tani rri rehat... Se mbete pa burrë.

Dukej sheshit që ajo qe mbushur mirë e donte të zbrazej. Edhe Kristina e ndjente këtë dhe u mundua t'i priste rrugën së jëmës, duke i ardhur pas oreksit.

— Ashtu qe fati, mama, — dhe i shkeli syrin Valit për të kërkuar të falur për lëshimin që po bënte.

— Demek e bëke dhe ti këtë që bëri kjo, po të dalka një fat i tillë!

— Mama!

— Teto Aspasi, po unë s'jam fejuar.

— Aq më keq... Dashuriçka.

— Po... një ditë mbase do të fejohemi.

— E sheh! Si s'të vjen keq për prindërit!? Të rritën një okë mish... Të bënë sa një... (s'e tha atë fjalë që i erdhi në majë të gjuhës). E tani u kthen kurrizin! Mjer kush, ka çupa në këtë ditë! Mjer kush ka çupa!

— E ke gabim.

— Posi, e paskam gabim unë... Ti e ke mirë.
Ç'do thotë nënëzeza e babaziu kur ta marrin vesh.
Le që ç'të thonë!? Tani që ua bëre proçkën!

Edhe Vali ndjeu se po nxehej.

— Mjer kush ka çupa!

— Po ti ç'ke që bërtet?

— Se më vjen keq, se po merr veten në qafë...

— Ahu... u!

— Po pse, moj korbë, pse? Mbetë pa burrë?

— Epo s'më gjete ndonjë ti me ato letrat e tua.

— Mua më merr të keqen... Le të bëjë ime
bijë këtë që bën ti, pa të shohë.

Si e kishte zënë Aspasia, as të nesërmen s'mbaronte, prandaj Vali e pa të kotë të vazhdonte më tej. U shtri mbi shtrat e s'po i kthente përgjigje. Aspasia jepte e merrte me veten. Edhe Kristina s'po ja ushqente fjalën.

Nga jashtë dikush thirri:

— O vullnetare... Vali moj?... Moj çupë!

Aspasia ngriti perden.

— Kush është?

— I ati Demirit.

Vali doli. Aspasisë s'ju ndejt pa përgjuar në dritare. Xha Bektashi u përshëndet me Valin, e pyeti për shëndetin e për punën e pastaj i tha pse kishte ardhur:

— Ti tani u bëre mike në shtëpinë time. Unë të kam si çupë. Po me ata pleqtë e tu s'njihemi. Bëju një copë kartë e thuaju të vijnë një herë këtej. Unë shkoja vetë, po s'jam për rrugë të gjatë tani. Më ka vënë pleqëria përposh. Thuaju të vijnë një herë, thuaju... Se nesër, pasnesër ti do të ikësh, po miqësia të na mbetet.

Plaku fliste ngadalë, mbështetur me të dy duart mbi shkopin e thanës dhe e shihte Valin në sy. Asnjëherë Vali s'kishte qenë kaq e ndrojtur në bisedë me xha Bektashin. Megjithatë, me fjalët e tij të fundit i erdhi për të qeshur. Bektashi, ndonëse e merrte me mend që i biri do t'i kish ntrashur punët me vullnetaren, donte ta kërkonte te i ati, sipas zakonit, mbasi t'ja kishte njohur mirë rrënjët e degët. Plaku as që e merrte me mend si mund ta fejonte ndryshe të birin. Ajo i premtoi se do t'u shkruante dhe ai u kthye e nisi të çapitej ngadalë.

Vali i futi krahun ta ndihmonte. Po ku pranonte Bektashi.

— Më rrofsh, më rrofsh, po shkoj vetë... S'jam bërë aq, — dhe iku.

«Do t'u shkruaj», përsëriti me mend ajo duke ndjekur me sy plakun, ndërsa letra kishte tri ditë që kish marrë udhën drejt qytetit të saj të lindjes. Ishte matur njëqind herë t'u shkruante për Demirin, po i dukej ende shpejt. Dhe, sikur të kishte biseduar më parë me xha Bektashin, u kishte shkruar që, po qe se rregullonte mamaja nja katër-pesë ditë leje, do bënin mirë të dilnin një herë nga fshati. Natyrisht, kjo s'ishte një kërkesë thjesht për t'u çmallur.

Vali hyri e menduar në dhomë. Kristina po lexonte. Aspasia kishte heshtur dhe po thurte tantene. Ngriti një herë shikimin mbi syza dhe i tundi kokën.

— Ç'të tha vjehri?

— Të thashë një herë që unë s'jam fejuar.

— Moj po lëri këto!

— Epo më tha se do të të çojë ty delegate të jashtëzakonshme, për të përfunduar marrëveshjen me prindërit e mi.

— Mua!?

Valit i mbiu një buzëqeshje e papritur. Ju ul pranë dhe i hodhi krahët supeve.

— E, moj teto Aspasi! Kështu e ka kjo koha jonë!

Ajo s'foli. Psherëtiu, lëvizi shpatullat për t'i liruar nga krahët e vajzës dhe vazhdoi të thurte tantella me penjët e bardhë dhe mendimet e saj të çuditshme. Përsëriti me mend fjalët e Valit: «Kështu e ka kjo koha jonë». Dhe pa Kristinën në sy. Ajo buzëqeshi.

ERËRA TË NDRYSHE

Ndoshta dikujt s'do t'i pëlqejë që në këta kapitujt e fundit po merrem më shumë me dashurinë e Valit, se sa me punën e saj në fshat. Këtë mendim kishte edhe Reshati, i cili qaj se Vali na paskej rënë shumë pas dashurisë dhe sikur po e zvarriste përgatitjen e bisedës që kishte për të punuar në organizatën e gruas. Po Fadili i thoshte:

— Të dashurosh në këto kushte dhe të mbrosh një dashuri si ajo e saja, në një front kaq të zbuluar, ku fryjnë erëra nga tërë anët, a nuk është punë e madhe? A nuk është ndoshta një problem më i rëndësishëm se shumë të tjerë?

Mbas një jave s'kishte mbetur njeri në fshat që s'e kishte marrë vesh dashurinë e Valit me Demirin. Ditët e para fjala filloi të hapej vesh më vesh, po kjo s'vazhdoi gjatë, se Fadili u bë vetë trumbetues. Ai u fliste të gjithëve dhe mundohej t'ua shpjegonte njerëzve drejt, që ta çmonin e ta vlerësonin lart këtë dashuri. Shpesh ai dashurinë e dy të rinjve e quante fejesë, po për atë kjo s'kishte asnjë rëndësi.

Fshati ziente. Rinia ishte entuziazmuar. Të vjetrit

e pleqëronin shtruar këtë çështje. Gratë e shikonin me tjetër sy.

Grupi artistik ishte nisur për të konkuruar në festival. Me diletantët kishte shkuar edhe Fadili. Kurse fshati turrte hollë e hollë fillin e Valit e të Demirit. Erërat frynin sheshit.

Në brigadë:

— Atë që bëri ajo, s'e ka bërë çupë në republikë.

— Pse flet kot... Se mos e dimë ne.

— E pakët të duket ty, a?

— Dale, se dardha e ka bishtin prapa. Janë hau e hiu akoma... Prit kur të dalin havazet. S'e fut Bektashi në shtëpi atë, or jo...

— E o! Demiri që s'ta mbushte syrin... I fortë doli.

— Qe i zgjuar ai, po lëri llafet.

— Do na nxjerrë telashe kjo punë.

— Ama dhe ti!

— S'ke çupë zotrote, prandaj... Pa më pyet mua, që kam një stan? Ecë e t'i mbash tani.

— Mirë e ke ti, Shaqo. Kjo puna e sevdasë është si viranoti. Një fije sheh sot këtu, pas një jave shtrihet e të zaptton parcelën. Ta mbajmë me shëndet tani, na e mbolli Vali këtë farë.

— S'na the gjë hiç. Hasëll, hasëll këtë farë e mbolli më parë e bija e Veliut.

— Veliut i pifsha dollinë. Është burrë ai... I tregoi sinorët.

— Këtu do të jemi po s'e mori i biri i Sadikut të bijën e Veliut.

— Në atë krah fli ti...

— Këtu do të jemi e do të shohim... Po Demirit i lumtë, mori çupë, jo shaka!

- Kur ta marrë.
- Ku ta kisha këtë fat për djemtë unë!

Gratë:

- Si thua ti, Kike?
- Çupa më pëlqen. Kur hyn e del, të ndrit shtëpia.
- Shoqe s'ka!
- Se mos ja njohim tabijetet. Janë ca piperka këto të qytetit, që të përvëlojnë. Unë kam hallin e Hamdies së shkretë...!
- Hamdia është bërë me krahë, ti...
- Posi, posi... E zu belaja pa... Ç't'i bëjë djalit! Apo s'e ka edhe të vetëm!
- Çupa s'ka të sharë.
- Ajo s'di të bëjë një çorap.
- Do të mësojë.
- Tani që u bë grua e burrit, do të mësojë!?
- Se mos vetëm çorape! Ajo s'di të bëjë një gjellë.
- Gjellët i bën që ç'ke me të. Ka gatuar te unë.
- Apo s'është e paqme!
- Po pajë do të ketë, thua?
- Më vrafshin mua, po solli gjë.
- E ku ta dish!
- Ja bleva mendjen, kur më erdhi në shtëpi.
- «Ç'janë këto pajëra të mëdha, — më tha. — Sot vajzat shpien ca gjëra të vogla... Të tjerat i bëjnë tok me burrin».
- Mirë e ka.
- U... u!
- Aq mirë sa... Ne kemi qenë budallaqe. Jemi gënjyer tërë jetën, jemi qeruar mbi qëndizma, për ca të shkreta lecka.

- E na u kallbën nëpër sëndyqe.
- Njeriu të jetë i mirë, pa leckat bëhen.

Në klub:

Dikush i thotë me zë të lartë banakierit:

— Na ruaj ca raki për në vjeshtë, se kemi dasma sivjet.

Këto fjalë, si një çelës automatik, i kthejnë gjithë bisedat, nga janë e nga s'janë, te Vali.

— E bëri fora vullnetarja!

— Qerrata i madh i biri i Bektashit, diti të shtjerë, qerratai.

— Diti të zgjedhë, diti.

Në një tryezë, tre burra bisedojnë kokë më kokë:

— Akoma s'e marrin vesh këta!

— Kushedi ç'ka bërë andej ajo e vjen i mbetet Demirit në dorë.

— Unë ja mora erën që sapo e pashë. Dukej ajo, bishtpërdredhur.

— Mjer Bektashi, thuaj!

Po pëshpëritjet e tyre shuheshin nën zërat e fortë, që mbushnin sallën e klubit:

— T'i bëjmë dasmë të madhe, se na e ka bërë borxh. S'ka lënë kusur e shkreta.

— E ka hak.

— Në vatrën e kulturës ta bëjmë.

Në shtëpinë e Bektashit:

— Mirse të gjej, Bektash!

— Bujrum, Veli, mirse të vish. Si je, ku je?

— Si të gjallët, me punë e me halle. Ti, a mbahesh?

— Me pleqëri. Ngroh vezët në furrik.

Heshtje. Këmbehen kutitë e duhanit.

— E po për hair të qoftë, o Bektash! Me këmbë të mbarë e huaja!

—

— Kështu më thanë. Apo janë llafe?

— Gjersa qenka mbushur fshati, s'do mend që llafe janë... Ç'është e drejta, djali e pëlqen. Edhe mua sikur ma ka qejfi. Po as që i kam hyrë kësaj pune.

— Unë kështu dëgjova.

Bektashi u prek në sedër.

— Epo, po qe kësmet, të bëhet, s'jam pishman.

— Demek e paske me zemër?

— Seftë m'u duk si e përpjetë... Se thashë sikur s'na puqen pipëzat. Po tani sikur po më mbushet mendja. S'e njuh çupën ti!

— Si, ore, s'e njoh!

— Mor po dëgjomë mua. S'e njuh hiç. Më ka bërë për vete shejtanka.

Veliu luajti kokën mendueshëm.

— Të them të drejtën, s'ma priste mendja.

— Ja!? Pse, or, si të duket çupa ty?

— Nga goja është brisk... E kam dëgjuar vetë unë. Edhe e zgjuar duket. Po ti ke zënë vendin. Edhe plaka avash-avash po të vjen pas. Çupa s'ke. Në shtëpi, e kam fjalën. Djalë tjetër për të martuar s'ke. E që të ngas llafin, do një çikë sajdi, një çikë yzmet pleqërie.

— Të thashë, o Veli, që nuk e njuh çupën ti, jo... o! Të tëra i bën ajo. Më mirë se çupat tona.

Përsëri heshtje e përsëri ndërrohen kutitë e duhanit. Veliut i ka rënë një hije e rëndë. Bektashi është çelur.

— Veli, po edhe për ty dëgjova se sikur e kishe çupën në fjalë.

—

— Më thanë se ta kërkoi Sadiku për të birin.

— S'ja dhashë.

— Gabim e ke.

— S'bëhem gazi i fshatit unë, Bektash! S'ka martuar njeri çupë brenda në fshat gjer më sot.

— Edhe krushqi me kaurët s'kish bërë njeri këtu gjer më sot, po unë, po qe kësmet, e bëj e as dua t'ja di hiç.

— Epo ty të mban konferenca për natë yt bir, më duket. Se si shumë ke ndryshuar. Le që edhe më parë ti ndryshe nga të tjerët ke qenë.

— More ca gjëra i kanë mirë këta të rinjtë, po hajde ti... S'kanë qenë gjë hiç këto punë... Jo turq, jo kaurë... Unë ja kam hequr fillin kësaj pune me kohë. E di ti... Kur më vodhën atëhere! Jepi para hoxhës unë e ai lutej që mos të më vidhnin hajdutët prapë. Kur na doli që hajduti na qenkej vetë hoxha! Që atëhere s'm'u ngroh e s'm'u ngroh më xhamia. Po kur prishi rinia tylobën e Sherifit! Ç'gjetën? Kocka gomari gjetën. Ca thoshin se ishin kocka kali, po unë i pashë me sytë e mi që ishin prej gomari. Prandaj të them që s'janë gjë ato, jo turq jo kaurë! Kaur ishte ai që më shpëtoi kokën në kohë të partizanllëkut, kur mbeç i plagosur në qafën e Zënçes. Më shpëtoi mua e mbeti vetë sakat. Dhe e bëra vëlla... Po tani që s'ka as hoxhë, as prift, as kishë, as xhami...? Ç'na gjeti? Ja vdiqëm ne pleqtë. Kujt do t'i bjerë ndër-mend se është turk apo kaur! Tani edhe emrat po përzihen. Ja, i biri i Selos djalit të vogël ja ka

vënë emrin Genc. Ndaj të them. Këto janë pesë me
hiç. Shqiptarët kanë qenë shqiptarë tej e mbanë.
Kështu tregonin pleqtë ca historira. Po vinin zap-
tonin turqit e i bënë një pjesë muslimanë, vinin
zaptionin grekët e i bënë një pjesë krishterë.

— E or, Bektash Metja, e...!

— Unë vetëm që u ruhesh llafeve të fshatit.
Po fundja do flasin, do lodhen e do pushojnë. Le
që të thashë, s'i kam hyrë akoma kësaj meseleje.
Edhe ti... «S'ka dhënë njeri çupë në fshat. Jepë
ti i pari. Po s'the një, s'thua dot dy. Ganiu i Sa-
dikut është goxha djalë. Apo u ruhesh llafeve dhe ti?

— More le llafet, po jemi një gjak e një soj.

— Me Sadikun?

— Se mos vetëm me të!

— Ama llaf dhe ti! Ta zësh ashtu, me tërë
Shqipërinë kam borxh të të nxjerr kushërrillëk. Yt
atë me tanë e Sadikut janë therur e janë grirë për
një bythë gorice, ti seç thua. Demek, edhe unë po
ta kisha kërkuar çupën tënde për Demirin, do të
na nxirrje kushërrinj!

— Ndonjë damar do ta kemi.

— Jemi ngrohur në një diell. Jepi or çupën
Sadikut me të mirë. Ata do të merren që do të
merren.

— Kur të kafshoj dhe unë, po. Sa të jem gjallë,
ja këpus kokën.

— I rruan bishtin. Dëgjove!? Se ta vënë ty
kokën në darë.

Veliu ngjiti fletën e cigares që i ishte shqitur.
U ngrit duke lëshuar një psherëtimë të gjatë, sikur
ta kishte bastun e do mbështetej në të.

— Ç'ke?

— Erdha nallban e dola i mbathur.

— Dëgjomë mua. Jepe çupën e mos e zgjat.

Tjetri s'foli. Me një lëvizje të brrylave rregulloi xhaketën e shajaktë, që kishte hedhur krahëve, lidhi duart pas shpine dhe mori rrugën e kërrusur, duke lëshuar fjolla të mëdha tymi.

M B R È M J A

Grupi artistik i Malasit zuri vendin e tretë në festival. Për shumicën e kooperativistëve kjo dukej e pabesueshme, kurse disa pleqve s'u vinte mirë.

— S'dolët të parët? S'qenkeni gjë. Na vini dhe me yner, pa le.

— Të fortë qenki, për ideal. Apo bëni shaka? — thoshte Reshati.

— Shikoje këtë. — Dhe i treguan flamurin.

— Epo ta djegim... Të bëjmë një mbrëmje. E kanë hak. Që sonte ta bëjmë.

— Ta bëjmë.

— Jo vetëm me grupin, po me gjithë fshatin.

— Me shpenzimet e kooperativës?

— Me shpenzimet e kooperativës vetëm për grupin artistik që na nderoi, se për tërë fshatin s'na mban qeseja. Jemi shtëpi e re akoma, baba-xhan...

Dhe u vendos që të bëhej mbrëmja. Nja katër-pesë të rinj shkuan të pregatisnin sallën e vatrës së kulturës. Tryezat i sajuan me dërrasa të gjata, duke i vendosur përmbi arka. Dy qoshet e ballit të sallës i regulluan njëri për bufenë e tjetri për

për orkestrën. Në orën 8, salla ishte mbushur plot. Fadilit e Reshatit as ua kishte marrë mendja se mund të vinin kaq shumë njerëz. Nëpër shtëpi kishin mbetur vetëm të vegjëlit e ndonjë plakë.

Diletantët ishin mbledhur të gjithë në një vend e tryezën ua kishin shtruar me gjithë të mirat.

— Epo fillojmë, o shokëni e shoqeni? — tha Fadili.

— Veç, aman, mos e bëj fjalën tërkuzë.

— S'jemi në mbledhje këtu, de.

— Jo, po, e ke si zakon ti.

Dikush qeshi. Fadili ishte ngritur dhe po priste. Salla u qetësua.

— Do ta bëjmë këtë mbrëmje për këta kapëdanët (tregoi me dorë tryezës ku rrinin diletantët), që na nderuan. Ju e dini më mirë se unë... Ne ishim hiç. Vjet s'muarëm pjesë fare. Sivjet drejt e në çmim. Mua se si më erdhi kur dëgjova ata të zhurisë. Sikur s'më bënin veshët. Po ne e morëm këtë. — Ai i mshoi zërit në fjalët e fundit dhe shpalosi flamurin.

Copa duartrokitjesh. Urime. Përshëndetje me zë të lartë.

— Në fillim, kur na thanë për grupin, ne u përtypëm: «S'bëhet...» Prapë na e kujtuan. Prapë «S'bëhet» ne. «Jemi fshat i vogël, kooperativë e re, s'kemi artistë».

— Fadil! — Dësh ta kujtonte dikush se po zgjatej.

— Epo, duhen thënë këto gjëra, që të na hyjnë në kokë. Po ç'tha partia e s'u bë, mor shokë?! Më shtrëngoi dorën dhe më uroi vetë sekretari i parë i rrethit. E, or, e, vetë. Ai që më dha dru një muaj më parë. Kështu posi.

Dikush po pëshpëriste:

— Për ideal, në ju gënjej. Ja, pyesni rininë. E thirri pastaj edhe Valin në zyrë. Me gjithë Demirin. Hë, mo, nuk ju tha «Ju lumtë»?

— Ashtu na tha, — u hodh Demiri.

— Na tha dhe ca gjëra të tjera, — pasoi Vali. Pëshpëritje. Të qeshura.

— Kishte kritikë? — pyeti me solemnitet Fadili.

— Jo.

— Po urime?

— Po.

— Ashtu më thuaj, Tani, shokë, unë, në emër të organizatës së partisë, të kryesisë së kooperativës e në emrin tuaj, falënderoj këto shoqet e këta shokët e grupit artistik, që na zbardhën faqen. Falënderoj Valin për tërë atë punë të madhe që ka bërë. Sidomos me çupat (e ngriti zërin). Jo. Me baballarët e çupave sidomos. Falënderoj shoket mësues, e sidomos Bashkimin që u bë copë. Falënderoj...

Po i mbeti fjala pezull, se s'dinte ku të vinte gisht.

— Epo... i falënderoj të gjithë. Rrcftë rinia! — Dhe filloi të përplasë shuplakat me forcë, duke ndjellë një duartrokitje të stuhishme. — Tani të pimë, të kërcëjmë, të këndojmë e të gëzojmë. Pastaj do japim çfaqje. Mbushja, Myrto.

Gërnetisti mezi po priste. E pasoi fizarmonika dhe dajreja. Të rinjtë shkonin e vinin në bufe dhe shërbenin nëpër tryeza. Filluan të këmbehen të kryqëzuara shëndete, urime, të qeshura, shikime, shaka e thumba me sheqer e me piper. Po mesi i sallës vazhdonte të mbetej bosh.

- Gëzuar!
- Gëzuar qofsh!
- Të kam gjetur!
- Të gjetë e mira!
- Me fund!
- Me shëndet!
- Gjak e dhjamë t'u bëftë.
- Gëzuar, rini!
-

Nëpër tryeza bisedat nisën të marrin udhë. Bektashit i vetëtinin sytë dhe i dridheshin mollëzat nga gazi. Bënte ç'bënte dhe i hidhte sytë herë Valit, herë të birit.

— Gëzuar, xha Bektash, — e uroi Vali dhe ngriti gotën.

— Me gaz të paça, moj bijë, — u kënaq plaku. Hamdia e ledhatoi që larg me një buzëqeshje si push kadifeje..

Veliu e Sadiku shikonin shtrembër njëri tjetrin, thurnin cigare të trasha dhe nxirrnin tym paresh-tur. Reshati mori gotën e rakisë dhe pjatën e mezesë me vete dhe shkoi e u fut në mes të të rinjve. Aspasia, të cilën Fadili e kishte marrë në tryezën e tij, rrinte si mbi gjemba. Këmbente nga ndonjë fjalë me të e me të shoqen, po muhabeti s'i ecte.

— Kjo çupa jote, që thua ti, la nam dje në festival. Jo se të bëj qejfin, po s'kish tjetër t'ja dilte në recitim. Nuk ta them kot, ë! Ma tha vetë sekretari i parë.

— Faleminderit!

— Edhe këtu në fshat po na bën punë tani. Pyeti, pyeti gratë. Folë, moj grua.

— Faleminderit!

— Hajde gëzuar! Në dasëm të Kristinës!

Orkestra kishte marrë një valle të shtruar.

— E, ku je, Myrto, ku je! Mos vdeksh kurrë!

— Bequa u ngrit e doli në mes të sallës.

— Hajde rini ta dredhim një herë me plakun,

— ju drejtua grupit të diletantëve. — Ngruhuni.

U çua Demiri, Bujari, Vali, Reshati, Ganiu...

— Jepi, Myrto, jepi!... Ohooo... o... hopa...

Hajde... Le-le-le... Hopa...

Dikush nxori dhe i dha shaminë. Po ai mori festen nga koka.

— Hajde... de-de-de... Hopa...

Vargu i valltarëve zgjatej. Nga diletantët s'mbeti njeri në tryezë. Edhe të tjerë ishin ngritur shumë. Vali herë pas here shkëputej, merrte gra e vajza nga tryezat dhe i fuste në valle. Fadili mori të shoqen. Edhe Kristina u shkëput dhe ju sul të jëmës. Ajo e kuptoi dhe i kafshoi buzën për t'i prerë hovin, po Kristina s'pyeti. E kapi për krahu dhe e tërhoqi.

Sadiku e Veliu vazhdonin të thithnin në hesh-tje cigaret e trasha. Bequa që mbytur në djersë e mezi merrte frymë, po s'e linte që s'e linte kreun e valles. S'i kishte bërë kurrë vaki të linte vallen në mes: «Ma paska bërë benë, qerratai!» — i thoshte Myrtos me mend. «Po edhe unë s'kam për ta lënë, sikur pika të më bjerë mun këtu». Dhe ngrinte zërin për t'i dhënë forca vetes.

— Hopa!

Vargu që zgjatur aq shumë, sa njerëzit mezi vërtiteshin. Tre katër të rinj në mes të vargut seç pëshpëritën vesh më vesh, pastaj u shkëputën dhe u shpërndanë nëpër vargun e valltarëve. Njerëzit fi-

lluan të ndërronin vendet në valle kaq shpesh, sa askush s'merrte vesh ç'po bëhej, veç Veliut, që i genë zgjeruar flegrat e hundës, Sadikut që po çelej, e Qeramit që ckërmitëj me vete, duke parë thumbueshëm nga pleqtë. Vali i kishte dhënë dorën Demirit dhe kërcente mbas tij, kurse më poshtë, nga mesi i vargut, Qukanjozi u shkëput nga vallja dhe Ganiu me Sanijen i dhanë dorën njëri tjetrit. Tani të gjithë e kuptuan qëllimin e lëvizjes së të rinjve gjatë valles. Po shumëkush s'mendonte për më tej. Qukanjozi shkoi dhe diç i tha Myrtos, në vesh. Ai e preu vallen si me thikë. Veli sikur u lehtësua. Bequa fshiu ballin e qullur me festen e zezë dhe u mbajt në krah të Demirit, sa t'i kalonte marramënti. Valltarët ishin hutuar nga ndalimi i befasishëm i orkestrës dhe vargu ende s'po shthurrej. Fizarmonika ja nisi përsëri, kurse gërneta e pasoi ngadalë dhe me pasiguri, gjersa kapi ritmin. Ishte një muzikë e panjohur për pleqtë. Bequa hapi sytë dhe u shushat.

— Ngaje, Beqo Selami, ngaje, — thirri dikush.

Një çast vargu i valltarëve mbeti i çoroditur. Myrtua luajti kokën i pakënaqur nga surpriza, po Qukanjozi i bëri shenjë të vazhdonte. Vali s'priti më. I futi krahun Demirit dhe filluan të kercenin. Demiri i shkeli syrin Ganiut dhe Sanijes, që ende s'i kishin shkëputur duart prej hutimit.

— Jepini, — u tha edhe Fadili. — Mos kini frikë. — Dhe iu kthye së shoqes. Hajde, moj këtu. Të kërcëjmë edhe ne kështu një herë, pa copë të bëhet.

Fadili dukej shumë qesharak në kërcim.

— Hajde rini... Kërceni. — Dhe i ra me brryl

Ganiut. Ai e mposhti hutimin më në fund dhe...
Një pjatë ra dhe u thye me zhurmë në çimento.

Sanijes ju drodh zemra. Ganiu mbajti frymën. Në atë atmosferë të nderë, zhurma e pjatës i ngjau një krisme.

— Për hair... për hair na qoftë... — ja pat Bequa.

Veliu hoqi thellë cigaren, sikur desh ta soste me një të thithur. Fadili me të shoqen, Demiri me Valin dhe Shpresa me një të kushëririn, që sapo ishin ngritur, formuan një mur midis Veliut e Ganiut me Sanijen. Ata filluan të kërcëjnë. Qukanjozi po matej të shkonte te Kristina, po s'ja mbante nga Aspasia. Bashkimi s'e la të mendohej gjatë. Hoqi fizarmonikën nga supet dhe u nis.

— Mund të kërcëj me Kristinën? — i kërkoi leje Aspasisë.

Asaj i vinte të hante veten. E sillte fjalën nëpër dhëmbë. Kristinës i erdhi turp kur pa se Bashkimi po skuqej duke pritur, dhe u ngrit.

— Ngrehu! — tha Aspasia si kofini pas të vjelit.

Të rinjtë filluan vallëzimin, kurse ajo shikonte sallën qoshe më qoshe. I dukej sikur të gjithë flisnin për të bijën. Kurse askush s'e kishte mendjen aty. Shikimet shigjetonin Veliun nga të gjitha anët. Sadiku qe çelur e qe ngritur. Muri i çifteve qe prishur dhe Ganiu e Sanija kërcënin përballë Veliut. Atij i therën tëmthat, ju mpinë gjymtyrët, kurse para syve nisën t'i formohen rrathë vezullues të mbushur me mijëra xixa. I kujtohej ajo natë, kur erdhi mori të bijën. Kurse tani...!

«Bukur po ma marrin hakun!»

Disa qeshën me të madhe. Ai u drodh, puliti sytë katër-pesë herë dhe bëri duart grusht. Po nje-

rëzit nuk po qeshnin me të. Fadili, duke u munduar të rrotullonte të shoqen në vallëzim, u pengua dhe po të mos e kishte mbajtur Demiri, do të qe këputur barkas.

— Ti e ke fajin, — i tha Valit. — S'ke bërë punë me organizatën e gruas. S'ma ke mësuar gruan të kërcejë.

— Se mos di ti më mirë!... O... o::: Avash, o se, më coptove, ej!

— Mos u mërzit... Do të mësojmë me forcat tona. Mos u tërhiq para vështirësive, shoqja grua. Prapë u ndezën të qeshurat.

— Qenke shumë i lezeçëm në mbrëmje, — i tha Vali me të qeshur.

— Rri, se mos të të dëgjojë kjo (tregoi të shoqen me kokë) e na mori lumi.

Veliu nxirrte duhan me gjuhë nga fundi i cigares dhe e përtypte me dhëmbët e rrallë. I dukej sikur kafshonte veten. Kokën e mbante poshtë dhe s'guxonte të shihte njeri.

«S'e kam ndjerë kurrë veten më ngushtë se sot! Dhe s'di ç'të bëj!»

I nguli sytë gotës së rakisë. I ra një fije duhani në të dhe nisën të formohen ca rrathë të vegjël, po që atij i dukej se shtoheshin e zmadhoheshin pashim dhe po e mbulonin të gjithin.

«O perëndi! Ime bijë e bën këtë!? I ka vënë dorën në sup atij... Ai e ka zënë për beli... Bark më bark e gjoks më gjoks... Me sa mend e bën këtë para syve të mi! S'e di ajo që ngrihem dhe i punoj qindin?!... E, Vali, Vali! Nuk ngrihesh dot, jo... o!.. Unë? Ti, or, ti...»

Ju kujtuan fjalët që kishte këmbyer me Fadilin: «Jam burrë zakoni unë».

«Ishe burrë zakoni, kur ishte kohë zakoni. Tani është kohë revolucion!».

I hodhi një shikim hajdutshe Sadikut.

«Të qesh buza, hë?! Pse mos të të qeshë! E ke mëzat ti... Po unë që e kam pelë! E s'ta jap çupën, or, jo... Kaq ta bësh dhëmbin. Apo do të vijë vetë? Në e bëftë këtë, në djall të vejë... Zëre se s'e pata...»

I nguli përsëri sytë rakisë dhe e mbuluan dallgë të mëdha, të turbullta. Edhe gërneta i gjëmonte në vesh, megjithëse ajo kishte pushuar e Myrtua po përtypte mish shelegu.

— Të kam gjetur, Veli!

Përpëlitej përmes dallgësh të turbullta e gjëmimesh gërnete.

— O Ve...li...i!

— Ohu...u — u mbush me frymë, si të kishte dalë nga ato dallgë fantastike.

Bektashi kish marrë gotën në dorë dhe po priste buzagaz.

— Të kam gjetur!

Veliu mori gotën.

— Të gjetë e mira, — e vuri gotën në buzë, po s'e hoqi fare.

— Të mirën të dëgjofsha, po pije me fund.

Veliu u bind dhe e ktheu gotën. Po e kapërceu me zor dhe s'kuptoi në i që ntrashur fyti, apo ishin ata rrathë të mëdhenj që s'kalonin dot.

— Me shëndet!

— E morëm edhe një fletë-lavdërimi tjetër sonte, — ja pat Reshati me zë të lartë. Veliu i nguli sytë, megjithëse nuk e ndjeu ku e qëlloi kjo batare.

— Gëzuar, Veli Cungu! — i tha Bequa, që i
qe afruar dhe i çiku gotën.

— Të pimë një gotë për rininë... Rroftë rinia!
— thirri Fadili. Të gjithë ngritën gotat. E ngriti
edhe Veliu, po i dogji më shumë se të tjerëve.

— Të pimë një gotë për rininë... Rroftë rinia!
zërin Veli. *Salla për përqafimin e Veli!*

— E, të paça, moj rini!

— Një për Partinë. Me fund! — Bektashi ishte
ngritur në këmbë. — Ta kemi sa malet.

U ngritën edhe të tjerët.

— Me fund!

— Tani do fillojmë çfaqjen, — tha Bujari.

Salla nisi të gumëzhijë. Perdja u mbyll. Dile-
tantët kaluan në prapaskenë. Duke ngjitur shkallët,
Veli i shtrëngoi dorën Sanijes, kurse, mbasi kishin
dalë prapa perdes, e përqafoi dhe e puthi në të dy
faqet.

ATJE KU THYHEN GURËT

Nga shirat që kishin rënë para një muaji dhe nga plehu kimik misri që harlisur si s'mbahej mend. Kishte hedhur trup e po priste kallëp. Po moti kishte nisur përsëri me të nxehtë e me sa dukej shirat do të vononin shumë. Fshatarët filluan t'i mbanin përsëri sytë nga qielli. Zienin diskutimet nëpër brigada, në kryesi, në organizatën e partisë, nëpër familje.

— Të hapim një kanal e, sido që të jetë, të shpëtojmë parcelat e brigadës së dytë e një pjesë të së tretës, — propozoi dikush.

— S'bëhet tani kanali. Do punë më nge.

— Bëhet, bëhet.

— Një brigadë as gjer në dimër s'e hap dot.

— Të punojnë dy brigada.

— Po punët e tjera, kush do t'i bëjë, Marika?

— Ato presin një javë. Të shohim ku humbasim më shumë.

— As me dy brigada s'bëhet gjë.

— Të vëmë tërë forcat në kanal.

Më në fund u vendos të liheshin punët e tjera që s'ishin shumë të ngutshme dhe të fillonin kanalën. Ai nuk do të hapej shumë i thellë dhe as që

do t'i bëhej ndonjë sigurim kushedi se çfarë. Kjo punë do të lihej për në dimër. Tani luftohej për të shpëtuar misrin nga thatësira. Të sigurohej buka.

Më e vështira qe pjesa që kalonte nëpër një grykë shkëmbi të zi, që mezi çahej. Megjithëse s'kishte më shumë se 100 metra, kjo pjesë mori dy ditë të mira dhe me sa dukej s'do mjaftonte as e treta. Punonin të gjithë. Jo vetëm brigadat, por dhe punonjësit e administratës. Pushimet bëheshin të shkurtëra. Puna niste në pesë të mëngjezit dhe lihej kur perëndonte dielli. Nuk mateshin normat. Nuk bëheshin llogaritje për ditët e punës. As që pyeste njeri në do të paguheshin me normë, apo me ditë pune fikse. Ishte lufta për bukën, një nga luftrat më të njohura dhe më epike të fshatarit. Edhe aty kishte diçka epike, në shikimet e njerëzve, në forcat e tyre të pashterura.

Nga dreka, korieri i fshatit i solli Fadilit një copë letër. Ai e lexoi, u mendua pak dhe e futi në xhep. Pastaj e përshkoi fund e krye vargun e kooperativistëve që punonin, këmbëu nja dy fjalë me disa prej komunistëve, me Bujarin, me Valin, me Agimen, kryetaren e oragnizatës së gruas dhe vazhdoi punën. Brigadat dhe skuadrat ishin përzier. Vali e la lopatën dhe mori një vare.

— Lëre këtë, lëre. S'është për ty kjo, — i tha xha Bequa. Po ajo bëri sikur s'dëgjoji dhe nisi të godasë një kokë shkëmbi. I dha nja pesë-gjashtë të goditura, po krahët ju prenë e s'e ngriti dot më hekurin e rëndë.

— Të thashë, moj, lere varenë. S'është me inat, po me takat.

Ajo s'kundërshtoi më.
Shpëtimi ju afrua Fadilit.

— Më mirë të bëhet mbledhje, — them unë.
— S'kemi kohë për mbledhje.
— Në mos me të gjithë, të bëhet mbledhja e organizatës së gruas.

— Gratë janë gjysma.
— Po si do të vendoset?
— Ja, këtu.

Në pushimin e drekës, Fadili lajmëroi që të mos shpërndareshin kories, po të mblidheshin te sheshi i vogël, se kishin pesë minuta punë. Një-rëzit ishin të lodhur e s'u erdhi mirë, po përsëri u bënë kureshtarë. Fadili filloi pa ceremonira:

— Na njoftojnë se këto ditë hapet një kurs për gratë në një nga qytetet e bregdetit. Nga kooperativa jonë kërkohen tri shoqe. Të vendosim këtu.

— Ç'është ky kurs?
— Sa do të zgjasë?
— Si e qysh, e tek...

— Kursi do të vazhdojë tre muaj. Gratë do të mësojnë për të qepur, për gatime, për pastërti...

— I dinë gratë tona këto.
— Posi s'i dinë.

— Atje do të bëjnë edhe punë politike. Kjo është sidomos...

Ndërsa Fadili po sqaronte qëllimin e kursit, Kasëmi i thoshte Qeramit:

— Do të ngrihem i pari për time shoqe.
— Je në vete?

— Budalla! Më tha një mik nga Pisha. Fjalë e sigurtë, ë?! Do të mësojnë të qepin në maqinë. Kur të kthehen, kooperativa do t'u blerë maqina e do merren me atë punë. Bie shi, bie dëborë e e vret ditën e punës ajo. Shko ha dhe me dhëmbë

ti e unë. Pastaj... do qepë edhe kështu, nën dorë...
Po, merr vesh ti!

— Kështu të jetë, thua?

— Fjalë e sigurtë.

— Fadili po e sjell si ndryshe. Thotë që atje gratë do të bëhen agjitate.

— E... e, ashtu e sjell ai, që të mos dalin vullnetare ë të dërgojë të shoqen. Si s'i kupton këto gjëra, bre Qeram? Ma mban dhe veten për të zgjuar, pa le!

Ishin ndezur bisedat. Në sytë e grave dhe të vajzave lëvrinin dëshira.

— Hajde, se s'kemi kohë, — tha Fadili, — të vendosim.

Vali diç bisedonte me ca shoqe.

— Hë, se s'do t'i dërgojmë asqere të shkretën. Për të mirën e tyre bëhet kjo. Të tyren dhe të fshatit. Hëni, se na zu nata këtu. Hajde, shoqeni. Flisni vetë ju. Mos prisni lejen e burrave.

Heshtje e shkurtër.

— Epo mirë thotë Fadili... Sikur kushedi ç'është, — u hodh Kasëmi. — Shënoje atë timen, o Fadil.

Fadili shënoi një emër mbi copën e letrës.

— Edhe dy shoqe të tjera.

— Gonxhen, — propozoi dikush.

— Pikës i ke rënë.

Fadili u mat të shënonte, po u ngritën zëra:

— Jo, jo. Një tjetër.

— Mezi e sollëm brigadën në terezi.

— Ka të tjera plot këtu. Mos na e largoni brigadieren.

— E ka bërë atë kurs ajo. Le të bëhen dhe të tjerat kaq sa Gonxhja, pa...

Ishte e pamundur të ndërroje mendjen e brigadës.

— Tjetër?

— Unë, — tha Shpresa.

Fadili i shkeli syrin Beqos.

— E, o derëzi, ç'më shikon? Shkruaje.

— Edhe një tjetër duhet.

— Unë.

— Shënomë edhe mua.

— Shënoje time bijë, — u ngrit mbi të tjerët zëri i trashë i Veliut.

— Oj, oj... Të zbrazim pushkë... Që kur kë-shtu, o Veli?

Disa u hutuan. Fadili ja nguli sytë plakut për të deshifruar qëllimin e tij. Edhe Vali këtë punë po bënte.

Fadili ngurroi të shkruante.

— Shënoje, — u dëgjua përsëri zëri i Veliut.

— Unë s'jam dakord, — tha Vali si kishte këmbyer një shikim me Sanijen. — Të shkojë një tjetër!

— Pse, moj, ti, ç'ka ime bijë? — kërceu Veliu — Hë, moj? — ju kthye Sanijes. — Ç'thua ti? S'vete atje ku të thotë partia?

Sanija s'diti ç'të thotë. Edhe Fadili u zu ngushtë. Veliu e kishte vënë para një hendeku dhe, kur të hidhej, duhej të matej mirë.

— Mos kam qenë ballist unë? — e thelloi më tepër hendekun Veliu. Edhe Vali s'priti më gjatë.

— Sanija s'e bën dysh fjalën e partisë, po tani kemi ca punëra të tjera këtu në fshat. Kurse do të hapen përsëri... — Ajo e pa që Veliu po matej t'i merrte fjalën, ndaj u ngut t'i priste rru-

gën, duke menduar se s'ishte rasti për debate të tilla.

— Fundja të tjerat folën para xha Veliut. Le të shkojë Agimja. Është edhe kryetare e gruas.

— Pa dale, dale një herë.
Fadili s'e la të vazhdonte më tej.

— Agime ç'thua ti?

— Unë do të dilja e para, po kisha hall mos flisnin të tjerët. . . Mos ma merrnin për keq.

— Do të hapen prapë kurse dhe do të shkojnë shoqe të tjera. Kështu. Mbaruam. Domethënë do të ikin këto shoqe. Vera Shkëmbi, Shpre. . .

— O Fadil. . . Prit, ore, prit. . . Dale një herë. . . E ke marrë vesh gabim byrazer. Unë thashë për gruan, jo për çupën. Shëno atje Hysnie Shkëmbi.

Dikush qeshi.

— Dëgjo ,Kasëm! Më mirë të shkojë Vera, — tha Fadili. — Aty duhen edhe një çikë me shkollë, se do të bëjnë edhe mësimë. Hysnia s'para ja thotë gramës. Verën të lëmë.

— Jo, jo. . . Unë thashë për gruan.
Filluan pëshpëritjet, të qeshurat, thumbat. Disa ngritën zërat.

— Demek për çupën paske frikë?

— E dhe fjalën tani e mos luaj.

— Unë thashë për gruan

— Ti the «atë timen».

— Po, bre, gruan time.

— Pse jot bijë s'është jotja? Rri tani.

Pasuan dhe shumë zëra të tjerë. Kasëmi s'u ndie më.

— E. . . e! — i tha Qerami. — Shkove të qe-
thje mjekrën e priftit, po erdhe qeroz.

— Atëhere Vera Shkëmbi, Shpresa Sejdini e

Agime Mullai. Këto shoqe do të nisen pasnesër. Do të shkojnë në qytet e që atje, tok me ato të kooperativave të tjera, do të nisen me autobuz. Tani të hamë bukë, të marrim një frymë e të vazhdojmë punën.

Dikush po ngacmonte Veliun.

— Si e pate sot, o Velo?

— Si e pata? Hiç, ore... Të shkojë me shoqet, ku thotë partia.

— More leri ato... Ti deshe ta largoje nja tre muaj, se kushedi ç'mendoje.

I erdhi hidhur Veliut, po s'pati fuqi të kundërshtonte të vërtetën. U ul pas një trungu dhe hapi torbën e bukës. E bija zuri vend pranë tij. Filluan të përtyphen në heshtje, duke menduar për njëri tejetrin. Sanija ktheu kokën nga Vali dhe i buzëqeshi. Nuk ishte thjesht një buzëqeshje, po një shënjë e singërtë admirimi, një falënderim i përzemërt. Vali ndjeu një të goditur me guriçkë në ije. Ktheu kokën dhe mori një falënderim tjetër nga Ganiu.

D Y L E T R A

Bujari, Vali e Qukanjozi po rregullonin para zyrave të kryesisë një fotoekspozitë me fotografi të nxjerra nga revistat e gazetat. Rreth tyre qenë mbledhur një grumbull fëmijësh kureshtarë. Fotografitë ishin me formate të ndryshme dhe kjo u sillte vështirësi për t'i vendosur.

— Në mes duhet ta lëmë vendin bosh. Duhet të bëjmë një artikull për 10 Korrikun.

— S'e ke keq.

Qukanjozi po vendoste geramat e titullit të fotoekspozitës.

— I ke vënë shtrembër, — tha Bujari.

— Dale... Këtu në mes, thua ti?

— Edhe këto dy këtej. Duhet më lart.

— Në formë harku duken më bukur.

Qukanjozi s'pritti diskutime dhe filloi t'i heqë geramat prej letre.

— Në të majtë të titullit, lart, të vëmë këtë, — dhe Vali u tregoi të tjerëve foton e përmendores së një ushtari, që mbante pushkën gati për të hapur zjarr.

— Në të djathtë këtë tjetrën, — tha Bujari dhe

tregoi një skicë — pllakat, dy duar të fuqishme, që shtrëngonin kazmën dhe pushkën.

Dhe vendosja e fotografive mori udhë.

Pas ndonjë gjysmë ore, kur ata pothuaj kishin mbaruar punë, Valit dikush i ra lehtë në sup. Ktheu kokën dhe pa Tefikun, korierin e fshatit, i cili bënte dhe punën e shpërndarësit të shtypit dhe të letrave.

— Të kam sjellë letër.

Valit i ndritën sytë.

— E ke nga pleqtë më duket. Si shumë letra kini këmbyer këto kohë.

I rrëmbeu zarfin nga dora dhe filloi ta hapte me padurim. E shpalosi letrën dhe nisi të përpijë me sy shkrimin e njohur të të jatit.

— Kam edhe një për Aspasinë. Zahmet, shpjerja një çikë.

Vali zgjati dorën pa e ndërprerë leximin. U gëlltit disa herë. Lexonte pothuaj pa marrë frymë. Dhe papritur ja krisi vrapit. Bujari dhe Qukanjozi shtangën.

Hyri në dhomë si furtunë, duke përplasur derën pas murit. I erdhi rëndë që s'u përmbajt. Po Aspasia kishte dalë. Kristina s'po merrte vesh gjë. S'e kishte parë kurrë Valin kështu. Sytë i shkëlqenin, si t'i kishte lyer me vaj, fytyra i avullonte.

— Kristina! — e përfshiu për beli, e vërtiti një herë dhe e uthi fort.

— Moj! Ç'pate? Të iku?

— Lexoje! — dhe i zgjati letrën e shpalosur. U shtri në shtrat, me fytyrë nga tavani, mbylli sytë dhe u mbush me frymë e kënaqur.

Kristina filloi të lexonte.

«E dashur bija jonë Vali!

Letrën tënde e morëm dhe e kënduam me radhë...

Valit s'ju durua dhe u ngrit me vrull nga shtrati.

— Këtu lexo, në fund.

— «Ç'është e vërteta, edhe përpara se të na shkruaje ti, na pat shkuar ndërmend që të vinim nja dy ditë andej. Po gjene s'vendosnim dot, se mos bëheshim gazi i botës, si disa që ndjekin fëmijët pas nëpër aksione... Këtë radhë i dhamë karar e nga java që vjen na prit.

Të fala:

Vangjeli, Tefta, Kiçua»

— Domethënë... — mërmëriti Kristina.

— Domethënë mund të kemi ca probleme... — Dhe Vali e përqafoi përsëri. I mori letrën nga dora, e palosi me kujdes dhe e futi në zarf.

— Kam për t'i punuar një numër që ta çmend fare.

— Kujt?

— Shokut përgjegjës të blektorisë. — Dhe ju sul derës. — Ou... Harrova. Tefiku më dha edhe një letër për teto Aspasinë.

Dhe mund të duket si një koinçidencë e kurdisur. Po ja që ndodh edhe kështu. E vjetra me të renë janë kaq afër me njëra tjetrën! Më afër se dy fqinjë, që i ndan një mur ose një avlli. Ato hyjnë te njëra tjetra, fërkohe, gryejnë njëra tjetrën, mpleksen e shpleksen me njëra tjetrën... Rruga ku ecin ato është e ngushtë për të dyja,

megjithatë janë bashkë. Njërën e tërheq fort e ardhmja. Tjetrën mundohet ta mbajë e shkuara. Dhe ato kacaviren pas njëra tjetrës. Sikur të qe aq lehtë që t'i dallonim e t'i ndanim, do ta kishim thurur shtëpinë tonë me një avlli të lartë e s'do linim të na hynin brenda degët me gjemba të së vjetrës. Po ja që s'është kështu. Dhe jo për fajin tonë. Nga të gjitha luftrat, kjo është më e çuditshmja e ndoshta më e vështira. Forcat armike shpesh janë të përziëra dhe s'dallohen dot as nga uniforma, as nga llojet e armëve. Ato vazhdimisht fërkojnë, thuren e s'thuren e një ditë përplasen përballë, si këto dy letra. Ato mund të mos kishin ardhur në një ditë. Po patjetër do ishin përplasur një ditë tjetër, në një formë tjetër. Dhe patjetër njëra palë do të kishte humbur një copë front, një llogore... Sigurisht e vjetra.

Kristinën e kishte shushatur gazi i Valit dhe ende s'po e mbidhte veten. E solli zarfin disa herë nëpër duar dhe, si e ngrirë, filloi ta hapë. Brenda gjeti një fletë fletoreje të mbushur nga të dy anët.

«E dashura Aspasi!

Jemi të gjithë mirë. Dëshiroj që edhe ju kjo letër t'u gjejë mirë me shëndet e me ç'ju do zemra. Porosinë që më dhe, s'e kam harruar. Më duket se e gjetëm, Aspasi. Është një goxha djalë. Unë e bëra timen e gjer më tani punët i kam në vijë. Tani hap sytë. E quajnë Nikollaq dhe është inxhinier. Është nga derë e mirë. I kam shoshitur të tëra unë dhe mos ki merak për gjë. Djali ka vetëm pleqtë dhe një motër. Po dialë për kokën e

djalit, ama. Kështu në të parë, sikur s'ta mbush syrin, po është njeri me një barrë mend, moj të keqen. Apo s'ka një fjalë të ëmbël! Mjaltë, mjaltë! Po sjellja e tij! Ç'të të thotë Dhorka ty!? Merr nja tetë a nëntëmijë në muaj. Me shtepi të tijën, me plaçkë e me prokopi. Lum Kristinka në ç'derë do të hyjë, po qe kësmet të bëhet. Kërkoj çupën e një gjitones sonë, po s'ja dhanë. Se na qenka i madh! Ç'janë këto, moj të keqen, ç'janë këto! Ai s'ka mbushur 33... Apo ta zëmë shumë, shumë 35! Po ka lezet. Po s'që burri një çikë i pjekur, i prokopisur... le që shyqyr që s'e dhanë, se do të na e kishin marrë fatin nga dora».

Kristinës ju frynë damarët. I hipi një e nxehtë, që po e mbyste. Sytë i digjnin. Kurse dhëmbët i kërcisnin ndër ethe.

«... Unë fola me tëmën e djalit. Ç'zonjë, moj Aspasi! Ata janë dakord. U tregova dhe fotografinë e Kristinkës. Tani e kemi lënë kështu: djali do ta shohë një herë çupën me sytë e tij. Epo fundja s'jemi në kohë të Turqisë, de... Le ta shohë. Ta shohë, ta pëlqejë e ta marrë me dashuri, si tërë bota.

Kështu puna! Tani ti më jep përgjigje mua. O të vijë djali atje, o dil e prite me vajzën në qytet. Ose bëni si të bëni dhe hajdeni një ditë këtej. Veç mos ma vono përgjigjen, se puna më s'pret. Kam marrë vesh se i kanë hyrë edhe për një çupë tjetër. Po munde, bëme telegram.

Njëqind të puthura
Dhorka

Kristinës i puth ato syçkat e bukura, që m'i ka si të kukllave».

Kristinës i erdhi neveri, ndjeu të përziëra, i dogji fyti e muskujt ju tendosën. Pastaj ju duk vetja si diçka krejt e zbrazët. Dhe nga ai boshllëk i gënjeshtërt shpërtheu një duf i menjëhershëm. Ajo e shtrëngoi letrën me të dy duart, sikur të kish kapur njeri prej fyti dhe desh ta mbyste. I dha krahëve fort anash, sikur do të provonte në mund të këpuste një zinxhir të trashë. I mbajti një çast copat e letrës me grushtat e shtrëngur dhe hodhi sytë nga dritarja. Vali kishte dalë nga udhëza si shtrat përroi dhe vraponte drejt stallës. Mbi fshat po binte tisi i hirtë i muzgut. Kristina ndjeu t'i lëngësh-toheshin sytë, po u gëlltit dhe i kapërdui lotët. Ju afrua dritares, hapi për gjysmë njërin kanat dhe, pa ja ndarë sytë Valit, filloi ta bënte letrën copëza, copëza, të cilat puhiza e lehtë e mbrëmjes i dridhte në ajër dhe i shpërndante mbi rrugë, ku do t'i shkelnin njerëzit.

— Ç'po gris ashtu, moj?

Kristina u drodh dhe mblodhi duart grusht.

— Një letër, — tha pas pak, si e mblodhi veten nga zëri i papritur i së jëmës, që po e shihte nga poshtë.

— Do bësh pa fshirë.

— Do t'i marrë era, — tha Kristina dhe hodhi një grusht me copëza letre, që u shpërndanë si fjolla bore. Aspasia priti gjersa ranë në tokë dhe vazhdoi rrugën duke shkelur mbi to, pa e kuptuar se po shkelte ëndërrat e saj.

Kristina hapi kanatet deri në fund, që të ngopej me ajrin e freskët të mbrëmjes.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Ngjitje me ngarkesë të rëndë	3
Pranë njerëzve	22
Ujërat e burimeve të hidhura	30
Prita	42
Revolta	57
Çorba e xha Beqos	68
E papritura	82
Vajzat	90
Kthesa	98
Duke pritur shiun	105
Dhe guri po merr vlagë	117
Mysafire te xha Bektashi	129
Tri ditë në shtrat	134
Reportazhi	156
Në mbrojtje të dashurisë	164
Një letër anonime	190
Kujtime rinie	200
«Të kam gjetur, xha Bektash!»	205
«Natë e bukur!»	213
«E, kjo dashuria»	217
Koha jonë	222
Erëra të ndryshme	228
Mbrëmja	236
Atje ku thyhen gurët	246
Dy letra	253